

MËSIMDHËNIA E HISTORISË MODERNE TË EUROPËS JUGLINDORE
Materiale Mësimore Plotësuese

Perandoria Osmane

Mësimdhënia e Historisë Moderne të Europës Juglindore. Materiale mësimore plotësuese. Redaktor për botimin në gjuhën shqipe: Helian Demiri

Titulli në origjinal: Teaching Modern Southeast European History, Alternative Educational Materials, The Ottoman Empire (*Mësimdhënia e Historisë Moderne të Europës Juglindore, Materiale mësimore plotësuese, Perandoria Osmane*), Selanik, 2009

Përkthyen nga anglishtja: Danjela Shkalla, Lumnis Çela, Sonila Danaj, Ymer Leksi

Redaktor gjuhësor: Prof. Dr. Tomor Plangarica

Recensentë për botimin në gjuhën shqipe: Prof. Dr. Xhevat Lloshi, Prof. Dr. Remzi Përnaska

Faqesja dhe botimi: Shtypshkronja „Obod” ad Cetinje

Numri i kopjeve: 700

Ky botim është financuar nga Bashkimi Europian



The European Union's Instrument for Pre-accession Assistance (IPA)

“The contents of this publication are the sole responsibility of the author and can in no way be taken to reflect the views of the European Union.”

Përmbajtja e këtyre librave është përgjegjësi vetëm e autorëve dhe nuk mund të thuhet se paraqet pikëpamjet e Bashkimit Europian

Raportues i CDRSEE-së në bordin drejtues të *Projekti i Historisë së Përbashkët*: Costa Carras

Drejtor ekzekutiv: Nenad Šebek

Drejtor i programeve: Corinna Noack-Aetopoulos

Koordinatorë të projektit: Antonis Hadjiyannakis, Zvezdana Kovač, Jenny Demetriou & Susan Nadeau Bustamante

Sponsorë për botimin në gjuhën shqipe:

THE PUBLICATIONS AND TEACHER TRAINING ACTIVITIES OF THE JOINT HISTORY PROJECT HAVE BEEN MADE POSSIBLE THROUGH THE KIND FINANCIAL BACKING OF THE FOLLOWING:



Copyright: Center for Democracy and Reconciliation in Southeast Europe (CDRSEE)

Krispou 9, Ano Poli, 54634 Thessaloniki, Greece

Tel.: +30 2310 960820-1; Fax: +30 2310 960822

e-mail: info@cdrsee.org, web: www.cdrsee.org

ISBN 978-99956-726-8-3

MËSIMDHËNIA E HISTORISË MODERNE TË EUROPËS JUGLINDORE
M a t e r i a l e M ë s i m o r e P l o t ë s u e s e

LIBRI I PUNËS 1

Perandoria Osmane

Redaktorë: HALIL BERKTAJ dhe BOGDAN MURGESKU
Redaktore e përgjithshme e serise: KRISTINA KOULOURI
Redaktor për botimin në gjuhën shqipe: HELIAN DEMIRI

Botimi i dytë



Cetinë 2012





FALËNDERIME

Bordi drejtues i Qendrës për Demokraci dhe Pajtim në Europën Juglindore (CDRSEE) dëshiron t'u shprehë mirënjohje të thellë të gjithë studiuesve dhe kontribuesve të tjerë të cilët, me punën e tyre serioze, bënë të mundur përfundimin e katër *Librave të punës të Historisë*, që tashmë po botohen për të dytën herë në gjuhën shqipe dhe janë botur gjithashtu në jo më pak se shtatë gjuhë të ndryshme të rajonit. Është për tu theksuar se në vitin 2009 librat u përkthyen edhe në një gjuhë tjetër, në atë japoneze.

Një kontribut të shkëlqyer ka dhënë prof. Kristina Koulouri (koordinatore e përgjithshme dhe redaktore e serisë), pa punën serioze dhe profesionalizmin, aftësinë drejtuese dhe përkushtimin vetjak të së cilës do të ishte e pamundur të përfundonte ky projekt. Përpjekjet e palodhura dhe përkushtimi i gjashtë redaktorëve të katër *Librave të punës*, prof. Halil Berktajit dhe prof. Bogdan Murgeskut (*Perandoria Osmane*), dr. Mirela Luminita Murgeskut (*Kombet dhe shtetet në Europën Juglindore*), prof. Valeri Kolevit dhe prof. Koulourit (*Luftërat Ballkanike*), dhe Z. Kreshmir Erdeljasit (*Lufta e Dytë Botërore*), të cilët, pavarësisht nga pengesat e shumta që kanë hasur gjatë këtyre dy viteve e gjysmë, bënë të mundur botimin e librave që ju sot keni në dorë. Bordi drejtues u është tepër mirënjohës këtyre studiuesve, për bashkëpunimin e ngrohtë dhe përpjekjet e tyre të vazhdueshme.

Gjithashtu do të donim të falënderonim edhe të gjithë studiuesit që kontribuan për hulumtimin, shqyrtimin dhe grumbullimin e materialeve të përfshira në këta libra – katërbëdhjetë studiues, nga njëmbëdhjetë shtete të Europës Juglindore. Ne i falënderojmë ata shumë për zëmërisht për orët që kanë kaluar në arkivat kombëtarë të vendeve të tyre, bibliotekat dhe koleksionet vetjake, për të gjetur tekstet dhe figurat e përfshira në këta libra. Një falënderim i veçantë u përket edhe mësuesve të historisë, të cilët morën pjesë në takimet e punës për të vlerësuar apo për të dhënë vërejtjet përkatëse për këta *Libra pune*, gjatë procesit të shkrimit të tyre. Do të dëshironim të përmendnim këtu edhe anëtarët e Komisionit të CDRSEE-së për Mësimin e Historisë, të cilët janë përfshirë në këtë projekt qysh kur ai nisi, në vitin 1998.

Prof. Robert Stradlingu, prof. Maria Todorova, prof. Peter Vodopivec dhe Ivan Vejvoda, duke qenë recensentë të këtij botimi, kanë shqyrtuar dhe komentuar hollësisht përmbajtjen e të katër *Librave të punës*, duke dhënë në këtë mënyrë një kontribut të rëndësishëm në saktësimin, harmonizimin dhe baraspeshimin e burimeve të përfshira në ta.

Së fundi, shumë falënderime stafit të CDRSEE-së, të cilët e përkrahën qysh në fillim këtë projekt, kontribuan dhe mbështetën procesin që nga hedhja e idesë, deri në realizimin e tij përfundimtar.

Ishte e kuptueshme që ky botim do të kishte edhe reagime kundërshtuese në vendet ku *Librat* u paraqitën, prandaj do duhej të falënderonim anëtarët e Bordit të vendeve të ndryshme dhe gjithashtu Nenad Sebek të cilët kanë bërë një punë të palodhur që të shmangin apo sqarojnë keqkuptimet dhe që të mundësojnë përdorimin e këtyre *Librave të Punës* si materiale ndihmëse në shkollat e mesme.

Mbi të gjitha, falënderime shkojnë për mësuesit nga Europa Juglindore të cilët kanë marrë pjesë në projekt, kanë kontribuar në të, e kanë vlerësuar atë dhe vazhdojnë ta çojnë më tej, përkushtimi dhe guximi i tyre janë thelbi për suksesin e vazhdueshëm të PHP. Tashmë *Librat e Punës* janë botuar në disa gjuhë të rajonit dhe materialet mësimore janë përdorur gjatë këtyre tre viteve në Ballkanin Perëndimor dhe në Qipro. Një numër prej 740 mësuesish janë trajnuar deri më tani dhe aktivitete të cilat synojnë zgjerimin e rrjetit të

mësuesve të historisë të trajnuar për përdorimin e këtyre materialeve që japin një paraqitje nga shumë këndvështrime të historisë, po ndërmerren në mënyrë serioze dhe energjike.


Përgjigjet pozitive që Qendra jonë ka marrë për përpjekjet e saj si nga mësuesit ashtu edhe nga nxënësit tregojnë që vetë *Librat e Punës* ofrojnë një vlerë në përgatitjen e historianëve të të ardhmes, apo dhe qytetarëve të ardhshëm, dhe që Europa Juglindore, në kundërshtim me komentet ironike dhe veprimet cinike të disa vëzhguesve të jashtëm, është në shumë plane, më në përputhje me nevojat e të ardhmes sesa disa rajone të vetëkënaqura. Projekti i Historisë së Përbashkët i ndërmarrë nga Qendra jonë nuk ka për qëllim të kritikojë mënyrën sesi historia mësohet në Europën Juglindore, por është një përgjigje pozitive ndaj sfidave me të cilat përballen rajone të ndryshme të botës ku mendohet se një mësim më i mirë i historisë së këtyre rajoneve do të sjelle shpresë për një të ardhme më të mirë.



Kosta Karras

Raportues pranë bordit drejtues të Projekti i Historisë së Përbashkët.

Bordi Drejtues dëshiron të shprehë një falenderim të thellë dhe gjithashtu të verë në pah kontributin e vyer të Kosta Karrasit. Qe ideja dhe frymëzimi i tij që bënë të mundur fillimin e këtij projekti, si dhe përkushtimi dhe energjia e tij e pashtershme që e mundësuan realizimin e kësaj nisme. I detyrohemi së tepërmi për ndjekjen e tërë ecurisë së projektit dhe për punën e tij si përfaqësues i Bordit drejtues për këtë projekt.



Richard Schifter
Kryetar i bordit drejtues (deri në 2006)



Dr Erhard Busek
Kryetar i bordit drejtues (prej 2006)

PARATHËNIE

Modernizimi i mësimdhëniessë historisë në shkollë, shfrytëzimi dhe përdorimi i metodave bashkëkohore në mësimdhënie është proces që në periudhën e tanishme është i domosdoshëm, sidomos kur kihen parasysh nevojat për një rifreskim të teksteve shkollore të historisë dhe kërkesat e vetë mësuesve për të përditësuar mësimdhënien.

Për t'i ardhur në ndihmë mësimdhënies së historisë në shkollë, e cila aktualisht gjendet përballë kërkesave të kësaj natyre, është ndërmarrë hartimi dhe botimi në anglisht dhe në disa prej gjuhëve të vendeve të Ballkanit, dhe në këtë kuadër edhe në gjuhën shqipe, i *Librave të punës* për mësimdhënien e historisë në shkollë, si material plotësues në studimin e historisë së Europës Juglindore.

Botimi i *Librave të punës* është bërë në kuadër të projektit ndërbalkanik "Mësimdhënia e Historisë Moderne të Europës Juglindore" të Qendrës për Demokraci dhe Pajtim në Europën Juglindore (CDRSEE).

Në këto *Libra pune* trajtohen disa periudha me rëndësi të veçantë të historisë së rajonit të Ballkanit. Librat janë një përmbledhje tematike burimesh parësore, dokumentare dhe pamore, që fokusohen në këtë problematikë: *Perandoria Osmane, Kombet dhe shtetet në Europën Juglindore, Luftërat Ballkanike dhe Lufta e Dytë Botërore*.

Ky botim synon që të sjellë një sërë risish nga të cilat mund të përmendim:

- Njohja dhe interpretimi i fakteve dhe dukurive historike në shkollë përmes burimeve parësore, të cilat nxisin dhe zhvillojnë mendimin kritik të nxënësve dhe debatin.

- Vështrimi dhe studimi i historisë kombëtare si pjesë e historisë së rajonit, historisë europiane dhe asaj botërore, duke iu larguar në këtë mënyrë shkrimit të historisë me nota nacionaliste dhe etnocentriste.

- Studimi dhe interpretimi i fakteve dhe dukurive që lidhen me jetën e përditshme të popujve të këtij rajoni, me zakonet dhe doket e tyre, veshjet, artin, kulturën, letërsinë, fenë, legjislacionin, me shqetësimet dhe meditimet që lindin tek njerëzit e thjeshtë, që më tej bëhen bartës, pse jo edhe aktorë në histori.

Sidoqoftë, librat nuk mëtojnë që të shqyrtojnë në mënyrë shteruese çdo aspekt historik që lidhet me këto periudha; ato synojnë të nxisin kërkime të mëtejshme studimore, kritika dhe debate.

Me botimin e librave në gjuhën shqipe, tashmë edhe mësuesit, nxënësit dhe studiuesit shqiptarë do të kenë një mundësi më shumë që t'i përdorin këto materiale në mësimin dhe mësimdhënien e historisë, si dhe në punën e tyre kërkimore.

Helian Demiri

Redaktor për botimin në gjuhën shqipe

Paraqitja e projektit

Përgatitja e materialeve plotësuese për mësimdhënien e historisë së Europës Juglindore është sipërmarrje tepër ambicioze dhe e vështirë, meqenëse interpretimi i së shkuarës kolektive dhe përmbajtja e historisë, ashtu siç mësohet në shkollë, ka shkaktuar debate të shumta e të nxehta jo vetëm ndërmjet vendeve fqinje, por edhe brenda të njëjtit shtet.

Megjithatë, nevoja për një botim të tillë ka dalë si përfundim i natyrshëm i projekteve studimore, të cilat gjatë dhjetëvjeçarit të fundit janë përpjekur të analizojnë materialet dhe programet shkollore, pikëpamjet e mësuesve dhe opinionit publik në vendet e Europës Juglindore.

Komisioni i CDRSEE-së për Mësimin e Historisë filloi punën për *Projektin e Historisë së Përbashkët* në vitin 1999. Mbasi organizoi dy seanca trajnimesh dhe botoi dy libra (*Mësimdhënia e historisë së Europës Juglindore dhe Clio në Ballkan. Politikat e mësimdhënies së historisë*), Komisioni ishte në gjendje të përcaktonte mangësitë konkrete në mësimin e historisë, karakteristikat e ndryshme të sistemeve arsimore, rolin e administratës qendrore, dëshirat dhe synimet e mësuesve për futjen e risive në procesin e mësimdhënies së historisë.

Ndaj u vendos që të shkohej përtej përcaktimit të problemeve e këqyrjes së gjendjes së tanishme, dhe të përvijohesh një mënyrë e re për mësimdhënien e historisë, e cila do të ishte fryt i njohurive të përbashkëta jo të një grupi të vogël historianësh, por të një rrjeti më të gjerë studiuesish, të cilët kanë kontribuar në dy fazat e para të *Projektit të Historisë së Përbashkët*. Përveç koordinatorëve, të cilët ishin përgjegjës për strukturimin e secilit libër dhe për përcaktimin përfundimtar të burimeve, në këtë projekt kanë kontribuar edhe dy studiues nga secili vend, të cilët përzgjedhën dokumentacionin (tekstet dhe figurat), sipas udhëzimeve të vendosura në konceptimin fillestar të librave. Për më tepër, librat, të cilët janë paraqitur këtu në këtë formë përfundimtare, janë rishikuar dhe vlerësuar fillimisht në formën e tyre paraprake nga dy mësues, në takime të veçanta të realizuara vitin e kaluar, për të parë se sa të pranueshme ishin këto materiale mësimore për vetë mësuesit e historisë. Së fundi, materialet janë rishikuar nga pesë recensentë: Kosta Karrasi, Robert Stradlingu, Maria Todorova, Peter Vodopivec dhe Ivan Vejvoda. Ata kanë dhënë një ndihmesë të vlefshme në lidhje me aspekte të veçanta të historisë së Europës Juglindore dhe mbi çështjet e mësimdhënies së historisë.

Projekti u hartua duke patur parasysh dhe shqyrtuar pikat e mëposhtme:

- 1) programet e veçanta shkollore dhe paragjykimet etnocentrike në mësimdhënien e historisë, të cilat ekzistojnë në të gjitha vendet e rajonit;
- 2) faktin që ndryshimet në tekstet shkollore të historisë, në shumicën e vendeve të Europës Juglindore, varen nga ministritë e arsimit, të cilat ushtrojnë një kontroll të rreptë mbi përmbajtjen e programeve shkollore dhe librave;
- 3) dëshirën e mësuesve për të pasuruar dhe rifreskuar mësimdhënien me materiale plotësuese, të cilat mund t'i gjenin lehtë;
- 4) pamundësinë për të hartuar një tekst të vetëm shkollor, ku historia e Europës Juglindore të paraqitej si një e vetme, i cili të mund të përdorej në të gjitha shtetet e Europës Juglindore.

Për këto arsye menduam që është më mirë të përgatitim libra tematikë (*librat e punës*) me dokumente të shkruara dhe pamore, të cilët do të shërbejnë si plotësues të teksteve ekzistuese shkollore.

Pra, këta *libra pune* nuk synojnë të zëvendësojnë tekstet shkollore të Historisë që përdoren tani në klasë, as nuk mëtojnë të japin një përshkrim shterues të historisë së Europës Juglindore nga shekulli i 14-të deri më sot. Megjithatë, ata kanë synime informuese dhe morale, mundësojnë metoda të shumta dhe mjete të larmishme

për mësimdhënien e historisë. Ata sugjerojnë rishikimin dhe rishkrimin e **metodave të mësimdhënies së historisë dhe jo brendinë a përmbajtjen e saj.**

Qëllimet dhe përzgjedhja

Për përcaktimin e qëllimeve të përgjithshme dhe të veçanta të këtij materiali mësimor, si dhe për përzgjedhjen përfundimtare të temave dhe burimeve historike të përfshira në të, pika fillestare ishte vlerësimi realist i kushteve të tanishme të mësimdhënies së historisë dhe krijimi i një koncepti të ri, më largpamës në interpretim. Propozimet tona bazohen në studimet e kohëve të fundit në fushën e historisë dhe në projekte të ngjashme për përmirësimin e mësimdhënies së historisë, kryesisht në Europë.

Në këtë kuadër, propozohen dy ndryshime të rëndësishme:

Ndryshimi në mënyrën e trajtimit historiografik të dukurive

- Historia kombëtare që mësohet në shkolla **nuk duhet të jetë histori nacionaliste**. Duke marrë të mirëqenë faktin që forma mbizotëruese e historisë në shkolla është historia kombëtare, ndërsa historia e vendeve fqinje mësohet sipas një këndvështrimi etnocentrik, ne nuk propozojmë ta zëvendësojmë historinë kombëtare, por të ndryshojmë mënyrën se si jepet mësim.
- Historia e rajonit të Europës Juglindore nuk mund të shikohet më vete, **por si pjesë e historisë europiane dhe e historisë botërore**. Kjo do të thotë gjithashtu që ideja se historia e Ballkanit pati një zhvillim të “veçantë” nuk është e pranueshme dhe mënjanohet si klishe dhe paragjykim.
- Historia e secilit shtet më vete, dhe e rajonit në tërësi, nuk është trajtuar si e pandërprerë, e njëtrajtshme dhe harmonike. Ndarjet, konfliktet dhe këndvështrimet e ndryshme janë vënë në dukje po aq sa edhe elementet e përbashkëta dhe të përafërta. Në vend që të përpiqemi të paraqitim një pamje harmonie të rreme, dëshirojmë të tregojmë mënyrat se si t’u **mësojmë nxënësve rreth dallimeve dhe kontradiktave**.

Ndryshimi në metodën e mësimdhënies

- Historinë mësojmë që të njohim dhe kuptojmë të shkuarën tonë. Nëse e gjithë lënda e historisë kombëtare që mësohet në shkolla, njësohet me kombin, atëherë bëhet një përpjekje për të kuptuar që kombi nuk duhet të shihet si i vetmi identifikim i mundshëm. Nxënësve u kërkohet të shkojnë përtej kombit, të identifikohen me tërësi më të gjera ose më të ngushta dhe të **pranojnë identitete të ndryshme që plotësojnë njëri-tjetrin**. Identiteti femëror apo mashkullor, identiteti vendor a lokal, identiteti i një tifozi në klubin e futbollit apo identiteti evropian mund të paraqiten si shembuj identitetesh që mund të bashkëjetojnë, pa qenë, në të vërtetë, njëllot të rëndësishëm për individët që i mbartin ato. Nxënësve u mundësohet të zgjerojnë njohuritë e tyre, duke shtrirë horizontet e së shkuarës përtej kufijve të gjeografisë politike.
- **Zhvillimi i mendimit kritik** është një tjetër qëllim i rëndësishëm i mësimdhënies së historisë. Ky qëllim mund të arrihet me më shumë sukses me anë të përdorimit të dëshmive a dëshmitarëve të drejtpërdrejtë të pranishëm në ngjarje, që paraqitin pamje të ndryshme të së njëjtës ngjarje, ekzistenca e të cilëve lëkund sigurinë e një të vërtete të vetme dhe përjashtuese ndaj interpretimeve të tjera.
- Puna me dëshmitë historike synon të kultivojë tek nxënësit elementet e punës **kërkimore e interpretuese të historianit**. Është e rëndësishme për nxënësit të kuptojnë që një dokument historik mund të jetë subjekt i interpretimeve të ndryshme; kjo nuk do të thotë që ai dokument është keqpërdorur apo që është shtrembëruar qëllimisht.

■ Përmes mësimit të historisë, nxënësit duhet të zhvillojnë aftësinë për të vlerësuar veprimet njerëzore dhe të japin gjykime morale. Zhvillimi i mendimit kritik nuk mund të bazohet thjesht në ngritjen e dyshimeve; ai duhet të ndihmojë për të krijuar qytetarë të përgjegjshëm me vlera morale, të cilët janë në gjendje të përballojnë çdo lloj përpjekjeje për t'i mashtruar ata.

Në hartimin e këtij projekti është mbajtur parasysh që të gjithë popujt e Europës Juglindore të jenë në gjendje të gjejnë veten e tyre në këta *libra pune*. Ndaj, dy kërkesa qenë të nevojshme:

a) **përputhja** e brendisë së librave të punës me programet dhe tekstet e tanishme shkollore;
b) **paraqitja e baraspeshuar** dhe përfaqësimi po ashtu i barabartë i të gjitha vendeve të Europës Juglindore në to. Për të patur këtë përputhje, u përzgjedhën katër tema të historisë moderne që gjenden në të gjitha programet shkollore të rajonit:

- Perandoria Osmane
- Kombet dhe shtetet
- Luftërat Ballkanike
- Lufta e Dytë Botërore

Për të patur përfaqësim të baraspeshuar, kërkuam dëshmi historike nga njëmbëdhjetë shtete, pa përdorur kriterin e kontributit të secilit shtet në historinë e rajonit, dhe pa përdorur asnjë lloj njësie matëse. Megjithatë, përfaqësimi i secilit vend ndryshon në varësi të temës së librit. Për shembull, ishte e natyrshme që Sllovenia të dilte më në pah në librin mbi Luftën e Dytë Botërore, sesa në librin mbi Luftërat Ballkanike. Mungesa e baraspeshës hera-herës ka ndodhur edhe për shkak të gatishmërisë së treguar nga studiuesit, të cilëve iu kërkuar të studionin burimet për secilin shtet dhe shkallës së punës kërkimore të bërë nga vetë ata. Gjithashtu duhet shtuar se disa vende kanë arkiva të organizuar më mirë, botime sistematike të dokumenteve dhe mundësi për të punuar me një shumëllojshmëri më të madhe burimesh historike. Pra, ka pasur pengesa të cilat, pavarësisht nga synimet tona paraprake, kishin një ndikim të pashmangshëm në baraspeshën përfundimtare të dokumenteve.

Katër tema, një koncept

Nëse gjeografikisht brendia e katër librave ka të bëjë me Europën Juglindore, nga Sllovenia në Qipro, shtrirja e tyre kronologjike përfshin periudhën nga pushtimi osman i Ballkanit deri në ditët e sotme. Temat që zgjedhëm mbulojnë të gjithë këtë hark kohor dhe plotësojnë njëra-tjetrën. Ndërkohë që ecuria kronologjike e ngjarjeve shfaqet në vijimësi nga njëri libër tek tjetri, ka edhe pjesë të cilat përkohë me njëra-tjetrën.

Libri i punës 1 – Perandoria Osmane dhe **Libri i punës 2 – Kombet dhe shtetet në Europën Juglindore** mbulojnë periudha të gjata kohore, nga shekulli i 14-të deri në fillim të shekullit të 19-të, dhe nga shekulli i 18-të deri në fund të shekullit të 20-të. **Libri i punës 3 – Luftërat Ballkanike** dhe **Libri i punës 4 – Lufta e Dytë Botërore** mbulojnë periudha më të shkurtëra kohore dhe përfshijnë dy konflikte të mëdha të armatosura në rajon. Në këndvështrimin tonë, *Libri i punës 1* dhe *Libri i punës 3* kanë të bëjnë më tepër me historinë rajonale, ndërsa dy të tjerët, *Libri i punës 2* dhe *Libri i punës 4*, u përkasin kryesisht historisë europiane dhe botërore, edhe pse ata sërish përqendrohen në Europën Juglindore.

Nuk kemi lënë mënjanë, gjithashtu, **historinë e politikës dhe të diplomacisë**. Përkundrazi, dy nga *librat e punës* kanë luftën si temë kryesore. Kjo përzgjedhje mbështetet në besimin tonë që heshtja ndaj konflikteve të shkuara nuk është rruga më e përshtatshme për të përvijuar e nxitur paqen në të ardhmen. Për popujt e Europës Juglindore, luftërat përbëjnë një pjesë të madhe të përvojës së tyre të përbashkët historike dhe do të ishte gabim t'i linim jashtë një projekti që synon të nxitë njohjen e së shkuarës së përbashkët.

Si në aspektin e saj vërtet tragjik, po ashtu dhe në imazhin e saj heroik ose të idealizuar, lufta në shekullin e 20-të ka qenë me të vërtetë ngjarje e rëndësishme dhe ka shoqëruar kujtimet e të gjithë brezave. Monumentet, ceremonitë, përvjetorët dhe varrezat i forcojnë dhe i përjetësojnë këto kujtime edhe më tepër. Prania e saj

ka pasur të njëjtën rëndësi edhe në historiografi. Në historiografinë tradicionale të bazuar në ngjarje, lufta vendoset në qendër të periudhës historike dhe mbizotëron në trajtesat a interpretimet historike të periudhës përkatëse. Shumica e kthesave historike përkon me ngjarje politike ose luftëra. Përveç kësaj, i gjithë shekulli i 20-të mund të ndahet në periudha, me anë të një ecurie kronologjike luftërash: Luftërat Ballkanike, Lufta e Parë Botërore, vitet mes dy luftërave, Lufta e Dytë Botërore, periudha mbas Luftës dhe Lufta e Ftohtë, si dhe luftërat në Jugosllavi. Mpakja ose zbehja e ngjyrave të ndezura të ngjarjeve historike hera-herës perceptohej nga disa studiues e didaktë si një politikë e përshtatshme për një arsimim paqësor: historia nuk do të shqyrtonte dhe nuk do të bënte interpretime për luftërat në periudha të caktuara dhe nuk do të trajtonte modelet heroike luftarake, por do të përqendrohej në jetën e përditshme dhe në historinë ekonomike, shoqërore dhe kulturore. Por si mund të mësojmë rreth shekullit të 20-të ose shekujve të mëparshëm, pa iu referuar luftës? Nga ana tjetër, a i shkatërron përfundimisht paragjykimet a klishetë ekzistuese mësimdhënia që përqendrohet në jetën e përditshme, pa trajtuar ngjarjet politike, konfliktet ideologjike dhe ndarjet shoqërore? Në të vërtetë, politika e të mësuarit vetëm rreth asaj çka lidhet me jetën e përditshme dhe kulturën lë çështje tepër delikate të hapura për interpretime, të cilat nxënësit do t'i kërkojnë dhe gjejnë jashtë shkollës. Por mësimdhënia e historisë parakupton t'i mbrojë ata ndaj interpretimeve paragjyquese të së shkuarës, të cilat kanë të bëjnë kryesisht me konfliktet politike dhe shoqërore. Zgjidhja gjendet në një metodë më të re. Dikush mund të mësojë për luftën, pa i thurur lavde asaj dhe pa detaje, shifra apo data të mërziutshme. Lufta mund të mësohet si pjesë e një përvojë të përbashkët njerëzore, në llogore e në prapavijë, me anë të syve të fëmijëve, me anë të urisë, varfërisë, strategjive të mbijetesës dhe mëdyshjeve morale. Është pikërisht kjo metoda që ne zgjodhëm në përgatitjen e këtyre *librave të punës*.

Në të njëjtën kohë, u munduam t'u kushtojmë vëmendjen e duhur pjesëmarrësve të heshtur të historisë, si *grave dhe fëmijëve*, të cilët tradicionalisht mungojnë në tekstet shkollë. Nëse nuk arritëm shkallën e përfaqësimit që dëshironim, kjo ndodhi për shkak se në burimet më të shumta dhe më të shfrytëzueshme, gratë dhe fëmijët zënë një vend të vogël.

Protagonistët në këta *libra pune* janë "njerëzit e mëdhenj", të njohur madje edhe jashtë kontekstit të historisë së tyre kombëtare, por edhe njerëzit e thjeshtë, anonimë, nga çdo cep i Europës Juglindore, ata të cilët, në fund të fundit, i japin "jetë historisë". Nëse do të fshinin emrat e njerëzve dhe vendeve nga tekstet, në disa raste nuk do të ishim të sigurtë se cilit shtet apo popull u referohen ato burime. Një formë e tillë pune në mësimdhënie, një ushtrim i tillë shkollor, do të tregonte *të përbashkëtat e shumë përvojave*, pavarësisht nga ndarjet kombëtare dhe kufijtë politikë.

Ne jemi përpjekur të paraqitim jo vetëm aspektet negative të përvojës historike, por edhe ato pozitive, ato që shprehin ndjenjat njerëzore, si miqësia, solidariteti dhe dëfrimi. Ndaj në *Librat e punës 3 dhe 4* kemi përfshirë kapituj të veçantë që trajtojnë akte humanizmi dhe solidariteti në kohë lufte, në kohë konfliktesh, urrejtjesh dhe mbijetesë. Megjithatë, jemi munduar që në pamjen a portretin vetjak të popujve të Europës Juglindore *të paraqitim edhe anët negative të tyre*. Në të vërtetë, sfida më e vështirë ndoshta është të bashkërendojmë veten tonë me anët negative dhe të errëta të historisë sonë.

Luftërat në Jugosllavi gjatë viteve 90-të risollën në trajtesat perëndimore shumë paragjyqime a klishë negative mbi "të veçantën e Ballkanit". Kjo seri *librash pune* mbi historinë bashkëkohore të Europës Juglindore u jep vetëm një përgjigje të pjesshme paragjyqimeve të tilla. Megjithatë, kjo përgjigje nuk bazohet në ndonjë përpjekje për të provuar "vlerën" e rajonit. Ne besojmë se informacioni që kanë këta *libra pune* është i mjaftueshëm për të hedhur dritë mbi paragjykimet dhe për të kontribuar për një vetidentifikim evropian, në të cilin përfshihet edhe kjo pjesë e kontinentit.

Së fundi, përzgjedhëm formën e një botimi "*tradicional*" të shtypur, ku teksti është mbizotëruar ndaj figurës, çka mund t'i bëjë këta libra të duken më pak tërheqës, madje edhe të vështirë për t'u lexuar. Është e qartë se është më e vështirë të lexosh një tekst të shkruar në një gjuhë të panjohur, sesa të "lexosh" figurën nga një shtet, gjuhën e të cilit dikush nuk e flet. Pra, problemi kryesor i komunikimit ndërmjet mësuesve të historisë në vendet e Europës Juglindore ka qenë pengesa gjuhësore. Por përkthimi i shmang këto pengesa dhe na mundëson të dëgjojmë zërin e të tjerëve.

Për më tepër, aspekti më i rëndësishëm i të qenit konservator nuk lidhet me mjetin. Është e qartë që një CD-ROM mund të përdoret po aq tradicionalisht sa një libër i shtypur, ndërkohë që interneti përfshin informacione të diskutueshme që shtrembërojnë dëshmitë historike dhe riprodhon paragjykime dhe interpretime të cekëta.

Struktura dhe përdorimi

Siç u përmend edhe më lart, katër librat plotësojnë njëri-tjetrin, pavarësisht se në të njëjtën kohë secili nga ata përmban një tematikë të veçantë dhe mund të përdoret më vete.

Struktura e përgjithshme e këtij botimi është si më poshtë:

- **Hyrja e përgjithshme**, e shkruar nga koordinatori i përgjithshëm, në të cilën paraqitet koncepti i përgjithshëm i *Librit të punës* dhe ku mësuesve u jepen udhëzime metodologjike. Hyrja e përgjithshme gjendet vetëm në *Librin e punës 1*;
- **Kronologjia** (Pasqyra e ngjarjeve);
- **Hyrjet e veçanta** për secilin *Libër pune*, të shkruara nga koordinatorët përkatës dhe që paraqitin temën e veçantë të secilit *libër pune*;
- **Seksionet tematike** - Katër deri në gjashtë kapituj, me një numër të ndryshëm nënkapitujsh. Secili kapitull nis me një hyrje të shkurtër dhe përfshin tekste dhe figura, të paraqitura ose të shoqëruara me shënime shpjeguese, ndërkohë që secilin tekst e pasojnë pyetje të veçanta.
- **Referencat**, të cilat në të vërtetë përbëjnë një bibliografi të përbashkët për të gjitha vendet.
- **Hartat**, dy ose tri për secilin libër pune.

Në përzgjedhjen e dokumenteve kemi përdorur parimin që çdo relike nga e shkuara mund të perceptohet si burim historik. Prandaj jemi përpjekur të përfshijmë shumë llojshmëri tekstesh dhe figurash, në mënyrë që ato të bëheshin shprehëse të aspekteve politike, ekonomike, shoqërore dhe kulturore të përvojave të ndryshme historike dhe të shkaktonin reagime të ndryshme tek lexuesi. Kemi ndjekur **të njëjtin model për paraqitjen e teksteve** në të gjithë *librat e punës*, sipas të cilit çdo tekst ka një titull, pasohet nga një shënim shpjegues dhe nga pyetjet. Për më tepër, në disa raste ka pyetje të përgjithshme në fund të çdo kapitulli. Pyetjet synojnë të ndihmojnë mësuesit e historisë gjatë mësimdhënies; ata mund t'i përdorin pyetjet ashtu siç janë, ose mund të krijojnë pyetje të tjera. Gjithashtu mund të përzgjedhin tekste paralele, nga dy ose tre *libra pune*, siç këshillohet ndonjëherë edhe nga pyetjet që u referohen *librave të tjerë të punës*.

Për mësuesit e historisë së një vendi, praktikisht është e vështirë të paraqitin dëshmi nga vende të tjera dhe t'i përfshijnë në të njëjtin kontekst, përderisa kjo kërkon njohuri të cilat ata nuk i kanë marrë gjatë arsimimit të tyre. Kjo është arsyeja përse priremi të japim sa më shumë informacion që të jetë e mundur për secilin tekst, por pa anashkaluar iniciativën e vetë mësuesve. Mësuesit mund t'i përdorin tekstet në dy mënyra:

1. Si mundësi hulumtimi **në këndvështrimin e të tjerëve** për një ngjarje të cilën vetë ata dhe nxënësit e tyre e njohin nga leximi i një teksti etnocentrik;
2. Si tregues **të ndjenjave dhe përvojave të përbashkëta**, të njerëzve që u përkasin grupeve të ndryshme kombëtare ose etnike, në lidhje me **një çështje të diskutueshme**.

Marrja e njohurive vetë është e mjaftueshme për të hequr paragjykimet e krijuara. Paragjykimet dhe klishetë ushqehen nga padija; mungesa e marrjes së njohurive ka përfutur gjendjen e tanishme, që karakterizohet nga njohuritë e kufizuara që kemi për fqinjët ose për periudha të tëra të historisë sonë. Heshtja mund të jetë aleati më i fortë i klisheve dhe paragjykimeve. Ndaj njëri prej qëllimeve të *librave të punës* është qëllimi njohës: të japë informacion për zhvillimet historike në Europën Juglindore, dhe të nxitë e të parakuptojë edhe pyetje të ndryshme. Librat nuk mëtojnë që të shqyrtojnë në mënyrë shteruese çdo aspekt historik që lidhet me këto periudha; ato synojnë të nxisin kërkime të mëtejshme studimore, kritika dhe debate.

Përdoruesit e librave të punës mund të jenë kryesisht nxënës në klasat e larta të arsimit të mesëm, 15 deri në 18 vjeç, për të cilët është hartuar enkas ky material mësimor, por mund të jenë edhe studentë universiteti

si në Europën Juglindore, dhe në atë Perëndimore. Ndërsa vazhdonte puna jonë me librat, kuptuam interesin që ky botim do të kishte për historianët perëndimorë, të cilët nuk kanë mjetet e nevojshme për të studiuar historinë e rajonit. Një përmbledhje burimesh nga të gjitha vendet e Europës Juglindore në anglisht do të ishte e nevojshme për një publik akademik perëndimor, i cili e njeh historinë e Ballkanit pothuajse tërësisht nga burime bibliografike dytësore.

Katër ndalesa në udhëtimin nga shekulli i 14-të deri sot

Ne vendosëm t'ia kushtojmë *Librin e punës 1 Perandorisë Osmane*, sepse kjo periudhë, e cila përbën pjesën më të madhe të përvojës së përbashkët historike të popujve të Europës Juglindore, nuk është pranuar nga botimet e mëparshme si pjesë e së shkuarës kolektive. Edhe pse ajo mësohet në të gjitha vendet e rajonit, këndvështrimi është gjithnjë etnocentrik – i nisur nga pikëpamja ngushtësisht e përcaktuar e një pale të interesuar. Për rrjedhojë, njohuritë në lidhje me këtë perandori të madhe, e cila mbizotëroi në Europën Juglindore dhe detin Mesdhe për shumë shekuj me radhë, janë të pasistemuara dhe të paragjykuara. Pikëpamjet për Perandorinë Osmane luhaten nga vlerësimi për të si faktor përparimtar, deri tek ato që e konsiderojnë si një faktor që ndikoi në prapambetje; ajo vështrohet mes parajsës shumëkulturore dhe egërsisë së pushtimit, lirisë dhe shkatërrimit. Këto interpretime, të cilat bien ndesh me njëra-tjetrën, janë pasqyruar edhe në historiografinë perëndimore që trajton këtë periudhë historike.

Paraqitja e Perandorisë Osmane si pjesë e së kaluarës së përbashkët historike nuk do të thotë që e paraqesim atë si “periudha e artë” e bashkëjetesës harmonike të popujve të Ballkanit. Siç e përmendëm edhe më parë, përvoja e përbashkët historike përfshin si përplasjet, ashtu dhe bashkëjetesën. Për më tepër, Perandoria Osmane nuk ishte një njësi e njëtrajtshme dhe e qëndrueshme. Ashtu siç ndodhte shpesh me perandoritë shumetnike dhe shumëfetare, ajo karakterizohej nga kontradikta e përplasje të brendshme dhe ka ndryshuar përgjatë historisë, duke njohur periudha përparimi dhe krizash. Së fundi, njohja e thellë e kësaj perandorie ndihmon të mënjanohet paragjykimi i përhapur në pjesën e krishterë të Europës Juglindore dhe në Europën Perëndimore – rreth “prapambetjes” së saj kulturore.

Pikënisja jonë ishte shekulli i 14-të, kur Perandoria Osmane u shfaq për herë të parë në rajon dhe filloi të pushtonte Ballkanin. Ne vendosëm që *Libri i punës 1* të mbulojë periudhën deri në fillim të shekullit të 19-të. Megjithëse kjo periudhë, sigurisht që nuk është fundi i Perandorisë Osmane, përkon me shfaqjen e lëvizjeve kombëtare që çuan në krijimin e shteteve ballkanike në shekujt e 19-të dhe të 20-të. Rënia e shkallëshkallshme e perandorive dhe ndërtimi i shteteve kombëtare mbi gërmadhat e tyre është subjekti i *Librit të punës 2*, i cili përkon pjesërisht me të parin, pasi fillon në shekullin e 18-të. Një pjesë tjetër e paraqitjes së Perandorisë Osmane gjendet edhe në *Librin e punës 3*, i cili mbulon Luftërat Ballkanike. Pra, i këshillojmë lexuesit të bëjë lidhje paralele ndërmjet *Librave të punës*.

Libri i punës 2, mbi “**Kombet dhe shtetet në Europën Juglindore**”, trajton një temë tepër delikate dhe të debatueshme. Që nga lëvizjet kombëtare kundër Perandorisë Osmane, deri në luftërat në Jugosllavi, konfliktet ndërmjet kombeve në rajon kanë patur ndikim tepër të rëndësishëm për zhvillimin historik të tij. Edhe sot, lajmet mbi territore a zona pak a shumë “të nxehta”, sondazhet mbi opinionet e njerëzve, por madje dhe disa aspekte të mësimdhënies së historisë konfirmojnë mbijetesën e pasioneve kombëtare. Sigurisht, një temë e tillë që ka një rol qendror në historinë moderne të rajonit nuk mund të anashkalohej. Një tjetër mëdyshje që patëm në hartimin e këtij *libri pune* ishte shtrirja kohore e problematikës në të: ta ndërprisnim trajtimin në fund të Luftës së Madhe apo të shkonim përtej Luftës së Dytë Botërore? Ka pasur argumente të forta kundër përfshirjes së viteve 1990 në këtë libër, por në fund vendosëm që ishte e nevojshme të përfshihej kjo periudhë bashkëkohore e lëvizjeve dhe konflikteve kombëtare, për të arritur një kuptim më të plotë të së tashmes sonë. Për më tepër, në këtë rajon, gjatë kësaj periudhe të fundit, janë krijuar disa shtete kombëtare.

Përveç ndarjeve të veçanta tematike, *Libri i punës 2* ndjek një linjë kronologjike, në mënyrë që të mos mbetet një ushtrim teorik mbi nacionalizmin, por për të treguar edhe: 1) ecurinë e përcaktimit të një kombi; 2)

kronologjinë dhe shtrirjen gjeografike të lëvizjeve kombëtare dhe, pa dyshim, edhe dallimet ndërmjet tyre; 3) fazat e ndryshme në formimin e shteteve kombëtare në Europën Juglindore. *Libri i punës 2*, më tepër se sa librat e tjerë të punës, zhvillon të mësuarit nga shumë këndvështrime, pasi ai prek thelbin e vetëpërcaktimit të kombeve dhe shpërbën konceptin e të qenët unik dhe origjinal në karakterin kombëtar. Kontributi më i madh i *Librit të punës 2* është se ai e historizon kombin, duke e pastruar nga paraqitjet johistorike për vazhdimësinë dhe unitetin. Në të njëjtën kohë, në këtë libër historia e Europës Juglindore përfshihet si pjesë e historisë europiane dhe botërore, përderisa shteti kombëtar zë vend qendror në historinë moderne dhe bashkëkohore të botës.

Libri i punës 3, Luftërat Ballkanike mund të ishte pjesë e *Librit të punës 2* ose edhe të *Librit të punës 1*, përderisa ai paraqet çastet vendimtare të formimit të shumë kombeve në Ballkan, si dhe rënien përfundimtare të Perandorisë Osmane. Në të njëjtën kohë, rënia e Perandorisë ishte një “ngjarje tërësisht ballkanike”, e cila, pavarësisht nga rezultati, konsiderohet si një provë e aftësive të popujve të Ballkanit për të përcaktuar fatin e tyre, pa pasur ndërhyrje nga “Fuqitë e Mëdha” të Europës. Rënia e saj tregon edhe rëndësinë relative të besimit fetar në konfliktet kombëtare: nëse në Luftën e Parë Ballkanike pati një aleancë të shteteve të krishtera kundër Perandorisë Osmane myslimane, në të dytën, kundërshtarët sigurisht që nuk u përcaktuan nga besimi i tyre fetar.

Libri i punës 3 është më i shkurtëri nga të katër librat, pasi ai trajton ngjarjet e dy viteve (megjithëse përfshin disa dokumente nga periudha para dhe pas luftërave). Ashtu si edhe *Libri i punës 4*, ai është shembull i historisë së një periudhe të shkurtër kohe, ku përpqemi të hedhim dritë jo vetëm mbi ngjarjet politike dhe ushtarake (të cilat gjithsesi trajtohen në tekstet shkollore), por edhe mbi aspektet e ndryshme të përvojës së luftës. Në të njëjtën kohë, në këtë libër jepet informacion rreth një ngjarjeje të historisë së rajonit, e cila është paraqitur nga studiuesit perëndimorë si një konfirmim i “së veçantës” lidhur me dhunën e shfaqur gjatë konflikteve në të. Nuk është e rastësishme që i njëjti këndvështrim, madje edhe përdorimi i termit “Luftërat Ballkanike” u përsëritën për luftërat në Jugosllavi gjatë viteve 1990. Opinioni i përgjithshëm ndërkombëtar u ushqye me idenë që gjakderdhja dhe urrejtja nacionaliste janë të përhershme dhe tipike për Gadishullin Ballkanik. Për këtë arsye, do të ishte e nevojshme që në klasë të bëhej një krahasim me Luftën e Madhe, e cila pasoi Luftërat Ballkanike dhe që me të vërtetë ndryshoi përkufizimin e luftës.

Libri i fundit, *Libri i punës 4*, mbulon një ngjarje të madhe të historisë botërore, e për rrjedhojë: 1) e vendos historinë e rajonit në kontekstin global; 2) arrin qëllimet morale që ka mësimdhënia e historisë. Në të vërtetë, nëse historia mësohet për të formuar qytetarë demokratikë, *Lufta e Dytë Botërore* ofron disa nga mësimet më të mira për ta arritur këtë. Sigurisht, vendet e Europës Juglindore nuk i shpëtuan anës së errët të kësaj “luftë tërësore”, siç paraqitet edhe në dokumentet historike në këtë libër. Në të njëjtën kohë, historia e kësaj pjese të Europës na jep mundësinë t’u ofrojmë nxënësve mësim mbi humanizmin dhe vlerat morale, nëpërmjet:

1. **Luftës kundër fashizmit.** Menduam se për arsye mësimore duhet të theksojmë qëndresën ndaj ideologjisë totalitare, ndaj vrazhdësisë e egërsisë së fashizmit, kryesisht nëpërmjet lëvizjeve të rezistencës, të cilat u organizuan pak a shumë masivisht në vendet ballkanike. Historitë e njerëzve të thjeshtë gjatë krizës më të madhe të qytetërimit perëndimor u japin nxënësve standarde kuptimplote sjelljeje dhe i ndihmojnë ata të vlerësojnë moralisht veprimet njerëzore;

2. **Solidaritetit, pavarësisht nga ndryshimet fetare, politike dhe kombëtare.** Ia vlen të vihen në dukje këtu veprimet individuale ose kolektive të atyre që ndihmuan njerëzit në nevojë gjatë luftës, në atë kohë të vështirë mëdysjesh morale dhe përpjekjesh për të mbijetuar.

Në të njëjtën kohë, edhe pse Lufta e Dytë Botërore përfaqëson një ngjarje tepër të veçantë, vuajtjet gjatë luftës u bënë të zakonshme. Shkatërrimi i plotë i qyteteve dhe vrasja e civilëve pothuajse e zhdukuri dallimin ndërmjet frontit dhe prapavijës. Lufta u shndërrua në diçka të zakonshme dhe të pranueshme, si pjesë “e natyrshme” e jetës politike dhe shoqërore. *Libri i punës 4* paraqet përvojat e përbashkëta të Europës Juglindore, Europës Qendrore dhe Perëndimore dhe nxjerr në pah “të veçantën” e “vrazhdësisë” ballkanase.

Nga ana tjetër, largësia e shkurtër kohore nga ngjarja historike që trajton *Libri i punës 4*, rrit rrezikun e leximeve dhe interpretimeve kundërthënëse. Për disa vende të Europës Juglindore, periudha mbas Luftës së Dytë Botërore ishte po aq e dhimbshme, sa edhe vetë Lufta, kështu që interpretimi i saj është ndikuar nga përvojat e

pas Luftës. Duke patur parasysh kompleksitetin dhe shtrirjen ndërkombëtare të zhvillimeve që pasuan Luftën, vendosëm ta përfundonim *Librin e punës* 4 në periudhën kohore të Çlirimit, e cila është e ndryshme për secilin shtet. Në këtë mënyrë ruajtëm frymën e optimizmit të shkaktuar nga rënia e tmerrit nazist, pa vazhduar me pasojat e drejtpërdrejta ose të tërthorta për shoqëritë e pasluftës, si në Europën Perëndimore, po ashtu edhe në atë Lindore. Për më tepër, gjatë periudhës së Luftës së Ftohtë, vendet e rajonit ndoqën rrugë të ndryshme; disa u bënë pjesë të Europës Lindore, e të tjerë të asaj Perëndimore (nëse flasim me termat e Luftës së Ftohtë).

Metodat e mësimdhënies

Nuk mund të themi me siguri dhe as nuk mund ta marrim si të mirëqenë që këta katër *libra pune* do të përdoren gjerësisht në klasë. Ka një sërë kufizimesh të cilat i morëm parasysh gjatë përgatitjes së këtyre librave:

1. Koha e kufizuar për mësimdhënien e historisë në programet mësimore kufizon mundësitë e mësuesve për risi në mësimdhënie;
2. Interesi i nxënësve për lëndën e historisë ka filluar të bjerë vazhdimisht, duke kaluar në dobi të lëndëve të tjera, me njohuri më “moderne” dhe tërheqëse, si teknologjitë e reja në komunikim, dhe
3. Trajnimi i pamjaftueshëm i mësuesve për të përtërirë njohuritë e tyre dhe për të përvetësuar aftësitë e duhura për të përdorur materiale mësimore plotësuese. Për rrjedhojë, është e vështirë të vlerësosh deri ku realizohen qëllimet e parashtruara në programet shkollore për mësimdhënien e historisë.

Metodat që mund të përdorin mësuesit e historisë gjatë përdorimit të këtyre katër librave janë të shumta e të shumëllojshme, dhe disa nga ato sigurisht që përdoren çdo ditë në mësimdhënie. Pyetjet e bëra në fund të çdo burimi historik dhe në fund të shumicës së nënkapitujve përbëjnë hapin e parë drejt zhvillimit të mësimin me anë të metodave më të përparura, si simulimet a loja me role, esetë, të mësuarit aktiv etj. Disa tema mësimore mund të krijojnë më shumë mundësi për të mësuar në mënyrë të pavarur, si p.sh., temat që kanë të bëjnë me Luftën e Dytë Botërore, për të cilën mësuesit mund të ndërthurin metodat e historisë gojore, filmat dhe dokumentarët. Gjithsesi, *Librat e punës* ofrojnë mjete për një qasje kritike ndaj librave shkollorë dhe mundësinë për përvetësimin e njohurive të reja me anë të punës kërkimore kritike dhe arsyetuese. Suksesi i kësaj sipërmarrjeje varet pothuajse plotësisht nga iniciativa, zotësia dhe qasja metodike e mësuesve.

Megjithatë, qasja kritike ndaj tekstit shkollor nuk duhet të keqkuptohet. Tekstet shkollore janë të cilësive të ndryshme dhe nuk janë më pak “autentike” se një libër me burime historike. Duhet të jetë e qartë që në fillim, se vendimi ynë për të bërë një përmbledhje me burime historike dhe jo një punë historiografike, nuk do të thotë në asnjë mënyrë që pranojmë objektivitetin apo autenticitetin e burimeve; qëllimi ynë është thjesht të tregojmë shumëllojshmërinë e interpretimeve dhe pikëpamjeve të përçuara nga vetë burimet historike. Thënë ndryshe, këndvështrimi ynë është zbatim i metodës krahasuese dhe i qasjes nga shumë këndvështrime.

Si përfundim, jemi krejtësisht të vetëdijshëm që përzgjedhja jonë nuk mund të jetë e rastësishme: ajo pasqyron këndvështrime dhe interpretime të veçanta, ashtu siç e kemi bërë të qartë edhe në hyrjet përkatëse.

Këto vërejtje kanë të bëjnë si me tekstet, ashtu dhe me figurat në këta libra. Sigurisht, figurat janë më interesante për të rinjtë dhe ndihmojnë që të “imagjinohet” e shkuara më e përjetuar. Megjithatë, e dimë që edhe figurat mund të keqinformojnë, prandaj ato duhen analizuar në mënyrë kritike, ashtu si dhe tekstet. “Leximi” i figurave, ashtu si edhe leximi i teksteve, parakupton njohjen e kontekstit (shoqëror, kulturor etj.) ku ato janë prodhuar. Jemi përpjekur të japim shpjegime për figurat e përfshira në *Librat e punës*, edhe pse në shumicën e rasteve ato përputhen me informacionin e dhënë nga tekstet e përfshira në të njëjtin kapitull. Përderisa *Librat e punës* mbulojnë shtatë shekuj histori, ilustrimet që kemi përfshirë janë të llojeve të ndryshme, ndaj kërkojmë metoda dhe analiza të ndryshme. Jemi përpjekur të përdorim shumëllojshmëri ilustrimesh: fotografi, pllakate, karikatura, litografi, piktura, dorëshkrime, lajmërimet, kartolina, pulla, kartëmonedha etj. Kriteri që ndoqëm, përveç disa parapëlqimeve estetike të pashmangshme, ishte të ndërtonim tablo mendore, duke përdorur

dëshmi pamore. Për shembull, figurat e përfaqësuesve të shtresave të ndryshme shoqërore në Perandorinë Osmane na ndihmojnë të rindërtojmë ose thjesht të zbulojmë të “ndryshmen”. Duhet të theksojmë këtu që e “ndryshmja” nuk është domosdoshmërisht e njëjtë me “tjetrin”; dallimi kulturor për shkak të kalimit të kohës, madje edhe ndërmjet bashkëkohësve jo gjithnjë parakupton konflikt.

Përfundim

Kjo seri librash është një përmbledhje diskutimesh dhe argumentesh të shumta e të larmishme, si dhe pasqyrim i asaj surprize të këndshme që puna e një historiani mund të zhdukë kufijtë. Tani në Ballkan gjenden një numër i madh mësuesish të historisë që janë mjaft të interesuar për punën e tyre dhe të gatshëm për ndryshim. Nisma jonë u kushtohet këtyre mësuesve, të cilët kërkojnë mënyrat dhe udhëzimet për të arritur ato synime. Këta njerëz mund të veprojnë si shumëfishues në ripërtëritjen e mësimdhënies së historisë, e cila tani është në krizë të padiskutueshme në të gjithë shoqërinë europiane. Kundërshtari më i madh ndaj kësaj sipërmarrjeje nuk do të jetë kundërveprimi politik apo ideologjik, por mepshtësia dhe indiferenca.

Prandaj, sfida që shfaqet para nesh është të ngjallë tek nxënësit interesin për të mësuar për rajonin ku shtrihet vendi i tyre, dhe t’i pajisë me mjetet për të kuptuar ndërlikueshmërinë e së tashmes. Ky projekt nuk është thjesht një ushtrim shkencor; ai ka të bëjë me sfidën me të cilën përballen vendet e Europës Juglindore në lidhje me të ardhmen e tyre të përbashkët.

Pasqyra e Lëndës

Hyrje	25
Kronologjia	27
Kapitulli I: Zgjerimi territorial osman në Europën Juglindore	41
Ia. Fazat e para të shtetit osman në Anatoli	41
I-1. Martesa e Orhanit me vajzën e <i>tekvurit</i> të Jar Hisarit	41
I-2. Pushtimi i Karaxha Hisarit dhe leximi i parë i <i>hutbes</i> në emër të Osman Gazit	42
Ib. Pushtimi osman i Gadishullit Ballkanik	43
I-3. Kontradiktat ndërmjet shteteve të krishtera në Ballkan dhe roli që luajtën në zgjerimin territorial osman	43
I-4. Fermani i Muratit të Parë, i cili i jep Evrenoz beut të drejtën për të sunduar territorin e Maqedonisë Jugore (1386)	43
I-5. Roli i bashkëpunëtorëve lokalë/vendas në zgjerimin e territoreve osmane në Ballkan	44
Fig. 1. Bajaziti i Parë vjen për të shpëtuar Nikopolisin e rrethuar një natë përpara betejës me kryqtarët (1396) – miniaturë osmane (rreth 1584)	45
I-6. Shpjegime të shekullit të 14-të mbi fitoret e osmanëve ndaj të krishterëve – Gregori Palamas (1354) dhe Hans Shiltberger	45
I-7. Pronarët e krishterë të timareve në provincën e Arvanidit, Shqipëri (1431/1432)	46
I-8. Despot serb, vasal i osmanëve (1432)	46
I-9. Rënia e Novo Bërdos (1455)	47
Fig. 2. Ushtria osmane fiton betejën në Mohaç (1526) – miniaturë osmane (rreth vitit 1588)	47
I-10. Shkatërrimet turke në Slloveni – letër e guvernatorit habsburgas të Karniolas (1491)	48
Fig. 3. Banorë të Beogradit të zënë rob (1521)	48
I-11. Robërit e krishterë në Bosnjë (1530)	48
Ic. Rënia e Kostandinopojës / pushtimi i Stambollit (1453)	49
I-12. Këndvështrim bizantin mbi rënien e Kostandinopojës – George Sfrances	49
I-13. Ripopullimi i Stambollit gjatë sundimit të Mehmetit të Dytë	50
Id. Ndryshimet e popullsisë dhe të fesë	50
I-14. Shpërngulja me forcë e popullsisë [<i>syrgjyni</i>] nga Azia e Vogël në Ballkan (fondi i shekullit të 14-të)	50
I-15. Premtime osmane, bërë fshatarëve boshnjakë – letra e mbretit Stjepan Tomasevic (1461-1463) dërguar Papa Piut të Dytë	51
I-16. Joasafi, peshkopi ortodoks i Vidinit, mbi islamizimin e detyruar dhe atë me dëshirë (shekulli i 15-të).	51
I-17. <i>Kadiu</i> regjistron një djalë të ri pa baba, që kthehet në fenë islame (1636)	51
I-18. Kërkesa e një të riu, i cili dëshiron të kthehet në fenë islame (1712)	51

Kapitulli II: Institucionet e Perandorisë Osmane	53
Ila. Sulltani dhe Pallati	54
II-1. Titulli që përdorte Sulejmani në korrespondencën e tij me Ferdinandin e Parë (1562)	54
II-2. Cilësitë e sunduesit ideal, paraqitur në poemën e Xhelalzades, kushtuar sulltan Selimit të Dytë (1566-1574)	54
II-3. Qëndrime të ndryshme ndaj vëllavrasjes perandorake – kronika e Mehmet Neshriut mbi ekzekutimin e Mustafait të Vogël (1422)	55
Fig. 4. Planimetria e <i>Pallatit Topkapi</i> në Stamboll	56
Skema 1: Pallati dhe Administrata Qendrore Osmane	57
Fig. 5. Ambasadorët perandorakë në pritje me sulltanin osman	57
II-4. Mustafai i Parë hipën në fron (1617)	58
Fig. 6. Festime perandorake gjatë një fushate ushtarake	58
Fig. 7. Sulltan Bajaziti i Dytë (1481-1512) në gjueti afër Filibesë [Plovdiv]	59
Ilb. Sistemi i devshirmes	60
II-5. Sistemi i devshirmes, i përshkruar nga një ish-jeniçer	60
II-6. Të krishterët kritikojnë sistemin e devshirmes; shkëputur nga <i>Jeta e Georgi Novit</i> nga Sofja (1539)	60
Fig. 8. Fëmijë duke u regjistruar si <i>devshirë</i>	61
Fig. 9. Aga jeniçerësh	62
II-7. Lutfi pasha kujton karrierën e tij, që nga koha kur u rekrutua me anë të sistemit të devshirmes	62
Ilc. Sistemi i timarit	63
II-8. Rregullat osmane që përcaktonin dhënien e timareve	63
II-9. Lista e të ardhurave që një spahi duhej të mblidhte nga timari i tij	63
II-10. Një timarliu i jepet një timar tjetër nga mesatar deri te i madh	63
II-11. Vendime për timarlinjtë që nuk merrnin pjesë në fushata ushtarake (1635)	64
Fig.10. Spahinj të armatosur	64
Ild. Ideologjia e mbrojtjes së nënshtetasve dhe praktikat e administratës juridike	65
II-12. Rekomandimet e Muratit I për Evrenoz beun, kur e caktoi atë guvernator (1386)	65
II-13. Fermani i Mehmetit I, lëshuar në dobi të murgjve të manastirit <i>Margarit</i> , në rajonin e Seresit (1419)	66
II-14. Vendimi i <i>kadiut</i> në një konflikt mes një të krishteri dhe një jeniçeri. (Sofje, 1618)	66
II-15. Vendimi i <i>kadiut</i> në një konflikt mes një myslimani dhe një të krishteri (Vidin, 1700)	66
II-16. Komuniteti i ishullit të Mikonos vendos të heqë kadiun (1710)	67
II-17. Vendim kundër <i>koxhabashit</i> Todoraki nga Samakoxhuku (1762)	67
II-18. Dekreti osman në mbrojtje të manastireve boshnjake (1785)	68
Ile. Provincat dhe shtetet vasale	68
II-19. Dispozita për statusin e Raguzës, përsëritur në një <i>ahidname</i> të lëshuar nga Murati III (1575)	68
II-20. <i>Ahidname</i> e Ahmetit I për Transilvaninë (1614)	69
II-21. Autonomia e Moldavisë (1716)	69
II-22. Udhëtari francez, Flashat, flet për statusin e veçantë të princave të Vllahisë (1741)	70
Skema 2: Ndarjet administrative të territoreve të sunduara nga osmanët (shekulli i 16-të).	71

Kapitulli III: Institucionet, komunitetet dhe ritet fetare	73
IIIa. Myslimanët	73
III-1. Mbishkrim në portalin e Xhamisë së Sulejmanit në Stamboll (mesi i shekullit të 16-të)	73
III-2. Dimitri Kantemiri mbi lutjet myslimane	74
Fig.11. Xhami e shekullit të 14-të në Iznik (Nikea)	75
Fig.12. Sulejmania (Xhamia e Sulejmanit) në Stamboll (1500-1557)	75
III-3. Arsyetimi i një myslimani mbi lidhjen që ekziston mes Allahut dhe shiut (1779)	75
Fig.13. Mbishkrime zburuese të Kuranit, në brendësi të Xhamisë Eski në Edrene (shekulli i 15-të)	76
Fig.13a. Xhamia e Hysen Pashës, e ndërtuar në vitin 1569 në Pljevlja	76
Fig.13b. Muret e brendshme të zburuara në xhaminë e Hysen Pashës në Pljevlja.	76
Fig.14. Një grua turke hipur mbi deve, duke shkuar për në pelegrinazhin e Mekës	77
III-4. Heterodoksia myslimane – Anekdota bektashinjs	77
Fig.15. Qendra e vëzhgimit astronomik në Stamboll (rreth vitit 1580)	78
Fig.16. Heroi popullor, Nastradin Hoxha	78
IIIb. Të krishterët	78
III-5. Zgjedhja e Genadio Skolariosit si patriarku i parë ortodoks pas pushtimit të Kostandinopojës (1453)	78
Fig.17. Enë e argjendtë osmane e shekullit të 16-të, me mbishkrime greke, e cila përdorej në ritualet ortodokse.	79
III-6. Udhëtari francez Pierr Leskalopier tregon për <i>Manastirin e Shën Savës</i> në Serbi (1574)	79
III-7. Pali nga Alepoja përshkruan kishat moldave (mesi i shekullit të 17-të)	79
Fig.18. Manastiri i Voronetit në Moldavi (i ndërtuar në vitin 1488; afresket e jashtme janë pikturuar në vitet 1547-1550)	80
Fig.19. Darka e fundit – afresk në manastirin <i>Stavronikita</i> , Atos (1546)	80
Fig.20. Manastiri i Ostrogut në Malin e Zi, 1650.	80
III-8. Kozma Aitoliani u bën thirrje të krishterëve të arsimojnë fëmijët e tyre	81
III-9. Kiril Pejçinoviçi rreth marrëdhënieve të tendosura midis fshatarëve ortodoksë dhe priftërinjve (1816)	81
IIIc. Hebrejtë	82
III-10. Letër e Isak Xarfatit, rabin i Edrenesë (Adrianopojës), drejtuar hebrejve në Europën Qendrore (mesi i shekullit të 15-të)	82
III-11. Elijah Kapsali tregon për mirëqenien e hebrejve në Perandorinë Osmane gjatë sundimit të Mehmetit II	82
III-12. Ringjallja e hebrejve: shembulli i Sabbata Zevit (1666)	83
Fig.21. Doktor hebre – gravurë franceze (1568)	84
IIId. Bashkëjetesa dhe diskriminimi fetar	84
III-13. Dialogu fetar gjatë kohës që Gregori Palamasi u mbajt rob (1354)	84
III-14. Bashkëjetesa e komuniteteve të ndryshme fetare në qytetet osmane (rreth vitit 1660)	85
III-15. Marrëdhëniet midis ortodoksëve, katolikëve dhe luteranëve në Bullgari e Vllahi (1581)	86
III-16. <i>Fetvaja</i> e Ebus-Suudit për shiitët myslimanë (mesi i shekullit të 16-të)	87
III-17. Urdhri perandorak që ndalon punën për konvertimin “frëng” mes armenëve të Anatoisë Lindore (1722)	87

III-18.	Autoritetet osmane në Bosnjë gjykojnë një çështje midis ortodoksëve dhe katolikëve (1760)	87
III-19.	Kufizime perandorake për jomyslimanët (1631)	88
III-20.	Ekzekutimi i një ortodoksi që vishte rroba të papërshtatshme (1785/1789)	88
III-21.	Urdhri perandorak për një kishë të ndërtuar pa leje në Stanimaka, afër Plovdivit (1624)	89
III-22.	Mungesa e tolerancës së të krishterëve ndaj njerëzve që jetonin si çifte ndërfetare (Qipro, 1636)	89
III-23.	Rregullat fetare në Transilvani (1653)	89
III-24.	Vendim antihebre i sinodit peshkopal të Stonit, në Raguzë (1685)	90
III-25.	Privilegj për një hebre në Raguzë (1735)	90
III-26.	Martirizimi i Shën Kiranas në Selanik (1751)	90
Fig. 22.	Miniaturë osmane që paraqet ngritjen në qiell të Krishtit (1583)	91

Kapitulli IV: Ndarjet shoqërore dhe jeta e përditshme 93

IVa. Elitat dhe populli i thjeshtë 93

IV-1.	Elita osmane i përbuz fshatarët turq	93
Fig. 23.	Akinxhiu	94
Fig. 24.	Spahiu	94
Fig. 25.	Jeniçeri	95
Fig. 26.	Ushtarë në Shqipëri – pikturë nga Zhan-Baptist Hiler (1809)	95
Fig. 27.	Shejh-ul-Islami	95
Fig. 28.	Nëpunës a shkrues osman i rangut të lartë	96
Fig. 29.	Tregtar arab	97
Fig. 30.	Tregtar nga Raguzë	97
Fig. 31.	Rrobaqepës osman	97
Fig. 32.	Bariu	98
Fig. 33.	Peshkatari	98
Fig. 34.	Dervishi	99
Fig. 35.	Murg armen	99
Fig. 36.	Patriarku ortodoks i Kostandinopojës	100
Fig. 37.	Rabini i madh i Stambollit (fundi i shekullit të 18-të)	100
Fig. 38.	Fisnik i krishterë i shekullit të 18-të	101
Fig. 39.	Një ajan i shquar: Ali pasha i Janinës (1741-1822) – pikturë e Lui Dypresë (1819)	101
Fig. 40.	Këmbyes parash osman	102
Fig. 41.	Një përkthyes: Pjerr Jamoglu, përkthyes i ambasadës franceze (1787)	102
Fig. 42.	Ambasadori suedez (1788)	102
Fig. 43.	Skllav anijeje duke mbajtur racionin e tij të ujit	103

IVb. Jeta në fshat 103

IV-2.	Rregullorja mbi vetëqeverisjen në fshat në provincën e Vidinit (1587)	103
IV-3.	Detyrimi i fshatarëve për të kultivuar tokën (<i>Kodi i Karamanit mbi tokën</i> , 1525)	103
Fig. 44.	Shtëpi bullgare në Tërjavna (shekulli i 18-të)	104
IV-4.	Shtëpi bullgare pranë Ruses, të përkthyer nga udhëtari francez Pjerr Leskalopier (1574)	104
IV-5.	Përkthimi i veshjes dhe njerëzve që jetonin afër Plovdivit (1553-1555)	104
IV-6.	Ushqimi dhe pijet në Shqipëri (rreth vitit 1810)	104

Fig. 45. Dhomë në Arbanas (shekulli i 18-të)	105
IV-7. Udhëtim përmes fshatrave bullgare (1761)	105
Fig. 46. Gra që po lajnë jashtë shtëpisë (Larisa, fillimi i shekullit të 19-të)	106
Fig. 47. Burra dhe gra në ishullin Paros, duke u rënë veglave muzikore dhe duke kërcyer	106
IV-8. Rrugët dhe letërkëmbimi në Shqipërinë osmane	106
IVc. Jeta në qytete	107
IV-9. Përshkrimi i Beogradit (1660)	107
Fig. 48. Një turk hipur mbi kalë, ngarkuar me shporta të mëdha për të mbajtur fruta dhe perime të freskëta	109
Fig. 49. Parada e bukëpjekësve në Stamboll (1720)	109
IV-10a. Rezenca e princit të Vllahisë, Kostandin Mavrokordatit, përshkruar nga udhëtari francez Flashat (mesi i shekullit të 18-të)	109
IV-10b. Johann Georg von Hahn përshkruan qytetin e Prizrenit (mesi i shekullit të 19-të)	110
IV-11. Statuti i esnafëve të bakallit në Moskopolis (1779)	111
IV-12. Kontrata për marrjen e një çiraku në ishullin e Skirosit (1793)	111
Fig. 50. Fëmijë osmanë hipur në një rrotullame për festën e Bajramit	111
IV-13. Fetvaja e Ebus-Suudit për ndalimin e kafeneve në perandori (çereku i tretë i shekullit të 16-të)	112
IV-14. Këngë mejhaneje nga Senji.	112
IV-15. Shkrimet e Evlija Çelebisë për bakllavanë e Beogradit (1660)	112
IV-16. Menuja e Shefki Mula Mustafait (Sarajevë, gjysma e dytë e shekullit të 18-të)	113
IVd. Jeta pranë kufijve të ndryshëm	113
IV-17. Luftëtarët osmanë <i>deli</i> , të përshkruar nga udhëtari francez Nikola de Nikolai (1551)	113
Fig. 51. Luftëtar osman <i>deli</i> (shekulli i 16-të)	114
IV-18. Institucioni i vëllamit në kufirin boshnjak (1660)	114
IV-19. Kërkesë osmane për një doktor nga Raguza (1684)	115
IV-20. Letra e Simun Koziciç Benjas, peshkop i Modrusit, drejtuar papës Leo X (1516)	115
IV-21. Letra e Fran Kërsto Frankopanit për Gaspar Kolnicin (1670)	115
IV-22. Këngë për sulmin kroat mbi Kladushë	116
IV-23. Marko Krajleviçi pi verë gjatë muajit të Ramazanit	116
IV-24. Letër e Petar Petroviç Njegoshit, dërguar Ali Pashë Rizvanbegoviçit (rreth vitit 1834)	117
IV-25. Ndikimi i të krishterëve tek myslimanët shqiptarë	118
IVe. Aspekte nga jeta e grave	118
IV-26. Martesa “mbretërore” në shekullin e 15-të	118
IV-27. Gratë shqiptare (rreth vitit 1810)	118
IV-28. Solidariteti ndërmjet grave të krishtera – flijimi i Shën Filoteas (1589)	118
IV-29. Akti themeltar i Esnafit të Grave Sapunprodhuese në Triki, Thesali (1738)	119
Fig. 52. Zonja e Athinës (1648)	119
IV-30. Divorc në një fshat afër Sofjes (1550)	120
Fig. 53. Grua turke me fëmijë (1568)	120
Fig. 54. Grua turke me veshjen që dilte në qytet – vizatim francez (rreth viteve 1630)	120
IV-31. Rasti i një gruaje qipriote që merr divorcin duke u konvertuar në islam (1609) – marrë nga regjistri i <i>kadiut</i>	121

Fig. 55. Vajzë malësore e Shqipërisë së Veriut (fillimshekulli i 19-të)	121
IV-32. Regjistrimi tek <i>kadiu</i> i divorcit të një burri mysliman dhe një gruaje të krishterë (1610)	121
IV-33. Tradhtia bashkëshortore e një jeniçeri me një grua myslimane në Stamboll (1591)	121
IV-34. Komente të zonjës Mari Uortlei Montagu mbi gratë osmane (1717)	122
Kapitulli V: Aspektet e krizës	125
Va. Fatkeqësitë “natyrore”	125
V-1. Zia e bukës në Stamboll (1758)	125
V-2. Tërmeti në Stamboll (1766)	126
V-3. Murtaja në Bukuresht (1813)	127
Vb. Kriza politike në Stamboll	127
V-4. Zgjidhjet që jepen në ditarin e Koçi beut për krizën e shtetit osman (rreth 1630)	127
V-5. Të dërguarit e princit moldav Kostandin Mavrokordati argumentojnë se në Stamboll është e nevojshme të korruptosh shumë njerëz (1741)	128
Vc. Luftërat, kryengritjet dhe trazirat në popull	128
V-6. Fshatarët largohen drejt qyteteve (1665)	128
V-7. Kryengritja e Mehmet aga Bojaxhi-oglu-së në Qipro (rreth 1680)	129
V-8. Raport, dërguar papës, lidhur me kryengritjen në Çiprovcit (1688)	130
V-9. Serbët largohen nga frika e përndjekjeve osmane (1690) – dëshmia e (Dhjakut) Atanasije Gjakon Sërbinut	130
V-10. Raport i guvernatorit të përgjithshëm venecian për Dalmacinë, në lidhje me ndikimin që Shçepan Mali kishte në Malin e Zi, 1767	131
V-11. Kryengritja moldave kundër osmanëve (1711)	131
V-12. Ditari i një oficeri habsburgas që përshkruan rrethimin e Dubicës (1788)	132
V-13. Mungesa e sigurisë gjatë udhëtimit nëpër Shqipëri	132
V-14. Bastisja e Kazanlikut nga Topal Ibrahim (1809)	133
V-15. Letër e Petar Petroviç Njegoshit, dërguar Josip Jelaçicit (3 qershor 1849)	133
V-16. Ndërthurja e fatkeqësive në rrëfimin e mësuesit bullgar Todor nga Pirdopi, afër Sofjes (1815-1826)	133
V-17. Lutje drejtuar sulltanit për të emëruar Hysen Gradashçeviçin në postin e vezirit	134
V-18. Leopold Ranke shkruan për Hysen Gradashçeviçin	135
Bibliografia	137
Shënime mbi koordinatorët	141
Lista e kontribuesve	143
Lista e mësuesve që morën pjesë në seminarët vlerësuese	144
Harta: Perandoria Osmane dhe Europa (1600)	146

Perandoria Osmane është një nga forcat më të mëdha politike, e cila i ka dhënë trajtën historisë së Europës Juglindore për një periudhe të gjatë kohore. Në të vërtetë, nga shekulli i 14-të deri në fillim të shekullit të 20-të, shteti osman ka qenë organizmi politik më i madh në këtë rajon. Megjithatë, kjo nuk është e vetmja arsye për të studiuar historinë e Perandorisë Osmane në Europën Juglindore. Perandoria Osmane është e rëndësishme për vetëpërcaktimin kolektiv të kombeve të Europës Juglindore.

Lufta kundër osmanëve ishte një përparësi tepër e dukshme për të argumentuar lidhjen që këto kombe kishin me Europën e krishterë. Për më tepër, pushtimi osman shpesh konsiderohet si përgjegjës për prapambetjen ekonomike dhe pështjellimin politik, i cili ka ndikuar edhe më tej në shumë vende të Europës Juglindore deri në ditët e sotme. Nuk është qëllimi ynë që të debatojmë këtu *pro ose kundër* përgjegjësisë osmane për këto dukuri. Ne mendojmë që vështrimi më nga afër i një morie burimesh të historisë sonë të përbashkët nga periudha osmane, do të na ndihmojë të gjykojmë këto çështje, si dhe çështje të tjera, në mënyrë të pavarur.

Ka edhe një arsye tjetër për të studiuar historinë e periudhës osmane. Gjatë dhjetëvjeçarëve të fundit, studimet e periudhës osmane kanë qenë një nga fushat më dinamike të studimeve historike jo vetëm në Turqi dhe në vende të tjera të Europës Juglindore, por edhe në Europën Perëndimore, Shtetet e Bashkuara, madje dhe në Japoni. Historianët kanë pasur mundësi të kenë në duar burime të reja, mbi të cilat ata kanë ngritur teza të ndryshme, me ndihmën e metodave të reja dhe të vjetra; për rrjedhojë, imazhi ynë mbi historinë osmane tani është më i pasur, më i detajuar dhe më i baraspeshuar. Për më tepër, shumë fakte të marra më parë si të mirëqena janë vënë në pikëpyetje dhe/ose nuk janë pranuar nga studime të kohëve të fundit.

Shpeshherë është argumentuar që Perandoria Osmane ishte një shtet turk. Është e vërtetë që themeluesit e shtetit dhe dinastisë osmane kishin origjinë turke, por me pushtimet që kreu, shteti osman përfshinte një numër të madh popujsh, të cilët flisnin gjuhë të ndryshme dhe që u përkisnin besimeve të ndryshme fetare. Për më tepër, gjatë pjesës më të madhe të historisë, shtesa sunduese osmane ishte tepër e përzier nga pikëpamja etnike. Në të vërtetë, që nga "periudha klasike" e Mehmetit të Dytë dhe Sulejmanit, deri në shfaqjen e nacionalizmit në shekullin e 19-të, përfaqësuesit e klasës sunduese osmane e konsideronin etiketimin "turq", si sinonim për fshatarët e vrazhdë dhe analfabetë nga Azia e Vogël, me të cilët ata shpresonin të kishin sa më pak anë të përbashkëta. Po ashtu, zyrtarët dhe intelektualët osmanë asnjëherë nuk e quanin shtetin e tyre "Turk"; ata e quanin atë "devlet-i-aliye" ("shteti i lartë" ose "devlet- i-ali-Osman" ("shteti i shtëpisë së Osmanëve"). Si në shumë shtete të tjera gjatë mesjetës dhe fillimit të kohës së re, besnikëria ndaj dinastisë ishte më e rëndësishme se çdo përkatësi etnike.

"Despotizmi osman" është kundërshtuar gjithashtu në punime historike të kohëve më të fundit. Argumenti më serioz kundër këtij koncepti është fakti që ai nuk merr parasysh ndryshimin, kurse në të vërtetë shoqëria osmane ndryshoi shumë gjatë ekzistencës së saj të gjatë. Në fakt, të paktën gjatë së ashtuquajturës "periudhë klasike", sulltanët ishin të plotfuqishëm dhe mëtonin të kontrollonin gjithçka që ndodhte në zotërimet e tyre. Megjithatë, ishte tepër e vështirë të kontrollohej një perandori kaq e madhe, e shtrirë në tri kontinente, e për më tepër, me atë numër të paktë të mjeteve teknike gjatë mesjetës së vonë dhe fillimit të kohës së re. Edhe sistemi i njohur i *timarit*, i cili u mundësonte sulltanëve të kontrollonin pjesën më të rëndësishme të ushtrisë së tyre, në të vërtetë ishte vetëm një formë e mekanizmit, i cili praktikisht përdorej kudo në botë, në shoqëritë e pjekura bujqësore, me territor dhe popullsi të madhe, për të arritur në shkallë lokale atë çka nuk mund të arrihej në të gjithë vendin njëherësh, për shkak të sistemit të pazhvilluar monetar dhe teknologjisë paraindustriale të transportit dhe komunikimit: kjo ishte shpërndarja e elitës qeverisëse në të katër anët, në kurriz të fshatarëve, për të vendosur ligjin dhe mbajtur rregullin dhe për të bërë kalimin e mbiprodhimit nga prodhuesit, tek vetja.

As kontrolli i sulltanit mbi *timaret*, dhe as monopoli i timareve mbi armët e zjarrit (Perandoria Osmane mund të konsiderohet si një “perandori baruti”, ashtu siç mund të konsiderohen dhe shume vende të tjera gjatë fillimit të kohës së re), nuk mbijetuan mbas krizës së fundshekullit të 16-të.

Për më tepër, edhe pse sulltanët pretendonin se autoriteti i tyre ishte absolut, ashtu si shumë sundimtarë “absolutë” në Azi, Europë apo pjesë të tjera të botës, ata duhej të merrnin parasysh kufizimet që vinin nga Ligji i Shenjtë i Zotit - në rastin e osmanëve nga *Sheriati*. Shpeshherë sulltanët e anashkalonin këtë kufizim me ndihmën e *şeyh-ül-Islam-it*, por në të vërtetë mbështetja e tyre në këtë procedurë na zbulon se e kuptonin që fuqia e tyre nuk ishte e pakufizuar. Për ta thënë më qartë, fuqia “despotike” e sulltanëve osmanë teorikisht varej nga Zoti, dhe praktikisht nga rrethanat njerëzore.

Përplasjet ndërmjet shoqërive dhe popujve të Europës Juglindore nga njëra anë, dhe osmanëve pushtues/shtypës nga ana tjetër, kanë qenë tema kryesore në shumicën e historive tona kombëtare. Është e qartë që ka patur shumë çaste konfliktesh e mizorish, si gjatë pushtimit, ashtu edhe gjatë sundimit të gjatë osman. Megjithatë, historia e Europës Juglindore nga shekulli i 14-të deri në shekullin e 20-të nuk përbëhet vetëm nga konflikte. Në të vërtetë, ashtu si dhe në shumë shoqëri të tjera të sunduara nga perandoritë e mëdha shumëkombëshe e me shumë besime fetare, njerëzit jo vetëm kanë bërë qëndresë, por edhe kanë kërkuar mënyra për t’u përshtatur me situatat historike, ose për të ndërtuar një fat më të mirë për veten e tyre dhe për komunitetet të cilave ata u përkisnin. Ndonjëherë kjo përfshinte “negociatat” me sundimtarët, si dhe bashkëpunimin aktiv me ta, për të fituar disa privilegje individuale ose kolektive. Kjo mund të interpretohet edhe si nënshtrim ndaj autoriteteve, ose, në të kundërt, mund të shihet edhe si zgjedhje e një forme pasive ose aktive qëndrese. Kjo do të thotë, gjithashtu, që jeta e përditshme zakonisht ishte më e rëndësishme se çështjet politike. Studime të kohëve të fundit kanë hedhur dritë mbi disa aspekte praktike të jetës së njerëzve në Europën Juglindore gjatë sundimit osman, duke bërë krahasime me situata dhe ngjarje të ngjashme në rajone të tjera gjatë së njëjtës periudhë, duke paraqitur elementet e përbashkëta për të gjithë Europën Juglindore dhe karakteristikat specifike të zonave të veçanta të rajonit.

Në dritën e këtyre studimeve krahasuese të kohëve të fundit, karakteri “përrjashtimor” historik i Europës Juglindore gjatë sundimit osman zhduket shkallë-shkallë: ngjashmëritë me rajone të tjera dhe me shoqërinë tonë të sotme na e bëjnë atë të njohur. Sigurisht, që sërish mbeten dallimet, të cilat janë dhënë me detaje në studimet e kohëve të fundit, por ato asnjëherë nuk kanë arritur deri aty sa ta kthejnë historinë e Europës Juglindore nën Perandorinë Osmane në një truall ekzotik. Këto dallime na ndihmojnë të kuptojmë më mirë kompleksitetin e shoqërive në të shkuarën dhe të tashmen, dhe në të vërtetë, ky është një nga qëllimet kryesore të njohurive historike.

Ky *Libër pune* synon t’u japë mësuesve, nxënësve dhe studiuesve një mundësi tjetër, për ta parë historinë e Europës Juglindore gjatë sundimit osman nga një këndvështrim i ri. Për të shmangur përsëritjet me *Librin e punës 2* të këtij projekti, i cili trajton problematikën që ka të bëjë me kombet dhe shtetet në Europën Juglindore, shekulli i fundit i ekzistencës së Perandorisë Osmane nuk është përfshirë në këtë libër. Për këtë arsye, ky *Libër* mbaron me fundin e shekullit të 18-të, duke përfshirë vetëm disa burime nga shekulli i 19-të. Edhe me këtë kufizim, ishte praktikisht e pamundur të ilustrueshin të gjitha aspektet dhe detajet e pesë shekujve të mesjetës së vonë dhe fillimeve të historisë së re të Europës Juglindore, në një numër të kufizuar faqesh. Prandaj na u desh të vendosnim disa përparësi dhe të bënim disa zgjedhje. Disa aspekte, edhe pse të rëndësishme, duhej ose të hiqeshin, ose të përmbledheshin shumë shkurt. Në përzgjedhjen tonë të burimeve jemi mbështetur nga kontribuesit tanë dhe jemi munduar të japim një panoramë të baraspeshuar si nga pikëpamja gjeografike, ashtu edhe nga ajo tematike. Gjithsesi jemi të ndërgjegjshëm që disa prej lexuesve të cilët do të lexojnë dhe/ose do të përdorin këtë *Libër*, mund të mendojnë se edhe ata mund të kishin përfshirë tekste ose pamje të tjera; nëse është kështu, ne do të kemi arritur njërin prej synimeve tona, i cili është të nxisim mësuesit, nxënësit dhe historianët profesionistë të rrokin rëndësinë e shumëllojshmërisë së shqyrtimeve dhe interpretimeve dhe të hedhin një vështrim të ri në historinë e ndërlikuar të Europës Juglindore gjatë sundimit të Perandorisë Osmane.

Kronologjia

Sulltanët osmanë	Proceset politike	Ngjarjet politike dhe ushtarake	Ndryshimet territoriale	Shoqëria dhe kultura	Ngjarjet më të rëndësishme jashtë Perandorisë Osmane
Osmani i Parë (1281-1324)	Rreth viteve 1300-1345 - Nis zgjerimi territorial osman në Azinë e Vogël Veriperëndimore, në kurriz të Perandorisë Bizantine; gjatë kësaj periudhe, emirati osman është në konkurrencë me principatat e tjera turke në Azinë e Vogël; hyrja shkallë-shkallë e dijetarëve myslimanë (ulema) në sistemin politik osman.	1302 – Fitorja e osmanëve kundër Bizantit në Bafeon.			1307 – Dorëzimi i sulltanatit Selxhuk të Rumit; principatat turke të Azisë së Vogël bëhen vasale të drejtpërdrejta të shtetit mongol (Ilçanid) në Persi.
Orhani (1324-1362)			1326 – Pushtimi i Brusës (Bursës), i cili u pasua nga pushtimi i Nikeas (Izmit, 1331) dhe Nikomedias (Izmit, 1337).	Kthimi i qyteteve bizantine në qytete osmane (kryesisht myslimane); ky proces përhapet shkallë-shkallë në Azinë e Vogël dhe Ballkan gjatë shekullit të 14-të dhe 15-të.	1335 – Shpërbërja e Perandorisë Ilxhanid; principata (emirati) osmane bëhet e pavarur.
				1339 – Orhanije, Bursë - xhamia e parë në formë T-je.	1337-1453 – Lufta Njëqindvjeçare ndërmjet Francës dhe Anglisë.
					1341-1354 – Lufta civile në Perandorinë Bizantine.
					1345-1353 – Epidemia e murtajës (vdekja e zezë) përhapet në Azi, Europë dhe Afrikën Veriore.
		1345 – Ndërhyrja e parë ushtarake osmane në Europë, në ndihmë të perandorit të ardhsëm bizantin Joan VI Kantakuzen (1347-1345).	1345 – Pushtimi i emiratit Karesi, përfshirë edhe bregun lindor të Dardaneleve.		
				1346-1347 – Nga Kafa, murtaja mbërrin në Europën Juglindore dhe përhapet në pjesë të mëdha të rajonit.	

Sulltanët osmanë	Proceset politike	Ngjarjet politike dhe ushtarake	Ndryshimet territoriale	Shoqëria dhe kultura	Ngjarjet më të rëndësishme jashtë Perandorisë Osmane
	1345-1402 – Zgjerimi territorial osman në Europën Juglindore; gjatë kësaj periudhe, udhëheqësit ushtarakë të kufirit turk vepronin shpesh me iniciativën e tyre dhe u integruan dalngadalë në sistemin politik osman; osmanët përdorin mekanizma të ndryshëm politikë për të arritur zgjerimin territorial: marrëveshjet me shtetet ekzistuese në Europën Juglindore (të cilat pranohen si haraçpaguese), martesat për hir të aleancave, marrja me forcë dhe shpërndarja e timareve luftëtarëve të tyre; kolonizimi i territoreve me turq të ardhur nga Azia e Vogël etj. Në vitet 1390, Bajaziti e shpejton me dhunë ecurinë e integritimit perandorak, duke shkaktuar pakënaqësi tek turqit në Azinë e Vogël etj.		1354 – Pushtimi i Galipolit.		1355 – Vdes Stefan Dushani (1331-1355); rënia e shtetit serb.
Murati i Parë (1362-1389)			1361-1369 – Pushtimi i Trakës bashkë me Edrenenë.		
		1371 – Fitorja e osmanëve ndaj serbëve në Çirmen.	Vitet 1370-1380 – Pushtimi i Maqedonisë dhe disa pjesëve të Greqisë dhe Shqipërisë.	1378-1391 – Xhamia Jeshil, në Iznik	1370-1405 – Sundimi i Timur Lengut.
Bajaziti i Parë (1389-1402)		1389 – Beteja e parë e Kosovës; Osmanët mundin koalicionin ballkanik të udhëhequr nga princi serb Llazar; Serbia bëhet vasale e shtetit osman.	1390-1391 – Osmanët aneksojnë për herë të parë principatat turke në Azinë e Vogël Jugperëndimore (Saruhanin, Ajdinin, Menteshen etj.)		1385 – Bashkimi i Polonisë me Lituaninë.
		1396 – Beteja e Nikopolisit; Bajaziti i Parë mposht ushtrinë kryqtare të drejtuar nga Sigismundi i Luksemburgut, mbret i Hungarisë.	1396 – Me aneksimin e Vidinit kryhet dhe përfshirja e plotë e Bullgarisë në zotërimet osmane.		
			1397-1398 – Bajaziti i Parë përfundon pushtimin e pjesës më të madhe të Azisë së Vogël.		
1402-1413 - Lufta civile për mbretërim ndërmjet djemve të Bajazitit të Parë.		1402 – Beteja e Ankarasë; Bajaziti i Parë mundet dhe kapet rob nga Timur Lengu.	1402 – Timur Lengu ngre përsëri një sërë principatash turke në Azinë e Vogël.	1403-1414 Xhamia Eski, në Edrene.	
Mehmeti i Parë (1413-1421)	Nis rimëkëmbja dhe rindërtimi me kujdes i shtetit osman; rinisin zgjerimet territoriale, por të kujdesshme, si në Ballkan, dhe në Azinë e Vogël.	1419-1420 – Fushatat osmane në Danubin e Poshtëm; Vllahia bëhet vasale e shtetit osman.	1419-1420 – Pushtimi i Dobrukhës, Gjurgut dhe Turnut	1416 – Rebelohet sheiku Bedredin; thyhet nga Mehmeti i Parë	

Sulltanët osmanë	Proceset politike	Ngjarjet politike dhe ushtarake	Ndryshimet territoriale	Shoqëria dhe kultura	Ngjarjet më të rëndësishme jashtë Perandorisë Osmane
Murati i Dytë (1421-451, me një ndërprerje në sundimin e tij nga 1444-1446.)			1425-1428 – Aneksimi përfundimtar i Azisë së Vogël Jugperëndimore (principatat e Ajdinit, Menteshesë, Tekes, Germijanit etj.).	1421-1437 Kompleksi Muradije në Bursa zbukurohet nga poçarët nga Tabrizi.	
			1430 – Selniku pushtohet nga osmanët.		
			1439 – Serbia pushtohet për herë të parë nga osmanët.		
	Si kundërveprim ndaj përdorimit të artillerisë nga ushtria hungareze, osmanët të detyruar fillojnë të përdorin armët e zjarrit.	1443 – Fillon fushata hungareze në Ballkan; shqiptarët, të udhëhequr nga Skënderbeu (Gjergj Kastrioti), organizojnë një qëndresë të suksesshme.	1443 - Osmanët lëshojnë Serbinë dhe Shqipërinë.		
	1444 – Fushata e re hungareze në Ballkan thyhet në Varna.				
	1448 – Beteja e dytë e Kosovës; osmanët dalin fitimtarë ndaj ushtrisë hungareze të udhëhequr nga Janosh Huniadi.				
Mehmeti i Dytë (1444-1446, 1451-1481)	Shteti osman organizohet tërësisht si perandori ("epoka klasike"); vendoset struktura e Pallatit dhe një hierarki e qartë e rendit shoqëror; pjesërisht vriten, dhe me ndihmën e <i>kapikuluve</i> (skllevërve	1456 – Osmanët thyhen në Beograd nga Janosh Huniadi	1453 – Pushtimi i Kostandinopojës.	Kostandinopoja kthehet në kryeqytet osman, -Stamboll; <i>Shën Sofia</i> kthehet në xhami; ndërtohen <i>Pallati Topkapi</i> (deri në vitin 1478), tregu i mbuluar (<i>bezistan</i>) dhe një sërë xhamish (midis të cilave <i>Xhamia Fatih</i> – 1463-1470).	1453 – Fundi i Luftës Njëqindvjeçare; Franca del fituese.

Sulltanët osmanë	Proceset politike	Ngjarjet politike dheushtarake	Ndryshimet territoriale	Shoqëria dhe kultura	Ngjarjet më të rëndësishme jashtë Perandorisë Osmane
	të konvertuar të sulltanit), shfuqizohet tërësisht fisnikëria e vjetër; bëhet regjistrimi i pjesës më të madhe të tokave si pronë shtetërore, e cila u shpërnda si <i>fief</i> (timar); për herë të parë përdoren me efektshmëri armët e zjarrit (Perandoria Osmane u quajt "Perandoria e Barutit").		1455-1456- Moldavia bëhet haraçpaguese.		1455 – Gutenbergu boton Biblën e shtypur.
			1459 – Serbia aneksohet përfundimisht.		
			1460 – Pushtohet Dukata e Athinës, Despotati i Mistras dhe pjesa më e madhe e Moresë.		
			1461 – Pushtimi i Perandorisë Bizantine të Trebizondës.	1454 – Patriarku Genadius themelon Akademinë e Patriarkanës në Kostandinopojë.	
		1463-1479 – Lufta osmano – venedikase.	1463 – Pushtimi i pjesës më të madhe të Bosnjës.		1462-1505 – Sundimi i Ivanit të Tretë në Moskovi; marrja e disa principatave ruse dhe shkëputja e Rusisë nga <i>Hordhia e Artë</i> (1480).
			1468 – Pushtimi i Karamanit (Azia e Vogël).		
		1473 – Fitorja osmane mbi Uzun Hasanin në Otlukbeli; forcohet sundimi osman në Anatoli	1470 – Pushtimi i Negropontit (Eubea).		
		1475 – Beteja e Vasluit; osmanët munden nga Stefani i Madh, princi i Moldavisë (1457-1504).	1475 – Osmanët pushtojnë Kafan (koloni gjenoveze në Krime); Hanati Tatar i Krimesë bëhet vasal i Perandorisë Osmane.	1476 – Botohet libri i parë greqisht në Milano (Kostandin Laskaris, Επιτομη των οκτω του λογου μερων).	1469-1492 – Në Firence sundon Lorenzo di Medici; shkëlqimi i Rilindjes Evropiane.
			1479 – Pushtohet pjesa më e madhe e Shqipërisë.		
			1480 – Osmanët pushtojnë Otranton (Italinë Jugore); e lëshojnë atë më 1481.		

Sulltanët osmanë	Proceset politike	Ngjarjet politike dhe ushtarake	Ndryshimet territoriale	Shoqëria dhe kultura	Ngjarjet më të rëndësishme jashtë Perandorisë Osmane
Bajaziti i Dytë (1481-1512)	Politika e paqimit të acarimeve të brendshme shkaktuar nga "despotizmi" i Mehmetit të Dytë, ndërkohë u ruajtën arritjet kryesore centralizuese.		1483 - Pushtimi i Hercegovinës.		
			1484 – Pushtimi i Çilias dhe Cetatea Albas (Akermanit); Moldavia humb daljen në Detin e Zi.	1492 – Dëbimi i hebrenjve sefarditë nga Spanja; një pjesë e madhe e tyre mirëpritën dhe vendosen në Perandorinë Osmane;	1489 – Qiproja bëhet territor venedikas.
		1499-1503- Lufta osmano-venedikase.	Pushtimi i fortesave venedikase në Greqinë kontinentale dhe në Shqipëri.	1493 – shtypshkronja e parë në Stamboll, e ngritur nga hebrenjtë sefarditë të ardhur nga Spanja;	1492 – Kolombi zbulon Amerikën.
			1498 – Perandoria Osmane anekson zonën e brendshme të Malit të Zi; pjesa e bregdetit malazes mbetet nën sundimin venedikas.	1493 – shtypshkronja e parë sllave në Europën Juglindore në Cetinë Mal i Zi (nën ndikimin venedikas); në shekullin e 16-të, shtypshkronjat sllave u përhapën edhe në Vllahi (1508), Bosnjë, Serbi dhe Transilvani, por shumica prej tyre funksionuan vetëm për një periudhë të shkurtër kohe.	1494 – Fushata franceze në Itali; fillimi i luftërave italiane.
			1499-1540 – Pushtimi i Likas dhe i disa pjesëve të Dalmacisë.	1505 – Ngrihet xhamia Bajaziti i Dytë në Stamboll.	1497-1498 - Vasko de Gama zbulon rrugën detare nga Portugalia për në Indi.
Selimi i Parë (1512-1520)	Shtypet me forcë rebelimi i brendshëm pro persian në Anatoli dhe bëhen zgjerime të konsiderueshme territoriale në Lindjen e Afërme, çka rriti ndjeshëm elementin mysliman në Perandorinë Osmane.	1514 – Beteja e Çaldiranit; fitore e madhe osmane në Persi.	1514-1515 – Merret pjesa lindore e Azisë së Vogël.		1502 – Vendoset dinastia e Sefevidëve në Persi; Persia bëhet shiite.
		1516 – Beteja e Marxh Dabikut; fitore e madhe osmane ndaj mamlukëve.	1516-1517 – Pushtimi i Sirisë, Palestinës dhe Egjiptit; osmanët marrin nën mbrojtje Mekën dhe Medinën.		1517 – Botohen "95 tezat" e Martin Luterit në Vitenberg, Gjermani; fillon Reformacioni.

Sulltanët osmanë	Proceset politike	Ngjarjet politike dhe ushtarake	Ndryshimet territoriale	Shoqëria dhe kultura	Ngjarjet më të rëndësishme jashtë Perandorisë Osmane
			1519 – Algjeria njih varësinë nga Perandoria Osmane.		1519 – Karli V zgjidhet perandor gjermano-romak. Duke qenë edhe mbret i Spanjës që nga viti 1516, ai gëzon pushtet të konsiderueshëm dhe e përqendron këtë pushtet në dinastinë habsburgase, duke u bërë kështu kundërshtari më i fuqishëm i Perandorisë Osmane.
Sulejmani i Parë "Ligjvënësi" (1520-1566)	Kulmi i pushtetit osman; zgjerim territorial si në Europë, ashtu dhe në Azi, duke ndërthurur fuqinë ushtarake me një veprimtari të gjerë diplomatike; sistemimi i së drejtës dhe administratës osmane.		1521 – Pushtimi i Beogradit.	1526 – Piri Reisi (1465-1554) shkruan Kitabi Bahrije (Libri i detit), ku përmbledh përvojën detare të asaj periudhe; më 1513, ai bën gjithashtu një hartë detare të detajuar, ku paraqiten edhe dy Amerikat.	1519-1522 – Magelani nis udhëtimin e parë rreth botës.
			1522 – Pushtimi i Rodosit.		1526 – Fillimet e Perandorisë Mughal në Indi.
		1526 – Beteja në Mohaç; fitore e madhe ndaj Hungarisë.			
		1529 – Në Hungari fillon konflikti osmano-habsburgas; dështon Rrethimi i Parë i Vjenës.	1534-1535 – Pushtimi i Irakut.		
		1538 – Osmanët kryejnë një fushatë të suksesshme në Moldavi.	1538- Aneksimi i Benderit (Tigina).	1538- Sinani (i njohur si Mimar Sinan, 1490-1588) bëhet arkitekti perandorak; shkëlqimi i arkitekturës osmane.	
		1541 – Sulejmani nis një fushatë të re në Hungari.	1541 – Aneksionet Hungaria Qendrore (provinca e Budës); Transilvania bëhet principatë haraçpaguese.		
					1543 – Koperniku boton <i>De revolutionibus orbium coelestium</i> .
					1545-1563 -Këshilli i Trentos; Reformacioni Katolik

Sulltanët osmanë	Proceset politike	Ngjarjet politike dhe ushtarake	Ndryshimet territoriale	Shoqëria dhe kultura	Ngjarjet më të rëndësishme jashtë Perandorisë Osmane
			1551-1552 – Aneksionet e Banatit.	Mesi i shekullit të 16-të – Reformati shpërndahet në Hungari dhe në Transilvani; saksonët e Transilvanisë pranojnë <i>luterianizmin</i> , ndërsa një pjesë e madhe e popullsisë hungareze pranojnë <i>kalvinizmin</i> .	1551-1556 – Rusia anekson hanatet tartare të Kazanit dhe të Astrahanit.
		1555 – Në Amasja nënshkruhet paqja midis Perandorisë Osmane dhe Persisë; bëhet më i qëndrueshëm kufiri lindor i Perandorisë Osmane.		1550-1557 – Në Stamboll ndërtohet <i>Xhamia Sulejmanie</i> nga Mimar Sinani.	1555 – Në Perandorinë Gjermane arrihet paqja fetare e Augsburgut.
				1555 – Libri i parë i botuar në gjuhën shqipe: <i>Meshari (Libri i Shërbesave)</i> , nga Dom Gjon Buzuku (botuar në Itali).	1556 – Rënia nga fronti e Karlit V; ndarja e zotërimeve habsburgase ndërmjet trashëgimtarëve spanjollë dhe austriakë.
			1566 – Osmanët aneksojnë Kiosin.	1557 – Ringrihet Patriarkana Ortodokse Serbe e Pejës.	1562-1598 – Luftërat fetare në Francë.
Selimi i Dytë (1566-1574) - "Pijaneçi"		1571 – Në Lepanto, flota osmane mundet nga flota e Lidhjes së Shenjtë.	1570-1571 – Pushtimi i Qipros.	1567 – Shtypshkronja e parë armene në Stamboll. 1569-1575 – Mimar Sinani projektonte <i>Xhaminë Selimje</i> në Edrene.	1566 – Fillon revolucioni antispajnoll në Vendet e Ulëta.
Murati i Tretë (1574-1595)	Kriza financiare, zhvleftësimi i akçeve dhe inflacioni.	1578-1590 – Lufta shkatërrimtare me Persinë.	Pushtimi i Azerbajxhanit dhe i disa provincave të tjera persiane.	1580 – Shkatërrimi, me urdhër të Sulltanit, i observatorit astronomik në Stamboll, pas kundërshtimeve nga drejtuesit fetarë.	1587-1629 – Sundimi i Abazit të Parë në Persi; kulmi i pushtetit Sefevid.

Sulltanët osmanë	Proceset politike	Ngjarjet politike dhe ushtarake	Ndryshimet territoriale	Shoqëria dhe kultura	Ngjarjet më të rëndësishme jashtë Perandorisë Osmane
	Krizë e brendshme e rëndë në Perandorinë Osmane; luftërat e gjata me Perandorinë Habsburgase dhe Persinë shkaktuan vështirësi financiare dhe rënien e organizmave tradicionale ushtarake, veçanërisht të trupave spahi; Perandoria Osmane shkon dalëngadalë drejt përdorimit të mercenarëve (<i>levend</i>) dhe shton numrin e atyre që duhet të paguajnë taksën bujqësore (<i>iltizam</i>).	1593-1606 – Lufta shkatërrimtare me Lidhjen e Shenjtë, e kryesuar nga habsburgët austriakë; rebelimi kundërosman i principatave rumune (1594).		1583-1586 – Kompleksi Muradije në Manisa. 1596 – 1609 – Rebelimi Xhelali në Azinë e Vogël.	1588 – Shkatërrimi i armadës spanjolle nga flota angleze. 1598 – Edikti i Nantës, tolerancë ndaj kalvinistëve francezë.
Mehmeti i Tretë (1595-1603)					
Ahmeti i Parë (1603-1617)		1602-1612 – Lufta me Persinë. 1606 – Traktati i Paqes në Zsitvatorok me habsburgët austriakë.	Osmanët humbasin territoret e pushtuara në vitet 1578-1590; humbjet e para të mëdha territoriale të Perandorisë Osmane.	1609-1616 – Në Stamboll ngrihet xhamia e sultan Ahmetit (<i>Xhamia Blu</i>)	1603 – Vdes Elizabeta e Parë (1558-1603); Xhejms Stjuart, mbret i Skocisë, bëhet edhe mbret i Anglisë, duke bashkuar të dyja mbretëritë. 1613 – Vendosja e dinastisë së Romanovëve në Rusi.
Mustafai i Parë (1617-1618)					
Osmani i Dytë (1618-1622)	Përpjekjet për reforma të brendshme shkaktojnë rebelimin e jeniçerëve; sultani rrëzohet nga fronti dhe vritet.	1620-1634 – Lufta me bashkimin Poloni-Lituani për sundimin mbi Moldavinë.			1618-1648 – Lufta 30-vjeçare.
Mustafai i Parë (1622-1623)					
Murati i Katërt (1623-1640)	Ndiqet një politikë e ashpër për të rivendosur ligjin dhe rregullin.	1623-1639 – Lufta me Persinë; pas humbjeve fillestare në luftë kundër Abazit të Parë, me ekspeditat e Muratit të Katërt dhe Traktatin e Paqes së Kasri-Sirinit, (1639) rivendosen kufijtë e viteve 1555 dhe 1612.		1627 – Patriarku Ciril Lukarisi hap një shtëpi botuese greke në Stamboll; ajo u mbyll nga osmanët mbas ekzekutimit të patriarkut. (1638)	
				1635 – Revan Kiosku, në Pallatin Topkapi.	

Sulltanët osmanë	Proceset politike	Ngjarjet politike dhe ushtarake	Ndryshimet territoriale	Shoqëria dhe kultura	Ngjarjet më të rëndësishme jashtë Perandorisë Osmane
Ibrahimi i Parë - "I çmenduri" (1640-1648)		1645-1669 – Lufta shkatërrimtare me Venedikun.	Pushtimi i Kretës (përfundoi vetëm më 1669);		1640 – Fillimi i Luftës Civile në Angli, midis mbretit dhe parlamentit.
Mehmeti i Katërt (1648 – 1687)	Mbas disa viteve trazirash të brendshme, vezirët e mëdhenj të familjes së Qyprilinjve arritën të forconin institucionin e vezirit të madh, të rivendosnin rregullin e brendshëm dhe të rifillonin zgjerimin e jashtëm territorial.	1656 – Mehmet Qyprili pasha emërohet vezir i madh, dhe merr pushtet të plotë për të qeverisur Perandorinë.		1648-1657 – Gjeografi dhe historiani i famshëm osman Qatip Çelebi (1609-1657) shkruan librin e tij gjeografik <i>Xhihannüma</i> .	1648 – Rebelimi i kozakëve në Ukrainë, i udhëhequr nga Bogdan Hmelnicki; krizë në bashkimin Poloni-Lituani.
		1661 – Fazel Ahmed Qyprili pasha pason babanë e tij si vezir i madh (1661-1676).		1665-1666 – Lëvizja mesianike e Sabbata Zevit.	1655-1660- Lufta e Parë Nordike.
		1672-1676 – Lufta me bashkimin Poloni-Lituani.	Pushtimi i Podolias.	1667 – Tërmet i madh që dëmton rëndë Raguzën.	1661 – Fillimi i sundimit personal të Luigjit XIV në Francë (mbret në vitet 1643-1715); kulmi i absolutizmit francez.
		1683 – Rrethimi i dytë osman i Vjenës; osmanët mundën në Vjenë nga një ushtri austro-polake.			
		1684 – Krijohet Lidhja e Shenjtë (Austria, Poloni-Lituania, Venediku, Shteti Papal, dhe Rusia, që nga viti 1686).	1686-1687 – Trupat austriake pushtojnë Hungarinë dhe Transilvaninë.		1685 – Shfuqizimi i Dekretit të Nantës në Francë.
				1687 – Isak Njutoni boton <i>Philosophiae naturalis principia mathematica</i> .	

Sulltanët osmanë	Proceset politike	Ngjarjet politike dhe ushtarake	Ndryshimet territoriale	Shoqëria dhe kultura	Ngjarjet më të rëndësishme jashtë Perandorisë Osmane
Sulejmiani i Dytë (1687-1691)	Reformat e mëdha monetare dhe fiskale rimëkëmbin të ardhurat osmane; në këtë mënyrë mund t'u bëhet ballë shpenzimeve të luftës.		1688-1690 – Pushtimi i përkohshëm austriak i Beogradit dhe pjesëve të tjera të Serbisë.	1690 – Ri-pushtimi osman i Beogradit pasohet nga një shkallë e lartë emigrimi të serbëve nga Serbia Jugore dhe Kosova, për në Sllavoni dhe Hungari.	1688 – Revolucioni i Lavdishëm në Angli, i cili vendosi monarkinë parlamentare. 1689 – Fillon sundimi personal i Pjetrit të Parë (1682-1725) në Rusi.
Ahmeti i Dytë (1691-1695)				1694 – Princi Konstantin Brankoveanu hap Akademinë Mbretërore Greke në Bukuresht; në shekullin e 18-të, një institucion i ngjashëm u krijua në Jashi (Moldavi).	
Mustafai i Dytë (1695-1703)	1695 – Riorganizimi i sistemit të tatimit bujqësor, me futjen e taksës së përhershme bujqësore (e quajtur <i>malikane</i>); sistemi i ri forcon bazën e pushtetit, që përbëhet nga familjet fisnike (ajane) në provinca, të cilat grumbullojnë zotërimet e mëdha të trashëgueshme.	1697 – Humbja e betejës së Zentës kundër austriakëve. 1697 – Danilo Petroviç Njegoshi bëhet metropolit i Cetinës (Malit të Zi); nis ndërgjegjësimi gradual për shkëputje nga sundimi osman dhe krijimin e një principate të udhëhequr nga princët-metropolitë të familjes <i>Petroviç Njegosh</i> .			
		1699- Paqja e Karlovcit.	Perandoria Osmane humbet Hungarinë (duke përfshirë këtu Sllavoninë) dhe Transilvaninë, të cilat i kalojnë Perandorisë Habsburgase; Moreja, Lika dhe territore të tjera më të vogla dalmate i kalojnë Venedikut; Podolia i kalon Polonisë dhe Azovi, Ruisë.	Rreth viteve 1700 – Kompozitori Dimitrie Kantemiri (1673-1723), shkruan një libër mbi muzikën osmane, në të cilin përfshin edhe një përmbledhje me 353 pjesë instrumentale.	1700-1721 – Lufta e Madhe Nordike; fitore e madhe e Ruisë ndaj Suedisë në Poltavë (1709). 1701-1714 – Lufta për fronin spanjoll.

Sulltanët osmanë	Proceset politike	Ngjarjet politike dhe ushtarake	Ndryshimet territoriale	Shoqëria dhe kultura	Ngjarjet më të rëndësishme jashtë Perandorisë Osmane
Ahmeti i Tretë (1703-1730)		1710-1711 – Lufta me Rusinë.	Rimerret Azovi.		
	E ashtu quajtura “epoka e tulipanëve” karakterizohet nga risi kulturore dhe përpjekje për reforma të brendshme dhe hapje me Perëndimin, të nxitura nga veziri i	1715-1718 – Lufta me Venedikun dhe Austrinë; osmanët mundën dhe nënshkruajnë Traktatin e Paqes së Pasarovicit.	1715 – Pushtimi i Moresë nga venedikasit.		
	madh Ibrahim pasha Nevshehirli (1718-1730), por kjo periudhë u ndal nga një rebelim i jeniçerëve, i cili i detyroi vezirin dhe sulltanin të linin pushtetin.		1716-1718 – Banati, Serbia Veriore dhe Oltenia (Vllahia Perëndimore) u dorëzohen austriakëve.	1720 – Surnamei-Vehbi tregon për festimet me rastin e synetllëkut të djemve të sulltanit, shkruar nga poeti Vehbi dhe i ilustruar me 137 piktura në miniaturë nga Levni (1673-1736).	
			1722-1725 – Pas kaosit në Persi, pushtohet Gjeorgjia, Azerbajxhani dhe Shirvani.	1727 – Në Stamboll hapet shtypshkronja e parë osmane nga Ibrahim Myteferrika; ajo u mbyll me vdekjen e tij, në vitin 1745.	1722 – Persia pushtohet nga afganët; bie sundimi Sefevid.
			1730 – Perandoria Osmane humbet Azerbajxhanin dhe Shirvanin, që merren nga Nadiri.	1728 – Ndërtohet shatërvani i Ahmetit të Tretë (përpara Pallatit Topkapi).	1726-1730 – Nadiri (shah në vitet 1736-1747) i kthen Persisë shkëlqimin e saj.
Mahmuti i Parë (1730-1754)	Politikat e reformave të kujdeshme, veçanërisht në artileri (veprimtaria e ekspertit francez, kontit të Bonevalit) dhe në zhvillimin urban (ndërtimi i më shumë se 60 shatërvanëve publikë në Stamboll).	1730-1736 - Lufta me Persinë.	Perandoria Osmane humbet Gjeorgjinë.		1733-1738 – Lufta për fronin polak.
		1736-1739 – Me anë të Traktatit të Paqes në Beograd, përfundon lufta me Austrinë dhe Rusinë.	Oltenia i kthehet Vllahisë dhe Serbia Veriore, Perandorisë Osmane; Rusia rimerr Azovin.	Emigrimi i dytë i popullsisë serbe për në Banat dhe në Hungari.	

Sulltanët osmanë	Proceset politike	Ngjarjet politike dhe ushtarake	Ndryshimet territoriale	Shoqëria dhe kultura	Ngjarjet më të rëndësishme jashtë Perandorisë Osmane
		1743-1746 – Lufta me Persinë.		1746 – Princi Kostantin Mavrokordati ndalon me ligj bujkrobërinë në Vllahi; në vitin 1749, ai ndërmerri një reformë të ngjashme në Moldavi.	1740-1786 – Frederiku i Dytë sundon në Prusi. 1740-1748 – Lufta për fronin austriak. 1748 – Monteskjë boton <i>Lesprit des lois</i> . 1751-1780 – <i>Enciklopedia</i> me 35 volume, e botuar në Paris, arritje e madhe e Iluminizmit Europian.
Osmani i Tretë (1754-1757)					1756-1763 – Lufta 7-vjeçare.
Mustafai i Tretë (1757-1774)	Mbas një periudhë të gjatë paqeje dhe përpjekjesh për të qëndruar larg konflikteve europiane, Perandoria Osmane hyn në luftë me Rusinë; kjo luftë do të nxjerrë në pah të gjitha dobësitë e saj të grumbulluara në kohë. Për këtë Perandori nis tashmë faza e rënies së vazhdueshme; pushteti i <i>ajanëve</i> (fisnikëve lokalë) është në rritje, ndërsa autoriteti i qeverisë qendrore, në shumicën e provincave, dalngadalë shpërbëhet.	1768-1774 – Lufta ruso-turke; ushtritë ruse pushtojnë Krimenë, Moldavinë dhe Vllahinë; flota detare ruse mund osmanët në detin Egje, ndërkohë frymëzon disa kryengritje në Greqi dhe në Levant. 1774 – Traktati i Paqes në Kyçyk Kajnarxhik; Rusia përforcon pozitat e saj në bregdetin verior të Detit të Zi dhe bëhet mbrojtëse e nënshtetasve ortodoksë të Perandorisë Osmane.	1774 – Krimeja nuk është më shtet vasal osman.	1766-1767 – Autoritetet osmane ndalojnë veprimtarinë e Peshkopatës së Ohrit dhe Patriarkanës së Pejës; Patriarkana e Kostandinopojës ushtron autoritet fetar mbi të gjithë ortodoksët e Perandorisë Osmane në Europë.	1762-1796 – Katerina II mbretëron në Rusi. 1722 – Ndarja e parë e Polonisë.

Sulltanët osmanë	Proceset politike	Ngjarjet politike dhe ushtarake	Ndryshimet territoriale	Shoqëria dhe kultura	Ngjarjet më të rëndësishme jashtë Perandorisë Osmane
Abdulhamiti i Parë (1774-1789)	Përpjekje për të rivendosur pushtetin ushtarak osman, me ndihmën e ekspertëve perëndimorë (veçanërisht francezë). Gjithsesi, lufta e viteve 1787-1892 nxori në pah dështimin e këtyre përpjekjeve.		1755 – Osmanët i dorëzojnë Bukovinën (Moldavinë Veriperëndimore) Austrisë.	1784 – Rihapet shtypshkronja turke në Stamboll.	1775-1783 – Lufta e popullit amerikan për pavarësi.
			1783 – Rusia anekson Krimenë.		1780-1790 – Jozefi i Dytë mbretëron në Austri.
Selimi i Tretë (1789-1807)	Përpjekjet për reforma administrative, ushtarake, financiare dhe politike. Për shkak të rrëmujave të brendshme dhe opozitës konservatore të jeniçerëve, dështojnë përfundimisht	1787-1792 – Lufta midis Rusisë dhe Austrisë; humbje të mëdha osmane; Revolucioni Francez dhe çështja polake shpëtojnë Perandorinë Osmane nga humbja e territoreve të mëdha.			1787 – Kushtetuta e Shteteve të Bashkuara të Amerikës.
					1793,1795 – Ndarja e dytë dhe e tretë (përfundimtare) e Polonisë
	"Ligji i ri" – <i>Nizam-i xhedid</i> ; kulmi i fuqisë së ajanëve në provinca.	1798-1799 – Fushata franceze në Egjipt dhe Siri. 1798-Kuvendi i krerëve malazezë miraton <i>Kodin e Përgjithshëm dhe të Malësisë</i> .			

KAPITULLI I:

Zgjerimi territorial osman në Europën Juglindore

Zgjerimi territorial osman filloi rreth vitit 1300 në Azinë e Vogël Veriperëndimore, dhe vazhdoi deri nga fundi i shekullit të 17-të; pushtimi i fundit i rëndësishëm ishte Podolia (në atë kohë provincë e Poloni-Lituanisë, tani pjesë e Ukrainës), në vitin 1672. Ky zgjerim territorial e shndërroi principatën e vogël të fshatarëve gjysmështegtarë në një perandori botërore burokratike, të shtrirë në tri kontinente.

Pjesa më e madhe e Europës Juglindore u pushtua në shekujt e 14-të dhe 15-të, por disa pjesë të saj u pushtuan më vonë (p.sh. Sllavonia, Banati, Qiproja, Kreta) ose mbetën të lira nga sundimi osman (p.sh. Korfuzi, Sllovenia, pjesë të Dalmacisë dhe Kroacia). Për popujt e rajonit, pushtimi osman ishte një ngjarje e rëndësishme, që pati ndikim në jetën e tyre si në planin afatshkurtër, ashtu edhe në atë afatgjatë. Historianët kanë shprehur opinione të ndryshme dhe shumë herë kontradiktore për këtë proces. Shumica e tyre e kanë paraqitur atë nga këndvështrimi kombëtar, edhe pse njerëzit në fund të mesjetës rrallëherë e vështronin botën sipas kufijve etnikë. Këta historianë e kanë paraqitur këtë proces si një varg arritjesh ushtarake heroike, në të cilat populli i tyre luftonte me guxim kundër armiqve të fuqishëm. Për ta, pushtimi osman ka qenë ose një katastrofë për popullin e tyre dhe/ose për qytetërimin evropian, ose, në të kundërt, një vendosje me përfitime e paqes nga osmanët. Për disa historianë të tjerë, natyra e vërtetë e procesit të pushtimit ka qenë më e ndërlikuar. Ndarjet etnike, fetare dhe etike shpesh nuk ishin kaq të qarta. Fushata të mëdha ushtarake shoqëroheshin edhe nga përlëshje lokale. Në nivel lokal, motivimi dhe këndvështrimi ndryshonin shumë nga ndarjet e prera që bëjnë sot historianët modernë. Të sigurojë bashkëpunëtorë, ishte shpeshherë po aq e rëndësishme sa edhe të luftoje. Heroizmi dhe përkushtimi ndaj idealeve të caktuara ishin pjesë e së njëjtës tablo, ku gjendeshin mizoritë, vuajtjet dhe mashttrimet.

Ky kapitull i këtij *Libri* nuk synon të dokumentojë me hollësi procesin e pushtimit osman dhe/ose qëndresën e popujve të ndryshëm ndaj tij. Thjesht ai jep një numërtë kufizuar burimesh, që u bëjnë të mundur nxënësve të hedhin një vështrim mbi ndërlikueshmërinë e këtij procesi dhe mënyrat e ndryshme me anën e të cilave njerëzit e asaj kohe i vështronin dhe i përjetonin ngjarjet.

Ia. Fazat e para të shtetit osman në Anatoli

I-1. Martesa e Orhanit me vajzën e *tekvurit*¹ të Jar Hisarit

Pjesa e 13-të

Në këtë pjesë flitet për nusen që ata morën, e cila ishte vajza e *tekvurit* të Jar Hisarit; kujt iu dha nuse dhe çfarë u bë me të.

Osman Gazi² e mori Ylyfer Hatunin për djalin e tij, Orhan Gazin³. Në atë kohë, Orhani ishte bërë një djalë

trim. [...] Dhe kur ata i zunë këto katër kështjella [Bilexhikun, Jar Hisarin, Inegëlin, Aja Nikolën], sollën drejtësi dhe barazi në atë provincë dhe të gjithë njerëzit e atyre fshatrave u kthyen dhe u rivendosën aty ku u takonte. Ata filluan të bënin një jetë më të mirë sesa nën sundimin e të pafeve. Njerëz nga provinca të tjera filluan të vinin, ndërsa dëgjonin se sa mirë trajtoheshin këta të pafe. Ndërkohë Osman Gazi donte të bënte dasmë, për t'ia dhënë për

¹ Shkruhet edhe *tekfur* dhe do të thotë sundues i vogël i krishterë në Azinë e Vogël, zotërimet e të cilit përfshiheshin në territoret osmane.

² Osmani i Parë – themeluesi i shtetit osman, sundoi nga viti 1281 deri rreth vitit 1324.

³ Orhani – sundues osman nga 1324 deri më 1362.

nuse Ylyfer Hatunin djalit të tij, Orhan Gazit. Dhe kështu bëri. Ylyfer Hatuni është zonja që ka një *teqe* pranë kalasë së Bursës, afër Portës së Kapluxhës [Burimeve të Nxehta]. Ishte ajo që kishte ndërtuar urën mbi përroin Ylyfer. Kjo është ura që i ka dhënë emrin e saj atij përroi. Dhe të dy, si Murat Kan Gazi⁴ dhe Sulejman pasha⁵, janë djemtë e saj. Babai i të dyve ishte Orhan Gazi. Kur zonja vdiq, ajo u varros bashkë me Orhan Gazin në kalanë e Bursës.

Aşikpaşa-zâde, f. 102.



Kronika e Ashikpasha-zadesë është një nga kronikat e para të dinastisë osmane, por është shkruar në shekullin e 15-të, domethënë thuhet një shekull pas ngjarjeve që përshkruhen në të.



Përse u martua Orhan Gazi me vajzën e tekvurit? Përse e mori babai i tij vendimin për të kryer këtë martesë? Mendojeni veten tuaj në pozicionin e Orhanit. Sipas Ashikpasha-zadesë, cilat ishin cilësitë më të rëndësishme që duhej të kishte një grua osmane?

I-2. Pushtimi i Karaxha Hisarit dhe leximi i parë i *hutbes* në emër të Osman Gazit.

Pjesa e 14-të

Në këtë pjesë flitet për mënyrën më të cilën Osman Gazi arriti që lutjet e së premtes të kryheshin në emër të tij; po ashtu edhe mënyrën se si filloi kjo praktikë në qytet.

Kur zaptoi Karaxha Hisarin, shumica e shtëpive në qytet ishin boshatisur. Dhe shumë njerëz vinin nga provinca e Germijanit dhe provinca të tjera. Ata kërkonin që Osman Gazi t'u jepte shtëpi. Dhe Osman Gazi u dha shtëpi. Nuk zgjati shumë kohë dhe qyteti filloi të lulëzojë. Kishat e tyre të shumta ata i kthyen në xhami. Gjithashtu, ata ndërtuan edhe një treg. Dhe këta njerëz [*kavim*, gjithashtu: fis] ranë në një mendje me njëri-tjetrin që të kryenin lutjet e së premtes, dhe të kërkonin gjithashtu edhe

një *kadi*. Ishte pikërisht një njeri i shenjtë me emrin Dursun Faki që shërbeu si *imam* për fisin dhe ishte ky personi të cilit njerëzit i flisnin hapur. Më pas, ai shkoi tek vjehri i Osman Gazit, EdeBali dhe i tregoi për këtë gjë. Por përpara se ai të mbaronte bisedën, aty erdhi Osman Gazi. Ai e kuptoi se çfarë donin ata. Osman Gazi tha: "Çfarëdo që duhet bërë, bëjeni." Dursun Faki tha: "Por, hani im, na duhet leja e sulltanit⁶". Osman Gazi tha: "Këtë qytet unë e zaptova vetëm me shpatën time. Ç'punë ka sulltani, përse duhet t'i kërkojmë leje? Injëjti allah që i dha atij sulltanatin, më ka dhënë mua kazanë dhe principatën time, - tha ai. Dhe nëse ai më përçmon mua për flamurin që unë mbaj, atëherë unë do t'i kujtoj se nën këtë flamur unë kam luftuar kundër të pafeve. Dhe nëse ai do të më tregojë që është nga dinastia e selxhukëve [Âl-i Salçukvan], unë do t'i thoj që dhe unë jam vetë djali i Gëk Alpit. Dhe nëse ai më thon se ka arritur në këto troje përpara nesh, atëherë do t'i them se ishte gjyshi im, Sulejmanshahu, i cili ka ardhur përpara tij"- përfundoi ai. Dhe kështu ndodhi që ai popull [ose ai fis] u bindën. Ai i dha Dursun Fakiut postin e kadiut dhe të drejtën për të predikuar. *Hutbeja* e së premtes u lexua për herë të parë në Karaxha Hisar. Atje ishte edhe vendi ku ata kryenin lutjet e *Bajramit*.

Aşikpaşa-zâde, f. 102-103



Në traditën politike islamike, leximi i *hutbes* të së premtes në emër të sunduesit është një kusht paraprak për të fituar sovranitetin (sundimin e pavarur). Kronika e shekullit të 15-të e shtrembëron realitetin historik të fillim shekullit të 14-të; në të vërtetë, ishin mongolët që i dhanë fund sulltanatit selxhuk në vitin 1307, përpara sesa Osmani të bënte ndonjë përpjekje për të ushtruar sovranitetin e tij. Për më tepër, mbas vitit 1307, Osmani, dhe më pas djali i tij Orhani, i paguan haraç Principatës Mongole të Persisë, deri kur ra ajo, në fund të viteve 1330.



Çfarë strategjish përdori Osmani për të zgjeruar bazën e pushtetit të tij? Ç'informacion japin të dy tekstet për strukturën etnike dhe fetare të Anatólisë Veriperëndimore në prag të pushtimit osman?

⁴ Murati i Parë - sundues osman (1362-1389).

⁵ Sulejman pasha – djali i madh i Orhanit; udhëhoqi osmanët në sulmet e para në Gadishullin Ballkanik dhe pushtoi Galipolin (1354); vdiq në vitin 1357.

⁶ Leja e sulltanit selxhuk të Konjës (Ikonion), i cili më parë kishte qenë drejtuesi i prijësve ushtarakë të kufirit, siç ishte Osmani.

Ib. Pushtimi osman i Gadishullit Ballkanik

I-3. Kontradiktat ndërmjet shteteve të krishtera në Ballkan dhe roli që luajtën në zgjerimin territorial osman

Vetëm Amorati⁷ mbeti gjallë. Ai ishte i ri, i pabindur dhe ishte kundër bullgarëve. Ai donte që grekët ta lejonin të kalonte, por u ndalua nga anije dhe varka të shumta, të cilat Kantakuzeni⁸ i kishte ndërtuar dhe i mirëmbante në mënyrë që të ruante vaun e Galipolit. Sikurse thamë, Amorati ishte i detyruar të kalonte detin. Kur Kantakuzeni e kuptoi që nuk mund t'i ushqente ushtarët që kishte nëpër varka, pasi kishte mungesë në ushqime dhe mish derri, dhe thesari po i boshatisë çdo ditë e më shumë, domethënë dukatet dhe argjendi iu pakësuan, atëherë mendoi të dërgonte lajmëtarë në Tërnovo, tek car Aleksandri⁹ për të kërkuar ushqime për detarët e tij, në mënyrë që ata të ruanin vaun. Megjithatë, kur e morën vesh këtë gjë, bullgarët i tallën dhe i fyen grekët, jo vetëm duke i sharë e fyer drejtpërdrejt, por edhe duke sharë gratë dhe nënat e tyre. Pra, i përzunë. Kur dëgjoi këtë lajm, Kantakuzeni ra në dëshpërim të thellë dhe dërgoi lajmëtarët e tij tek sunduesit serbë Uroshë, despoti Uglesha dhe mbreti Vulkashin për të kërkuar ndihmë për flotën e tij. Edhe ata, kur dëgjuan këtë kërkesë, i tallën dhe i fyen grekët, jo vetëm duke i fyer ata vetë, por edhe duke sharë gratë dhe nënat e tyre; dhe i përzunë po ashtu duarbosh. Kur dëgjoi këtë lajm, Kantakuzeni ra në një dëshpërim edhe më të thellë, pa ditur se ç'të bënte. Më pas, Kantakuzeni dërgoi lajmëtarët e tij si te carët bullgarë, ashtu dhe tek sundimtarët serbë për t'u thënë atyre: "Ju nuk deshët të na ndihmoni, por do të pendoheni për këtë." Megjithatë, ata nuk i morën parasysh fjalët e tij dhe iu përgjigjën: "Kur të vijne tek ne turqit, do të dimë si të mbrojmë veten tonë." Atëherë Kantakuzeni bëri një marrëveshje me Amuratin; ata i dhanë fjalën njëritjetrit dhe shkëmbyen letra, të cilat janë ruajtur deri në ditët e sotme, ku thuhet që turqit në asnjë mënyrë nuk do t'u bëjnë keq grekëve as në Rumani¹⁰, dhe

as në Maqedoni. Turqit u betuan që do ta mbanin premtimin e tyre dhe pas kësaj Kantakuzeni i la turqit të kalonin Galipolin.

Georgieva, Kitanov, f. 4-6.



Autori anonim i *Kronikës bullgare* të shekullit të 16-të ka njohuri të paqarta dhe të pasakta për faktet historike të mesit të shekullit të 14-të. Në të vërtetë, Joan Kantakuzeni i kishte thirrur osmanët të udhëhequr nga Sulejmani, djali i Orhanit dhe vëllai i madh i Muratit, për ta ndihmuar atë në luftën civile kundër perandorit Joani V Paleologu (1341-1391). Në atë kohë, serbët udhëhiqeshin nga Stefann IV Dushani (1331-1355), i cili e shfrytëzoi luftën civile të Bizantit për të pushtuar vetë territoret bizantine.



A i bie besueshmëria idesë së përgjithshme të *Kronikës anonime bullgare* për shkak të pasaktësisë së fakteve? Apo faktet janë shtrembëruar me qëllim nga ana e autorit, në mënyrë që të përçojë një 'mesazh' të caktuar?

I-4. Fermani i Muratit të Parë, i cili i jep Evrenoz beut të drejtën për të sunduar territorin e Maqedonisë Jugore (1386)

Fermani i Lartë Perandorak urdhëron si më poshtë: Të nderuarit, mbrojtësit të territoreve, themeluesit të provincës, krenarisë së pushtuesve fisnikë, komandantit të luftëtarëve të besimit në luftë kundër të pafeve dhe paganëve, Gazi Haxhi Evrenoz beut – lumturia i zgjattë përgjithmonë! – i cili kaloi nëpër provincën e Rumelisë, së bashku me vëllanë dhe udhëheqësin tim, Gazi Sulejmanin, dhe i pushtuan këto toka. Për shërbimet e tij, unë i jap: qytetin e Gjumurginës, si dhe qytetin e Seresit deri në Bitola, Biglishte dhe Hrupishte, që mund të merren si një sanxhak (me të ardhura dhjetë herë njëqind mijë akçe¹¹), gjithçka që ka fituar me shpatën e tij.

⁷ Murati i Parë (1362-1389), për bullgarët.

⁸ Joan VI Kantakuzeni, perandori bizantin 1341-1354; i detyruar të abdikojë, ai u bë murg dhe u shqua si një nga akademikët më të rëndësishëm të Bizantit.

⁹ Ivan Aleksandri (1331-1371).

¹⁰ Në mesjetë, kjo nuk nënkuptonte territorin gjeografik të Rumanisë së sotme, por territorin e Perandorisë Bizantine.

¹¹ Akçe (aspër) – monedhë e vogël e argjendit osmanë; ajo ka qenë monedha më e përdorur gjatë shekujve XIV-XVII.

Unë të kam caktuar komandant të përgjithshëm në këto toka dhe të këtyre luftëtarëve dhe ushtarëve të cilët luftojnë për fe, dhe të urdhëroj: të jesh një udhëheqës i drejtë! Por ki kujdes që mos kesh zili e të thuash "Unë e hapa rrugën dhe pushtova këto pjesë të Rumelisë", por është më mirë që ta dish se toka i përket në fillim Zotit, dhe më pas Profetit. Dhe me urdhër të Zotit të Plotfuqishëm, Profetit dhe besimtarit të tij, t'u dha ty.

Odrani, I, f. 187-189.



Evrenozit është një nga udhëheqësit e parë të akinxhinjve (kalorësisë që sulmonte e para për të vrrarë dhe plaçkitur). Fermani i vitit 1386 është pjesë e përpjekjeve sistematike të Muratit të Parë për të integruar në sistemin shtetëror udhëheqësit ushtarakë, të cilët shpesh vepronin si të pavarur gjatë fazave të para të zgjerimit territorial osman.



Si u përpoq Murati i Parë ta nënshtonte dhe të siguronte besimin e Evrenoz beut?

I-5. Roli i bashkëpunëtorëve lokalë/vendas në zgjerimin e territoreve osmane në Ballkan

Tradicionalisht [*rivayet iderler ki*], vendet që zotëronte Sosmanozi, djali i Aleksandrit, ishin ato në anën e Edrenesë të lumit Danub [Tuna]. Rrugës për në Vllahi [Eflak], ajo çka shtrihej në anën e sipërme të Danubit, ishte Vllahia dhe ajo çka shtrihej në anën tjetër, ishin tokat e Sosmanozit¹². Dhe kjo ishte një provincë me të vërtetë e mirë dhe e begatë. Ajo furnizonte gjithë botën me mjaltë, me gjalpë dhe me bagëti. Të gjitha prodhimet dhe të ardhurat që kishte kjo zonë ishin më të mëdha se në të gjitha provincat e tjera. Dhe kështjellat e saj të forta ishin më tepër se dyzet.

[...]

Historia e ardhjes së Ali pashës¹³ në rrethinat e kalasë së Provadjas [Piravadi]

Thuhet se Ali pasha, i cili kishte ngritur dhe mbledhur këtë ushtri, u nis nga Edreneja për të ardhur në Ajdos. Mbikëqyrësi [subashi] i Provadijas, dikush me emrin Hysen bej, i cili në të vërtetë ishte një i pafe, por i njohur për bujarinë e tij, e takoi dhe e mirëpriti pashanë. Në fillim i dha mikpritjen e tij. Më pas, pashai kaloi përroin e Kamxhit dhe arriti në kështjellën e Çenekes [Çenge]; ai qëndroi atje gjithë ditën, por ditën tjetër zbriti në afërsi të Provadijas. Ai mori një mijë luftëtarë për të shoqëruar Jahshi beun, djalin e Temurtashit, dhe e nisi për në Provadija me këto fjalë: "Mundohu dhe shiko nëse mund të gjesh ndonjë marifet për të pushtuar Provadijan, mirë?" Kështu, Jahshi beu u nis dhe shkoi në rrethinat e Provadijas. Ata bënë sikur po ngrinin kampin e tyre aty pranë. Ishte dimër dhe binte dëborë. Hysen beut i erdhi keq për kuajt dhe donte t'i strehonte diku, që të mbroheshin nga të ftohtët dhe, duke mos ditur se për ç' arsye kishin ardhur, i futi ata në Tash-hisar [atje ku mbaheshin gurët]. Pasi kishin hyrë në Tash-hisar, natën, të maskuar, ata hynë në kullën e kështjellës dhe morën kështu kështjellën; pastaj dërguan një farë Murati tek pashai për t'i dhënë lajmin e gëzuar. Të nesërmen, pashai vetë u nis dhe erdhi në Provadija, hyri në kështjellë dhe vendosi trupat e tij atje, ndërsa myezinët nisën të thërrasin besimtarët për të ardhur në lutje. Mbas kishte armatosur dhe furnizuar kështjellën, pashai erdhi dhe ndërtoi kampin në Vençen [Vefçen, Vefxhen]. Kur panë që po vinte, njerëzit në kështjellë i çuan çelësat e fortesës. Në të njëjtën mënyrë, atij i sollën edhe çelësat e Madaras dhe Shumnit, të cilat u dorëzuan vetë. Më pas pashai hyri në kështjellën Shumni dhe e përforcoi këtë fortesë.

Neşri, str. 245–247




Kronika osmane e fillimshekullit të 16-të përpiqet të nxjerrë në dukje meritat e pushtuesve osmanë, dhe mundohet të shmangë faktin që ata këmbëngulën të bënin marrëveshje me feudalët vendas në Bullgarinë Lindore; megjithatë, në këtë burim gjenden lehtë raste të bashkëpunimit midis tyre.

¹² Ivan Shishmani, sundues bullgar [car] i Tërnovos (1371-1395), djali i Ivan Aleksandrit (1331-1371).

¹³ Ali pashë Çandarlızadeja, djali i Halil Hajredin pashës, i cili, ashtu si babai i tij, u bë gjyqtar ushtarak, komandant ushtrie, dhe më pas vezir i madh, nga viti 1389 deri në fund të jetës së tij, në vitin 1407. Ai tregoi aftësi të shquara administrative, diplomatike, ushtarake, duke u shërbyer tre sundimtarëve me radhë: Muratit I, Bajazitit I dhe Sulejman Çelebiut.

❓ Ç'ndodhi me mbikëqyrësin e krishterë të Piravadit mbas pushtimit osman? Çfarë ju sjell ndërmend emri "Hysen bej"? A ishte Hysen beu një tradhtar apo viktimë e një mashtrimi? A ishte ai bujar, i korruptuar apo i sjellshëm (atij i erdhi keq për kuajt)? Apo i kishte të gjitha këto cilësi së bashku? Krahasoni veprimet e Ali pashës me ato të Hysen beut. Cili ishte më i aftë si luftëtar- politikan? Në ç'mënyrë karakteristikat vetjake (të protagonistëve) u japin ngjyrë ngjarjeve historike?

► **Fig. 1. Bajaziti i Parë vjen për të shpëtuar Nikopolisin e rrethuar një natë përpara betejës me kryqtarët (1396) – miniaturë osmane (rreth 1584)**



Lewis, str. 292

❓ Përse janë pikturuar të krishterët me veshje të shekullit të 16-të? Gjeni një element tjetër në pikturë që nuk përdorej nga osmanët në shekullin e 14-të. Si paraqitet sulltani në raport me figurat e tjera, domethënë me të krishterët? Pse janë vizatuar njerëzit kaq të mëdhenj në krahasim me relievin dhe ndërtesat?

I-6. Shpjegime të shekullit të 14-të mbi fitoret e osmanëve ndaj të krishterëve

A. Gregori Palamas (1354)

Disa nga ata [turqit] m'u afruan, filluan diskutimet dhe, për të kompensuar dobësitë e argumentimit të tyre, e paraqitën kapjen [tonë] si shenjë që besimit tonë i mungon baza fetare.

Këta njerëz të paditur, të urryer nga Zoti dhe të poshtër, mburren me faktin që kishin fituar kundër Romejve¹⁴, si rezultat i dashurisë së tyre për Zotin; ata nuk e dinë që kjo botë jeton në mëkat dhe pjesa më e madhe e saj u përket atyre që i shtypin fqinjët e tyre me armë; prandaj, deri në kohën e Kostandinit, i cili sundoi me të vërtetë me dashuri për Zotin, idhujtarët kanë zaptuar pothuajse të gjithë botën, madje edhe për shumë kohë mbas tij, të tjerët nuk ndryshonin aspak ose tepër pak nga ata.

Phillipidis-Braat, f. 140-143.



Gregori Palamas (1296-1359, i shenjtëruar në vitin 1368) ishte një nga teologët kryesorë ortodoksë të shekullit të 14-të. Ai mbrojti dhe teorizoi mbi hesicizmin dhe u bë kryepeshkopi i Selanikut. Në vitin 1354, u kap rob nga osmanët dhe kaloi një vit në burg, përpara se të lirohej kundrejt një pagese të paguar nga serbët. Ky fragment është shkëputur nga një letër e shkruar për kongregacionin e tij në Selanik, në të cilën ai flet për fatin e tij në burg.

B. Hans Shiltberger (1396)

Të pafetë thonë se ata nuk i pushtuan tokat e të krishterëve as prej fuqisë dhe zgjuarsisë së tyre, dhe as prej besimit dhe përljes ndaj Zotit, por për shkak

¹⁴ "Romejtë" ishte emri që përdornin për vete dhe perandorinë e tyre ata që deri në mes të shekullit të 16-të njiheshin në historiografi si "bizantinë".

të mëkatit, ligësisë dhe arrogancës së përhapur ndër të krishterët. Kjo është arsyeja që Zoti i plotfuqishëm i kishte urdhëruar të pushtonin tokat e krishtera, dhe të pushtonin gjithnjë e më shumë, pasi të krishterët nuk u ishin bindur ligjeve, fetare dhe laike – dhe me ligjet e tyre, ata kërkonin vetëm përfitime; të pasurit shtypnin të varfërit me mënyrat e tyre të gjykimit, nuk i ndihmonin të varfërit as me prona, dhe as nuk bënëin drejtësi me ta. Gjithashtu, ata nuk u bindeshin rregullave fetare që Profeti u kishte lënë.

Këto fatkeqësi që u ndodhën, ishin të gjitha të urdhëruara nga vetë Zoti, për shkak të padrejtësisë dhe ligësisë së tyre.

Schiltberger, f. 133.



Hans Shiltbergeri mori pjesë në kryqëzatën e vitit 1396 dhe u zu rob në betejën e Nikopolit. "Shënimet e udhëtimit" që ai shkroi, janë ndër burimet e para perëndimore që flasin për osmanët.



Krahasoni arsyetimin moral të suksesit osman në tekstet I-3 dhe I-6. Ç'mendoni për skemën logjiko-teologjike të përvijuar në këto burime historike? A mund të funksionojë kjo skemë në kohën e sotme?

I-7. Pronarët e krishterë të timareve në provincën e Arvanidit, Shqipëri (1431/1432)

153 – Timar që zotërohet nga Petro, i cili me sa duket ka patur lidhje martesore me qatip Jorgjin, prandaj dhe ka përfituar një timar. Në kohën e [të ndjerit ?] sulltanit¹⁵ tonë, ishte Ymeri i Saruhanit që [fillimisht ?] hante prej tij¹⁶. Në kohën e sulltanit¹⁷ tonë, timari iu dha pronarit të tanishëm, i cili ka leje të lëshuar prej sulltanit tonë.

Fshati Lagos, 6 kryefamiljarë, 1 vejushë. Të ardhurat [e pritshme]: 531 [akçe].

Inalcik 1987, f. 59



Në fazat e para të sundimit të tyre, osmanët u munduan të siguronin bashkëpunimin me të paktën një pjesë të fisnikëve vendas. Prandaj ata bënë vasalë fisnikë të lartë, ndonjëherë duke kërkuar që ata të dërgonin edhe djemtë e tyre si pengje në oborrin e sulltanit (siç ishte rasti i të famshmit Skënderbej, me emrin e tij të origjinës, Gjergj Kastrioti, djali i Gjon Kastriotit, prijësi i Shqipërisë së Mesme). Në të njëjtën kohë, ata u dhanë timare më të vogla fisnikëve të vegjël të krishterë, siç dokumentohet edhe në këtë regjistër. Situata ndryshoi më vonë, kur sundimi osman u bë më i qëndrueshëm dhe timaret u jepeshin vetëm myslimanëve.



Vini re faktin që teksti dokumenton një të krishterë, i cili zëvendësoi një mysliman si pronar timari. Si e shpjegoni ju këtë ndryshim? Ç'formë tjetër bashkëpunimi është dokumentuar në këtë burim?

I-8. Despot serb, vasal i osmanëve (1432)

Pas qytetit Krushevac, me anë të një anijeje kalova lumin e Moravës dhe hyra në zotërimet e despotit të Rashkës ose Serbisë. Ajo çka ndodhet në anën tjetër të lumit u përket turqve, ndërsa ajo që ndodhet në këtë anë i përket këtij despoti, i cili paguan taksë për të, në shumën prej 50 000 monedha floriri [dukate] në vit. [...]

Mbërrita në një qytet të quajtur Nikodem (Nekudim), një qytet i cili ngjante si fshat, dhe viset përreth ishin shumë të këndshme e të mira. Dhe ky sundimtar i Rashkës¹⁸ jeton në këtë qytet, pasi ai ndodhet mes pyjesh dhe lumenjsh, të përshtatshëm për gjueti kafshësh të vogla dhe për gjueti me fajkonj. E hasëm sundimtarin në një fushë, kishte dalë për gjueti me fajkonj nga lumi, bashkë me tre djemtë e tij dhe rreth pesëdhjetë kalorës, si dhe një turk, i cili kishte ardhur t'i kërkonte, në emër të Turkut të Madh, që t'i dërgonte djalin e tij dhe burrat në ushtri, ashtu siç ishte zakoni. Kjo për faktin se përveç taksës që ai paguan, është i detyruar, sipas kërkesës së turkut,

¹⁵ Mehmeti i Parë (1403-1421).

¹⁶ Këtu do të thotë që "përfitonte prej tij".

¹⁷ Murati i Dytë (1421-1451).

¹⁸ Gjuraq Brankoviçi, despot serb në vitet 1427-1456. Ai ndërtoi fortesën e Smederevos, pranë Danubit, si një kryeqytet të ri të Serbisë dhe në rrethana të vështira u mundua të ruante ekuilibrin ndërmjet dy fuqive fqinje, Mbretërisë së Hungarisë dhe Perandorisë Osmane.

të dërgojë djalin e dytë me 1000 ose 800 kalorës. Për më tepër, edhe pse ai i ka dhënë turkut një nga vajzat e tij për grua¹⁹, ende mbetet frika që mund t'i merret i gjithë vendi. Më thanë, që disa njerëz ia kanë shtënë në vesh këtë Turkut, i cili ishte përgjigjur se kështu siç ishte, ai merrte më shumë kalorës sesa po ta kishte vendin në zotërim të tij, sepse atëherë do t'i duhej t'ia jepte atë vasalit të tij dhe më pas nuk do të merrte asgjë prej tij.

Le voyage, f. 129, 131.



Bertrandon de la Brokiere ishte një fisnik nga Burgundi, i cili udhëtoi shumë në Europën Juglindore dhe në Lindjen e Afërme. Ndërmjet viteve 1389 dhe 1459, për pjesën më të madhe të kohës, Serbia ishte shtet vasal i Perandorisë Osmane.



Si arritën osmanët të siguronin besimin e vasalëve të tyre serbë? Cilat ishin përparësitë e kësaj marrëveshjeje për secilën palë?

I-9. Rënia e Novo Bërdos (1455)

Prej andej, perandori²⁰ u largua në vitin 1455 dhe rrethoi një qytet të quajtur Novo Bërdo, që do të thotë Mali i Argjendtë dhe i Artë; e pushtoi atë, por bëri një marrëveshje, ku u premtoi qytetarëve që do t'i linte në shtëpitë e tyre dhe që nuk do t'ua merrte gratë e reja dhe fëmijët e vegjël. Kur qyteti u dorëzua, perandori urdhëroi që të gjitha portat, përveç njërës, të mbylleshin. Kur turqit hynë në qytet, urdhëruan që të gjithë kryefamiljarët me familjet e tyre të dilnin nga kjo portë, dhe të linin gjithçka që kishin në shtëpitë e tyre. Dhe ata dolën një e nga një. Perandori, që qëndronte përpara portës, i zgjidhte, duke urdhëruar që djemtë t'i veçonin në njërën anë dhe vajzat në tjetrën; burrat u vendosën tek hendeku dhe gratë krijuan një grup të katërt. Më pas ai urdhëroi që të gjithë njerëzit e shquar në mes tyre të vriteshin. Të tjerët ishin të lirë të ktheheshin në qytet dhe asnjë njeri nuk u pengua të qëndronte në pronën e tij. Ai përzgjedhi një numër prej 320 të rinjsh dhe 704 grash dhe ua shpërndau të gjitha gratë të pafeve dhe i mori djemtë e rinj për jeniçerë dhe i dërgoi ata në Anatoli, përtej detit, ku dhe mbahen.

¹⁹ Vajza e Gjuraqit, Mara, ishte një nga gratë e Muratit të Dytë (1421-1451).

²⁰ Mehmeti i Dytë (1444-1446; 1451-1481).

Edhe unë që po shkruaj, jetoja në qytetin e Novo Bërdos dhe më morën bashkë me dy vëllezërit e mi.

Mihailović, f. 132-133.



Kostandin Mihailoviçi, i lindur rreth vitit 1435 afër qytetit të Novo Bërdos në Kosovë, u dërgua në Azinë e Vogël si rob, bashkë me djem të tjerë të rinj serbë. Më pas, ai shërbeu në trupat jeniçere dhe u bë oficer. Pastaj ai shkoi në Poloni, ku shërbeu në oborin e mbretit dhe vdiq mbas vitit 1501. Kujtimet e tij, të shkruara ndërmjet viteve 1497 dhe 1501, u botuan për herë të parë në Pragë, në vitin 1565, me titullin *Historia ose kronika turke*.



Sa e besueshme ishte marrëveshja midis Mehmetit të Dytë dhe banorëve të Novo Bërdos. A kishte mundësi popullsia vendase të bënte një zgjedhje më të mirë? Mendoni për fatin e veçantë që pati tregimtari i kësaj historie. Ç'ndjenja shpreh ai për ngjarjen që përshkruan?

► Fig. 2. Ushtria osmane fiton betejën në Mohaç (1526) – miniaturë osmane (rreth vitit 1588)



Lewis, f. 285.

? Si paraqiten hungarezët? Gjeni në pikturë Sulejmanin e Parë. Krahasoni figurën e sulltanit në këtë pikturë, me atë në figurën 1. Si janë të armatosur trupat jeniçere?

I-10. Shkatërrimet turke në Slloveni – letër e guvernatorit habsburgas të Karniolas (1491)

Gjatë gjithë jetës sime nuk kam parë asnjëherë kaq shumë mjerim në këtë vend. Me sa shikoj unë, dhe me sa më raportojnë ndihmësit që unë dërgoj, ata [turqit] gjenden kudo në Shmarje: në Turxhak, Çushperk, Dobropolje, Nadlishëk, Karnek, Zhuzhemberk, krahinën e Suhas, Ribnica, Koçevje. Në këto krahina, ata dogjën gjithçka dhe nuk ka asnjë dyshim që i morën banorët me gjithë bagëtitë e tyre. [...] njerëzit e shkretë me zor kishin mbledhur të korrat dhe ishin gati të fillonin shirjen. Drithërat, bari dhe kashta u dogjën të gjitha, sa [...] ata nuk kishin ç'të hanin.

Ndërsa turqit e tjerë kishin ngritur kampin e tyre afër Belacerkevit. Duke djegur dhe grabitur, ata po bëjnë kaq shumë dëme, sa që është tepër e dhimbshme të shkruash për to. Shentjerneji Fushë, Hmeljniku, Novo Mestoja, Prezheku, Kostanjevica, Otočeku, Mehovo, të gjitha këto vende u dogjën dhe u shkatërruan. [...] I gjithë vendi, nga provincat deri në Lubjanë, është djegur dhe shkatërruar. Priten të mbërrijnë edhe këtu, në çdo kohë. Dashtë Zoti, me mirësinë e tij, t'i mbajë larg nesh!

Gestrin, Kos, Melik, f. 51-52.

? Cilat ishin pasojat e drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta të mësymjes osmane në Slloveni? Cilën nga ato do të vlerësoni si më të dëmshme për popullsinë vendase?

► Fig. 3. Banorë të Beogradit të zënë rob (1521)



Samardžić, f. 128-129.

? A paraqiten në figurë ndjenjat e robërve? Bëni një përshkrim të shkurtër, duke u mbështetur tek figura. Krahasoni atë që ju shkruat me tekstin I-11.

I-11. Robërit e krishterë në Bosnjë (1530)

Së pari, Bosnja e Poshtme ka shumë male, është e rrethuar me pyje të mëdhenj dhe përveç një pjese të vogël, nuk është e punuar dhe e mbjellë, thjesht sepse kroatët dhe të tjerët shpesh e shkatërrojnë atë. Kur zotërohej nga të krishterët, autoritetet nuk lejonin që në të të mbillej, por që nga koha kur turqit e pushtuan, pjesa më e madhe e Bosnjës së Poshtme është punuar dhe mbjellë. [...]


Po atë natë, disa orë mbas nesh, turqit erdhën në fshatin Krushica [Bosnja e Mesme], ku kishim qëndruar për të kaluar natën. Ata kishin marrë me vete njëzet fëmijë të gjorë, të krishterë, vajza e djem, të cilët i kishin kapur shtatë ditë më parë. Gjatë natës, përpara nisjes sonë, ata ia dhanë fëmijët Usref beut, pashait të Vërhbosnës²¹ (aq sa i takonin atij). O skllavëri mizore e Babilonit! [...] Sa herë i kemi parë ata të qëndronin


²¹ Vërhbosna ishte qytet mesjetar (civitas Vrhbosna) në krahinën e Sarajevës.

me duar të shtrira para nesh, me sytë drejt qiellit, duke psherëtirë; atyre nuk u lejohej të flisnin me ne. Kur ndonjëri prej tyre ishte vetëm me ne, thoshte: “Si është e mundur që ne prisnim të liroheshim me ndihmën e Krishtit! Ne do të vinim me kënaqësi në vendin tuaj, për t’i shpëtuar kësaj tiranie. Tani i kemi humbur shpresat, kur shikojmë që edhe ju duhet t’i përulemi perandorit turk dhe t’i kërkoni atij paqe”. Ne i përgjigjeshim me keqardhje dhe i ngushëllonim me shpresën për një të ardhme më të mirë. Të lutem, o Zot, që zemrat e të gjithë atyre që nuk mund të preken nga dhuna turke, ta ndiejnë këtë, në mënyrë që t’u vijë keq për këta njerëz që i konsiderojmë të krishterë të vërtetë dhe që pavarësisht nga fati i tyre

i keq dhe dhuna e pamëshirshme, i kanë qëndruar besnikë fesë së tyre të krishterë.

Kuripesic, f. 17-23.

 Benedikt Kuripesici udhëtoi nëpër Bosnjë dhe provinca të tjera osmane, rrugës për në Stamboll, në cilësinë e përkthyesit të dërgatës habsburgase.

 Cilat ishin pasojat ekonomike të pushtimit osman në Bosnjë e Poshtme? Krahasoni këtë situatë me shkatërrimet në Slloveni. Mundohuni të kuptoni shkaqet e këtij ndryshimi.

Ic. Rënia e Kostandinopojës / pushtimi i Stambollit (1453)

I-12. Këndvështrim bizantin mbi rënien e Kostandinopojës – George Sfrances


Në 4 prill të të njëjtit vit [1453], sulltani u kthye dhe rrethoi qytetin, me të gjitha llojet e mjeteve dhe stratagemave tokësore dhe detare. Ai rrethoi të gjithë perimetrin e qytetit prej 18 miljesh, me 400 varka të vogla e anije të mëdha nga deti, dhe me 200 000 veta nga toka. Edhe pse qyteti ynë ishte tepër i madh, ata që e mbronin atë ishin vetëm 4 773 grekë dhe rreth 200 të huaj.

[...] Të martën e 29 majit [1453], herët në mëngjes, sulltani e mori qytetin; gjatë kohës që po pushtohej qyteti, zotëria dhe perandori im i ndjerë, i madhi Kostandin²² u vra.

[...] Unë u kapa rob dhe vuajta poshtërimet e skllavërisë. Më në fund unë u lirova më 1 shtator 6962 [1453] dhe u nisa për në Mistra²³. Gruaja dhe fëmijët e mi ishin në pronësi të disa turqve të moshuar, të cilët nuk i trajtonin keq. Më pas, ata iu shitën *Mirahorit*²⁴ të sulltanit, i cili vuri pasuri të madhe vetëm duke shitur gratë e bukura fisnike. [...] Ndoshta do të donit të dinit përgatitjet që perandori bëri përpara rrethimit, ndërsa sulltani po mblidhte forcat e tij, dhe ndihmën që ne morëm nga të krishterët e tjerë. Asnjë

lloj ndihme nuk na u dha nga të krishterët e tjerë [...]. Perandori pranoi që emri i papës të përmendej detyrimisht në shërbesat tona fetare, sepse kështu shpresonim të na jepnin ndonjë ndihmë. [...] Gjashtë muaj më pas kishim marrë po aq ndihma nga Roma, sa na ishin dërguar nga sulltani i Kajros.

Sphrantzes, f. 69-72.

 George Sfrancesi ishte zyrtar i lartë gjatë periudhës së fundit të Perandorisë Bizantine dhe për një farë kohë ishte edhe kancelar. Mbasi u lirua, ai u bë murg dhe shkroi këtë kronikë, e cila është një nga burimet kryesore mbi rënien e Kostandinopojës. Në përpjekjen e tij për të justifikuar politikat e Bizantit të vonë, Sfrancesi fajëson katolikët të cilët nuk ndihmuan Bizantin, duke anashkaluar faktin që mbas bashkimit fetar të Firences (1439), papa arriti të organizonte disa kryqëzata kundër osmanëve; megjithatë, është e vërtetë se mbas humbjeve të mëdha në Varna (1444) dhe Kosovë (1448), këto përpjekje për të përzënë osmanët nga Europa dhe për të shpëtuar Perandorinë Bizantine ishin ndërprerë dhe në momentin e sulmit të fundit osman, Kostandinopoja u ndihmua shumë pak.

²² Kostandin XI Paleologu, perandori i fundit bizantin (1449-1453).

²³ Mistra ishte kryeqyteti i Principatës Bizantine të Moreas, e cila u pushtua nga osmanët vetëm në vitin 1460.

²⁴ Zyrtar osman, përgjegjës për stallat perandorake.



Cili ishte fati i të mbijetuarve bizantinë pas rënies së Kostandinopojës? A u përjashtuan nga të qenët skllëvër ata që u përkisnin familjeve të pasura fisnike?

A mendoni se ndjekja e një politike tjetër mund ta kishte shpëtuar Kostandinopojën nga pushtimi osman?

I-13. Ripopullimi i Stambollit gjatë sundimit të Mehmetit të Dytë

Këtyre njerëzve të sapoardhur iu dhanë shtëpi. Stambolli filloi të lulëzojë. Më pas, këta njerëz u detyruan të paguanin një *mukataa*²⁵. Ata e patën të vështirë që ta pranonin këtë dhe thoshin: “Ju na larguat nga vendi/prona jonë [mylk]. A na sollët këtu që të paguanim qiranë për këto shtëpi të të pafeve?” Disa u larguan, duke braktisur gratë dhe fëmijët e tyre. Sulltan Mehmeti kishte një skllav i cili quhej Kula Shahini; ai ishte skllav i trashëguar nga i ati që dikur kishte qenë vezir. Ai tha: “Sulltani im i madhërishtëm! Paraardhësit e tu kanë pushtuar shumë vende. Ata asnjëherë nuk vunë pagesën e *mukataas*. Edhe ty nuk të përket ta vësh këtë”. Sulltani e dëgjoi fjalën e tij. E hoqi *mukataan*. Ai nxori një vendim, që çdo person të cilit i ishte dhënë një shtëpi, do ta mbante si pronë të tijën. Ata u dhanë njerëzve edhe dokumente, për të vërtetuar që shtëpitë ishin pronë e tyre. Qyteti filloi të lulëzojë edhe një herë. Njerëzit filluan të ndërtonin xhami, ndërtesa të ndryshme e shtëpi. Qyteti filloi të zhvillohej. Më pas, sulltani kishte vezir djalin e një njeriu të pafe; ai e mbante shumë pranë vezirin e tij. Të pafetë e vjetër të Stambollit ishin miq të babait të këtij veziri. Ata takoheshin

me të dhe i thoshin: “Hej! Çfarë po bën? Këta turq e lulëzuan edhe një herë këtë qytet. Ku është sedra jote? Ata zaptuan vendin që i përkiste babait tënd dhe neve. Ata e kanë atë në pronësi të tyre dhe e përdorin përpara syve tanë. Tani ti je miku i sulltanit. Bëj diçka që t’i ndalosh këta njerëz ta zhvillojnë qytetin. Ky qytet duhet të jetë në duart tona, ashtu siç ishte më parë”. Veziri tha: “Le të vendosim edhe një herë *mukataan*. Këta njerëz s’duhet të kenë prona. Qyteti duhet të mbetet në gjendje të mjeruar. Duhet të jetë në duart e njerëzve tanë”. Veziri ndikoi tek sulltani e për pasojë *mukataaja* u rivendos. Njërit prej këtyre të pafeve komplotistë, iu dha një skllave kinsemyslimane për grua. Ata mbajtën shënim çdo gjë që ky i pafe komplotues thoshte.

Pyetje: Cili është ky vezir?

Përgjigje: Ai është Mehmet pashë greku²⁶.

Më pas Sulltani urdhëroi që ta mbysnin, sikur të ishte qen.

Aşikpaşa-Žade, f. 193.



Mbas pushtimit të Kostandinopojës në vitin 1453, Mehmeti i Dytë u mundua ta rindërtonte atë, për të pasur një kryeqytet të përshtatshëm për perandorinë e tij. Plani i tij i zhvillimit urban përfshinte Pallatin Topkapi, disa xhami dhe disa ndërtesa të ndryshme publike. Një aspekt i rëndësishëm ishte dhe ripopullimi i qytetit. Për të arritur këtë qëllim, ai ndërthuri kolonizimin me forcë nga qytetarët që jetonin në territoret që ai kishte pushtuar, dhe tërheqjen vullnetare të kolonistëve nga e gjithë perandoria. Kronika e Ashikpasha-zadesë përkrahuan disa nga tensionet e shkaktuara nga kjo politikë; gjithashtu, ajo pasqyron urrejtjen e aristokracisë turke ndaj zyrtarëve të zgjedhur prej skllëvërve (*kul*) të sulltanit, në shumicën e rasteve të krishterë të konvertuar rishtas në islam.

Id. Ndryshimet e popullsisë dhe të fesë

I-14. Shpërngulja me forcë e popullsisë [syrgjyni] nga Azia e Vogël në Ballkan (fundit i shekullit të 14-të)

Sipas traditës, kishte banorë endacakë [gëçer evler] në provincën e Saruhanit²⁷, të cilët kalonin dimrin

në luginën e Menemenit. Në ato vende kripa ishte monopol. Ata nuk i bindeshin këtij monopoli. Fjala i ra në vesh sulltanit. Atëherë, Bajazit Hani²⁸ i dërgoi fjalë djalit të tij, Ertugrullit, dhe i tha që, nën kontroll të rreptë, bashkë me shërbëtorët e tij, t’i shoqëronte të gjithë banorët endacakë të fushës së Menemenit, në

²⁵ Zakonisht *mukataa* do të thotë taksë ferme. Në kontekstin e mësipërm, ajo do të thotë taksë banese; pra, këta kolonistë duhej të paguanin qera për shtëpitë ku ishin vendosur.

²⁶ Mehmet pasha ishte vezir i madh nga viti 1467 deri më 1470. Fjala turke për “grek” ishte “rum”.

²⁷ Provincë në Azinë e Vogël. Në fundin e shekullit të 14-të ka qenë principatë e veçantë turke, e cila u mor nga osmanët në vitin 1390, në fillim të sundimit të Bajazitit.

fushën e Filibesë [Plovdiv]. Ertugruli, duke iu bindur rreptësisht urdhrave të babait të tij, i dërgoi këta banorë endacakë në fushën e Filibesë me sukses; ata i dërguan dhe i detyruan të vendosen nëpër Filibe. Sot pjesa më e madhe e Filibesë popullohet prej tyre. Neşri, f. 339.

? A mund të zgjidhnin shtegtarët turq nga Menemeni të shkonin ose jo në Ballkan? Sipas mendimit tuaj, cilat ishin pasojat e pushtimit osman për popullsinë turke të Anatólisë?

I-15. Premtime osmane, bërë fshatarëve boshnjakë – letra e mbretit Stjepan Tomasevic (1461-1463) dërguar Papa Piut të Dytë

Turqit kanë ndërtuar disa fortesa në mbretërinë time dhe janë shumë të sjellshëm me popullsinë vendëse. Ata i premtojnë liri çdo fshatari që kthehet në fenë islame. Mendja e një fshatari të thjeshtë nuk mund ta kuptojë këtë dinakëri dhe beson se kjo liri do të zgjasë përgjithmonë.

Andrić, f. 15.

I-16. Joasafi, peshkopi ortodoks i Vidinit, mbi islamizimin e detyruar dhe atë me dëshirë (shekulli i 15-të).

O çfarë turpi! Shumë njerëz u bashkuan me fenë e pahijshme të Muhametit: disa nga frika, disa të tjerë të zbutur, sepse u morën me të mirë, ose të mashtruar nga të mirat materiale; dhe pati edhe të tjerë që u bashkuan me armikun, të hutuar nga letrat dhe dredhitë.

Bulgarska, f. 206.

I-17. Kadiu regjistron një djalë të ri pa baba, që kthehet në fenë islame (1636)

Zimi Totodori, moshë rreth 10 vjeç, nga fshati Orta Koj i kazasë Lefkosha [tha]: Tani unë e kam braktisur fenë e rreme dhe besoj tek Islami. Ai tani quhet Mustafa.

Jennings 1993, f. 139.



Zakonisht njerëzit regjistroheshin në regjistra me emrat e tyre të lindjes dhe me emrin e babait ("X-i, djali i Y-it"). Në rastin e Totodorit nuk përmendet emri i babait të tij, çka tregon që mbase ai ka qenë fëmijë i jashtëligjshëm.

I-18. Kërkesa e një të riu, i cili dëshiron të kthehet në fenë islame (1712)

Madhëria juaj, Sulltani im i Lavdishëm! Ju uroj shëndet të plotë!

Unë, skllavi juaj, jam njeri i varfër nga krahina e Ruses. Në vendin tim ndjeva dëshirën të bëhem mysliman dhe prandaj erdha tek Ju. Do të isha tepër i nderuar, nëse në praninë tuaj personale të pranoja fenë islame. Ju lutem, bëhuni bujar dhe më jepni disa rroba dhe diçka për të jetuar. Me mirësjellje, kërkoj urdhrin tuaj. Urdhri është në fuqinë e Madhërisë Suaj, sulltani im i mrekullueshëm.

Skllavi juaj, Abdullah.

Osmanski, f. 160.



Bëni një listë me arsytet që kishin të krishterët e Perandorisë Osmane për t'u kthyer në Islamë. Shikoni tekstet III-13 dhe IV-31. A janë nxitur konvertimet prej ngjashmërive ndërmjet dy besimeve fetare?

Kujtoni burimin historik ku thuhet se Zoti po i ndëshkon të krishterët. A është e mundur që ndjenja e fajit dhe dënimi i Zotit të kenë nxitur konvertimet?

Cilat ishin pasojat e përgjithshme të pushtimit osman në strukturën etnike dhe fetare të Europës Juglindore?

²⁸ Bajaziti i Parë, "Vetëtima" (1389-1402).

KAPITULLI II: Institucionet e Perandorisë Osmane

Procesi i pushtimit e ndryshoi natyrën e formacionit të shtetit osman. Ajo çka nisi si një principatë fisnore, u kthye në një perandori botërore. Në këndvështrimin osman, territoret e mëdha kërkonin mënyra dhe mjete të reja për t'i kontrolluar, administruar dhe shfrytëzuar. Këto mënyra dhe mjete frymëzoheshin kryesisht nga tradita politike islame, e përçuar nga *ulematë* (dijetarë myslimanë dhe ekspertë ligjorë), por edhe nga praktikat mongole dhe bizantine ose nga përvoja praktike.

Në shumë aspekte, shteti osman dhe institucionet e tij ishin tërësi hibride, ku ndërthurej besimi i fortë në islam me nevojën për të integruar nënshtetas të ndryshëm jomyslimanë dhe interesi për të bashkëpunuar me udhëheqësit e tyre fetarë, në mënyrë që të sigurohej funksionimi sa më i mirë i zotërimeve osmane. Ideja e fuqisë absolute të sulltanit u përball me mundësinë e kufizuar të pushtetit qendror për të depërtuar në sa më shumë hapësira dhe struktura shoqërore. Megjithëse rregullat dhe mënyra e trashëgimit të pushtetit ishin jo të qarta dhe ndryshonin herë pas here, dinastia osmane mbeti e paprekur për mëse 6 shekuj. Ndarja midis sferës publike dhe asaj private ishte tepër e rëndësishme për organizimin e pallatit osman. Sistemi ushtarak ndërthurte karakteristikat mesjetare (luftëtarë që luftonin për ideale fetare, për plaçkën e luftës ose për të ardhurat që u jepeshin në bazë të sistemit të timarit, i ngritur për të shfrytëzuar burimet pamjaftueshmërisht të lëvizshme ekonomike), me karakteristikat e fillimit të kohës së re (ushtri që kishte si bazë paranë dhe ushtarët me rrogë; është mjaft domethënëse që në këtë ushtri përziheshin sistemi islamik mesjetar i rojeve skllëvër të monarkut, me një sistem origjinal rekrutimesh [*devshirme*], i cili i ktheu shumë të rinj jomyslimanë në një grup shoqëror të privilegjuar, krenarë për statusin e tyre të veçantë *kapikulu*²⁹ [skllëvër të Portës së Lartë]. Nëpër provinca, autoriteti i guvernatorëve ushtarakë baraspeshohej praktikisht nga administrimi i gjykatësve [*kadi*], të zgjedhur nga gjiri i *ulemasë*, dhe nga vetëqeverisja që gëzonin shumë komunitete vendase. Megjithatë, ngritja e institucioneve të përbashkëta në të gjithë perandorinë nuk arriti të zhdukte ndryshimet dhe të veçantat e provincave. Sundimi i drejtpërdrejtë osman bashkëjetonte me institucionin e shtetit të krishterë vasal. Për disa nga këto shtete, statusi i haraçpaguesit rezultoi të ishte vetëm një fazë paraprake përpara aneksimit të tyre të plotë, ndërsa për të tjerë rezultoi të ishte një zgjidhje e përhershme. Perandoria Osmane ishte shtet islam. Ndaj ajo mbështetej kryesisht në *Ligjin Mysliman* [*Sheriat*]. I bazuar në Kuran dhe në traditë (*sunna*, e përbërë nga rrëfimet që flisnin për mënyrën se si kishte vepruar Muhameti në raste të ndryshme), *Ligji Mysliman* u zhvillua gjatë mesjetës, por edhe më vonë nga dijetarë të ndryshëm (*ulematë*). Edhe pse ky riinterpretim i vazhdueshëm bëri disa përshtatje në *Sheriat*, osmanët parapëlqyen t'i shtonin ligje dhe rregulla të cilat nxirreshin drejtpërdrejt nga vetë sulltani, të mbështetura në pushtetin e tij suprem. Ndryshe nga e drejta e kohëve të reja, këto ligje dhe rregulla, të cilat përbënin *Ligjin e Sulltanit* (fjala *kanun* rrjedh nga fjala greke *kanon*), nuk vinin si përfundime të rrjedhura nga parime të larta. Në të vërtetë, ato ishin rikrijime dhe riformulime të së drejtës zakonore, ndaj në to përfshiheshin zakone provinciale të periudhës paraosmane. Sidoqë teorikisht pushteti i sulltanit osman ishte i padiskutueshëm, *E drejta e Sulltanit* duhej të përshtatej me parimet e larta të *Sheriatit*, dhe dijetari mysliman i shkallës më të lartë në Perandori, *seyh-ül-Islam*, duhej të verifikonte këtë përputhje për secilin ligj, rregull apo urdhër të sulltanit.

Edhe pse ideologjia zyrtare ngulmonte në qëndrueshmërinë politike dhe në traditë, në të vërtetë, sistemi politik osman nuk ishte i përjashtuar të ndryshonte me kohën. Natyra e këtij ndryshimi është

²⁹ *Kapikulu* do të thotë "skllav i Portës (Perandorake)". Kjo përfshinte jo vetëm jeniçerët, por edhe gjashtë regjimentet e trupave të kapikulëve dhe anëtarë të ndryshëm të personelit të Pallatit.

tepër kontradiktore. Disa historianë mendojnë se ndryshimet që ndodhën kryesisht mbas shekullit të 16-të përfaqësonin një rënie nga organizimi thuajse i përsosur i së ashtuquajturës “epokë klasike”. Të tjerë argumentojnë që ndryshimet paraqisnin një përshtatje me sfidat e fillimit të kohës së re, dhe ishin të krahasueshme me formimin e shteteve moderne në pjesë të tjera të Europës ose Azisë. Fatkeqësisht, kufizimet e këtij *Libri pune* nuk na lejojnë të hedhim dritë në të gjitha aspektet e ndryshimeve të politikës osmane. Megjithatë, është tepër e rëndësishme të kujtojmë që institucionet osmane nuk ishin statike, por ishin tërësi dinamike. Burimet e përfshira në këtë kapitull na japin informacion mbi natyrën komplekse të institucioneve politike osmane. Përgjithësisht burimet na japin këndvështrime të ndryshme, madje edhe kundërtëne, për të njëjtën çështje. Ato kanë si qëllim të nxisin aftësinë e nxënësve për të analizuar natyrën komplekse të sundimit politik.

Ila. Sulltani dhe Pallati

II-1. Titulli që përdorte Sulejmani në korrespondencën e tij me Ferdinandin e Parë (1562)

Padishahu dhe Sulltani i Detit të Bardhë (Mesdhe) dhe Detit të Zi, i Nderuari i Qabesë dhe i Ndrëçuari i Medinës, i Jeruzalemit të Shenjtë, i fronit të Egjiptit, më i vyeri i kohës sonë, i provincave të Jemenit dhe Adenit dhe Sanas, i Bagdatit, vendit të paqes, dhe Basrës, dhe Lahsës, dhe qyteteve të Anushirvanit³⁰, i tokave të Algjerisë dhe Azerbajxhanit, i tokës së Hordhisë së Artë dhe tokës së Tartarisë, i Dijarbekirit, Kurdisanit dhe Luristanit, dhe i gjithë Rumelisë dhe Anolisë, dhe Karamanisë dhe Vllahisë, dhe Moldavisë dhe Hungarisë, dhe përveç këtyre, i shumë vendeve e tokave të tjera të mëdha e të vlerësuara [...]

Bayerle, f. 46-47.



Gjeni në hartë territoret e përmendura në titullin e Sulejmanit. Gjeni se cili vend mungon.

Ç’mesazh përcjell sundimtari duke përdorur një titull të tillë?

II-2. Cilësitë e sunduesit ideal, paraqitur në poemën e Xhelalzadesë, kushtuar sulltan Selimit të Dytë (1566-1574)

Ai që dëshiron të jetë një mbret i mirë,
Duhet të ketë një gur në vend të jastëkut.

Të heqë dorë nga rehatia e tij,
të heqë dorë nga pija,
të mos bëjë shokë
vartësit e tij.

Le të qëndrojë i padituri larg tij,
Siç thuhet, fëmijët kanë pak mençuri.

Ata që e duan shtetin,
Ata që janë zotër të faltores së shenjtë,

Ata duhet të rrezikojnë kokat dhe jetën e tyre,
Ata duhet të jenë të gatshëm të luftojnë në çdo kohë.

[...]

Edhe nëse do të jeni sulltani i gjithë botës, i pastër dhe absolut,
Asnjëherë mos buzëqeshni siç bëjnë femrat.
Nëse jeni i zgjuar,
Dëgjojeni me vëmendje fjalën e vërtetë. Merreni dhe pranojeni atë,

³⁰ Kryeqyteti i vjetër persian i Ktesifonit, në Irakun e sotëm.

Nëse jeni vërtet i thjeshtë [ehl-i dil].
Për një burrë të vërtetë,
mendimet janë të pjekura e të përmbajtura mirë.
Nuk ka xheloz, hakmarrje
apo tërbim në zemrën e tij.

Le të ketë bamirësi gjithnjë,
frikë nga Zoti, hyjnia jonë.
Le të shohin sytë e tij dallimin
Ndërmjet kokës dhe bishtit.

Le t'i falë ai gabimet
rrëshqitjet, apo thjesht dështimet.
Le të shohë ai Zotin e Madhërisëm,
me gatishmërinë e tij gjithkund.

Le të mos jetë ai dorështrënguar,
le të mos jetë ai lakmitar.
Le të jetë ai i mëshirshëm,
Edhe ndaj palës kundërshtare.

Le të jetë ai gjithnjë i drejtë
sipas Sheriatit.
Le ta dijë ai të vërtetën, [ose: Zoti; Hak]
Le ta largojë ai tiraninë.

Një njeri pa dije,
Nuk është njeri i vërtetë.
Nuk rrjedh gjak mbretëror
në venat e budallait [...]

Nëse nuk do të kishte qenë sulltan Selimi,
Ky mbret bujar, ky burim lumturie,

Armiku do të kishte zaptuar
vendin nga njëri cep në tjetrin.
Zoti nuk do të na kishte ndihmuar,
Nuk do të na kishte falur as tokat e pushtuara.
Celâlzâde, f. 77-78.



Këshilla për sunduesin ishte një lloj letrar, i përdorur gjerësisht në mesjetë dhe në periudhën e hershme të kohëve të reja. Paraqitja e figurës së sunduesit ideal ishte një mënyrë për të krijuar një kornizë pritshmërisht ideologjike, në mënyrë që të kufizohej sjellja e monarkëve, teorikisht sovranë. Kjo bëhet e qartë veçanërisht, nëse kemi parasysh që poema i kushtohet Selimit të Dytë, një pijaneci, i cili rrallëherë kujdesej për problemet e shtetit.



Përmbliidhni cilësitë e përcaktuara nga Xhelalzadeja për sunduesin ideal. Cilat mendoni se janë më të rëndësishmet? Duke pasur parasysh ato çfarë dini rreth Selimit të Dytë, mundohuni të kuptoni cili ishte qëllimi kryesor i poetit dhe ç'mendonte ai në të vërtetë. A ishte ai ironik (pasi karakteristikat e cituara për një sundues ideal janë thujtë të një shenjtori) apo thjesht tepër mendjengushtë për shkak të përkushtimit ndaj sulltanit?

II-3. Qëndrime të ndryshme ndaj vëllavrasjes perandorake – kronika e Mehmet Neshriut mbi ekzekutimin e Mustafait të Vogël (1422)

Vëllai i tij³¹ i vogël, i njohur si Mustafai i Vogli, të cilit babai i tij³² i dha tokën e Hamidit³³ dhe që ishte adoptuar nga princër prej Germijani³⁴, u nxit nga disa njerëz të këqij. Princat e Germijanit dhe Karamanit³⁵ i dhanë atij ushtarë dhe ai marshoi për në Bursë. [...] Kur sulltan Murati mori lajmin, gjeneralët e tij i dërguan një mesazh Sharabdar Iljazit³⁶, që sulltani e kishte caktuar guvernator të përgjithshëm të Anolisë. Ata i dërguan atij edhe fermanin. Ata i thanë që ta vononte djaln, deri sa të vinin ata. Sharabdar Iljazi zgjodhi që të tradhtonte, e pranoi mesazhin dhe qëndroi në vend [...] Sulltan Murati u nis me nxitim dhe arriti në Iznik, nëntë ditë. [...] mbasi la Edrenenë. Ndërkohë që

³¹ Muratit të Dytë (1421-1451).

³² Mehmeti i Parë (1403-1421).

³³ Provincë osmane në jug të Azisë së Vogël.

³⁴ Principatë, e më pas provincë osmane në Azinë e Vogël Qendrore.

³⁵ Principatë turke në jug të Azisë së Vogël, rivalja kryesore në Anoli e osmanëve, deri në aneksimin e saj në vitin 1468.

³⁶ Kujdestari i Mustafait të Vogël

po zhvillohej një betejë, Iljaz beu e kapi djalin nga shala e kalit. Djali i tha: “Hej, kujdestar [*lala*], pse më mban kështu?” Iljazi tha: “Do të të çoj tek vëllai yt, Murat Han”. Mustafai i Vogli tha: “Ti je një tradhtar i pashpirt. Mos më dërgo tek vëllai im, se do të më vrasë”. Iljaz beu nuk ia vuri veshin, uli kokën dhe e dorëzoi djalin. Kryegjenerali Mezid beu mori djalin, e uli mbi një daulle të madhe lufte dhe e puthi me respekt. Më pas, ai e çoi tek Murat Hani. Menjëherë Murat Hani u tha atyre të mbaronin punë. Ata ia morën djalin Mezidit. Në të dalë të Iznikut gjendej një pemë e madhe fiku; nën këtë pemë e mbytën djalin në ujë. Mbasi e zbatuan këtë urdhër, ata e dërguan në Bursë që ta varrosnin pranë të atit. Banorët e Bursës i takuan ata. Ata e morën trupin dhe e varrosën sipas ligjit fetar. Më pas, kur e pyetën Sharabdar Iljazin “Pse e bëre këtë?”, ai u përgjigj: “Në pamje të parë, unë u bëra tradhtar. Në të vërtetë, unë bëra gjënë e duhur. Nëse do t’i kisha lejuar, këto dy ushtri do të kishin luftuar dhe do t’i kishin bërë dëm vendit. Më mirë dëmi vetjak, sesa dëmi i përgjithshëm. Ky është, gjithashtu, një zakon i vjetër. Nuk kam qenë unë që e shpika këtë”. Mbas kësaj, atij nuk i mbeti aspak reputacion në radhët e fisnikëve.

Neşri, II, f. 567-573.



Neshriu e shkroi këtë kronikë në fund të shekullit të 15-të, gjatë sundimit të Bajazitit të Dytë (1481-1512), në kohën kur praktika e vëllavrasjes ishte kthyer në një kërkesë të ligjëruar nga Mehmeti i Dytë, i cili kërkonte që çdo sulltan duhej të vriste vëllezërit e tij pasi të hipte në fron, për të siguruar paqen e brendshme në perandorinë e tij. Tregimi i Neshriut për vrasjen e Mustafait të Voglit paraqet si argumentimin zyrtar, ashtu dhe faktin që një pjesë e rëndësishme e shoqërisë osmane e kundërshtonte këtë praktikë. Në fillim të shekullit të 17-të, ky kundërshtim çoi përfundimisht në ndalimin e vëllavrasjes perandorake (rasti i fundit i dokumentuar ishte ardhja në fron e Mehmetit të Tretë, në vitin 1595).



Mundohuni të kuptoni se përse ekzekutuesit zgjodhën këtë mënyrë të veçantë për të vrarë princin e ri.

Përveç justifikimeve të cituara nga Sharabdar Iljazi, a tregohet në tekst ndonjë arsye tjetër që e bëri Sharabdarin të vepronte në atë mënyrë?

► Fig. 4. Planimetria e Pallatit Topkapi në Stamboll



Inalcik 1973, fig. 3.

Skema 1: Pallati dhe Administrata Qendrore Osmane

A. Pjesa e brendshme e Pallatit (Enderuni) ³⁷	B. Pjesa e jashtme e Pallatit (Biruni)	C. Këshilli Perandorak (Divani)
<p>Ndarjet kryesore:</p> <ul style="list-style-type: none"> ■ Haremi ■ Dhoma personale (<i>has oda</i>) ■ Dhoma e fushatës (<i>seferli oda</i>) ■ Thesari personal (<i>hazine</i>) ■ Qilari i ushqimeve (<i>kiler</i>) <p>Oborrtarët kryesorë:</p> <ul style="list-style-type: none"> ■ Agai i Portës (<i>Kapi agasi</i>) ■ Agai i vajzave (<i>Kizlar agasi</i>) ■ Përgjegjësi i dhomës personale (<i>Has oda bashi</i>) ■ Kujdestari i Armëve (<i>Silahdar</i>) ■ Kujdestari i thesarit personal (<i>Hazi-nedar</i>) ■ Kujdestari i rrobave (<i>Çuhadar</i>) ■ Kujdestari i yzengjive (<i>Rikabdar</i>) 	<p>Ndarjet kryesore:</p> <ul style="list-style-type: none"> ■ Trupat e Pallatit (<i>kapikulu</i>)³⁸ ■ Kuzhina perandorake ■ Stallat perandorake <p>Oborrtarët kryesorë:</p> <ul style="list-style-type: none"> ■ Agai i jeniçerëve ■ Kujdestari i flamurit (<i>Mir alem</i>) ■ Kujdestari i stallave (<i>Mirahur</i>) ■ Përgjegjësi i ruajtësve të portave (<i>kapici bashi</i>) ■ Përgjegjësi i lajmëtarëve perandorakë (<i>çavush bashi</i>) ■ Kryekopshtari (<i>Bostanci bashi</i>) ■ Kujdestari i fajkonjve (<i>Çakirçi bashi</i>) 	<p>Anëtarët e përhershëm:</p> <ul style="list-style-type: none"> ■ Veziri i madh (<i>vizir-i azam</i>) Vezirët³⁹ ■ Gjyqtarët ushtarakë (<i>ka-di'asker</i>) të Anolisë dhe Rumelisë ■ Kancelari (<i>nishançi</i>) ■ Kryetari i Thesarit (<i>bash defterdar</i>) ■ Admirali (<i>kapudan pasha</i>) ■ Kryesekretari (<i>reis-yl-qitab</i>)

? Krahasoni planimetrinë e Pallatit me skemën e mësipërme. Mundohuni të gjeni në planimetri disa nga shërbimet kryesore dhe të shpjegoni përse ato janë vendosur pikërisht në këto zona.

? Çfarë informacioni na jep kjo figurë në lidhje me historinë dhe qytetërimin osman? Bëni një listë me të gjithë informacionin që mund të merrni nga kjo figurë dhe më pas e shkëmbeni atë me kolegët tuaj dhe krahasoni rezultatet.

Gjeni një figurë ku të paraqitet një pritje që një mbret në Europën Perëndimore bën me ambasadorët e tij (*shek. i 17-të*). Krahasoni figurat dhe përqendrohuni në veçanti tek ceremonia e pritjes, qëndrimi i monarkut, sjellja e ambasadorëve dhe veprimet e personave të paraqitur në këto figura.

► Fig. 5. Ambasadorët perandorakë në pritje me sulltanin osman



Inalcik 1973.fig.12

³⁷ Shërbimet personale të sulltanit. Zakonisht, të vendosur në oborin e tretë të Pallatit Perandorak. Përveç grave, njerëzit që shërbenin në Pallat ishin ose djem të rinj (*içoğlan*) ose eunukë.

³⁸ Përveç jeniçerëve, trupat kapikulu përfshinin edhe 6 njësi të tjera elitare.

³⁹ Oborrtarët e lartë, të caktuar si anëtarë të Këshillit Perandorak. Me kalimin e kohës, numri i tyre ndryshoi nga 4 në më shumë se 10. Guvernatori i përgjithshëm (*bejlerbeu*) i Rumelisë, dhe me raste edhe guvernatorë të tjerë të përgjithshëm, merrnin gjithashtu pjesë në këtë Këshill Perandorak.

II-4. Mustafai i Parë hipën në fron (1617)

23 Zilkade 1026 [24 nëntor 1617].

Kur me vullnetin e Zotit, sulltani i përjetshëm dhe i plotfuqishëm Ahmed Hani u largua nga kjo botë, princat e tij ishin ende shumë të vegjël. Nga ana tjetër, vëllai i tij, sulltan Mustafai, ishte në moshën e adoleshencës. Ndaj ai u kurorëzua në datën e përmendur më lart.

Por vezirët dhe komandantët, sheikët, dijetarët dhe oborrtarë të tjerë të lartë ngurronin t'i bindeshin sundimitarit të ri. Mustafa aga, *agai* i Portës së Lumturisë [*Darüs-saade aghasi*], i cili kishte pasur shumë ndikim në çështjet e shtetit gjatë kohës së sulltan Ahmed Hanit, nuk ngurroi t'i jepte hakun gjithkujt, ngriti zërin dhe i tha kryetarit të Këshillit të Drejtësisë [*shelh-ül-Islam*], Esat Efendiut dhe zëvendësvezirit të madh [*sadaret kajmakami*], Sofu Mehmet pashës, që sulltan Mustafa Hani nuk gëzonte shëndet të mirë mendor, nuk arsyetonte mirë dhe mendimet e veprimet e tij nuk mund të merreshin për bazë. Megjithatë u mendua që, nëse ky princ e ri do të hiqej nga froni për t'ia lënë vendin një fëmije, do të ishte e pamundur të parandaloheshin zërat dhe thashethemet dhe kjo do të sillte shqetësime. Gjithashtu u tha se sidoqoftë, në këtë kohë sulltan Mustafait i takonte të trashëgonte fronin, dhe nëse kjo mohohet, do të nxiste një reagim të ashpër tek njerëzit. Më tej u argumentua që këto çrregullime mendore ishin mbase pasojë e faktit që ai kishte qenë i burgosur dhe nuk ishte lejuar të fliste me askënd për një kohë të gjatë, dhe nëse do të kishte kontakt me njerëzit për ca kohë, mendja dhe arsyetimi i tij do të përmirësoheshin. Kjo ishte mënyra se si sulltan Mustafai u pranua si *padishah* nga nevoja.

Peçevi, f. 337.



Jepni një argument kundër hipjes në fron të Mustafait të Parë.




Kronika e Peçevit nuk paraqet interesat e veçanta të fraksioneve të ndryshme politike, por vlen për argumentet "publike" brenda udhëheqjes politike osmane. Megjithatë, Mustafai I qeverisi vetëm për disa muaj dhe në vitin 1618 u zëvendësua nga nipi i tij, Osmani II (1618-1622); mbas vdekjes së Osmanit II, i cili u vra gjatë një rebelimi jeniçerësh, në fron erdhi përsëri Mustafai I, i cili qëndroi për disa muaj dhe u rrëzua nga froni përfundimisht nga Murati IV (1623-1640).

► Fig. 6. Festime perandorake gjatë një fushate ushtarake



Hegyi, Zimanyi, fig. me ngjyra 40.

► Fig. 7. Sulltan Bajaziti i Dytë (1481-1512) në gjueti afër Filibesë [Plovdiv]



Hegyi, Zimanyi, fig. me ngjyra 38.

IIb. Sistemi i devshirmes

II-5. Sistemi i devshirmes⁴⁰, i përshkruar nga një ish-jeniçer

Sa herë që ata pushtojnë një vend dhe popullin e tij, sekretari mbretëror [qatipi] vjen menjëherë mbas tyre dhe merr të gjithë djemtë për jeniçerë. Për secilin djalë, ai jep pesë monedha ari (*dukate*) dhe i dërgon ata përtej detit, në Anatoli. Atje ka rreth dy mijë djem të tillë, të marrë peng. Dhe nëse ai nuk arrin të marrë një numër të mjaftueshëm nga kundërshtarët, atëherë të gjithë të rinjtë e krishterë nga vendi i tij do të merren nga të gjitha fshatrat, duke vendosur një numër të caktuar për secilin fshat, në mënyrë që të arrijnë shifrën e kërkuar. Djemtë e marrë nga fshatrat e vendit të tij quhen *çilik*. Ata mund t'ia lenë pronën e tyre mbas vdekjes kujt do që duan. Por ata që merren nga armiqtë quhen *penxhik*. Mbas vdekjes së tyre, ata nuk mund të lënë asgjë, dhe e gjithë prona e tyre bëhet pronë e sulltanit; vetëm nëse dikush do të lirohet për shkak të sjelljes së mirë, atëherë ai mund të bëjë ç'të dojë me pronën e tij mbas vdekjes.

Mihailović, f. 164-165.

II-6. Të krishterët kritikojnë sistemin e devshirmes; shkëputur nga *Jeta e Georgi Novit nga Sofja (1539)*

Kjo ndodhi gjatë sundimit të njeriut të pafe, të padrejtit dhe mbretit të poshtër turk, Selimit⁴¹. Fshtetas, duke përdorur dredhitë, gjatë vitit të tretë të mbretërimit të tij, ai dërgoi lajmëtarët

dhe nëpunësit e tij në të gjitha provincat e shumë mbretërive dhe i urdhëroi ata të shkonin, bashkë me ushtarët, në zonat ku kishte shtëpi të krishterësh. Dhe nëse do të gjenin tre djem në shtëpinë e një të krishterit, do të merrnin dy nga ata, ndërsa të tretin do t'ua linin prindërve. Por nëse një i krishterë do të kishte vetëm një djalë, atëherë ata do ta merrnin atë me forcë për mbretin e tyre. Ata vepruan në përputhje me urdhrin e mbretit; i bënë synet fëmijët, sipas fesë saraçene (myslimane) dhe u mësuan librin e rremë të Imamit. Mbas kësaj, mbreti dha urdhër që ata të stërviteshin ushtarakisht – të merrnin mësimë luftimi dhe kalorimi. Kur rriteshin, mbreti i nderonte duke i bërë jeniçerë. Dhe ata ishin kaq të verbër, sa u sollën në mënyrë të turpshme edhe me prindët e tyre – nënat dhe baballarët e tyre – ata filluan të vrisnin të krishterët në mënyrë makabre, dhe kështu u bënë edhe më të këqij se turma e saraçenëve.

Georgieva, Tzanev, f. 126-127.



Krahasoni shifrat që jepen në burimet II-5 dhe II-6 mbi numrin e të rinjve të përfshirë në *sistemin e devshirmes*, duke pasur parasysh faktin që gjatë periudhës së përshkruar në dy burimet, popullsia e krishterë e Europës Juglindore nën sundimin osman ishte të paktën 4 milionë banorë. Përse njëri nga këto burime i shtrembëron përmasat e kësaj dukurie. Cilat ishin përparësitë që sillte *sistemi i devshirmes* për shtetin osman? Për një djalë jomysliman, a kishte ndonjë përparësi të përfshihej në *devshirme*?

⁴⁰ Sistem origjinal osman për rekrutimin e burrave në shërbim të sulltanit, i cili filloi të zbatohet në shekullin e 14-të. Sistemi mbështetej kryesisht në grumbullimin e djemve të rinj jomyslimanë (të krishterë), nënshtetas osmanë. Këta të rinj të konvertuar në islam mësonin turqisht dhe përgatiteshin për të kryer shërbime të ndryshme shtetërore. Shumica e tyre caktoheshin në trupat kapikulu, veçanërisht jeniçerë, por disa nga ata përzgjidheshin gjithashtu për të shërbyer në Pallatin e Brendshëm ose të Jashtëm. Gjatë shekujve të 15-të e 16-të, një pjesë e madhe dhe shpesh mbizotëruese e elitës politike-ushtarake osmane përbëhej nga ish-devshirë, çka nënkuptonte dhe një ngritje shoqërore të tyre. Për shkak të rritjes së trysnisë nga nënshtetasit mysliimanë të sulltanit për të pasur përparësi në karrierën politike dhe ushtarake, sistemi devshirme gjatë shekullit të 17-të dalngadalë u ndërpre.

⁴¹ Selimi i Parë (1512-1520).

► Fig. 8. Fëmijë duke u regjistruar si devshirë



Çfarë informacioni na jep kjo figurë? Cilat janë personazhet e paraqitura në të dhe si janë vendosur ato? A mund ta kuptoni domethënien e veprimeve të tyre? Si mendoni, përse paraqiten kaq shumë gra në figurë?

Hegyi, Zimanyi, fig. me ngjyra 41.

► Fig. 9. Aga jeniçerësh



Hegyi, Zimanyi, fig. me ngjyra 43.

? Përshkruani veshjen e personazheve të paraqitur në figure. Mendoni se veshja ka pasur një rol të veçantë shoqëror në Perandorinë Osmane?

II-7. Lutfi pasha kujton karrierën e tij, që nga koha kur u rekrutua me anë të sistemit të devshirmes

Shkruesi i librave është skllavi më i dobët i Zotit, Lutfi pasha, djali i Abdulmuinit. Me anë të kërkesës së sulltanëve, unë, ky njeri i

përulur, u rrita në Pallatin e Brendshëm që nga koha e të ndjerit sulltan Bajaziti⁴² (i cili prehet në parajsë). Në portën e kësaj dinastie osmane, me vullnetin e Zotit, unë trajtohesha shumë mirë, dhe ndërsa qëndroja në Pallatin e Brendshëm, studiova shumë lloje diturish. Me ardhjen në fron të [...] sulltan Selimit⁴³, u largova nga posti i kujdestarit të veshjeve të sipërme [çuhadâr] të sulltanit dhe u futa në Shërbimin e Jashtëm, si oborrtar [myteferrika] me 50 akçe në ditë. Më pas mora postin e rojes së derës [kapıcı], kujdestarit të flamurit [mir-alem], guvernatorit [sanxhakbeut] të Kastamanusë, guvernatorit-gjeneral [bejlerbej] të Karamanit dhe Ankarasë, dhe së fundi, në kohën e sulltanit tonë, Sulejmanit⁴⁴, m'u caktuan postet e vezirit dhe vezirit të madh. Kur unë, ky njeri i përulur dhe jo i përsosur, u largova nga Pallati, shoqërohesha me shumë dijetarë [ulema], poetë dhe burra të kulturës dhe kërkova deri në maksimumin e mundësive të mia të përmirësoja karakterin tim nëpërmjet mësimit të diturive.

Inalcik 1973, f. 84.



Lutfi pasha (rreth viteve 1488-1563) që vezir i madh në vitet 1539-1541. Ai lindi në Shqipëri dhe u rekrutua me sistemin e devshirmes. Postet që mbajti në shërbim të sulltanit janë tipike për karrierën e skllavëve të sulltanit në shekujt e 15-të – 16-të (fillimisht, një karrierë në Pallatin e Brendshëm bënte të mundur që të merrje poste të mira në Pallatin e Jashtëm, dhe më pas të dërgoheshë drejtpërdrejt guvernator në provinca, çka ishte parakusht për t'u emëruar vezir në Këshillin Perandorak). Edhe pse arritjet vetjake të Lutfiut janë mbresëlënëse, nuk duhet të harrojmë faktin që, qysh prej sundimit të Mehmetit II deri në fund të shekullit të 16-të, shumica e vezirëve të mëdhenj zgjidheshin nga ish- skllavët të rekrutuar nga sistemi i devshirmes. Lutfi pasha është i veçantë më tepër për prirjet e tij kulturore dhe për faktin që mbasi hoqi dorë nga pozicioni i vezirit të madh, u bë i njohur me shkrime politike. Jeta e tij ishte gjithashtu domethënëse në lidhje me konvertimin: në një moment të caktuar, mbas marrjes së Lutfiut të ri, edhe i ati duket se u kthye në fenë islame.

⁴² Bajaziti i Dytë (1481-1512).

⁴³ Selimi i Parë (1512-1520).

⁴⁴ Sulejmani i Parë (1520-1566).

? Shikoni skemën 1 dhe gjeni postet që pati Lutfiu në Administratën Qendrore osmane, përpara se të dërgohej të sundonte në provinca të ndryshme.

Ç'tregon rasti i Lutfiut në lidhje me ndryshimin e statusit shoqëror në Perandorinë Osmane? A mendoni se mund ta përgjithësojmë këtë rast?

IIc. Sistemi i timarit

II-8. Rregullat osmane që përcaktonin dhënien e timareve

Të ardhurat që përftohen nga timari quhen “frytet e luftës” [*mâl-i-mukatele*]. Kjo do të thotë që një burim i tillë të ardhurash jepet në këmbim të pjesëmarrjes në luftë kundër armikut. [...]

Timaret, [...] [këto] janë dy llojesh. Njëri quhet “i rekomanduar dhe miratuar” [*tezkirelü*], dhe tjetri quhet “jo i rekomanduar” [*tezkiresüz*]. Kuptimi i këtyre termave “i rekomanduar dhe miratuar” dhe “jo i rekomanduar” është ky: në bazë të urdhrit perandorak [*beratit*] të lëshuar për të, çdo guvernator i përgjithshëm [*bejlerbej*] mund të japë një sipërfaqe toke [ose sasi të ardhurash] për të cilën duhet të lëshojë një vërtetim [*tezkire*] për rekomandimin e bërë, dhe më pas, miratimi jepet nga oborri perandorak [në Stamboll]. Kështu kanë filluar të përdoren termat “i rekomanduar dhe miratuar” dhe “jo i rekomanduar”.

Hezarfen, f. 139.

? Cili nga llojet e timareve ishte më i madh: i “rekomanduar dhe miratuar” apo “jo i rekomanduar”? Argumentoni përgjigjen tuaj.

II-9. Lista e të ardhurave që një spahi duhej të mblidhte nga timari i tij

Dyzet meshkuj nga shtëpitë e fshatit [*kirk nefer raja*] dhe tri prona [*zemin*], si dhe fshati Ardiç Agil, të ardhurat e regjistruara të të cilit përbëhen nga mbledhja e së dhjetës së drithit [*öshür*], taksa për tagjinë [*salârije*], taksa e miellit [*resm-i-gendüm*],

taksa e tokës [*resmi çift*] dhe taksa e tokës për fshatarët që kishin ngastra të vogla toke [*resm-i-bennâk*]; po ashtu edhe detyrimet për beqarët pa tokë [*resm-i-cebe= resm-i-caba*], si dhe të dhjetat për vreshtat [*öşür-i-bağ*], që gjithsej bëjnë pesë mijë akçe, bazuar në atë që shkruhet në *Librin e Hollësishëm [defter-i mufassal]* nga vetë dora e regjistruarit të pasurisë, ndërsa në *Librin Përmbledhës [defter-i icmâl]* përmendet se tre mijë akçe nga kjo shumë duhet të grumbullohen nga burime të tjera....

Barkan, f. 771-772.

? Përse shteti i regjistronte me hollësi të ardhurat e timarlinjve?

II-10. Një timarliu i jepet një timar tjetër nga mesatar deri te i madh

Mustafa bin Ahmed *çavushit*, të cilit i është hequr nga pronësia një *timar* me 15 100 akçe në Kajzeri, tani i është dhënë: një *timar* me 1 600 akçe në Endirlik dhe në fshatra të tjera të zonës [*nahijes*] Xhebel Erxhish; një *timar* me 2 000 akçe në fshatin [*mezra'â*] Gaziler dhe në territore të tjera të krahinës së Koramazit, që më parë ishin në pronësi të të ndjerit Abdul-Kerim; një *timar* me 2 000 akçe, nga të ardhurat [*mahsul*] e prodhimit të bozës [*boza hane*] në qytetin Kajseri, të cilit i përkisnin Abdul-Kerimit; *timar* 800 akçe, në një fshat të zonës Kenar-i Irmak; *timar* 3 000 akçe në Istefana dhe në fshatra të tjerë të Xhebel Erxhishit, si dhe disa prona të tjera të vogla, të cilat gjithsej arrijnë shumën 15 100 akçe.

Jennings 1972, f. 212.

Argumentoni, përsa burimet e të ardhurave të përfshira në timarin më të madh janë të shpërndara në zona të ndryshme.

II-11. Vendime për timarlinjtë që nuk merrnin pjesë në fushata ushtarake (1635)

Timari 2 500 akçe në zonën [*nahijen*] e Kosteres është i lirë [*mahlül*], pasi këtë vit, Sulejmani nuk shkoi në fushatën e Revanit [*Erivan*]. Ai nuk kreu as detyrimin e tij [*hidmet*] dhe nuk bëri as paraqitjen ushtarake [*joklama*]. Në bazë të një letre rekomandimi nga komandanti [*alajbeu*] i Nigdes, Musai, ky timar iu dha Mahmutit, të cilit i ishte dhënë dekreti [*berat*] që të merrte një timar me 3 000 akçe. Karaman Ibrahim beut, guvernatorit të përgjithshëm [*bejlerbeut*] iu dërgua një vërtetim [*tezkere*] që të caktonte timarin.

Dervish Mehmeti [*mytasarifi*], i cili kishte një timar prej 3 000 akçesh në zonën e Sahras, nuk shkoi në Erivan. Mahmut *çavushi* e mori në pronësi këtë timar, por më pas, ai nuk dha ndihmesën e tij në fushatë, kështu që timari është përsëri i lirë. I hiqet [*tahvil*] Mehmetit, i jepet Hamzës, në përputhje me një vërtetim të lëshuar nga guvernatori i përgjithshëm, Karaman Hasani. [datë] 1 Zil-kade 1025 nga Eregli.

Jennings 1972, f. 212.

Në fund të shekullit të 16-të dhe në shekullin e 17-të, lufta kundër Austrisë dhe Iranit filloi të bëhej gjithnjë e më e ashpër dhe largësia e madhe bënte që timarlinjtë shpesh herë nuk kishin kohë të mjaftueshme të ktheheshin të mblidhnin të ardhurat dhe të kujdeseshin për feudet e tyre. Ndaj, shumë timarlinj nuk shkuan në luftë, çka sipas ligjeve në fuqi i detyroi autoritetet që t'u merrnin atyre timaret dhe të ndëshkonin ata që nuk bindeshin.

Çfarë mënyrash përdorëshin për të siguruar që timarliu të shërbente ashtu siç pritej prej tij? Krahasoni sistemin osman të timarit me sistemin feudal.

► Fig. 10. Spahinj të armatosur



Inalcik 1973, fig. 25

Përshkruani armët dhe pajisjet e spahit. Krahasojeni këtë figurë me figura të tjera kalorësish europianë të shekullit të 16-të. Gjeni ngjashmëritë dhe ndryshimet. Nëse nuk do të ishte dhënë ndonjë shpjegim për figurën, çfarë do të kishit menduar për figurat e paraqitura në të? A ka ndonjë element të veçantë që ju bën të kuptoni se këta janë ushtarë osmanë?

IId. Ideologjia e mbrojtjes së nënshtetasve dhe praktikat e administratës juridike

II-12. Rekomandimet e Muratit I për Evrenoz beun, kur e caktoi atë guvernator (1386)

[...] Dëgjoje dhe mbaje mend këtë këshillë: Duhet ta dish, që vendet të cilat përbëjnë provincën e Rumelisë⁴⁵ janë shumë larg njëri- tjetrit. Për qeverisjen dhe plotësimin e nevojave të tyre dhe për mbajtjen e rregullit, sigurisht që do të kesh nevojë për shumë njerëz të shpatës e të penës. Por ki kujdes, mos të vësh dorë në pasuritë e njerëzve të tu. [...] Në këtë botë, ai që mbyll sytë prej besimit, harron frikën nga Zoti. Mos u ngatërro me këto gjëra. Mos ki besim tek askush, dhe mos iu hap asnjë njeriu. Shumë veta duket sikur agjërojnë gjatë ditës dhe rrinë zgjuar natën, por në të vërtetë, u besojnë idhujve. Ki kujdes nga këta njerëz. Mos u gënje nga pamja e jashtme...

Dhe kur dëshiron që të lësh dikë që të të zëvendësojë, mos u mbështet tek ajo çka ke ditur rreth tij më përpara. Më vonë, ai mund të ketë ndryshuar. Sepse trupi i birit të njeriut ndryshon nga një gjendje në një tjetër... Ndaj ruaje dhe vështroje me kujdes njeriun që e autorizon për ndonjë punë. Shiko nëse është po ai njeri që ka qenë më parë, dhe mati fjalët e tij nga ky këndvështrim. Mos të fyhet njeri nga kjo. Ki parasysh edhe këtë këshillë:

Nëse vartësit që do të caktosh do ta bëjnë punën me përkushtim dhe kujdes, kushtet e nënshtetasve [*raja*] do të jenë të mira [...] Dhe urdhëroi të gjithë që t'i konsiderojnë myslimanët në zonat e tyre si vëllezër dhe t'i trajtojnë nënshtetasit e tyre me respekt. Kujtoja atyre që do të vijë një ditë kur gjërat që ata kanë bërë në të shkuarën do të bien si dëborë mbi ta, në ditën e gjykimit. Le të kujdesen për njerëzit e varfër. T'u krijojnë kushte për të jetuar. Zoti i do të varfrit. Ai do ta marrë mbi vete varfërinë e tyre. Ai nuk do të kujdeset për ata që kanë pasuri të mëdha...

Respekto veçanërisht të shquarin e të diturve, Elvana Fekihan – që iu shtoftë dituria! – i cili është emëruar Sheikh-ul-Islam i të gjithë Rumelisë. Dhe kujdesu për udhëheqësit shpirtërorë të cilët janë trashëgimtarët e pasuesve të Profetit. Jepu dashuri dhe mëshiroji, respektoji dhe mbroji ata.

...

Hape derën për dhurata dhe shpërblime për spahinjë. Tregohu i kujdesshëm, që të mos jesh as shumë dorështrënguar, dhe as shumë dorëlëshuar. Mos ndërhy në caktimin e spahinjve, mos merr asgjë prej tyre në këmbim të favoreve. Mos u trego i gatshëm për të marrë, por puno me shumë kujdes. Mos u mburr me burrërinë dhe guximin tënd, por shpatën mbaje të mprehur. Ushqeje kalin tënd. Gjithmonë trego se je i pasur dhe shpërndaj dhurata. Gjithashtu mos u mërzit nëse të ardhurat e tokës që ke fituar me shpatë të bëjnë të thuash: “Nuk janë të mjaftueshme për shpenzimet e mia!” Nëse ke nevojë, na shkruaj neve këtu. Ne nuk do të kursehemi të japim çka kemi. Aq sa të kemi mundësi, do ta dërgojmë. [...]

Shkruar në muajin e bekuar të Shevalit, në vitin 788 [1386].

Odbrani, I, f. 187-189.

❓ Cili është kuptimi i fshehur i disa prej këshillave (“Ushqeje kalin tënd”)? Ç’rol zë feja në rekomandimet e Muratit?

Cilin apo cilët duhet të ketë frikë Evrenoz beu dhe pse? Ç’mendim keni për këshillat e sulltanit? A ishin këshilla praktike për një guvernator osman?

Cilat nga këto rekomandime të përgjithshme mund t’u vijnë në ndihmë nxënësve të sotëm?

⁴⁵ Kjo fjalë do të thotë “toka e grekëve” (Rum ili). Në tekstet osmane të shekullit të 14-të dhe 15-të, ky emër përcaktonte pjesën europiane të Perandorisë Osmane, që drejtohej nga një guvernator i përgjithshëm (bejlerbej). Pas pushtimeve të shekullit të 16-të, osmanët krijuan edhe ndarje të tjera administrative në Europë, por në provincën e Rumelisë vazhdonte të përfshihej pjesa më e madhe e Gadishullit Ballkanik.

II-13. Fermani i Mehmetit I, lëshuar në dobi të murgjve të manastirit *Margarit*, në rajonin e Seresit (1419)

Ky është vullneti i Perandorit dhe arsyeja për lëshimin e këtij urdhri të gëzuar – vullneti i Zotit të madhërisëm bëftë që të zgjasë deri në fund të kohërave – është si më poshtë:

Gjyshi dhe babai im i ndjerë kishin denjuar të lëshonin urdhra për zotëruesit e dokumenteve të shenjta, murgjit e manastirit *Margarit*. Pronat e tyre ishin shpallur të padiskutueshme dhe murgjit u përjashtuan nga [taksat] mbi pronat e tyre të patundshme, të cilat përbëheshin nga vreshta dhe mullinj uji, po ashtu edhe nga vakëfet e tyre, që përfshinin fshatra, toka, kopshte me fruta dhe shtëpi. Ishin hequr edhe taksat për shtëpitë dhe bagëtitë e nënshtetasve [*raja*] në Zuhna. Pra, në bazë të këtyre urdhrave, unë gjithashtu e shpalla pronën e tyre të padiskutueshme dhe lëshova këtë urdhër të shenjtë. Të gjithë murgjit përjashtohen nga *haraçi* [taksa e argatit për jomyslimanët]. Ata lejohen të zotërojnë pronat e mësipërme, siç kanë bërë edhe në të shkuarën. Përfundimisht, ky urdhër duhet të zbatohet për gjithçka që ata zotëronin në kohën e gjyshit dhe babait tim, dhe për atë çka zotërojnë sot. Askush nuk lejohet t'i pengojë ose t'i shqetësojë; gjithashtu nuk lejohet të bëhen ndryshime në këtë urdhër. Ata [murgjit] përjashtohen nga detyrimi që të përdoren si korrierë, të bëjnë punë që përcaktohen me ligj ose të paguajnë taksa të tjera.

Todorova, f. 49.

🔍 Diskutoni, përse murgjit e manastirit *Margarit* kërkuan një privilegj të ri nga Mehmeti I, edhe pse ata ruanin privilegje më të hershme nga Murati I dhe Bajaziti I.

II-14. Vendimi i *kadiut* në një konflikt mes një të krishteri dhe një jeniçeri. (Sofje, 1618)

Ky dokument vërteton që jomyslimani Ilija, banor i qytetit të Sofjes, lagjja [*mëhalla*] *Banishor*, doli

përpara gjyqit të sheriatit dhe kërkoi të paraqitet aty jeniçeri Osman *beshe*, i cili banon në të njëjtën lagje me të, dhe në prani të tij deklaroi: “Ky njeri, Osman *beshe*, e mban gruan time, Petkanën, në shtëpinë e tij dhe nuk bindet të ma kthejë mbrapsht, edhe pse ia kam kërkuar këtë gjë. Gjithashtu, ai mundohet ta bindë atë të divorcohet nga unë. Pra, ai e mban atë në shtëpinë e tij, pa qenë i martuar me të. Unë i lutem gjyqit që ta pyesë të akuzuarin për këtë çështje dhe të mbajë shënim përgjigjet e tij”.

Mbas kësaj deklarate që bëri Ilija, i lartpërmenduri Osman u mor në pyetje nga gjykata [që të jepte mendimin e tij mbi këtë padi]. Në përgjigjen e tij, ai rrëfeu që personi po thoshte të vërtetën dhe e solli të lartpërmendurën, jomyslimanen Petkana, në gjyq dhe ia ktheu atë burrit të saj, Ilijas.

Turski Izvori, 2, f. 119.

🔍 Në ç’përfundim dilni në lidhje me pozitat e grave në këtë shoqëri? Përse ata nuk pyetën Petkanën për këtë çështje? Si mendoni, çfarë do kishte thënë ajo nëse do t’i kërkohej të zgjidhte? A ishte thjesht propagandë teoria e mbrojtjes së nënshtetasve [*raja*]?

II-15. Vendimi i *kadiut* në një konflikt mes një myslimani dhe një të krishteri (Vidin, 1700)

Ivani, djali i Nikollës nga qyteti i Vidinit, lagjja *Karaman*, doli përpara gjyqit të shenjtë dhe ngriti një padi gjyqësore kundër berberit, usta Jumerit, djali i Aliut, për arsyen e mëposhtme:

Ivani ka trashëguar një vresht me sipërfaqe $\frac{3}{4}$ akra në zonën e Kozlovetit, që kufizohet me vreshtat e personave të mëposhtëm: Manushit, Jovan furrxhiut dhe Nikollës, si dhe me rrugën shtetërore. I sipërpërmenduri Jumer e ka zënë pa të drejtë këtë vreshtë.


Gjatë pyetjeve që iu bënë, Jumeri deklaroi se para disa kohësh, ai e kishte blerë vreshtin në fjalë për 15 gurush⁴⁶ nga një punonjës shtetëror, duke qenë se kishte qenë pronë shtetërore, pa pronar. Mbas

⁴⁶ Gurush – kështu quheshin nga osmanët monedhat e mëdha të argjendit. Mbasi përdorën gurushët e prodhuar në vende të ndryshme europiane, në fund të shekullit të 17-të osmanët filluan të nxjerrin gurushët e tyre, monedhë që ishte e barabartë me 40 para dhe 120 akçe.

vdekjes së pronarit të mëparshëm, Ivan Simitçijatës, i cili vdiq pa lënë trashëgimtarë, vreshti u bë pronë shtetërore.

Nikolla kundërshtoi; sipas tij, ajo që tha Jumeri nuk ishte e vërtetë dhe thirri dy dëshmitarë, të cilët pohuan që vreshti ishte i tij. Më pas, të pandehurit iu kërkua të thërrasë dëshmitarë që mund të mbështesnin dëshminë e tij, dhe për këtë iu la një afat i caktuar kohor. Duke qenë se Jumeri nuk që në gjendje të gjente dëshmitarë brenda kohës së caktuar, gjyqi i kërkoi atij të deklaronte, pasi të betohej, që ai vërtet e kishte blerë vreshtin, pasi ai kishte qenë pa pronar. Jumeri pranoi dhe u betua në emër të Zotit. Në bazë të këtij deklarimi, gjykata vendosi që Ivani të mos vazhdojë asnjë procedurë ligjore për këtë vresht.

Georgieva, Tzanev, f. 293.

 Nëse do të kishit qenë ju kadiu, cili do të ishte vendimi juaj në këtë rast? A e besoi vërtet kadiu betimin e Jumerit, apo kjo ishte diçka e sajuar? Ç'dini mbi praktikimin e betimit në drejtësinë mesjetare? Në gjyqet kundër jomyslimanëve [raja], a i favorizonin gjithnjë kadilerët myslimanët?

A përbënin gjyqet e kadilerëve një sistem drejtësie gjithmonë të paanshëm? Duke u bazuar në burimet e mësipërme, argumentoni mendimin tuaj.

II-16. Komuniteti i ishullit të Mikonos vendos të heqë kadiun (1710)


9 shtator 1710, Mikonos

Ne përfaqësuesit e komunitetit të Mikonos, duke parë mjerimin dhe trazirat që i kanë ardhur ishullit tonë prej gjykatësit të përgjithshëm që na është caktuar, i cili kërkon me çdo mënyrë të na fajësojë, si dhe duke patur parasysh shpifjet dhe fajet që do të na ngarkojë, ne të gjithë, pleq e të rinj, klerikët dhe populli i komunitetit të kishës së Nënës së Shenjtë të Zotit, mbrojtëses së këtij ishulli, e gjykuam të drejtë largimin e këtij gjykatësi, për t'u dhënë fund skandaleve dhe problemeve që shkaktonte ai; i gjithë komuniteti premtan se, nëse dikush do të ketë probleme për shkak të përzënies së gjykatësit,

ne do ta mbrojmë dhe mbështesim atë në çdo gjykatë; dhe për ta provuar këtë, kemi vënë këtu nënshkrimet tona.

[Nënshkrimet]

Zerlentou, f. 67-68.

 Cilat ishin rreziqet me të cilat u përball komuniteti i Mikonos kur u ngrit kundër kadiut? Ç'mendim kishin njerëzit e Mikonos?

II-17. Vendim kundër *koxabashit* Todoraki nga Samakoxhuku (1762)

Vendim për zëvendësgjykatësin [naib] e krahinës [nahije] së Midjes:

Haxhi Ibrahim, pasi ishte paraqitur me të drejtën për të mbledhur taksën për kokë [xhizje] në Stamboll dhe rrethinat që varen prej tij, ka deklaruar se në fshatin Samakoxhuk të krahinës së Midjes, që bën pjesë në rrethinat e varura nga Stambolli, një person jomysliman [zimmî] me emrin Todoraki, i cili është *koxabash* për banorët [jomyslimanë] [raja] e fshatit që mbrohen nga drejtësia, mblodhi më tepër se njëqind e pesëdhjetë burra rreth vetes dhe deklaroi: "Ne banorët e Samako [xhuk-ut] nuk do t'i bindemi urdhrit për mbledhjen e taksës për kokë [xhizje]; ne nuk do t'ju lejojmë që të shkelni në fshatin tonë." I sipërpërmenduri, Todoraki, bëri një qëndresë kokëfortë, dhe në shenjë proteste arriti deri aty sa të godiste rojet që shoqëronin paditësin, duke bërë që të ardhurat shtetërore të mblidheshin pjesërisht. Ai [Haxhi Ibrahim] më ka kërkuar të nxjerr një urdhër perandorak, ku ta dënoj personin e lartpërmendur [zimmî] me burgim për një periudhë kohe deri sa ai të pendohet. Tani, ky është urdhri im me shkrim: Nëse ai do të përpiqet përsëri të ndalojë që këta nënshtetas të paguajnë taksat për kokë, siç kërkohet nga Ligji i Shenjtë [sheriati], le të merret me forcë e të silltet para gjyqit perandorak [dmth. në Stamboll], të futet në burg e të marrë dënimin që meriton.

Kal'a, f. 177.



Vini re faktin që fshatari taksambledhës nuk iu ankua kadiut, por drejtpërdrejt Këshillit Perandorak në Stamboll.

❓ Ç'forma qëndrese përdorën banorët e Samakoxhukut kundër taksambledhësve? Ç'qëndrim mbajti sulltani? A linte ky vendim shteg për Todorakin që t'i shpëtonte dënimit për atë që kishte bërë?

II-18. Dekreti osman në mbrojtje të manastireve boshnjake (1785)

Bujurdia [një lloj dekreti osman] e pashait. Drejtuar gjykatësve të zonës së Bosnjës, komandantëve dhe taksambledhësve. Në bazë të këtij dekreti dhe fermanëve të lartë që janë lëshuar për ta, duhet të dini që vëllazëritë e tri manastireve [Krezevos, Fojnicas dhe Kraljeva Sutjeskas] janë të përjashtuar nga çdo lloj takse publike. Asnjëherë e në asnjë vend, as në manastire dhe as në fshatrat e rajonit

Benic, f. 303.



Gjatë fundit të shekullit të 18-të, kur pushteti qendror ishte më pak i efektshëm në provincë, shpesh herë banorët kërkonin dekrete të veçanta, të lëshuara nga autoritetet e provincës.



Krahasoni shkallën e privilegjeve të dhëna në tekstet II-13 dhe II-18.

Ile. Provincat dhe shtetet vasale

II-19. Dispozita për statusin e Raguzës, përsëritur në një *ahidname* të lëshuar nga Murati III (1575)

[...] Më parë, për shkak të bindjes dhe nënshtrimit, përkushtimit dhe integritetit të treguar nga bejlerët dhe rektorët e Dubrovnikut [Raguzës], në kohën e stërgjyshërve të mi të lavdishëm – Zoti i ndriçoftë bëmat e tyre [të madhësisë] – për ta u lëshua një dekret.

[...]

Sipas zakonit të vjetër, çdo vit ata do të dërgojnë dymbëdhjetë mijë e pesëqind monedha ari [*flori*], të cilat, që nga kohët e hershme, ata i kanë çuar në Oborin tonë, vendi i lavdisë, me anë të të dërguarve të tyre.

Prej tyre nuk do të kërkohet më tepër haraç sesa 12 500 monedhat e përmendura më sipër. Gjithashtu, nuk do t'u shkaktohet asnjë dëm në vendin e tyre ose në zotërimet a kështjellat e tyre; po ashtu, asnjë ndëshkim nuk do të bjerë mbi vetë ata nga guvernatorët [*sanxhakbejlerët*], oficerët [*subashët*],

çifligarët dhe nga të gjithë ata që janë nën varësinë time.

Ashtu si edhe më parë, qyteti dhe vendi i tyre do të jenë të sigurtë dhe të mbrojtur edhe në të ardhmen. Nga vendet fqinje, çdo njeri, qoftë armik ose mik, si me rrugë detare ose tokësore, mund të vijë e të shkojë në qytetin e tyre; askush nuk do t'i ndalojë ose pengojë.

Tregtarët e tyre mund të bëjnë tregti në zotërimet e mia të mbrojtura [nga Zoti]; ata mund të vijnë dhe të shkojnë. Askush nuk do t'i pengojë mallrat, kafshët dhe gjëra të tjera që ata kanë ose t'u shkaktojë ndonjë shqetësim. Atyre nuk do t'u kërkohet as taksë [bâc] për rrugët.

Biegman, f. 56-57.



Cilat ishin detyrimet e Raguzës si haraçpa-guese? Ç'mendoni për përcaktimet e bëra në lidhje me tregtarët dhe tregtinë? Mundohuni të argumentoni nëse ato sillnin përfitim vetëm për banorët e Raguzës apo edhe për osmanët?

II-20. Ahidname⁴⁷ e Ahmetit I për Transilvaninë (1614)

Nëpërmjet këtij dokumenti, unë ju premtoj dhe betohem [...], që për sa kohë që princi i lartpërmendur [beu], kapitenët dhe fisnikë të tjerë nga Hungaria e Sipërme janë nënshkruar të Portës sime të Lumturisë, nga thellësia e zemrës së tyre, me besim dhe nder, janë miq të miqve të mi dhe armiq të armiqve të mi; dhe të bashkuar, dhe në një mendje me Betlen Gabrielin⁴⁸ e lartpërmendur, do të përpiqen të largojnë dhe të shkatërrojnë armiqtë, nga cilado anë qofshin, të cilët mund të ngrenë krye kundër tokave të Transilvanisë; dhe, në mënyrë që të vërtetojnë se janë besnikë dhe të nënshtruar, me dëshirën e tyre do të dërgojnë këtë vit dhurata [peshqesh] për Portën time perandorake, në bazë të prodhimit dhe mundësive të vendit të tyre.

Atëherë unë, si këmbim, do t'i mbroj me çfarëdolloj mënyre që të mundem nga armiqtë e tyre, kur të kenë nevojë për ndihmën dhe mbështetjen time; që sot e tutje, të gjitha kështjellat dhe qytetet, si dhe të gjitha territoret e zotëruara prej tyre do të mbeten në duart e tyre; dhe absolutisht asnjë njeri, asnjë guvernator i përgjithshëm [bejlerbej] ose guvernator [bej] nën komandën time, as edhe kryekomandanti im [serasker] nuk do të ndërhyjnë në to.

Dhe në asnjë mënyrë, atyre nuk do t'u kërkohet të ndryshojnë ritet, rregullat dhe besimin fetar, si dhe zakonet që ata praktikojnë prej shekujsh me radhë, duke i lënë kështu të qetë, të jetojnë në paqe, nën mbrojtjen e drejtësisë.

[...] Dhe nga ky vend, nuk do të kërkohet taksat më të larta, sesa ato që kanë qenë deri tani.

Gemil, f. 165.



Cilat ishin detyrimet që kishte një shtet vasal? Komentoni përcaktimin “miq të miqve të mi dhe armiq të armiqve të mi”.

II-21. Autonomia e Moldavisë (1716)

Princat e Moldavisë nuk e gëzonin të drejtën që të shpallnin luftë, të bënin paqe, të nënshkruanin marrëveshje, të dërgonin lajmëtarët e tyre tek princat e vendeve fqinje për çështje të ndryshme që kishin të bënin me shtetin; megjithatë, atyre u ishte dhënë liri e plotë dhe u ishte lënë thuajse i njëjti autoritet që ata gëzonin më parë, që të bënin ligje, të ndëshkonin banorët, t'u jepnin njerëzve tituj si *bojar*⁴⁹ ose t'u hiqnin atyre këtë titull, të vendosnin taksat, madje edhe të caktonin peshkopë dhe gjëra të këtij lloji. Dhe këtë pushtet që gëzon, princi mund ta ushtrojë jo vetëm mbi fisnikët dhe banorët e Moldavisë, por edhe mbi tregtarët turq dhe persona të tjerë, për sa kohë ata ndodhen në territorin e tij. Jeta dhe vdekja e tyre janë në dorën e tij [...], të gjithë civilët dhe ushtarakët janë në mëshirën e tij: ai u jep atyre që ka për zemër, dhe u merr atyre që nuk i pëlqen. Dhe kur bën këto dhurata, princi nuk ka nevojë të zbatojë ndonjë rregull [...] Princi ka të njëjtin autoritet jo vetëm mbi klerikët e rangut të ulët, por edhe mbi mitropolitët, peshkopët, arkimandritët, abatët dhe të gjithë anëtarët e tjerë të kishës. Nëse ata kanë qenë të padrejtë ose u kanë shkaktuar dëme njerëzve, ose kanë komplotuar kundër princit a shtetit, princi, pa asnjë lloj problemi dhe pa miratimin e patriarkut të Kostandinopojës, mund t'u heqë atyre postin dhe titullin që mbajnë në kishë, por s'mund t'i ndalojë të mbeten priftërinj; dhe kur është e nevojshme, mund t'i dënojë ata me vdekje [...]. Megjithatë, atij nuk i ishte dhënë i njëjti pushtet mbi zotërimet e banorëve. Sado të larta të ishin taksat që ai vendoste në vend, është e vërtetë që asnjë njeri nuk mund ta kundërshtonte ose asnjë nuk guxonte të mos u bindej urdhrave të tij, pa rrezikuar të humbiste kokën; por nga ana tjetër, edhe ai ishte i detyruar prej oborrit osman të raportonte për taksat që vendoste. Edhe pse

⁴⁷ Në praktikën osmane, ahidname ishte dekreti që lëshohej nga sulltani për shtetet jomyslimane, shtete me të cilat ai kishte bërë paqe. Të tilla ahidname u ishin dhënë jo vetëm shteteve “klasike” vasale, po edhe Venedikut, Polonisë etj. Për një kohë të gjatë, osmanët nguruan të zbatonin praktikën e marrëveshjeve dypalëshe, të lëshuara dhe të nënshkruara nga të dyja palët; megjithatë, përcaktimet e bëra në ahidname, zakonisht diskutoheshin nga të dyja palët, para lëshimit të dokumentit.

⁴⁸ Princi i Transilvanisë (1613-1629).

⁴⁹ Bojar do të thoshte njëkohësisht edhe fisnik, edhe zyrtar.

askush nuk mund ta gjykojë për derdhjen e gjakut të të pafajshmëve – nëse ai do të kallëzohet tek veziri i madh – do të ishte në rrezik më të madh, nëse i gjithë vendi do të ankohej për taksat tepër të larta. Dhe nëse ai do të gjendej fajtor për këtë gjë, zakonisht dënohej duke u larguar nga vendi ose duke i konfiskuar zotërimet ; princi mund të ekzekutohej vetëm nëse ishte rebeluar ose nuk kishte pranuar të paguante haraçin vjetor. Por këto kufizime nuk i jepnin popullit aq shumë pushtet sa të mos nëpërkëmbej prej princit. Në të vërtetë, nëse princi, duke u dhënë dhurata, do t'i merrte me të mirë vezirin, si dhe zëvendësin e tij [*kethüdan*], mbajtësin e thesarit [*defterdarin*] dhe të tjerët që kishin një ndikim të veçantë tek sulltani, nuk kishte pse t'u trembej ankesave të bojarëve ose të të gjithë vendit, përderisa nuk ka arsye që një i akuzuar me duart plot me dhurata, të mos mbrohet me sukses përpara oborrit turk. Prandaj, sado e ashpër të jetë tirania turke në Moldavi, princi i saj mund të bëjë gjithçka që do, pa patur frikë nga asgjë: askush nuk mund ta kundërshtojë vullnetin e tij pa u ndëshkuar.

Cantemir 1973, f. 127-128.



Dimitri Kantemiri (1673-1723) sundoi dy herë si princ i Moldavisë (1693; 1710-1711) dhe u detyrua të largohej në Rusi, mbasi dështoi në kryengritjen e tij kundër osmanëve në vitin 1711. Duke kaluar pjesën më të madhë të fëmijërisë së tij në Stamboll, ai u bë një nga dijetarët kryesorë europianë të Perandorisë Osmane, dhe midis veprave të tjera shkroi një histori të Perandorisë Osmane dhe një libër mbi fenë myslimane. Gjithashtu, për publikun perëndimor, ai shkroi në latinisht librin “Përshkrimi i Moldavisë”.



E miraton apo e kritikon Dimitri Kantemiri zgjerimin e pushtetit të brendshëm që kishin princat moldavë?

Vlerësoni përparësitë dhe vështirësitë e popullsisë që jetonte në një shtet vasal dhe të asaj që jetonte në një provincë ‘normale’ osmane. Mundohuni të përcaktoni pozitat e veçanta të grupeve të ndryshme shoqërore.

II-22. Udhëtari francez, Flashat, flet për statusin e veçantë të princave të Vllahisë (1741)

Në Bukuresht kam vënë re diçka që më është dukur tepër e çuditshme. Edhe pse kjo principatë është në duart e sulltanit, turqit nuk kanë asnjë xhami atje dhe nuk janë nën autoritetin e princit. Ata njohin vetëm autoritetin e “përfaqësuesit” të sulltanit, i cili është i vetmi që ka të drejtë t'i dënojë ata. Megjithatë, për rumunët, grekët dhe të krishterët e tjerë ndodh ndryshe: *vojevoda* apo ‘gospodari’ i Vllahisë mund t’u marrë atyre jetën dhe pasurinë në mënyrë të dhunshme, nëse veprimet dhe vendimet e tij nuk pengohen nga sulltani, pasi ai varet tërësisht prej tij ; dhe sa herë që ai vonohet në pagimin e haraçit që i detyrohet Portës ose nuk plotëson detyrimet e tij ndaj Portës, ai duhet të jetë i përgatitur që të lërë fronin dhe ndonjëherë rrezikon edhe kokën. Ai është më tepër një mëkëmbësmbret, sesa një sundues. Vojevoda Kostandin [Mavrokordati]⁵⁰ meritonte një fat më të mirë; të gjitha vendet e tjera do të kishin qenë tepër të kënaqura ta kishin pasur atë për sundimtar.

Călători, IX, f. 257.



Ç’kufizime kishin osmanët që jetonin në shtetet vasale? Krahasoni burimet në këtë nënkaptull me burimin I-8.

⁵⁰ Kostandin Mavrokordati (1711-1769) ishte një nga përfaqësuesit më të shquar të elitës kulturore greke, të ashtuquajtur ‘Fanariotët’, të vendosur në Kostandinopojë në shekullin e 18-të. Ndërmjet viteve 1730 dhe 1769 ai sundoi gjashtë herë në Vllahi dhe katër herë në Moldavi. Ai ishte një njeri tepër i kulturuar dhe ndaloi me ligj bujkrobërinë dhe ndërmori edhe reforma të tjera të ndryshme në frymën e absolutizmit iluminist.

Skema 2: Ndarjet administrative të territoreve të sunduara nga osmanët (shekulli i 16-të).

A. Provincat “parësore” osmane (*ejalete*; të quajtura gjithashtu *liva* ose *vilajete*)

- Drejtoreshin nga një guvernator i përgjithshëm, i quajtur *bejlerbej*;
- zakonisht ishin të ndara në disa sanxhakë (të drejtuar nga guvernatorë të quajtur *sanxhakbej*) dhe përbëheshin nga disa *kaza* (të drejtuara nga *kadiu*);
- pjesa më e madhe e tokës shpërndahej në bazë të sistemit të çifligjeve (*timar*);
- shembuj: Anatolia, Rumelia, Buda, Qipro etj.
- raste të veçanta: kishte edhe rajone dhe komunitete të vogla të cilat gëzonin disa privilegje ose autonomi lokale (për shembull: manastiret në Atos dhe Sinai; disa komunitete që jetonin nëpër zona malore dhe ishuj në Mal të Zi, Shqipëri, Greqi etj.).

B. Provincat osmane të “brezit të dytë”

- Përgjithësisht *ejalete* të drejtuara nga guvernatorë të përgjithshëm që emëroheshin prej sulltanit;
- shumica e këtyre provincave organizoheshin mbi bazën e rregullave të veçanta financiare (sistemi *saljane*; vetëm pjesërisht ose aspak të përfshira në sistemin e feudeve);
- shembuj: Egjipti, Bagdadi, Basra, Tunizia, Jemeni etj.
- raste të veçanta: rrallë, në nivel *ejaleti*, dhe më shpesh në nivel *sanxhaku*, disa nga këto provinca drejtoreshin nga guvernatorë që e trashëgonin postin (shembuj: Lahsa, Adana, nën dinastinë Ramazan- Ogullari; disa *sanxhakë* kurdë; Vidin, nën dinastinë Mihaloglu në shekujt e 15-të dhe të 16-të etj.).

C. Shtetet vasale myslimane

- Shtetet që e pranonin varësinë nga Perandoria Osmane, por që ruanin format e tyre tradicionale të organizimit; megjithatë sulltani ndërhynte në emërimin e sunduesve të tyre;
- përgjithësisht kishin rëndësi të madhe politike, ushtarake dhe/ose simbolike për Perandorinë Osmane, dhe në forma të ndryshme, përfitonin mbështetje financiare nga Perandoria Osmane;
- shembuj: Hanati i Krimesë, Sherifati i Mekës etj.
- raste të veçanta: në periudhën 1590-1603, Persia paguante haraç, por nuk ishte gjithmonë shtet vasal osman.

D. Shtetet vasale të krishtera

- Shtetet që e pranonin varësinë nga Perandoria Osmane, i paguanin një shumë të caktuar haraçi sulltanit, duhej të mbështesnin politikën osmane, por ato ruanin autonominë e tyre dhe institucionet tradicionale të krishtera (nuk kishin asnjë ligj mysliman/osman);
- shembuj: Raguza, Vllahia, Moldavia, Transilvania, Gjeorgjia, Kiosi (deri në vitin 1566) etj.
- raste të veçanta: disa shtete të krishtera paguanin haraç ose për një pjesë të territorit të tyre (p.sh. Venediku për Qipron 1517-1570, Perandoria Habsburgase për Hungarinë e Sipërme 1533-1593) ose si “para për mbrojtje”, për të mos u sulmuar (p.sh. Poloni-Lituania i paguante Hanatit të Krimesë dhe ndonjëherë edhe osmanëve), por ruanin pavarësinë e tyre politike.

KAPITULLI III: Institucionet, komunitetet dhe ritet fetare

Perandoria Osmane përfshinte brenda saj njerëz të besimeve të ndryshme. Besnikëria ndaj islamit ishte thelbësore për legjitimitetin e sulltanit dhe elitave osmane, por po aq e rëndësishme ishte dhe nevoja për të gjetur mënyra integrimi për nënshtetasit jomyslimanë. Gjithashtu, shumëllojshmëria fetare ishte shumë më e madhe në Europën Juglindore, sesa në provincat osmane të Lindjes së Mesme ose ato të Afrikës.

Ky kapitull përpiqet të paraqitë rolin e rëndësishëm që luante feja në jetën e popujve të Europës Juglindore gjatë sundimit osman. Feja ishte me rol thelbësor në aspektin politik. Ndarja midis myslimanëve dhe jomyslimanëve ishte parësore në strukturën shoqërore osmane, dhe nënshtetasit jomyslimanë ndaheshin më tej, në bazë të feve të tyre, në ortodoksë, hebrej dhe armenë [*millet*]. Institucionet fetare ishin shumë të rëndësishme për formulimin e interesave dhe nevojave të këtyre komuniteteve. Kisha ortodokse kishte një marrëdhënie të veçantë me autoritetet osmane, por edhe udhëheqësit e feve të tjera bashkëpunonin me shtetin osman. Gjithsesi, për shumicën e njerëzve, feja ishte çështje besimi dhe komunikimi me Zotin dhe më pak çështje politike ose institucionale. Praktikrat fetare përbënin pjesën kryesore të jetës për shumicën e njerëzve dhe burimet e përfshira në këtë kapitull synojnë të hedhin dritë mbi disa prej këtyre praktikave a riteve.

Një numër i madh burimesh trajton çështjen shumë të diskutueshme të “tolerancës” fetare osmane. Shumë historianë këmbëngulin në natyrën myslimane të Perandorisë Osmane dhe në faktin se ajo i ka shtypur të krishterët për arsye fetare. Historianë të tjerë kanë argumentuar se në të njëjtën kohë kur në Europë u zhvilluan luftërat fetare dhe ata që nuk ishin të krishterë u detyruan ose të konvertoheshin, ose të largoheshin, osmanët ishin shumë më tolerantë dhe i lejuan nënshtetasit e tyre jomyslimanë të ruanin fenë e tyre, madje mirëpritën refugjatët fetarë. Edhe pse të dyja këto opinione kanë të vërteta brenda tyre, ato gjithashtu kanë ndikime ideologjike, dhe i thjeshtëzojnë së tepërmi dëshmitë historike. Burimet e përfshira në pjesën e fundit të këtij kapitulli synojnë t’i ndihmojnë nxënësit të kuptojnë natyrën e ndërlikuar të bashkëjetesës dhe diskriminimit fetar në Europën Juglindore nën sundimin osman nga një këndvështrim krahasues.

IIIa. Myslimanët

III-1. Mbishkrim në portalin e Xhamisë së Sulejmanit në Stamboll (mesi i shekullit të 16-të)

[Sulltan Sulejmani] është më pranë Zotit, Zotit të Madhërishëm dhe të Plotfuqishëm, Krijuesit të Botës së Sundimit dhe Sovranitetit. [Sulltan Sulejmani], i cili është skllavi i Tij, i fuqizuar nga Fuqia Hyjnore, Kalifi, që shkëlqen me Lavdi Hyjnore, që përmbush Urdhrin e Librit të Fshehtë dhe zbaton Udhëzimet e tij në (gjithë) zonat e banuara:

Pushtues i Tokave të Lindjes dhe të Perëndimit me Ndhimën e Zotit të Plotfuqishëm dhe Ushtrisë së Tij Fitimtare, Zotërues i Mbretërisë së Botës, Hije e Perëndisë mbi të gjithë Popujt, Sulltan i Sulltanit të Arabëve dhe Persianëve, Përhapës i Ligjeve Sulltanike [*kanun*], i Dhjeti i *Khaqan*-ëve Osmanë, Sulltan bir Sulltani, Han Sulltan Sulejman [...] Qoftë e gjatë deri në Fund të Ditëve dinastia e Sulltanatit të tij!

Imber, f. 75.



Shpjegoni lidhjen që mendohet se ekziston midis Zotit dhe sundimtarit osman. A ishte ky sundimtar (dhe shumë të tjerë që mëtonin se kishin lidhje me Zotin) një besimtar i vërtetë apo ai thjesht po përpiquej të manipulonte nënshitetasit e tij? Cili ishte roli i *ulemave* në këtë rast?

III-2. Dimitri Kantemiri mbi lutjet myslimane

Muhameti urdhëroi që të kryheshin lutje publike e private 5 herë në 24 orë [të ditës] [...]

Kur kryejnë lutjet e tyre, ata tregohen shumë të kujdesshëm për katër gjëra: 1. Të pastrohen; 2. T'i thonë këto lutje gjatë kufijve kohorë të urdhëruar sepse, nëse i bëjnë para ose pas kohës së duhur, ata besojnë se lutjet do të jenë të kota dhe të pakëndshme për Zotin; 3. Të sigurohen që vendi të jetë i pastër dhe, nëse kanë ndonjë dyshim për pastërtinë e vendit, duhet të vendosnin nën këmbë një qilim të vogël ose shallin e tyre; 4. Të drejtojnë fytyrën në vijën veri-jug, të cilën ata e quajnë *kibla*, për të cilën thonë se i drejtohet tempullit në Mekë. [...]

Lutjet përbëhen nga disa përkulje, gjunjzime, prekje të tokës me ballë, ngritje përsëri dhe thënia e lutjeve. [...]

Në *xhamitë* e mëdha [xhami], ata nuk ia lirojnë vendin e tyre askujt, as edhe sulltanit, por gjithsecili qëndron në vendin që ka zënë që në fillim pa lëvizur dhe pa u shqetësuar. Dhe, përpara se lutjet të mbarojnë, të gjithëve u ndalohet të thonë qoftë edhe një fjalë të vetme ose të lëvizin (O Zot i madh, sa shumë fetarë janë në këtë aspekt në krahasim me të krishterët, madje më të zellshëm se ata në nderimin e Zotit!), dhe as të pështyjnë ose kolliten, përveç rastit kur nevoja i detyron; dhe pështymën duhet ta hedhin në shaminë e dorës, sepse ata e quajnë veprim të pahijshëm të pështyjnë ose shfryjnë hundët në një vend të pastër.

E premtja. Të premtëve, që në gjuhën e *Kuranit* quhet *Xhuma* (që do të thotë dita e mbledhjes ose ribashkimit), në xhamitë e mëdha (që ata i quajnë *selatin*), pas lutjeve të mesditës, predikuesit japin mësim për dy a tri orë. Ata shpjegojnë tekstin e *Kuranit*, për temat që kanë zgjedhur paraprakisht. Duke folur me fjalë të bukura, kësaj i shtojnë diçka moralizuese dhe të mbushur me figura letrare, epitete e metafora, si edhe figura të tjera retorike. Në kohë paqeje, ata shtojnë diçka mbi zbatimin e drejtësisë, mbi kujdesin e administratës shtetërore për njerëzit, mbi mirësinë e Zotit dhe mbi parandalimin e lëvizjeve dhe qëllimeve të armiqve. Dhe gjatë ose para fillimit të një lufte ose fushate, sulltani i urdhëron predikuesit të flasin më shpesh, duke u treguar njerëzve dhe duke i bindur ata se lufta kundër armiqve bëhet sipas urdhërave të Zotit dhe Profetit të tij, dhe jo për të mirat tokësore, jo për fitime të veçanta ose për famë dhe lavdi njerëzore, por vetëm për përhapjen e besimit, për lavdinë e Zotit dhe për përfitimet e të gjithë popullit mysliman dhe popujve të tjerë.

Cantemir 1987, f. 289-295.



Ky fragment është shkëputur nga libri i Kantemirit mbi fenë myslimane, i shkruar gjatë periudhës së dëbimit të tij në Rusi (1711-1723), por bazuar te njohuritë mbi shoqërinë osmane që kishte marrë gjatë më shumë se dy dhjetëvjeçarëve që kishte kaluar në Stamboll, para vitit 1710.



Ç'është duhet të ndiqte një mysliman gjatë lutjeve?

Gjeni një argument, në mbështetje të natyrës "demokratike" të komunitetit të besimtarëve myslimanë (*umma*).

A ishte e justifikueshme ndërhyrja politike në shërbesat fetare? Paraqitni argumente *pro* dhe *kundër* kësaj ndërhyrjeje. Gjeni shembuj ndërhyrjesh të kësaj natyre në shoqëri të tjera. A ka ndërhyrje të tilla në shoqërinë tuaj?

► Fig. 11. Xhami e shekullit të 14-të në Iznik (Nikea)



Lewis, f. 294.

► Fig. 12. Sulejmania (Xhamia e Sulejmanit) në Stamboll (1500-1557)



Fotografi nga Helen Philon

? Krahasoni dy xhamitë. Nëse nuk do t'ju jepeshin udhëzime për kohën e ndërtimit të tyre, si do ta gjenit se cila është më e vjetër dhe cila më e re?

III-3. Arsyetimi i një myslimani mbi lidhjen që ekziston mes Allahut dhe shiut (1779)

Nuk ra shi për tre a katër muaj, kështu që u kryen shumë lutje për shi (një lutje e tillë quhet *dova*) në çdo xhami të Sarajevës. Por çdo gjë ka arsyen e vet, sepse Allahu nuk e ndryshon vendimin e Tij dhe bota e epërme shpirtërore është e lidhur me tonën. Nëse shiu duhet të bjerë, ka një shkak tjetër për këtë, të cilin e njohin astronomët; dhe lutjet për shi janë vetëm simbol bindjeje dhe shërbimi ndaj Zotit dhe jo arsye kryesore për reshjet. Sepse, nëse çdo lutje do të realizohej, atëherë bota do të shembej, prandaj sekretet nuk na tregohen. Por, kur afron koha e shiut dhe dikush lutet, njerëzit e quajnë atë njeri të mirë, lutjet e të cilit do të realizohen. Unë, mëkatar i varfër, rreth një muaj më parë kam dëgjuar nga një astronom se pas një muaji (që do të thotë tani), kompozimi i yjësive do të vijë dhe se “dera do të hapet”, që do të thotë se do të bjerë shi – çka edhe ndodhi. Në këtë rast disa injorantë filluan të nxirrnin përfundimet e tyre, që janë të pranueshme, edhe pse jo të rëndësishme, sepse do të bëhet ajo që do Allahu, pavarësisht nëse duam ne apo jo.

Başeskiya, f. 235.



Mulla Mustafa Basheskia (1731/1732-1809) e kaloi gjithë jetën në Sarajevë. Ai ishte imam dhe hatib në xhaminë e Buzaxhi Haxhi-Hasanit, më pas punoi si sekretar (*qatip*). Mulla Mustafai shkroi një *Kronikë*, e cila është një burim i shkëlqyer për jetën politike e të përditshme në Sarajevë, Bosnjë dhe vendet fqinje. Gjithashtu ky tekst tregon se ai ishte shumë kritik ndaj paragjykimeve të kohës, duke qenë kështu në të njëjtën linjë mendimi me intelektualët europianë të shekullit të 18-të; gjithsesi, ky qëndrim kritik nuk e shtyu deri aty sa të vinte në pyetje plotfuqinë e Allahut.

? Çfarë beson në të vërtetë Mulla Mustafa Basheskia? A është shiu një dukuri natyrore apo hyjnore?

► **Fig. 13.** Mbishkrime zbukuruese të Kuranit, në brendësi të Xhamisë Eski në Edrene (shekulli i 15-të)



Hegy, Zimanyi, fig. me ngjyra 90.

► **Fig. 13a.** Xhamia e Hysen Pashës, e ndërtuar në vitin 1569 në Pljevlja



Kasalica, f. 76.

► **Fig. 13b.** Muret e brendshme të zbukuruara në xhaminë e Hysen Pashës në Pljevlja.



Kasalica, f. 77.



Xhamia e Hysen Pashës u ndërtua në vitin 1569 prej Hysen Pashë Boljaniçit, i cili lindi në rrethinat e Pljevljës dhe vdiq rreth vitit 1594. Hysen Pasha ishte sanxhakbeu i Bosnjës, Hercegovinës dhe Egjiptit, si dhe vezir i Bagdadit. Xhamia ishte pronë e tij. Muret e brendshme të xhamisë, dhe në veçanti kupola gjashtëkëndore, janë të zbukuruara me motive nga natyra dhe figura gjeometrike. Një libër *Kurani*, i cili daton në vitin 1571, ruhet në këtë xhami si një nga kryeveprat e shkrimeve islamike.

► **Fig. 14. Një grua turke hipur mbi deve, duke shkuar për në pelegrinazhin e Mekës**



Hegyí, Zimanyi, fig. me ngjyra 62.

III-4. Heterodoksia myslimane – Anekdota bektashinjsh

Një dijetar mysliman [*hoxha*] po predikonte në një xhami, duke shpjeguar fuqitë dhe tiparet e Zotit. -Allahu nuk është as në tokë dhe as në qiell; as djathtas dhe as majtas; as mbi dhe as në oqean. Shkurt, ai nuk ka paraqitje konkrete, por ekziston vetëm në zemrat e besimtarëve, po thoshte ai, kur një bektashi që ndodhej mes dëgjuesve, nuk u përmbajt dot më dhe tha:

-O ju anëtarë të komunitetit, ju lutem për pak vëmendje. Kur ju thashë atë ditë se “Allahu nuk është këtu”, ju murmuritët se unë isha “kthyer në një të pafe”, ndërsa tani që *hoxhë efendiu* po thotë se Allahu nuk ekziston, asnjëri nga ju nuk po thotë një fjalë.

Një bektashi e pyetën: “Pse është e mbushur bota me kaq shumë kodra dhe rrëpira, shkëmbinj e male? Pse nuk është e sheshtë dhe e lëmuar gjithandej?” “Oh, ju lutem, çfarë prisni ju nga një vend që u krijua për gjashtë ditë?” - u përgjigj ai.

Dursun, f. 78.



Bektashinjët formuan një vëllazëri fetare dhe deklaruan se ndiqnin shembullin e Haxhi Bektash Veliut, një dervish i famshëm mistik i shekullit të 13-të. Edhe pse zyrtarisht të lidhur ngushtë me autoritetet osmane dhe me ndikim të madh në radhët e jeniçerëve, bektashinjët praktikonin një formë mistike (*sufi*) të islamit, ngandonjëherë më afër me *shiizmin* sesa me *sunizmin* zyrtar të Perandorisë Osmane. Bektashinjët filluan të përfaqësonin një lloj të veçantë nënvleftësimi për hierarkitë shoqërore, si edhe për ritet e ritualet konvencionale – të gjitha të mishëruara në anekdota të panumërta, që kishin si perzonazh një *baba* bektashi anonim, ose ndonjëherë dhe një *dede*, (fjalë për fjalë: “xhaxha” ose “gjysh”), që njihet si një nga figurat më të mëdha të humorit turk. Të pajisura edhe me shumë elemente të traditës gojore, anekdotat bektashiane nuk datohen lehtë dhe janë dëshmi e kujtesës shoqërore që është vënë shtresë mbi shtresë.



Ç’mendoni për këto anekdota? A ndihmuan ato në mobilizimin e popullit kundër ngrehnës fetare, apo ishin thjesht deklarata relativisht të padëmshme individësh të pabindur? A njihni ndonjë formë tjetër heterodoksie fetare në Europën Juglindore? A mund të bëhet misticizmi minus i institucioneve zyrtare fetare?

► **Fig. 15. Qendra e vëzhgimit astronomik në Stamboll (rreth vitit 1580)**



Lewis, f. 200.

❓ Cilat nga këto instrumente shkencore njihni? Sa prej tyre i përdorim ende sot? Përse janë vizatuar vetëm meshkuj në këtë figurë? Pse të gjithë mbajnë mjekër? Ishte kjo për modë, detyrim profesional apo shenjë e shtresës shoqërore? Mendoni se ka një përgjigje të saktë, apo kjo varej vetëm nga imagjinata e piktorit? Ç'përshtypje keni për hartën e paraqitur në figurë?

► **Fig. 16. Heroi popullor, Nastradin Hoxha**



Hegyi, Zimanyi, fig. me ngjyra 75.

❓ A dini ndonjë nga historitë e Nastradin Hoxhës? Si paraqitet ai në këto anekdota? A janë të famshme historitë për Nastradin Hoxhën në vendin tuaj? Kur janë botuar historitë e tij për herë të parë në gjuhën tuaj? Pyesni miqtë apo anëtarët e familjes suaj, ç'dinë rreth Nastradin Hoxhës.

IIIb. Të krishterët

III-5. Zgjedhja e Genadio Skolariosit si patriarku i parë ortodoks pas pushtimit të Kostandinopojës (1453)

Ditën e tretë pas rënies së qytetit, sulltani festoi fitoren e tij me një triumf të madh e të gëzueshëm [...]

Meqenëse patriarku ynë kishte ndërruar jetë pak kohë më parë, ai lëshoi urdhra për zgjedhjen e patriarkut të ri, sipas traditës dhe protokollit. Klerikët e lartë që u ndodhën aty, dhe ata shumë pak anëtarë të kishës dhe të popullit përzgjedhën

George Skolariosin dhe e emëruan patriark, nën emrin Genadios [...] Zakoni dhe ceremonia jonë tradicionale kërkon që perandori i krishterë t'i dhurojë patriarkut të ri një kërrabë të artë. Kështu që ky sulltan mashtrues u përpoq të hiqej si perandor i qytetit tonë, duke imituar perandorët e krishterë: ai ftoi Genadiosin të darkonte me të dhe e priti me nderime të mëdha. Ata folën gjatë dhe sulltani i premtoi shumë gjëra. Kur erdhi koha që Genadios të largohej, atij iu dha kërraba e shtrenjtë dhe iu kërkua ta pranonte.

Melissenos, f.133-135.

Para pushtimit të Kostandinopojës, Skolariosi ishte një nga udhëheqësit ortodoksë, kundërshtarë të Lidhjes së Firences (1439), sipas së cilës perandori bizantin Joani VIII e kishte vendosur kishën ortodokse në varësinë e papës, në këmbim të ndihmës që katolikët do të jepnin kundër osmanëve.

? Përse i interesonte Mehmetit II të vendoste Genadosin patriark?

► **Fig. 17. Enë e argjendtë osmane e shekullit të 16-të, me mbishkrime greke, e cila përdorej në ritualet ortodokse**



Muzeu Benaki, Athinë.

III-6. Udhëtari francez Pierr Leskalopier tregon për Manastirin e Shën Savës në Serbi (1574)

Më 21 mars mbërritëm në Uvac, një qytet i vogël turk. Nga aty pamë Manastirin e Shën Savës, manastir me murgj serbë. Ata janë veshur me të zeza, flasin gjuhë sllave dhe jetojnë sipas riteve greke. Na çuan të puthim një kockë të madhe të krahut të Shën Savës. Ata pretendojnë se zotërojnë të gjithë trupin e tij. Ne pamë hebrenj dhe turq të puthnin këtë kockë, me të njëjtin respekt si edhe të krishterët

dhe të jepnin shumë para për bamirësi. Këta murgj paguajnë një taksë të caktuar (*haraç*) ndaj sulltanit. Korrieri (*çaushi*) ynë na tregoi se si një ditë, një turk që erdhi për të mbledhur taksën dhe u bëri diçka të keqe murgjve, u gjend i vdekur në derën e manastirit. Ata na dhanë për të ngrënë vaj dhe supë me presh, si dhe ca peshk dhe një bukë gruri.

Samardžić, f.135.

? Ç'forme adhurimi mbizotëronin tek ortodoksët? A ishte kjo formë adhurimi, e veçantë vetëm për popullsinë ortodokse? Përse e respektonin besimtarët e feve të tjera trupin e shenjtit ortodoks serb? (Kjo është zona në të cilën besimet kanë përputhje me njëra-tjetrën.) Si motivohej ky veprim? Dini ndonjë shembull të përafërt, në ndonjë pjesë tjetër të Europës apo botës, ose të ndonjë periudhe tjetër kohore?

III-7. Pali nga Alepoja përshkruan kishat moldave (mesi i shekullit të 17-të)

Në Vaslui gjenden pallatet e tij [princit të mëparshëm, Stefanit të Madh], banja e tij, kopshtet, pastaj kisha e madhe dhe e lartë, me kubetë e saj edhe më të larta. Në të gjitha anët e kishës ka kube dhe harqe gjysmërrethore dhe brenda tyre ka piktura dhe ikona të të gjithë shenjtorëve. Më pas, tek dera, mbi murin e ulët, është pikturuar në ar dhe *lapis lazuli* gjykimi i fundit, më pas Moisiu që udhëheq Anën dhe Kajafën dhe të gjithë hebrenjtë e tjerë përpara Zotit tonë. Këto piktura janë të shëmtuara. Ato pasohen nga piktura të një lloji tjetër; janë pikturat me turq që mbajnë çallma të bardha në kokë, xhybe të mëdha prej kadifeje me ngjyra të ndryshme, me mëngë të gjata të varura dhe me rripa të leshtë e të verdhë, pastaj vijnë pikturat me dervishët; dhe në shpinë e përbri tyre, djaj që i ndjekin dhe tallen me ta. Satanai është në ballë, me një kapele në kokë. Njëri nga djajtë tallen me Satanain dhe i heq kapelen nga koka. Pra, kështu është pikturuar e gjithë pjesa e brendshme.

Arkitektura është e bukur. Në majë të kubesë qendrore gjendet fytyra e Zotit tonë, Jezu Krishtit

[...]. Jashtë portës së kishës varet një kabanë e madhe.

Kishat në këtë vend përbëhen nga tri pjesë: pjesa e parë është jashtë, me një derë, dhe është vetëm për femrat; pjesa e dytë është e ndarë nga një mur dhe një derë, dhe është për besimtarët; dhe pjesa e tretë, edhe ajo e ndarë nga një mur dhe një derë, i rezervohet princit dhe oborrit të tij.

Călători, VI, f. 29.

❓ Ç’rrol luajnë pikturat kishtare të turqve në jetën fetare të Moldavisë? Si është e mundur ekzistenca e të tilla pikturave në një shtet vasal të Perandorisë Osmane? A është ky një shembull i tolerancës fetare osmane? Krahasoni strukturën hierarkike të pjesës së brendshme të kishave moldave, me atë të xhamive myslimane, të përshkruar në burimin III-2.

► **Fig. 18. Manastiri i Voronetit në Moldavi (i ndërtuar në vitin 1488; afresket e jashtme janë pikturuar në vitet 1547-1550)**




<http://www.users.cloud9.net/~romania/vor/Voronet.html>

► **Fig. 19. Darka e fundit – afresk në manastirin Stavronikita, Atos (1546)**



Koliopoulos-Chassiotis, f. 169.

► **Fig. 20. Manastiri i Ostrogut në Malin e Zi, 1650.**



Kasalica, f. 54.



Manastiri i Ostrogut u ndërtua rreth vitit 1650 prej metropolitit të Hercegovinës, Vasilije Jovanoviçit (1610-1671). Në të vërtetë, në Ostrog gjenden dy manastire, ai i Sipërm dhe ai i Poshtëm. Manastiri i Sipërm, i ndërtuar në faqen e një shkëmbi, është tejet mbresëlënës. Në të gjenden tempulli *Shfaqja e Zonjës Sonë*, tempulli *Kryqi i Shenjtë*, si edhe një han. Sendet e shën Vasilijes ruhen në tempullin *Shfaqja e Zonjës Sonë*. Kulti i metropolitit Vasilije u ngrit pasi vdiq dhe u shpall shenjtor. Manastiri i Ostrog është një vend pelegrinazhi për shumicën e malazezëve. Ai vizitohet nga besimtarë të të gjitha besimeve, që vijnë nga Mali i Zi dhe nga vendet fqinje. Një numër i madh pelegrinësh e vizitojnë manastirin në 12 maj, kur është edhe *Dita e shën Vasilije Ostroshkit*.

III-8. Kozma Aitoliani u bën thirrje të krishterëve të arsimit në fëmijët e tyre

Dhe ju prindër, jepuni fëmijëve arsim të krishterë, mësojuni të lexojnë dhe shkruajnë. Bëni atë që duhet bërë për të ngritur një shkollë, gjeni një mësues dhe paguajeni që të mësojë fëmijët tuaj, sepse është mëkat i madh t'i lësh ata të verbër dhe analfabetë; mos u mundoni që atyre t'u lini vetëm pasuri dhe prona, vetëm që të mund të hanë e të pinë pas vdekjes suaj dhe t'ju kujtojnë. Është më mirë t'i lini ata të varfër dhe të shkolluar, sesa të pasur e të pashkollë.

Menounos, f. 173.



Kozma Aitoliani (1714-1779) ishte misionar i ringjalljes fetare, aktiv kryesisht në Greqinë Perëndimore dhe në Shqipëri, por i lidhur edhe me Atosin. Thirrjet e tij për të ndërthurr arsimin me besimin ortodoks, si dhe me praktikat fetare janë tipike për një lloj iluminizmi të hershëm të Europës Juglindore.



A jeni në një mendje me pohimet e Kozma Aitolianit? (Veçanërisht me pohimin e fundit.) Përse, sipas tij, arsimimi është kaq i rëndësishëm? Diskutoni, nëse një qëndrim i tillë sillte përparim shoqëror.

III-9. Kiril Pejçinoviçi rreth marrëdhënieve të tendosura midis fshatarëve ortodoksë dhe priftërinjve (1816)

I shoh ata në disa fshatra, Zoti më ndjeftë, dhe e kam tepër të vështirë! Nuk mund t'i quaj as të krishterë dhe as të pafe. Ata hanë dhe pinë *Të Premten e Zezë* dhe *Të Shtunën e Zezë*, gjatë *Kreshmës së Madhe* [...] kryejnë mëkate, shajnë, rrihen me njëri-tjetrin, ndërsa ditën e *Pashkëve* presin *Kungimin e Shenjtë [Eukaristinë]*. Dhe prifti i shkretë [i cili] u shërben tetë fshatrave, nuk di ku të shkojë më parë. Ai vrapon nga njëri fshat tek tjetri, ndërkohë që një burrë tjetër mban për të *Misteret e Shenjta*.

Më vjen keq për disa të krishterë të shkretë, të cilët e presin priftin deri në mesditë që t'u sjellë Eukaristinë. E kështu ata bërtasin: "Prifti po vonohet, për këtë arsye apo për këtë tjetër?!" Disa të tjerë thonë: "Ta rrahim, që të mos vonohet sërish!" Dhe ata që janë çorbaxhinj, pak më të pasur, thonë: "Jo ashtu, nëse e rrahim, zabiti do të na dënojë, por, të mbledhur siç jemi tani, të shkojmë dhe t'i dërgojmë një dash agait ose pashait, dhe pastaj ta rrahim e ta përzëmë priftin, dhe pastaj të gjejmë një tjetër, edhe nëse ai jeton më larg". Por një fshatar edhe më i pasur [kmet] thotë për priftin tjetër: "Ai kërkon shumë para, kështu që lëreni fare atë. Ky që kemi vjen vonë, por na merr më pak, ai gjithashtu këndon falas, ose pret me vite derisa t'i japim paratë. Ndërkohë prifti tjetër i mbledh shpërblimet e veta me turq, nëse nuk e paguajnë". Pra, një thotë kështu dhe tjetri ashtu, [...] të gjithë e përdhosin priftin, që është udhëheqësi i tyre shpirtëror, që i ka pagëzuar në emër të Trinisë së Shenjtë dhe i ka martuar dhe do t'i varrosë, dhe që është babai i tyre dhe më shumë se një prind për ta. Ata nuk mbajnë meshë dhe e përdhosin priftin, dhe presin për kungimin deri në mesditë. Dhe unë, Kirili mëkatar dhe i padenjë, që jam më mëkatar se të gjithë ata së bashku, bëra mëkat vetëm duke i akuzuar ata, kështu pra, unë mëkatar, i pashë duke folur në atë mënyrë, i pashë dhe nuk më pëlqeu, kështu që u thashë: "Pse presim ne të krishterët deri në mesditë? Pse nuk e presim bukën, t'i hedhim verë sipër dhe të mos presim për priftin?" Ata më përgjigjen: "Ajo që na sjell prifti, nuk është bukë dhe verë, por gjaku i Krishtit. Prandaj dhe presim deri në mesditë, pasi kemi dëgjuar nga të


moçmit se pa të nuk mund të jetohej.” Dhe unë u them: “Kush jua ka thënë këtë, prifti?” Ata më thonë: “Çfarë, prifti s’na ka thënë gjë deri tani, kjo s’ka dalë kurrë nga goja e tij. Atij i pëlqen të vijë me ne në ndonjë dasmë, piknik, valle, për gjueti, në festa, të blejë a të shesë, por përsa i përket të mësuarit, as e pyesim dhe as na thotë gjë.” Kështu, unë mëkatari, e pashë se faji qëndronte tek të dyja palët: tek të krishterët, sepse nuk e pyesnin priftin, dhe te prifti, sepse ai nuk i mëson nga pak, aq sa të mundet, aq sa di; e shoh se ai nuk do t’ia dijë për detyrën që ka marrë përsipër dhe që i rëndon mbi kurriz.”

Odbrani, II, f. 14-16.

IIIc. Hebrejtë

III-10. Letër e Isak Xarfatit, rabin i Edrenesë (Adrianopojës), drejtuar hebrejve në Europën Qendrore (mesi i shekullit të 15-të)


Vëllezërit dhe udhëheqësit e mi, pasi iu luta Zotit që t’ju falë paqe, dëshiroj t’ju shpjegoj shkaqet që sollën tek unë rabinin e ri, Zalmanin, dhe shoqëruesin e tij, rabinin David Kohenin. Ata më treguan të gjitha përvojat e hidhura, më të këqija se vdekja, që vëllezërit tanë, bijtë e Izraelit që jetojnë në Gjermani, kanë kaluar dhe ende po kalojnë; vendimet e marra kundër këtyre martirëve, dëbimet që ndodhin çdo ditë dhe që i detyrojnë të enden nga njëri vend në tjetrin, nga njëri qytet në tjetrin, pa u ndalur, pa gjetur një vend që t’i pranojë [...]. Kur mbërritën ata këtu në Turqi, tokë në të cilën zemërimi i Perëndisë nuk ka qenë shumë i rëndë, kur ata panë paqen, qetësinë dhe bollëkun që nuk shteron në këto toka dhe kur panë që largësia nga Turqia në Jerusalem është e vogël, dhe mund të kalohet në rrugë tokësore, ata u mbushën me gëzim dhe thanë: Pa dyshim, nëse hebrejtë që jetojnë në Gjermani do të dinin një të dhjetën e bekimeve që Zoti i ka dërguar popullit të Tij të Izraelit në këtë vend, as bora dhe as shiu, as dita dhe as nata nuk do t’i ndalnin derisa të mbërrinin këtu. Ata më kërkuan t’u shkruaj të dëbuarve, komuniteteve hebreje që banojnë në Gjermani, në qytetet Svabia, Rineland, Stiria, në Moravi dhe në Hungari, dhe t’i informoj se sa i këndshëm është ky vend.[...] Kur e kuptova se dëshira e tyre ishte e sinqertë, vendosa ta pranoj


 Përshkruani ndjenjat fetare të fshatarëve. Në çfarë besonin ata? Në ç’mënyrë dallonte feja e tyre nga ajo zyrtare?

Cilat ishin arsyet për veçantitë e tyre fetare? (Varfëria, mungesa e shkollimit, arsyetime të cekëta të çështjeve fetare?) Përse i kritikonin priftërinjtë e tyre? A është i justifikueshëm qëndrimi i tyre? Argumentoni duke mbështetur herë njërin palë, herë palën tjetër.

lutjen e tyre, pasi do të doja t’i jepja mundësinë Izraelit të fitonte atë çka meriton me të drejtë...

Shaw, f. 31-32.

 Persekutimet kundër hebrejve u shtuan pas epidemisë së *Murtajës së Zezë* në mes të shekullit të 14-të jo vetëm në Gjermani, por në shumicën e vendeve të Europës Perëndimore e Qendrore. Këto persekutime, që ishin ndërthurje e paragjykimeve fetare, konkurrencës ekonomike dhe përjashtimit shoqëror, shtynë një numër të madh hebrejsh të kërkojnë strehim në vende më të sigurta dhe më pak të populluara, si Poloni-Lituanja dhe Perandoria Osmane.

 A ka mundësi që të ketë ndonjë vend aq të përkryer sa ai i përshkruar në tekst? A janë përparësitë e të jetuarit në Perandorinë Osmane që përshkruhen aty, të drejta dhe të vërteta? A mungojnë në tekst disavantazhet e mundshme? Pse po përpiqej shkrimtari t’i joshte hebrejtë të zhvendoseshin në Perandorinë Osmane?

III-11. Elijah Kapsali tregon për mirëqenien e hebrejve në Perandorinë Osmane gjatë sundimit të Mehmetit II

Në vitin e parë të sundimit të sulltan Mehmetit, mbretit të Turqisë [...], Perëndia e nxiti shpirtin e mbretit [...], dhe zëri i tij përshkoi tërë mbretërinë e tij dhe ai shpalli:

“Kjo është fjala e Mehmetit, mbret i Turqisë. Zoti, Perëndia i Parajsës më dha një mbretëri mbi tokë dhe më urdhëroi t’i pranoj njerëzit, farë e Abrahamit, shërbëtorit të tij, bijtë e Jakobit, të përzgjedhurit, dhe t’u jap mbështetje mbi dhe, dhe të siguroj një strehë të sigurtë për ta. Kushdo mund të vijë me Perëndinë e tij në Kostandinopojë, në qendrën e mbretërisë sime dhe të ulet nën hardhinë e tij dhe nën pemën e tij të fikut, me pasurinë e tij, arin e argjendin, dhe me bagëtinë, të vendoset në këtë tokë dhe të tregtojë e të bëhet pjesë e saj”. Hebrejtë u mbledhën bashkë nga të gjitha qytetet e afërta e të largëta të Turqisë, secili erdhi nga shtëpia e vet; u mbledhën me mijëra e dhjetëra mijëra dhe Zoti i ndihste që nga qielli, ndërsa mbreti u jepte prona dhe shtëpi plot me të mira. Hebrejtë jetuan atje me familjet e tyre dhe u shtuan shumë [...]

Duke qenë se hebrejtë e kishin frikë Zotin, Ai u dha atyre begati dhe në atë vend ku më parë, gjatë sundimit bizantin, kishte vetëm dy a tri kongregacione, hebrejtë u shumuan dhe u shtuan më shumë se dyzet kongregacione, dhe toka nuk i la të vendoseshin të gjithë së bashku, sepse zotërimet e tyre ishin shumë të mëdha. Kongregacionet e Kostandinopojës ishin të lavdërueshme. Torahu, dhe pasuria, dhe nderi u shtuan ndër kongregacionet. Në kongregacione ata i luteshin Perëndisë, burimit të Izraelit, bërësit të mrekullive të mëdha. Ata hapnin gojën për t’i kënduar qiellit dhe bekonin Perëndinë, dhe gjithë shërbëtorët e Perëndisë që qëndrojnë në shtëpinë e Perëndisë gjatë kohëve të errëta.

Shaw, f. 30-31.



Duke qenë se Elijah Kapsali shkruan në shekullin e 16-të për ngjarje që kanë ndodhur në gjysmën e dytë të shekullit të 15-të, kuptohet që është më pak i interesuar në saktësinë historike, sesa në përforcimin e moralit tradicional hebre. Për këtë arsye, teksti i tij është plot me perifrazime nga Dhiata e Vjetër (p.sh. Gjenezë 13:6, 34:10; Eksodi 1:7, 1:21; Psalmet 68:27, 134:1 etj.).



Cilat ishin qëllimet e autorit? Çfarë po përpiquej të arrinte ai duke shkruar këtë dokument? Në ç’mënyrë u përpoq ai të bënte lidhjen midis dy feve? Gjenero se ç’rol të veçantë kishte Abrahami në Islam dhe në Judaizëm. Cilat elemente i japin peshë argumentit se fjalimi që Elijah Kapsali ia atribuoi Mehmetit II është historikisht i pasaktë?

III-12. Ringjallja e hebrenjve: shembulli i Sabbata Zevit (1666)

[...] vazhdojmë tek tjetri [viti – 1666], ku do të tregojmë shkurt për Sabata Zevin, Mesinë e rreme të hebrenjve, që në fillim u shfaq në Smirna, dhe ata e shpallën si Mesinë e tyre, duke e lidhur me Madhësinë e Mbretërisë së tyre që po afronte, si dorën e fortë që i kishte dërguar Zoti, për t’i mbledhur ata nga të gjitha anët e botës. Ai ishte i biri i një sekseri, i lindur në Smirna, njohës i shkëlqyer i hebraishtes dhe arabishtes, por, pasi e përzunë për shkak të një trazire në sinagogë, ai u end lart e poshtë Greqisë për ca kohë, dhe kur në fund arriti në Jerusalem, u takua me një sofist dhëlpërak të quajtur Natan; i cili, duke shpallur se ishte profeti i Sabatait, u tregua aq i sigurtë, sa të parashikonte se një vit pas datës 27 të K?slaut Mesia do të shfaqej para Zotërisë së Madh⁵¹ për të përgatitur ardhjen e tij. Kur mbërriti në Smirna, ai e shpalli hapur, përpara të gjithë hebrenjve, se është Mesia: Por [...] disa nga vetë populli i tij e kundërshtuan dhe e quajtën mashtrues; gjithsesi, ai vazhdoi më tej dhe deklaroi më pas se Zoti e kishte thirrur të vizitonte Kostandinopojën, ku do të kryhej edhe pjesa më e madhe e punës së tij. Por, sapo mbërriti ai, veziri⁵² mendoi ta mbyllte në një burg të keq, dhe më pas e dërgoi në Dardanele; ku hebrenjtë, nga skaje të ndryshme e të largëta të botës, vërshuan drejt tij të shumtë në numër, dhe ku ai pati kohë të hartonte metodën dhe kultin e tij të ri. Duke qenë se hebrenjtë po marroseshin gjithnjë e më shumë pas tij, dhe se Zotëria i Madh kishte dëgjuar për çmendurinë e

⁵¹ Term i përdorur nga europianët, që i referohej sulltanit osman, në atë kohë Mehmeti IV (1646-1687).

⁵² Fazil Ahmed Qypriili Pasha, vezir i madh, 1661-1676.

tij, urdhëroi që ta sillnin përpara tij, dhe sulltani, që nuk bindej pa një mrekulli, propozoi që Sabata të zhvishej lakuriq dhe të vihej si shënjestër para harkëtarëve të tij të zotë, dhe nëse shigjetat nuk do ta shponin trupin e tij, atëhere do ta besonte se ai ishte Mesia; por kur Sabata nuk e pranoi sfidën, iu desh të kthehej në muhamedan për të shpëtuar jetën e vet. Gjithsesi, shumica e hebrenjve pohonin se kjo nuk ishte e vërtetë, por vetëm se Hija e tij mbeti mbi dhe, dhe ecte me kokën e bardhë dhe sipas zakonisht muhamedan, ndërkohë që Trupi dhe Shpirti i tij shkuan në qiell, për të qëndruar derisa të vinte koha për përmbushjen e këtyre mrekullive; *Koçamët*⁵³ e Kostandinopojës e dënuan këtë besim si të mallkuar, dhe i ftuan ata të kthehen tek kultu i tyre i lashtë, duke i kërcënuar me dëbim nga feja e tyre.

Jones, II, f. 175-176.

❓ Nga se motivohej Sabbata Zevi? A besonte vërtet ai se ishte Mesia? Komentoni fundin e "karrierës" së tij: përse u konvertua ai në islam? Pse e ndiqnin hebrenjtë Sabbata Zevin? A ishte kjo lloj lëvizjeje tipike vetëm për hebrenjtë? A njihni ndonjë lëvizje të ngjashme mesianike në historinë e popullit tuaj? Analizoni mënyrën se si sulltani e trajtoi çështjen e Sabbata Zevit? Cili ishte qëllimi i tij? A ishte ai i suksesshëm?

► **Fig. 21. Doktor hebre – gravurë franceze (1568)**



Nicolay, f. 182.

❓ Si mendoni, përse piktori/udhëtari francez e quajti të rëndësishme që të paraqiste një doktor hebre? A kishte doktorë të besimeve të tjera fetare në Perandorinë Osmane? A ka ndonjë lidhje midis veshjes së doktorit hebre dhe statusit inferior të popullsisë jomuslimane, siç përmendet edhe në tekstet III-19 dhe III-20?

III.d. Bashkëjetesa dhe diskriminimi fetar

III-13. Dialogu fetar gjatë kohës që Gregori Palamasi u mbajt rob (1354)

Ai [imami] filloi të thoshte se ata [myslimanët] i pranojnë të gjithë profetët dhe Krishtin, dhe të katër librat që kanë zbritur nga Zoti⁵⁴, midis të cilëve njëri është Ungjilli i Krishtit. Dhe në përfundim, ai tha [...] "dhe ju, pse ju nuk e pranoni Profetin tonë dhe nuk besoni në Librin e tij, që gjithashtu ka zbritur nga qielli?". Unë iu përgjigja: "Si ju, ashtu edhe ne, kemi një zakon [...], të mos pranojmë dhe të mos

miratojmë asgjë si të vërtetë, pa pasur dëshmi për këtë [...] Krishti, përveç mrekullive të shumta e të mëdha që ka kryer, u njoftua se do të vinte nga vetë Moisiu dhe profetët e tjerë; dhe ai është i vetmi i të gjithë kohërave, që është shpallur, edhe nga vetë ju, si përçuesi i Fjalës së Zotit; i vetmi i të gjitha kohërave që ka lindur nga një virgjëreshë; dhe i vetmi i të gjitha kohërave, që u ngjit në parajsë dhe mbeti i pavdekshëm; dhe i vetmi i të gjitha kohërave, që ne shpresojmë se do të kthehet të gjykojë të gjallët dhe të vdekurit e ringjallur; - po them për të, vetëm

⁵³ Term i përdorur, për pleqësinë e komunitetit hebre.

⁵⁴ Pesëlibërshi, Psallmet, Dhiata e Re dhe Kurani.

atë që dhe ju turqit e pranoni. Prandaj ne besojmë në Krisht dhe në Ungjillin e tij. Por Muhametin nuk e kemi parë që të dëshmohej prej profetëve dhe ai nuk ka kryer ndonjë gjë të jashtëzakonshme ose të paharrueshme që duhet të na shtyjë të besojmë. Për këtë arsye, ne nuk besojmë tek ai dhe as në librin që vjen prej tij". Imami [*tassimani*] u trondit nga këto fjalë, por u mbrojti duke thënë: "Në ungjij ka patur gjëra të shkruara për Muhametin dhe ju i hoqët këto dëshmi. Për më tepër, duke u nisur nga thellësia e Lindjes, ai ka ardhur si fitimtar në Perëndim, siç mund ta shihni edhe vetë" [...]

"[...] Është e vërtetë se Muhameti, duke u nisur nga *Levanti*, vazhdoi si fitimtar në *Ponant*; por këtë e bëri nëpërmjet luftës, shpatës, plaçkitjes, shtypjes dhe vrasjeve; asnjëra prej tyre nuk vjen nga Zoti, që simbolizon mirësinë [...] A nuk u nis edhe Aleksandri nga Perëndimi për të nënshtruar, më në fund, të gjithë Lindjen? Dhe shumë të tjerë, në periudha të ndryshme, i kanë nisur ekspeditat e tyre dhe kanë sunduar në gjithë universin. Por asnjëri prej tyre populli nuk ua ka dhënë shpirtin e vet, ashtu si ia keni dhënë ju Muhametit. Për më tepër, ai [Muhameti], edhe pse përdori forcën, në të njëjtën kohë që predikonte kënaqësitë, ka zaptuar vetëm një pjesë të universit. Në të kundërt, mësimet e Krishtit, edhe pse mohonin pothuasje të gjitha ëmbëlsitë e jetës, janë përqafuar në të gjithë cepat e universit dhe kanë sunduar mes atyre që i luftonin ato; dhe këtë e bënë pa përdorur dhunë, por duke fituar gjithnjë ndaj dhunës që i kundërshtonte ato, pra, kemi të bëjmë me fitoren që ka mposhtur botën.

Në atë kohë, të krishterët që ishin atje, duke e ndjerë se zemërimi i turqve po shtohet, ma bënë me shenjë që ta prisja fjalën në mes. Por unë, për të sjellë pak qetësi, përsëri u thashë atyre duke buzëqeshur lehtas: "Nëse do të binim në një mendje për fjalët që themi, do të ndanim të njëjtin besim. Me mirëkuptim, le të kuptojmë domethënien e asaj që u tha". Dhe atëherë, njëri prej tyre tha: "Do të vijë ajo ditë kur të gjithë do të biem në një mendje".

Phillipidis-Braat, f. 154-157, 160-161.



Gjatë kohës që u mbajt rob nga osmanët (1354-1355), Gregori Palamasi (për hollësi shiko shënimin shpjegues në tekstin I-6) bëri një sërë diskutimesh teologjike me myslimanët dhe hebrenjtë, midis të cilëve njërin me nipin e Orhanit, Ismailin, dhe një tjetër me dijetarët e dërguar nga vetë Orhani. Në një letër drejtuar kongregacionit të tij në Selanik, ai kujton edhe një diskutim me një imam mysliman pranë *Nikeas*. Edhe pse Palamasi është i vendosur në argumentet që paraqet, rrëfimet e tij përfshijnë edhe shumë argumente të myslimanëve kundër besimit të krishterë; dhe në to, ai dëshmon për ndërlukeshmërinë e marrëdhënieve fetare në territoret e pushtuara nga osmanët.



Përse turqit osmanë diskutonin me aq zell çështjet fetare me një të burgosur?

Ç'mendim keni për argumentet e paraqitura në këto diskutime? A mund të përdoren këto argumente për të shpjeguar disa prej konvertimeve në islam që ndodhën gjatë pushtimit osman?

III-14. Bashkëjetesa e komuniteteve të ndryshme fetare në qytetet osmane (rreth vitit 1660)

[Beograd]

Në brigjet e lumit Sava ka tri lagje [*mëhalla*] arixhinjsh [*kibtî*], dhe në brigjet e lumit Danub ka tri lagje grekësh [*Rum*] të pafe, si edhe serbë dhe bullgarë që gjithashtu jetojnë në tri lagje. Ngjitur me fortesën ka një lagje hebrenjsh, nga ata që u përkasin shtatë komuniteteve të njohura si *hebrejtë karaim*. Ka edhe një lagje të pafesh armenë, por nuk ka lagje frëngjsh⁵⁵ ose hungarezësh, madje as edhe bajlozë ose konsuj të tyre. Gjithë të tjerat janë lagje myslimane; pra, familjet e ndjekësve të Muhametit zotërojnë pjesët më të mira, më të mëdha dhe më të ajrosura, të gjendura në vende të larta a të mesme të qytetit.

⁵⁵ Emër i përdorur zakonisht për njerëzit që vinin nga Europa Perëndimore, që përfshinte katolikët dhe protestantët.

[...] Gjenden gjithsej dyqind e shtatëmbëdhjetë⁵⁶ xhami [*mihra*], por [vetëm] xhamitë e sulltanit, nga të cilat mund të bëhen thirrjet e veçanta për lutjet e së premtes, si dhe xhamitë e vezirit dhe xhamitë e zotërinjve dhe fisnikëve vendas do të përshkruhen [më poshtë].

[...] Gjenden gjithsej nëntë kisha ose manastire, ku ata zhvillojnë ritet e tyre të liga. Ka edhe tempuj të grekëve, armenëve, serbëve, bullgarëve dhe hebrejve, por s'ka asnjë shtëpi adhurimi për frëngjit apo hungarezët.

[...] [Sarajeva]

Kishat – çdo kishë është e vogël, nuk ka kisha me këmbana. Kishat e të krishterëve serbë e latinë janë në kushte të mira. Frëngjtë e grekët gjithashtu i zhvillojnë rritualet e tyre fetare në këto kisha. Këtu gjendet edhe një sinagogë hebrejsh.

Evlija Çelebi, f. 195-198.



Krahasoni analizën që Evlija Çelebiu u bën kishave të krishtera në Sarajevë, me përshkrimin e kishave moldave nga Pal Alepoja (po në këtë kapitull, burimi III-7).

III-15. Marrëdhëniet midis ortodoksëve, katolikëve dhe luteranëve në Bullgari e Vllahi (1581)

Vizitori apostolik mbajti shënime, pasi dëgjoi disa fakte prej tregtarëve katolikë, për gjendjen e katolikëve në Bullgari e Vllahi. Më 11 mars 1581 vizitua Silistran dhe Provadian, të lejuar nga sundimtari ynë, nëpërmjet letrave të të shumëlvdëruarit imzot, [kardinal] i Komos. Më 5 dhjetor na u paraqitën tregtarët e Raguzës [...], që jetojnë në një vend pranë Danubit të quajtur Silistra dhe që nga vendasit thirret Deristor, dy ditë larg Varnës; toka quhet Dobrogea, në kohët e vjetra ishte Mëzia, gjuha është ajo bullgare ose ilirike. Nga ana tjetër e lumit qeveriset nga sulltani, dhe përballë këtij vendi shtrihet Vllahia, haraçpaguese e turqve. Bullgarët e përmendur më lart janë ortodoksë, ata kanë kisha, priftërinj e peshkopë. Ata thanë se

ka vetëm dhjetë familje katolike, [të cilat janë] me kombësi raguzane. Ata nuk kanë kisha as priftërinj të zellshëm, por së bashku me të tjerë që vijnë nga Provadia, kanë sjellë nga Raguzë, që ndodhet dy ditë larg nga Silistra, një burrë të quajtur at Nikolo Godini i Tivarit, një burrë me humanizëm të madh; ai shërben këtu për gjashtë muaj, me një pagesë prej 100 *talerësh*⁵⁷ në vit.

Ata pyetën, nëse mund të shkojnë në kishat ortodokse për t'u lutur dhe nderuar simbolet e tyre fetare, me gjithë përkushtimin e tyre; nëse u lejohet të marrin kungatën e shenjtë të pagëzimit dhe pendesës nga prifti ortodoks, nëse kanë nevojë, domethënë nëse po vdesin. Ata gjithashtu pyetën, nëse një i ri katolik që ka jetuar me një të re ortodokse, duke i premtuar asaj që të martohet me të dhe që të bëjnë fëmijë, mund ta ndryshojë premtimin e tij me një ndërgjegje të pastër. Gjithashtu thanë se, kur udhëtonin nëpër Danub drejt Transilvanisë, kishin parë shumë luteranë të kombësisë gjermane në Vllahi, të cilët gjithnjë përpiqeshin t'u flisnin për besimin e tyre dhe u jepnin libra mbi besimin e tyre të zvetnuar, falas [...] Silistra [është] në një largësi prej dy ditësh nga Provadia dhe shtrihet mbi Danub. Atje ka 1 500 shtëpi të krishterësh dhe paganësh. Ka tetë shtëpi katolikësh, me 40 persona, të gjithë tregtarë nga Raguzë, dhe tani kanë at Çelestinon si priftin e tyre, me një rrogë prej 2 000 *akçe* në vit; ata janë të krishterë të mirë [edhe pse] nuk kanë kishë; mesha zhvillohet në një dhomë. Atyre iu lejua të ndërtonin një shtëpi të vogël, që do të ishte kisha e tyre; nuk kanë veshje të tjera fetare, përveç asaj të priftit, i cili ka shërbyer këtu për tre vjet dhe për të cilin të gjithë flasin mirë; ai shërben gjashtë muaj këtu dhe gjashtë muajt e tjerë në *Manastirin e Tërgovishtes*.

Çalători, II, f. 504.



Ç'pyetje i bënë katolikët në Bullgari e Vllahi vizitorit apostolik? Ç'loj vështirësish praktike paraqiten nga ato pyetje? Përpiquni të gjeni se si mund të jetë përgjigjur vizitori apostolik.

⁵⁶ Si shumë nga shifrat e tjera në rrëfimet e Evlija Çelebisë, edhe kjo shifër është me siguri e ekzagjeruar.

⁵⁷ Monedha të mëdha argjendi, që vinin nga Europa Qendrore ose Perëndimore.

III-16. Fetvaja e Ebus-Suudit për shiitët myslimanë (mesi i shekullit të 16-të)

Pyetje: Sipas Ligjit të Shenjtë [*shariatit*], a është e drejtë të luftosh kundër pasuesve të Sefevidëve⁵⁸? Personi që i vret ata, a është luftëtar i shenjtë; dhe personi që vdes në duart e tyre, a është martir? Përgjigje: Po, është luftë e madhe dhe e shenjtë dhe sakrificë e lavdishme.

Pyetje: Duke besuar se është diçka e drejtë të luftosh kundër tyre, kjo thjesht për shkak të rebelimit dhe armiqësisë së tyre me sulltanin [osman] e popullit islam, meqë ata e drejtuan shpatën kundër trupave të islamit, apo për çfarë? Përgjigje: Nga shumë këndvështrime, ata janë edhe rebelë, edhe të pafe. Imber, f. 86.



Ebus-Suudi (rreth 1490-1574) ishte dijetar shumë i respektuar prej Sulejmanit; ai mbajti postin e kryekëshilltarit ligjor [*şeyh-ül-Islam*] për pothuaj tre dhjetëvjeçarë. Vendimet e tij [*fetva*] patën ndikim afatgjatë në shoqërinë osmane.



Ç'tregojnë këto vendime për kufijtë e solidaritetit mysliman?

Krahasoni qëndrimin e osmanëve kundrejt myslimanëve shiitë, me luftërat e shekullit të 16-të midis katolikëve dhe protestantëve.

III-17. Urdhri perandorak që ndalon punën për konvertimin “frëng” mes armenëve të Anatólisë Lindore (1722)

Patriarku armen i Stambollit, i quajtur *Ohanes* dhe vartësit e tij i kanë kërkuar Portës sime Perandorake lëshimin e urdhrave për parandalimin e herezisë rituale frënge që po ndodh tani ndër armenët e Erzurumit, Dijarbakirit dhe Tokatit. Gjërat do të qetësohen dhe rendi do të vendoset, edhe pse disa priftërinj frëngj, të maskuar si mjekë ose diçka tjetër, banojnë atje dhe përzihen me të pasurit dhe fisnikët. Pa e ditur, fisnikët i marrin ata për mjekë

dhe i ndihmojnë në të gjitha orvatjet e tyre. Pra, sipas patriarkut, priftërinjtë frëngj punojnë pa u ndalur për të provokuar armenët vendas dhe për t'u prishur mendjen që të konvertohen në ritin frëng. Ai kërkoi që frëngjtë të mos lejohen të qëndrojnë atje, me pretendimin se janë mjekë ose me ndonjë justifikim tjetër. Gjithashtu, nënshtetasit e varfër duhet të mbrohen kundër provokimeve të tyre dhe të lihen të qetë. Për këtë arsye, lëshohet *Fermani Perandorak* në përgjigje të kësaj kërkesë.

BOA, CA 3126



Ç'mendim keni për faktin se si patriarku armen Ohannes, ashtu dhe sulltani i etiketojnë të gjithë perëndimorët si “frëngj”, dhe nuk u kushtojnë rëndësi emërtimeve të ndryshme të përfshira në “herezinë rituale frënge”?

III-18. Autoritetet osmane në Bosnjë gjykojnë një çështje midis ortodoksëve dhe katolikëve (1760)

Pasi e shqyrtuam këtë situatë shumë të vështirë, më në fund, me anë të një ndërmjetësi, i dërguam fjalë zëvendëspashait [*qehaja beut*] se donim ta takonim. Ai na lejoi që ta takonim, kështu që dekani dhe tutori ynë i ri nga *Manastiri i Fojnicës* u nisën për në shtëpinë e tij. Nga ai, midis të tjerave, ata dëgjuan në fund këto fjalë: “Nëse doni ta fitoni këtë gjyq, para së gjithash hidhni njëzet qese me para në thesarin e shtetit” (domethënë, rreth 2 600 monedha të arta venedikase).

Pra, e kuptuam se përpjekjet tona gjithsesi do të dështonin, nëse nuk i jepnim atij këtë shumë të stërmadhe parash.

Për rrjedhojë, para se të përballëshim me kundërshtarët tanë në gjykatë, u takuam me pashanë dhe zëvendësin e tij. Për shkak të nevojës për t'u mbrojtur, u premtuam se do t'u jepnim gjithçka, vetëm që ata të qetësoheshin dhe të na siguronin mbrojtjen e tyre. Nga ana tjetër, udhëheqësit grekë⁵⁹ i kanë ofruar shuma të mëdha

⁵⁸ Dinastia Sefevide sundoi në Persi prej vitit 1502 deri më 1736, duke imponuar një formë të skajshme të islamit shiit, që në shekullin e 16-të ishte shumë e përhapur tek shumë nënshtetas osmanë nga Anatólia.

⁵⁹ Ortodoksë.

po këtij pashai, shumë më tepër se ne, që të marrë vendim në dobi të tyre, në bazë të fermanit [dekret osman] që ata kanë. Duke mos pasur shumë para, ne morën kredi nga thesari i shtetit.

Në fillim gjykatësi lexoi dokumentet e kundërshtarëve tanë dhe u analizua përmbajtja e tyre. Pas kësaj, gjykatësi e pyeti mitropolitin grek (ai ishte atje së bashku me patriarkun) se çfarë kërkonte në të vërtetë nga ky proces. Ai u përgjigj: "U kërkoi këtyre vëllazërive t'i binden këtij dekreti [fermani] të lëshuar nga sulltani ynë i lartë dhe që ju sapo e lexuat." Më pas gjykatësi na pyeti: "Cila është arsyeja që ju nuk u bindeni kundërshtarëve tuaj?" Dekani ynë u përgjigj në këtë mënyrë: "U bënë më shumë se treqind vjet që kur sulltani i lartë, Mehmeti, pushtoi Bosnjën dhe ne asnjëherë s'kemi pasur ndonjë gjë të përbashkët me grekët, sepse ata kanë një fe dhe ne një tjetër, gjë që mund të shihet fare qartë në këtë *hatisherif* [një tjetër dekret osman] dhe në dokumente e dekrete të tjera të lëshuara nga sulltanë mëshirëplotë. Që nga ajo kohë e deri më sot, ne gjithnjë kemi qenë të lirë në fenë tonë latine". Pasi e dëgjoi këtë, gjykatësi dha menjëherë vendimin: "Patriarku dhe mitropoliti nuk kanë asnjë të drejtë mbi ju, mbi vëllazëritë dhe katolikët. Ata nuk mund dhe nuk duhet të guxojnë të kërkojnë para taksash apo ndonjë gjë tjetër prej jush, sepse fermani nuk mund të jetë më i lartë se *hatisherifi*". Dhe kështu përfundoi ky gjyq. Mitropoliti u turpërua (Zoti e deshi të ndodhte kështu). Mor vëlla, pa para, s'bën dot marrëveshje me turqit!

Benic, f. 187-190.

? Krahasoni këtë tekst me burimin e mëparshëm mbi herezinë rituale frënge: në të dyja rastet, autoritetet osmane pothuaj nuk i kuptonin fare veçoritë e besimit të krishterë. Mendoni se e kishin po aq të vështirë të dallonin edhe degët e ndryshme të islamit? (E njëjta pyetje mund të bëhet për ndjeshmërinë e autoriteteve të krishtera kundrejt llojeve të ndryshme të islamit). Cilat ishin marrëdhëniet midis dy kishave të krishtera në Bosnjë? Cilët respektonin më shumë ata: autoritetet osmane apo kishat e krishtera "të afërme"? Cilat ishin vërejtjet e shkrimtarit ndaj autoriteteve osmane dhe ndaj Kishës Ortodokse?

III-19. Kufizime perandorake për jomyslimanët (1631)

Sipas Ligjit të Shenjtë [*shariatit*] dhe ligjit tonë, të krishterët [*qafirët*] duhet të dallohen nga rrobat dhe pamja e tyre, si të një rangu më të ulët se ne. Atyre nuk u lejohet të ngasin kuaj, të veshin rroba mëndafshi a sateni, ose të veshin xhaketa dhe kapele gëzofi. Nuk lejohet që gratë e tyre të veshin rroba të ngjashme me ato të grave myslimane ose të veshin *jashmakë* prej cope persiane. Gjithsesi, qysh prej disa kohësh, me lejen e gjykatësve, ky ligj nuk është zbatuar dhe të krishterët e hebrenjtë kanë filluar të vishen me rroba luksoze e të shtrenjta. Përsa u përket grave të tyre, ato nuk zbresin nga trotuari t'u lirojnë rrugën grave myslimane që takojnë në treg. Në tërësi, burrat dhe gratë vishen më mirë se myslimanët, çka tregon se ata nuk e quajnë veten më poshtë se ne. Pra, është tepër e domosdoshme që të jepen edhe një herë këta urdhra dhe të sigurohet që t'u binden atyre.

Georgieva, Tzanev, f. 121.

? Pse ishin kaq të ashpra kufizimet për popullsinë jomyslimane? Dhe pse nuk u bindeshin të krishterët këtyre kufizimeve? A mendoni se kufizime të tilla mund të zbatohen plotësisht në vende ku ka disa besime fetare?

III-20. Ekzekutimi i një ortodoksi që vishte rroba të papërshtatshme (1785/1789)

Po ashtu, në datën 21 të muajit [Muharrem] të lartpërmendur, kur padroni ynë i lavdishëm [sulltani Abdulhamid I] po udhëtonte i maskuar që të mos njihej, pa një të pafe grek. Greku kishte veshur këpucë të verdha, një kaftan me lule, një mantel të gjatë dhe një pallto gëzofi me vija si edhe një shall. Ai [sulltani] thirri xhelatin. Greku duhej të varej, por sulltani urdhëroi që t'i pritej koka.

Taylesanizade, f. 419.

? Krahasoni tekstet III-19 dhe III-20. Ç'krime kishte bërë greku që u ekzekutua?

III-21. Urdhri perandorak për një kishë të ndërtuar pa leje në Stanimaka, afër Plovdivit (1624)

Në letrën e tij, guvernatori i fshatit vakëf Stanimaka na njoftoi se të krishterët në këtë fshat kanë ndërtuar një kishë të re të madhe, të zbukuruar me mermer dhe zbukurime të tjera, në kundërshtim me Ligjin e Shenjtë.

Guvernatori është përpjekur t'ua përgjigjet ankesave të myslimanëve, pa pasur sukses dhe tani po kërkon që të lëshohet një urdhër mbretëror për të prishur kishën në fjalë, duke qenë se prishja e saj është në përputhje me përmbajtjen e ligjeve fetare të vendit. Pra, unë urdhëroj që, sapo të merrni këtë dokument, të hetoni këtë çështje dhe të prishni kishën e sapondërtuar, nëse është vërtet e re; dhe jo një që ka ekzistuar për një kohë të gjatë. Gjithashtu ju urdhëroj që të mos lejoni askënd ta kundërshtojë ose të mos i bindet Ligjit të Shenjtë dhe urdhrin Tim si Sulltan.

Georgieva, Tzanev, f. 120-121.



Cilat ishin argumentet e përdorura për të shkatërruar kishën në Stanimaka?

III-22. Mungesa e tolerancës së të krishterëve ndaj njerëzve që jetonin si çifte ndër-fetare (Qipro, 1636)

Milu, i biri i Andonit, në fshatin Çelije të krahinës së Tuzlës, thotë: Deri tani, ashtu si edhe paraardhësit e mi, unë kam qenë pjesë e komunitetit të krishterë [*millet*]. Nuk jam bërë mysliman. Jam i pafe [*qafir*]. Kur desha të kryej ritet tona në kishë, murgjit që ishin priftërinjtë tanë, më ndaluan të hyja duke thënë "Je martuar me një myslimane". Ka të ngjarë që kur të vdes, ata nuk do të më varrosin sipas riteve të të pafeve. Dua një vërtetim që tregon se unë jam i pafe.

Jennings, f. 142.



Përse murgjit e krishterë e ndaluan Milun të futej në kishë dhe nuk pranuan ta kungonin? Si mendoni, çfarë arsyes kishin ata për të mbajtur këtë qëndrim? A ishte i justifikuar veprimi i tyre? Kini parasysh se ligji mysliman i ndalonte gratë myslimane të martoheshin me një burrë që s'ishte mysliman, ndërkohë që ligji kanonik ortodoks i mohon komunionin një të krishteri ortodoks që martohet me një jo të krishterë.

III-23. Rregullat fetare në Transilvani (1653)

[Pjesa I, pika I]

Neni 2. Sipas vendimeve të këtij vendi, katër fetë zyrtare, qysh tani e në vazhdim duhet të mbahen si zyrtare përjetë... këto fe zyrtare janë: evangjelizmi i reformuar (në gjuhën e përditshme- kalvinizmi), luteranizmi ose augustianizmi, katolicizmi, unitarizmi ose antitrinitarizmi; atyre u garantohet që tani e në vazhdim praktikimi i lirë në vendet e caktuara dhe në përputhje me ligjet e këtij vendi [...]

Neni 3. Në lidhje me çështjet e besimit dhe fesë, përveç katër feve zyrtare, asnjë person privat i cilitdo statusi dhe asnjë grup nuk duhet të guxojë të bëjë ndonjë ndryshim ose ndarje të re, sepse dënohet si i pafe [...]

Neni 4. Judaizmi, duke filluar që nga kohët e vjetra, jo vetëm që nuk është llogaritur mes katër feve zyrtare, por përkundrazi, është i ndaluar nga ligjet publike të vendit, kundrejt parashikimit të një dënimi shumë të rëndë; edhe më parë, ata që gjendeshin fajtorë për praktikimin e tij, janë dënuar sipas ligjeve; prandaj u vendos që të dënohen gjithmonë ashtu si dhe më parë [...]

Neni 8. U vendos që askush nuk do të lejohet të detyrojë një komunitet, shërbyesit, njerëzit e shtëpisë së tij ose cilindo që ka nën urdhra, që të bashkohet me fenë e tij nëpërmjet dhunës ose kërcënimit për dhunë; po ashtu, nuk duhet që feudali i një besimi tjetër të pushtojë kishën e fshatit ose qytetit, ose t'i lejojë priftërinjtë e fesë së tij të kryejnë meshën e shenjtë, kur ka dëshirë: e dënueshme me gjobë prej 200 florinjsh⁶⁰ [...] [pika 8]

⁶⁰ Si fillim ishte një monedhë floriri, e përdorur në Mbretërinë e Hungarisë, sipas modelit të monedhave të Firences. Gjithsesi, teksti nuk i referohet kësaj monedhe, por vetëm njësisë monetare të përdorur në Mbretërinë e Hungarisë dhe në Principatën e Transilvanisë në atë kohë.

Neni 1. [...] populli i Vllahisë nuk është klasifikuar në këtë vend as midis shtresave të privileguara dhe as midis feve. Ata që nuk janë përfshirë midis feve zyrtare [...], janë toleruar [...] për të mirën e vendit.

Constituțiile, f. 47, 49, 50, 58.



Kushtetutat e Miratuara (*Constitutiones Approbatae*) u miratuan nga Kuvendi i Principatës së Transilvanisë gjatë mbretërimit të George Rakoshit II (1648-1660). Në fakt, këto kushtetuta ishin një përmbledhje e rregullave që kishin qenë në fuqi në principatën e Transilvanisë që prej shekullit të 16-të, dhe nganjëherë edhe më herët. Vini re se diskriminimi prekte jo vetëm pakicat e vogla, por edhe vllahët ortodoksë, që përbënin shumicën e popullsisë në principatën e Transilvanisë. Neni 4 nuk u referohet hebrenjve, por një grupi të vogël disident të krishterësh “judistë” (sabatarianët, të shkëputur nga unitarianët e njohur ligjërisht).



A kishte liri fetare për të gjithë banorët e Transilvanisë në atë kohë? Argumentoni duke mbajtur qëndrim në mbështetje dhe më tej kundër organizimit fetar që ekzistonte në Transilvaninë e shekullit të 17-të.

III-24. Vendim antihebre i sinodit peshkopal të Stonit, në Raguzë (1685)

Ndjekësit e djallit, ata që kryqëzuan Krishtin, armiqtë e emrit të krishterë, grabitësit, ata që bëjnë magjira, ata që thithin gjak njerëzish, si të ishin gjarpërinj helmues, ata filluan të mblidheshin në këtë peshkopatë nja dy vjet më parë. Me përlulje, ne lutemi për drejtësinë e Zotit që t’i shkatërrojë të gjithë, duke qenë se ai është gjykatësi i drejtë, lart në retë qiellore. Përsa u përket atyre mbi të cilët kemi pushtet, ne i urdhërojmë të gjithë njerëzit nën kujdesin tonë, të mos guxojnë të ndajnë të njëjtën banesë me hebrenjtë, as të mos u shërbejnë atyre pa leje të shkruar nga ne; përndryshe kërcënohen me shkishërim. Bijtë e mi, as mos u flisni atyre, përveçse kur bëni tregti apo kur jeni të detyruar të keni kontakte të nevojshme e të pashmangshme. Mbani mend se ata janë armiqtë e kryqit të Krishtit

dhe tuajtë; duke qenë se ju jeni ndjekës të Krishtit, largojini ndjekësit e djallit.

Stulli, f. 31.



Ç’akuza u bënë kundër hebrenjve? Ç’kufizime u përpoqën të vënë për ta peshkopët?

III-25. Privilegj për një hebre në Raguzë (1735)

[...] Simoni, i biri i Vital Vitalit, është nënshtetas i vërtetë dhe i ndershëm i kësaj Republike dhe për këtë arsye, ai ka të gjitha privilegjet dhe respektin e të gjithë nënshtetasve të tjerë dhe ne i urojmë që të gëzojë gjithë respektin që gëzojnë nënshtetasit tanë në mbarë botën.

Stulli, f. 41.



Krahasoni këtë privilegj, me burimin III-24. Cilat mund të kenë qenë arsyet për një qëndrim kaq të ndryshëm nga ana e autoriteteve civile?

III-26. Martirizimi i Shën Kiranas në Selanik (1751)

Kjo është ajo çka jeniçerët bënë gjatë ditës. Gjatë natës, rojtari i burgut e varte nga squetullat, edhe pse duart ia kishin lidhur me zinxhirë. Ai merrte ndonjë copë druri dhe e godiste pa mëshirë derisa të lodhej, dhe e linte të varur në të ftohtin e dimrit, sepse dimër ishte në atë kohë. Një i krishterë e pa gjithë këtë skenë, priti për çastin e duhur dhe, kur e kuptoi se vrulli i zemërimit të rojtarit të burgut kishte kaluar, shkoi dhe i kërkoi atij leje që ta ulte poshtë. Gruaja e shenjtë kishte kaq durim, qetësi dhe heshtje, sa dukej sikur nuk ishte ajo që vuante, por dikush tjetër; dhe i gjithë shpirti dhe vëmendja e saj ishin në qiell. Kishte dhe të krishterë të tjerë në burg, dhe hebrenj dhe disa gra turke, pasi kishin kryer akte të turpshme, edhe ato i thoshin rojtarit të burgut që i mungonte mëshira, dhe frika ndaj Zotit, sepse po torturonte një grua, e cila nuk i kishte bërë asgjë të keqe. Por ai, i krishteri,

asnjëherë s'reshti së kujtuari rojes gjykimin e Zotit (duke qenë se nuk kishte frikë prej tij) [...]; ai po i thoshte të gjitha këto që ta zbuste dhe ta ndalonte së shkaktuari vuajtje Gruas së Shenjtë. Por Satanai e kishte kthyer zemrën e tij në gur dhe pavarësisht sa shumë iu lutën ata, ai e torturoi atë edhe më shumë. Jeniçerët që e torturonin atë, herë pas here u përpoqën ta ushqenin në mënyrë që ajo të mos vdiste. Nganjëherë i jepnin rrush të thatë dhe nganjëherë hurma Arabie. Gjithsesi, shenjtorja nuk pranonte të hante, kështu që ata u përpoqën t'ia hapnin gojën me zor, por nuk ia arritën.

Synaxaristis, f. 336-337.



Kirana, një vajzë e re nga një fshat i quajtur Avusoka, afër Selanikut, i shpërfilli përpjekjet e një jeniçeri për ta joshur atë. Për të thyer qëndresën e saj, jeniçerët e burgosën dhe e torturuan. Pas një greve urie, ajo vdiq në burgun e Selanikut, më 28 shkurt.



Si e krishterë, a ishte Kirana më e rrezikuar nga abuzimi i jeniçerit sesa një vajzë myslimane?

Si mendoni, përse të burgosurit e tjerë u përpoqën ta ndihmojnë Kiranën? A ishin dallimet fetare pengesë në këtë aspekt? A dini ndonjë shembull tjetër solidariteti njerëzor përtej kufijve fetarë? Pse zgjodhi Kirana të hynte në grevë urie?

► **Fig. 22. Miniaturë osmane që paraqet ngritjen në qiell të Krishtit (1583)**



Nicolay, f. 182.



Si paraqitet Krishti në këtë miniaturë osmane? Përse? A keni parë ndonjëherë se si e paraqesin të krishterët ngritjen e Krishtit në qiell? Ç'mendoni për ngjashmëritë dhe ndryshimet?

Pyetje të përgjithshme mbi kapitullin III d

Komentoni në lidhje me ndërthurjen e tolerancës dhe diskriminimit fetar në botën e fillimit të kohës së re. Krahasoni gjendjen në Perandorinë Osmane, në Transilvani dhe në Raguzë. Si është kjo gjendje, krahasuar me botën moderne?

KAPITULLI IV:

Ndarjet shoqërore dhe jeta e përditshme

Ideologjia osmane i përkufizonte grupet shoqërore sipas marrëdhënies së tyre me shtetin. Ndarja bazë ishte ajo në grupet sunduese dhe “grigjën” e nënshtetasve të zakonshëm. Në grupet sunduese përfshiheshin ushtarakët [asqerët], dijetarët [ulematë] dhe nëpunësit [qatipët]. Të gjithë këta i shërbenin sulltanit nëpërmjet veprimtarive të tyre specifike, dhe për këtë ishin të përjashtuar nga pagimi i taksave. Në përgjithësi ata ishin myslimanë, por ka shembuj të dokumentuar, kur disa nga ushtarakët dhe nëpunësit nuk ishin myslimanë. “Grigja” [raja] përfshinte shumicën e popullsisë, myslimanë dhe jo-myslimanë, fshatarë dhe qytetarë. Tipari kryesor i përbashkët i tyre ishte fakti se ata duhet të paguanin taksat.

Shtresëzimi i vërtetë shoqëror ishte më kompleks. Ndarjet fetare e profesionale, vendndodhja dhe etnia, si edhe gjinia, mosha dhe shpërndarja e pabarabartë e pasurisë u jepnin formë dallimeve brenda grupeve të ndryshme shoqërore. Përshkrimi i modeleve shoqërore osmane hedh vetëm pak dritë në këtë larmi, pa qenë në gjendje të na tregojë tablonë e plotë.

Megjithatë, qëllimi i këtij kapitulli nuk është të përshkruajë një shtresëzim statik shoqëror, por të hedhë dritë në aspektet e jetës së përditshme dhe ndërveprimit njerëzor. Vëmendje e posaçme u është kushtuar formave të veçanta të ndërveprimit në zonat kufitare, ku ndërthureshin luftërat e egra me zakonet e përbashkëta dhe ndihmën që i jepej njëri-tjetrit. Pjesa e fundit i kushtohet rolit të grave. Gjatë asaj periudhe, si edhe sot, gratë përbënin gjysmën e popullsisë. Megjithatë, në të dyja mjediset shoqërore, myslimane e jomyslimane, gratë konsideroheshin si të nënshtuara ndaj burrave, dhe në përgjithësi, të përjashtuara nga sfera publike. Pra, burimet për historinë e grave janë më të pakta se rëndësia e tyre e vërtetë historike. Në fakt, ishin gratë ato që lindën fëmijë dhe i edukuan, dhe shumica e shtëpive drejtoheshin praktikisht nga gratë. Burimet e përfshira në këtë kapitull dokumentojnë diskriminimin ndaj grave dhe metodat e përdorura nga gratë për t’u fuqizuar.

IVa. Elitat dhe populli i thjeshtë

IV-1. Elita osmane i përbuz fshatarët turq

Një ditë, dy turq po flisnin me njëri-tjetrin, Duke përdorur fjalë të papërshtatshme në bisedën e tyre.

Njëri prej tyre pyet: “Çfarë ndodh nëse bëhesh zot?

Bëhesh një njeri i madh.

Çfarë do të haje më shumë në vaktet e tua, o vëlla?

Supë, mishra të shijshëm ose pulë?”

Tjetri thotë: “Do të haja bukë të butë dhe qepë të njoma. Kjo është më e mira.”

“Po ti? Çfarë do të parapëlqejë nëse do të bëheshe zot, Po të të jepej mundësia?”

Ai thotë: “Çfarë ka për të ngrënë?

Ti s’le asgjë për mua

S’ka asnjë ushqim më të mirë sesa ajo që deshe ti!”

Këta turqit janë popull i çuditshëm, Ata nuk arrijnë të dallojnë të mirën nga e keqja.

Gojët e tyre nuk e vlerësojnë shijen e mirë, Bisedën e tyre nuk ia vlen ta përsërisësh.

Guvahi, f. 167-168.



Pendname ishte një përmbledhje letrare popullore e vjetër persiane, e rishkruar dhe e pasuruar nga Gyvahi me materiale të reja, gjatë gjysmës së parë të shekullit të 16-të. Teksti ilustron faktin që anëtarët e elitave osmane e përdornin termin “turq” jo për veten e tyre, por për fshatarët anatolianë “të paqytetëruar”.



Cilat janë argumentet e poetit kundër “popullit turk”? A dini ndonjë shembull të ngjashëm nga historia juaj që lidhet me përbuzjen e elitave ndaj njerëzve të thjeshtë?

Tipat shoqërorë osmanë

► Fig. 23. Akinxhiu



Inalcik 1973, fig. 26.

Akinxhi: Kalorës “sulmues”, vullnetar, me origjinë turke ose joturke, që sulmonte territore armike për të plaçkitur. Gjatë shekujve XIV-XVI, *akinxhinjtë* ishin shumë të rëndësishëm për zgjerimin territorial osman. Në Europën Juglindore u vendosën katër grupe kryesore *akinxhinjsh*, që udhëhiqeshin nga trashëgimtarë të fiseve Mihaloglu, Malkoçoğlu, Turahanoglu dhe Evrenozoglu.

► Fig. 24. Spahiu



Hegyí, Zimanyi, f. 55, fig. 51.

Spahi: “Kalorës”, që luftonte në ushtrinë osmane, në këmbim të një çifligu fitimprurës [*timari* ose *ziameti*]. Në përgjithësi, *spahinjtë* rekrutoheshin nga djemtë e ushtarakëve; megjithatë, sulltani mund t’u jepte çifligje edhe njerëzve të tjerë që shquheshin për shërbimet e tyre. *Spahinjtë* shërbenin në njësitë e provincave të udhëhequra nga guvernatorët lokalë, zakonisht nga prilli në tetor, dhe më pas ktheheshin në çifligjet e tyre për të marrë fitimet e caktuara për ta.

► Fig. 25. Jeniçeri



Nicolay, f. 159.

Jeniçer: "Ushtar në ushtrinë e re", njësi këmbësorësh me trupa të zgjedhur osmanë, që u themelua në shekullin e 14-të. Deri në shekullin e 17-të, jeniçerët merreshin nga robërit e luftës ose nga *grumbullimi* [*devshirme*] i djemve jomyslimanë nga provincat osmane. Ktheheshin në islam dhe mbaheshin si skllevër të sulltanit, por merrnin pagesë të rregullt. Ata shërbenin në kryeqytet ose në fushatat e drejtuara nga sulltani. Gjatë shekujve XVI – XIX, duke qenë se numri i tyre u shtua, ata u vendosën jo vetëm në Stamboll, por edhe në qytetet provinciale. Ata merreshin me tregti dhe me punë zejtarie, mund të martoheshin dhe ua linin trashëgim pronat dhe statusin fëmijëve të tyre.

► Fig. 26. Ushtarë në Shqipëri – pikturë nga Zhan-Baptist Hiler (1809)



Levend: "ushtar me pagesë", i punësuar nga shteti ose nga guvernatorët e provincave për fushata të veçanta. Të rekrutuar nga shtresa të ndryshme shoqërore, *levendët* i përdornin shumë armët e zjarrit dhe u bënë tepër të rëndësishëm në shekujt e 17-të dhe 18-të, duke treguar se ishin ushtarë më të efektshëm se trupat e spahinjve a të jeniçerëve, tashmë të vjetruara. Ndonjëherë *levendët* bashkoheshin me ushtri armike dhe plaçkitnin provincat osmane.

► Fig. 27. Shejh-ul-Islami



Hegy, Zimanyi, f. 39, fig. 31.

'Alim: "Dijetar"; në shumë *ulema*. *Ulematë* ishin burra myslimanë, të shkolluar në shkollat fetare [*medrese*]. Pas diplomimit, ata mund të bëheshin drejtues të ritualit të lutjeve publike në xhami (*imamë*), mësues (*hoxhë*), pedagogë në medrese [*myderrizë*], gjykatës [*kadinj*] ose këshilltarë ligjorë [*myftinj*]. Postet më të larta për *ulematë* ishin ato të gjykatësve ushtarakë [*kadi-'asqer*] të Rumelisë a Anatólisë dhe kryekëshilltarë ligjorë të Perandorisë [*shejh-ül-Islam*]; por *ulematë* mund të emëroheshin edhe në poste të tjera, përfshirë dhe atë të vezirit të madh.

► Fig. 28. Nëpunës a shkruës osman i rangut të lartë



Hegyi, Zimanyi, fig. me ngjyra 121.

Qatip: "Shkruës", anëtar i burokracisë osmane. Të rekrutuar nga shtresa të ndryshme shoqërore, ata shërbenin në fillim si ndihmës dhe më pas si sekretarë në kancelarinë perandorake dhe në zyrat e financave. Deri në mesin e shekullit të 16-të kishte

më pak se njëqind të tillë, por u shtuan në numër më vonë, për shkak të zgjerimit të zyrave burokratike në nivel qendror e provincë. Edhe pse rrallëherë emëroheshin në poste të larta, qatipët kishin shumë ndikim në Perandorinë Osmane.

► Fig. 29. Tregtar arab



Nicolay, f. 223.


► Fig. 30. Tregtar nga Ragusa



Nicolay, f. 242.

Tregtar: Tregtarët osmanë e mësonin tregtinë nga familjet e tyre ose duke shërbyer te tregtarët e vjetër dhe merreshin si me tregtinë në largësi të mëdha, ashtu dhe me atë me pakicë. Gjatë udhëtimeve të punës, gratë drejtonin shtëpinë. Edhe pse zyrtarisht konsideroheshin si nënshtetas të thjeshtë [*raja*], tregtarët dalloheshin nga pasuria e tyre, niveli i lartë i jetesës, njohuria e gjerë, përvoja dhe aftësia. Si tregtarët myslimanë edhe ata jomyslimanë, shpesh herë mbështesnin institucionet fetare dhe zhvillimin e kulturës.

► Fig. 31. Rrobaqepës osman



Hegy, Zimanyi, fig. me ngjyra 133.

Zejtari: Ndërkohë që edhe një pjesë e fshatarëve bënë punë zejtarie, një numër i madh zejtarësh të specializuar e nxirrnin jetesën e tyre duke punuar nëpër qytetet osmane. Shkallë-shkallë zejtarët që zotëronin punishtet e veta u organizuan në esnafë [*sinif*, shumë *esnaf*], institucion që rregullonte mundësinë për të marrë një profesion, prodhimin dhe shpërndarjen. Në përgjithësi, që të bëhej usta [usta], së pari një person duhet të bëhej *çirak* [çirak] dhe më pas ndihmës [*kalfa*].

► Fig. 32. Bariu



Hegyi, Zimanyi, fig. me ngjyra 130.

Fshatar: Shumica e fshatarëve osmanë, qoftë myslimanë a të krishterë, e fitonin bukën e gojës nëpërmjet bujqësisë dhe blegtorisë. Ata gëzonin pronësinë mbi shtëpitë e tyre dhe mbi pronat e

tundshme, por u duhej të zbatonin rregullat e vendosura nga komuniteti i fshatit, çifligari dhe shteti. Jeta e fshatarëve ishte e rënduar sepse duhej të paguanin taksat dhe u mungonte siguria. Edhe pse ishin të lirë t'u drejtoheshin gjykatave të *kadive*, shumica e fshatarëve parapëlqente t'i zgjidhte konfliktet me ndihmën e pleqësisë dhe priftërinjve të fshatit.

► Fig. 33. Peshkatari



Hegyi, Zimanyi, fig. me ngjyra 138.

Detar: Osmanët përdornin lloje të shumta anijesh me rrema dhe me vela, edhe për luftë, edhe për tregti ose peshkim. Shumica e detarëve osmanë vinin nga ishujt ose rajonet bregdetare me traditë detare dhe punonin kundrejt një page që u jepej nga pronarët e anijeve ose nga flota; të huajt ishin gjithashtu të mirëpritur në flotë. Anijet me rrema përdornin edhe sklevërit ose të dënuarit dhe në rast lufte, autoritetet përdornin rremtarë nga provincat e thella. Detarët osmanë lundronin kryq e tërthor nëpër Mesdhe, si edhe në Detin e Zi e Detin e Kuq. Madje ata lundronin deri në Indonezi ose Afrikën Lindore, por, përgjithësisht, nuk u eci mbarë në Oqeanin Indian.

► Fig. 34. Dervishi



Hegyi, Zimanyi, fig. me ngjyra 69.

Dervish: Anëtar i pranuar me ceremoni në një vëllazëri fetare myslimane (e urdhrit *sufi*). Për t'u bërë dervish, një mysliman duhet, së pari, t'i nënshtrohet një procesi përgatitor, që përfshinte ushtrime mistike dhe meditim asketik. Dervishët mund të jetonin në komunitet, ose udhëtonin dhe ushtronin praktikatat e tyre fetare në fshat dhe në qytet. Njerëzit besonin se praktikatat e dervishëve ishin të dobishme, sepse lejonin që fuqia e Qiellit të zbriste në Tokë. Dervishët kishin shumë ndikim në shoqërinë myslimane, kanë kontribuar shumë në poezinë, muzikën dhe vallëzimet osmane, por ndonjëherë kanë qenë edhe zëra kritikë për autoritetet osmane.

► Fig. 35. Murg armen



Hegyi, Zimanyi, fig. me ngjyra 74.

Murg: Ortodoks ose i krishterë katolik, që vendoste të "braktiste botën" dhe të jetonte sipas shembullit të Krishtit. Për t'u bërë prift, në fillim duhet të hyje rishtar në një manastir, dhe më pas të bëje betimin e bindjes, varfërisë dhe virgjërisë. Zakonisht murgjit jetonin në manastire, por disa mund të veçoheshin në zona të thella. Shumica e murgjve ishin burra, por kishte edhe manastire për gra. Përveç meditimit dhe lutjes, murgjit gjithashtu përfshiheshin edhe në mbajtjen e manastirit dhe në veprimtaritë kulturore.

► **Fig. 36. Patriarku ortodoks i Kostandinopojës**



Asdrachas, fig. 3.

Prift: Burrë i shuguruar për të ushtruar shërbimin e shenjtë në komunitetet e krishtera. Sipas ligjeve fetare, priftërinjtë duhet të njihnin Biblën dhe të shuguroheshin nga një peshkop, por në bashkësitë fshatare të izoluara këto kritere nuk plotësoheshin gjithnjë. Priftërinjtë konsideroheshin si ndërmjetës midis besimtarëve dhe Zotit. Ata kryenin liturgjitë në famullitë e tyre dhe kungonin besimtarët. Kishin shumë ndikim, dhe shpesh vepronin si ndërmjetës midis komuniteteve të tyre dhe autoriteteve osmane. Priftërinjtë katolikë ishin të detyruar të mos martoheshin, ndërkohë që priftërinjve ortodoksë u lejohej të martoheshin.

► **Fig. 37. Rabini i madh i Stambollit (fondi i shekullit të 18-të)**



Juhasz, f. 124.

Rabin: “Mjeshtër” ose “mësues”, titull nderi për një mësues hebre ose specialist të së drejtës fetare. Në përgjithësi, një rabin vepronte në të njëjtën kohë si meshtar në një sinagogë, dhe i ofronte udhëheqje shpirtërore komunitetit. Rabinët e shkolluar mirë kishin një ndikim të madh në kulturën çifute. Gjithashtu ata ishin ndërmjetës në marrëdhëniet midis autoriteteve osmane dhe komuniteteve çifute.

► **Fig. 38. Fisnik i krishterë i shekullit të 18-të**



Istoria, vëll 11, f. 137.

Fisnik i krishterë: Ndërkohë që osmanët zgjerorin territoret e tyre, veçanërisht gjatë shekujve të 15-të dhe të 16-të, ata ua hoqën të drejtat fisnikëve të lartë trashëgimtarë në tokat që pushtuan, duke i lënë kështu fisnikët e vegjël pa udhëheqje. Nga ana tjetër, ata mbështeteshin tek këta fisnikë dhe tek elitat e tjera vendase, për të "njohur tokën" dhe qeverisur atë; dhe shumë fisnikë të krishterë (*koxhabashi* ose *arkontë*) fituan status pothuajse fisniku. Një situatë e veçantë u krijua në principatat rumune të Vllahisë dhe Moldavisë, ku *bojarët* e ruajtën statusin e tyre shoqëror gjatë gjithë periudhës së suzerenitetit osman. Në fillim, titulli i bojarit ishte i lidhur me prejardhjen dhe pronësinë mbi tokën; megjithatë, edhe princat jepnin çifligje dhe titullin bojar në këmbim të shërbimeve të spikatura ushtarake

dhe civile. Të ardhurat e bojarëve vinin nga taksat dhe detyrimet e fshatarëve në çifligjet e tyre, dhe nga postet shtetërore. Që nga shekulli i 16-të, një numër në rritje të krishterësh nga territoret osmane hynë në shërbimin e princave vllahë dhe moldavë, fituan çifligje dhe u bënë bojarë. Reagimet e vendasve, që ngulmonin në cilësinë e "pronarëve të tokave" [*pāmântean*], ishin të kota. Në mes të shekullit të 18-të, Kostandin Mavrokordati vendosi disa nënkategori bojarësh dhe i lidhi këta tituj me përbushjen e detyrave shtetërore.

► **Fig. 39. Një ajan i shquar: Ali pasha i Janinës (1741-1822) – pikturë e Lui Dypresë (1819)**



Istoria, vëll 12, f. 72.

Ajan: "Parësi", njeri i pasur, të cilit i jepej një post qeveritar gjysmëzyrtar, në mënyrë që të ndihmonte në mbledhjen e taksave në një njësi administrative të caktuar. Ajanët ishin kryesisht myslimanë; për një periudhë të gjatë kohe ose edhe për gjithë jetën, ata merrnin në administrim taksat nga shteti dhe më pas i përdornin pozitat e tyre që nënshtetasit të viheshin nën varësinë e tyre të plotë nëpërmjet borxheve. Të njohur zyrtarisht në shekullin e 18-të, nëpërmjet fajdeve dhe tregtisë, ajanët grumbulluan pasuri të mëdha, krijuan ushtri private dhe fituan kontroll politik në provinca. Sulltan Mahmudi II (1808-1839) i dha fund pushtetit të ajanëve.

► **Fig. 40. Këmbyes parash osman**



Hegyi, Zimanyi, fig. me ngjyra 140.

Sarraf: “Këmbyes parash”. Në qytetet e mëdha osmane, këmbyesit profesionistë të parave, qofshin ata myslimanë, ortodoksë, hebrenj, armenë a katolikë, e siguronin jetesën duke përfituar nga përdorimi i llojeve të shumta të monedhave të argjendta, të florinjta dhe atyre prej bakri. Ata jepnin edhe hua kundrejt një interesi dhe shpesh akuzoheshin si “fajdexhi”. Ndonjëherë, *sarrafët* e pasur mbështesnin edhe veprimtari të taksueshme bujqësore dhe ushtronin ndikim të rëndësishëm ekonomik e politik.

► **Fig. 41. Një përkthyes: Pjerr Jamoglu, përkthyes i ambasadës franceze (1787)**



Hitzel, nr. 59.

Dragoman: “Përkthyes”, në turqisht *terxhyman*. Pengesat gjuhësore në komunikimin midis autoriteteve osmane dhe të huajve nxorën në pah nevojën për përkthyes. Shumica e përkthyesve ishte me origjinë jomyslimane dhe ata mund të punësoheshin qoftë nga shteti osman, qoftë nga ambasadorët e huaj, tregtarët dhe udhëtarët. Në fund të shekullit të 17-të, përkthyesit përfshiheshin në sistemin burokratik osman. Postet më të larta ishin: përkthyes të Këshillit Perandorak dhe përkthyes i flotës; në përgjithësi, deri në fillim të shekullit të 19-të, në këto poste osmanët emëronin nënshtetas ortodoksë nga lagjja *Fanar* e Stambollit.

► **Fig. 42. Ambasadori suedez (1788)**



Theolin, f. 60.

Ambasador: Në shekullin e 15-të, duke filluar me Venedikun, fuqitë e mëdha të krishtera dërgonin ambasadorë të përhershëm në Stamboll, me mision të dyfishtë: të përfaqësimit të tyre në marrëdhëniet me sultanin dhe raportimit për çështje të ndryshme politike. Disa ambasadorë perëndimorë vinin në Stamboll për një numër të caktuar vitesh, ndërkohë që të tjerë nuk e dinin që në fillim se sa i gjatë do të ishte misioni i tyre. Shumica e ambasadorëve ishte me origjinë fisnike dhe atyre u caktoheshin rezidenca zyrtare, gëzonin mbrojtjen e sultanit dhe merrnin rroga të caktuara. Duke qenë se rrallëherë dinin turqisht, persisht ose arabisht, për komunikimin e tyre me autoritetet dhe vendasit, ambasadorët mbështeteshin tek përkthyesit. Duke qenë se shpesh mbikëqyreshin nga agjentë osmanë, në përgjithësi ata parapëlqenin të shoqëroheshin me punonjësit e ambasadës, me tregtarët e krishterë dhe me kolegët e tyre ambasadorë.

► **Fig. 43. Skllav anijeje duke mbajtur racionin e tij të ujit**



Hegyí, Zimanyi, f. 74, fig. 83.

IVb. Jeta në fshat

IV-2. Rregullorja mbi vetëqeverisjen në fshat në provincën e Vidinit (1587)

Kryepleqtë e fshatit [*knjazët*] dhe pleqësia [*primikuret*] janë të detyruar t'i ndihmojnë zyrtarët për të mbledhur taksat e ndryshme.

Kryepleqtë dhe pleqësia kanë për detyrë të gjejnë dhe të kthejnë nënshtetasit [*rajatë*] që janë arratisur nga fshatrat e tyre.

Për shërbimin e tyre, kryepleqtë dhe pleqësia përjashtohen nga pagesa e taksave të ndryshme, si *haraçi*, *ispenxha*, taksat për bagëtinë, e dhjeta për drithërat e prodhuara në arat e familjes, e dhjeta e mushtit të rrushit, taksat tjera dhe të gjitha taksat e zakonshme e të jashtëzakonshme.

[...]

Nëse ndonjë nga personat e përmendur më lart vdes, detyra e tij duhet t'i kalojë njërit prej djemve të tij, të përshtatshëm për këtë punë.

Përsa kohë personat e përmendur më lart u shërbejnë mirë taksambledhësve dhe me efektshmëri, guvernatorët [*bejlerët*] nuk duhet t'i mbajnë nën zgjedhë

Skllav: Në Perandorinë Osmane kishte shumë lloje skllavërishe, burra e gra, të bardhë e me ngjyrë, vendas ose "të importuar", që përdreshin për shërbime shtëpiake ose për veprimtari të ndryshme ekonomike. Si në shumë shoqëri myslimane, praktika e lirimit vullnetar të skllavëve ishte mjaft e përhapur; një lirim i tillë mund të ndodhte edhe kur skllavi konvertohej në islam. Skllavërit [*ku*] e sulltanit që shërbenin në Pallat, në ushtri a në administratë ishin raste të veçanta; në shekujt XV-XVII, disa nga qeveritarët më të zotë osmanë, përfshirë këtu edhe shumë vezirë të mëdhenj, kanë përfutur shumë nga ky status në karrierën e tyre.

❓ Nëse do të kishit jetuar në Perandorinë Osmane, cilës ndarjeje shoqërore do të parapëlqenit t'i përkisnit? Shpjegoni zgjedhjen tuaj.

dhe nuk lejohet t'i dërgojnë në luftë kundër vullnetit të tyre.

Georgieva, Tzanev, f. 151.

❓ Përse autoritetet osmane lejonin një shkallë vetëqeverisjeje në fshatra?

IV-3. Detyrimi i fshatarëve për të kultivuar tokën (*Kodi i Karamanit mbi tokën, 1525*)

Çdo nënshtetas [*raijet*] që kultivon një ngastër të tërë [*bir çiftlik jer*], duhet ta mbjellë me katër *mudd*⁶¹ fara gruri, sipas njësisë matëse të Bursës. Për çdo vit që do ta lërë tokën të pambjellë, atij do t'i merren pesëdhjetë akçe. Por nëse do të mbjellë një *mudd*, sipas njësisë matëse të Karamanit, do t'i merren njëzet e pesë akçe dhe asgjë tjetër. Nëse një nënshtetasi i ndodh ndonjë fatkeqësi dhe për këtë arsye nuk është në gjendje të vazhdojë ta punojë tokën dhe kështu që e lë atë, *spahiu* i tij duhet t'ia japë këtë tokë dikujt tjetër, dhe do t'i kërkojë atij vetëm detyrimet e argatit [*resm-i bennâk*] dhe jo pagesën e plotë të tokës [*resm-i çift*].

Barkan, f. 751-752..

⁶¹ Emri i një njësie matëse osmane, me origjinë bizantine. Siç mund të shihet në tekst, madhësia e saktë e *mudd*-it ndryshonte në vende të ndryshme të perandorisë.

? Pse interesoheshin autoritetet osmane nëse toka punohej apo jo? Çfarë mjetesh përdornin ata për të detyruar fshatarët që ta punonin tokën?

► **Fig. 44. Shtëpi bullgare në Tërjavna (shekulli i 18-të)**



IV-4. Shtëpi bullgare pranë Ruses, të përshkruara nga udhëtari francez Pjerr Leskalopier (1574)

Në datë 13 [qershor] fjetëm në Katselo, mali i fundit bullgar dhe më pas, duke ecur mes rrugëve të këqija të fshatit, arritëm në Rustsi, qytet në breg të lumit Danub, afër Vllahisë.

Më 14 qershor i lamë përsëri kuajt të pushonin, meqë ishin të rraskapitur nga rruga nëpër këto male, pyje dhe rrugë të tmerrshme të Bullgarisë, me popullsi aq të rrallë, sa shpesh ne dhe kuajt tanë na është dashur ta kalojmë natën jashtë. Shtëpitë e tyre janë përdhese. Kanë vetëm truallin e dyshemesë të rrethuar nga trungje dhe hunj të ngulur në tokë, të thurura me shkopinj të hollë si purtekat në Pikardi⁶². Muret janë të lyera me baltë, të përzier me kashtë të shkërmoqur. Shtëpitë janë

1 metër e 80 cm të larta dhe janë të mbuluara me kashtë; në çati ka një vrimë për të nxjerrë jashtë tymin e vatrës, e cila ndodhet në mes të shtëpisë. Njerëzit dhe gjithë bagëtia e tyre jetojnë bashkë, nën të njëjtën çati, dhe duke mos qenë në gjendje të durojmë pisllekun dhe erën e keqe, shpesh e kemi kaluar natën poshtë ndonjë peme.

Georgieva, Kitanov, f. 133.

⁶² Provincë në veri të Francës.

? Cila është përvoja e Leskalopierit në lidhje me fshatin bullgar, veçanërisht me kushtet e jetesës atje? Ç'përfundime mund të nxirni për kushtet e jetesës në vendin e tij të lindjes? Cili ishte qëndrimi i tij ndaj njerëzve në Bullgarinë fshatare?

IV-5. Përshkrimi i veshjes dhe njerëzve që jetonin afër Plovdivit (1553-1555)

Herët në mëngjesin e datës 14 korrik u larguam nga Filipopoli [emri i lashtë i Plovdivit] dhe rreth orës 4, pasi hëngrëm drekë, arritëm në një fshat të quajtur Vetren bullgarisht, dhe Hisardgixh turqisht. Ky është një fshat i madh bullgar. Fshati ka dy priftërinj dhe nuk ka turq rreth e rrotull. Njerëzit janë të pashëm dhe të fortë dhe në shumë shtëpi mund të blije verë, verë të re. Të gjithë shisinbukë të rrumbullakta, kashtë, kos, gjizë, mish dhe dardha.

Bullgarëve nuk u lejohet të veshin rroba të bukura; ata vishen të gjithë me pelerina gri e të bardha dhe me kapuç, nuk kanë as këpucë dhe as çizme, por veshin vetëm sandale të bëra nga lëkura e papërpunuar e lopës dhe çorape deri në gju. Kapelet e tyre me majë bëhen me shajak të bardhë ose copë bojëkafe. Burrat nuk veshin pallto dhe dalin me këmisha me mëngë në dimër e verë. Flokët nuk i presin aq shkurt sa turqit dhe kanë bishta të gjatë prapa kokës, çka tregon se ata nuk janë turq. Askush nuk mban ndonjë armë, përveç dajakëve të mëdhenj e të rëndë.

Vazvazova-Karateodorova, f. 211.

? Sipas tekstit, çfarë ndikimesh pati pushtimi osman në jetën e fshatarëve bullgarë?

IV-6. Ushqimi dhe pijet në Shqipëri (rreth vitit 1810)

Ushqimi kryesor i këtyre njerëzve janë buka e grunjtë ose buka e elbit, ose gatesa me misër të pjekur ose të zier, djathi i bërë me qumësht dhie, pilafi me gjalpë, vezët, peshku i tharë, ullinjtë dhe perimet. Gjatë festave, të vegjllit [ka shumë të ngjarë që autori ta ketë fjalën për qengjat në këtë kontekst] dhe delet theren, ashtu si edhe pulat, që gjenden me shumicë kudo; por sasia e mishit është shumë më e vogël se pjesa tjetër e dietës. Ata pinë verë,

si muhamedanët, ashtu edhe të krishterët, si edhe një pije alkoolike të fortë, të nxjerrë nga rrushi dhe elbi, të quajtur raki, që ngjason me uiskin. Pjesën më të madhe të qumështit e përdorin për të bërë djathë. Në fakt, uji i ftohtë është pija që përdorin më shumë, dhe e pinë në sasi të mëdha edhe në zhegun e vapës së verës, edhe kur janë duke bërë punë të rënda fizike, pa patur ndonjë pasojë nga pirja e tij. Kafën e gjen në shumë shtëpi, dhe ndonjëherë edhe verën e klasit të lartë nga Italia, ose likeret e prodhuara në Kefalonia dhe Korfuz.

Broughton, f. 130-131.

? Krahasoni përshkrimet e ushqimit në shekullin e 16-të me ato të fillimshekullit të 19-të. Ç'dallime vini re?

► Fig. 45. Dhomë në Arbanas (shekulli i 18-të)



IV-7. Udhëtim përmes fshatrave bullgare (1761)

U nisëm drejt *Karabunarit* më 8 të mëngjesit. Rrugës ramë në një pyll të madh e të gjatë. Në fillim takuam rojen nga *Faki*. Dhe më pas, atë nga *Karabunari*. Diku, në krye të fshatit, gjendej një pus dhe ngjitur me të, një kasolle me çati, që njerëzit e përdornin për t'u lutur dhe si strehë kundër shiut, madje dhe si vend për të kaluar natën. Gjatë rrugës kishte shumë baltë, kështu që udhëtimi na zgjati 5 orë, në vend të 4 orëve të zakonshme.

Karabunari është fshat i madh, me rreth pesë ose gjashtëqind shtëpi turke e bullgare. Shtrihet në një luginë të bukur e të sheshtë, të mbuluar me bar e lule. Lumenj të vegjël e përshkojnë tej e mbanë. Lugina është gjysmë milje e gjerë dhe rreth dy milje e gjatë, dhe shtrihet midis majës së malit nga njëra anë dhe kodrinave nga ana tjetër. Kur mbërritëm, na dhanë një shtëpi, afër shtëpisë së krishterë ku

kishte rënë lija; na thanë se në disa vende kishte rënë lija. "Çorbaxhija" i fshatit, emër i përdorur për kryetarin e jeniçerëve, por zakonisht, si edhe në këtë rast, i përdorur për kryetarin e fshatit, na lëshoi shtëpinë e tij. Ishte shtëpia më e mirë në fshat dhe zakonisht nuk jepej me qira. Ata na siguruan se në të nuk kishte lijë. Gjithsesi, ne menduam se ishte më mirë të ngrinim çadrat jashtë fshatit, për të qenë më të sigurtë. Kaluam urën dhe i ngritëm çadrat në luginën pranë kodrave që ishin shumë të ulta. Kur ngjitesh në ato kodra, sheh pamjen më të bukur që mund të imagjinosh: lart, nga njëra anë mund të shohësh fshatin, bagëtitë, dhe nga ana tjetër, një luginë tjetër të madhe, me një rresht kodrash të bukura. Sapo i kishim ngritur çadrat, kur filloi një shi i madh; dhe kur pushoi, disa njerëz nga fshati erdhën dhe filluan të na këndonin disa këngë të egra, që të merrnin ndonjë bakshish nga ne.

[...]

Dobrali është një fshat i vogël bullgar me rreth 60 shtëpi, në një luginë të madhe, mes maleve ku fillon vargmali Ballkan, domethënë *Emo*. [...] Shkëlqesia e tij qëndroi në një shtëpi të re bullgare, që kishte vetëm një dhomë të madhe të pastër. Të tjerët u rregulluan, me aq sa mundën, në disa shtëpi të vogla bullgare. Pak pas mbërritjes sonë, nja dy vajza erdhën të kërcenin dhe këndonin para derës së ambasadorit. Ato e përsëritën vallen e tyre kombëtare disa herë dhe në fund ato hidhnin një shami, në fillim tek Shkëlqesia e Tij dhe më pas tek njerëzit e shpurës, për të marrë ndonjë monedhë. Bëmë një shëtitje nëpër fshat, edhe pse nuk ishte aq i bukur, dhe po kërkonim për mjetet që do të bënin të mundur nisjen tonë të nesërmen, por nuk arritëm në ndonjë përfundim. Ditën tjetër realizimi i planit dukej edhe më i vështirë, sepse të gjithë burrat e fshatit u larguan, duke marrë të gjithë qetë me vete, të cilët duhet t'i merrnim ne. Pas një sërë kërcënimesh serioze, të gjitha vështirësitë u kapërcyen. Ne i detyruam qerret nga *Karnabata*, që tërhiqeshin nga qe, të vazhdonin rrugën dhe gjetëm gjashtë çifte qesh për dy qerret tona në fshat përqark."

Boskovic, p. 40-41, 51.

? Si ishin marrëdhëniet midis fshatarëve ballkanas dhe udhëtarëve të huaj? Çfarë vështirësish të jetës fshatare përmenden në këtë burim?

► **Fig. 46. Gra që po lajnë jashtë shtëpisë (Larisa, fillimi i shekullit të 19-të)**



Istoria, vëll 11, f. 165.

► **Fig. 47. Burra dhe gra në ishullin Paros, duke u rënë veglave muzikore dhe duke kërcyer**



Istoria, vëll 11, f. 288.

IV-8. Rrugët dhe letërkëmbimi në Shqipërinë osmane

E prishur dhe e rrezikshme, kështu ishte rruga që po ndiqja. Kjo ishte xhadeja përmes Shqipërisë, që fillonte në Maqedoni e shkonte deri në Durrës,

në bregdet; dhe përgjatë saj, edhe pse tashmë e shkretë, në historinë e mbi njëzet shekujve të shkuar, kishte udhëtuar një ushtri e lavdishme, që është shuar dhe harruar me kohë.

Turqit nuk kishin bërë asgjë për ta përmirësuar këtë rrugë. Ishte ashtu siç e kishte lënë natyra dhe romakët. Në një vend na u duk sikur do të binim thikë mes shkëmbinjve të zinj. Rruga gjarpëruese e plot kthesa ishte gërryer kaq shumë gjatë qindra vjetëve të shkuar, sa që në të ishte krijuar një kanal i thellë dhe kur ecje, ai të vinte deri në gju.

[...]

Ajo kalonte edhe nëpër një urë me harqe të rregullt të ndërtuar nga romakët, që sot ishte po aq e fortë sa ç'kishte qenë kur e përdorën ata.

Pashë disa nga këto ura romake në Shqipëri. Disa ishin po aq të përdorshme sa në fillim; disa ishin pjesërisht të rrënuara, me rrasa e gurë të rënë në rrëqe; të tjera ishin thyer më dysh. Por nuk pashë asnjë urë të riparuar nga turqit.

[...]

Nga Elbasani nuk ka tregti të rregullt ose ndonjë formë tjetër komunikimi. Doja të dërgoja letra. Më

thanë se njëherë në javë posta shkonte në Manastir, por shkonte veçse kur kishte shumë letra për të marrë; ndërsa rruga e Durrësit, që ishte mënyra më e shpejtë për të dërguar një letër në Angli, nëse do të nisej menjëherë, ishte më e pasigurtë, sepse transporti ishte më i rastësishëm dhe për gati dy muaj, askush nuk mund të të thoshte me saktësi se kur do të dërgoheshin letrat.

Fraser, f. 242, 251-252.

IVc. Jeta në qytete

IV-9. Përshkrimi i Beogradit (1660)

[...] brenda këtij qyteti të madh gjenden njëqind e gjashtëdhjetë pallate që u përkasin vezirëve, zëvendësve të tyre dhe fisnikëve të tjerë. (I gjithë qyteti ka shtatëmbëdhjetë mijë dhoma, duke qenë se në çdo shtëpi janë regjistruar pesë deri në dhjetë dhoma.)[...]

Përveç këtyre, të gjitha familjet, të pasura e të varfra, banojnë në ndërtesa të mëdha ose të vogla guri [kârgir], me një kat përdhes dhe një tjetër lart, dhe me çati të mbuluara me tjegulla – shtëpi të bukura me papafingo të larta në katin e sipërm dhe ballkone të mbyllura, të rrethuara me kopshte ose vreshta, me rrugica të shtruara në to. Duke qenë se janë të gjitha të ndërtuara në radhë njëra mbi tjetrën, dritaret dhe ballkonet e tyre shohin nga Danubi, Sava apo Fusha e Zemunit; të gjitha shtëpitë janë shumë të zbukuruara me oxhakë elegantë dhe porta me dy kanate.

[Hanet – karavan-saraj]

Ka gjashtë [hane] të tilla, që strehojnë udhëtarë që vijnë e shkojnë. [Kryesori] mes tyre është hani i martirit [çehîd] Sokollu Mehmed Pasha⁶³, brenda Tregut të Madh, një ndërtesë guri ose tullash [kârgir], me njëqind e gjashtëdhjetë dhoma në katin e parë e të dytë, dhe me hangarë e stalla për gamilet, si edhe një harem [për gratë]; është një han si fortesë

? Pse në Shqipëri rrugët ishin kaq të këqija? A vlen kjo për të gjithë Perandorinë Osmane, apo vetëm për territoret periferike? Pse udhëtarët perëndimorë e theksonin gjithnjë infrastrukturën e keqe të zonave fshatare në Perandorinë Osmane? Mendoni që shkri-mtari përpiquej ta tregonte veten si një udhëtar aventurier apo si një anëtar të botës së “civilizuar”?

me portë hekuri, jashtë së cilës portierët dhe rojat e natës u bien daulteve para se të mbyllin portën dhe [më pas] kur e hapin [në mëngjes]....

[Tregjet]

Në të gjithë tregun perandorak gjenden tre mijë e shtatëqind dyqane, por më i bukuri nga të gjithë është tregu i mbuluar [bezistân] në Tregun e Grave [Avrat bâzâr]. Edhe pse nuk është një ndërtesë guri me kupola dhe porta hekuri, gjithsesi është një mrekulli e tregut mbretëror, që është bërë më i famshmi nga të gjithë, me emrin tregu i bukur [...] Dhe në Tregun e Gjatë [Uzun çârsü] gjenden të gjitha llojet e zejeve, duke qenë se është një rrugë kryesore që vazhdon për tre mijë hapa të gjatë, duke filluar nga xhamia Kapucu deri në Tregun e Peshkut. Këtu mund të gjesh të gjitha llojet e prodhimeve të çmuara nga India, Indutë dhe Jemeni, Belhi dhe Buharaja, Arabia e Persia, dhe që mund t’i marrësh në këtë treg të gjatë, pa t’u dashur të lutesh ose të paguash shumë për to.

Dhe Tregu i Kazanpunuesve [Kazancılar çârsûsî], dhe Tregu i Peshkut, dhe Sheshi Qendror [Orabâzâr], dhe Tregu i Bajram Beut, së bashku me restorantet me supë pule dhe kafenetë e tij, dhe Tregu i Vogël janë gjithashtu tregje të shkëlqyera.

Të gjitha tregjet dhe sheshet e pazarit, si edhe të gjitha rrugët kryesore të lagjeve të ndryshme të

⁶³ Mehmed pashë Sokollu. Lindi më 1505 në Sokol (Bosnjë), u rekrutua në ushtrinë osmane nëpërmjet devshirmes (fëmijëve-haraç) dhe bëri një karrierë të shkëlqyer, duke arritur në postin e vezirit të madh, të cilin e mbajti për 14 vjet, nën 3 sulltanë (1565-1579). Edhe para se të bëhej vezir i madh, përkrahu me sukses vendosjen e patriarkatit serb në Pejë, më 1557. Ai mori titullin “martir”, sepse u vra në vitin 1579, në rredhë të dyshimta.

këtij qyteti janë të shtruara me gurë të bardhë e të lëmuar kalldrëmi, si luspa peshku.

[Veshjet e njerëzve]

Të gjithë fisnikët e tyre vishen me gëzof kunadheje dhe saten e mëndafsh të hollë. Njerëzit e thjeshtë vishen me rroba të gjera dhe gëzofë dhelpre. Të varfërit, gjithashtu, vishen me rroba të gjera dhe mantele [kaftan] prej pëlhure pambuku. Të gjithë fshatarët [rajatë] vishen me *shajak* [shajak] dhe coha të leshta [aba] të kuqe e të bardha, dhe mbajnë *kalpakë* boshnjakë mbi kokë.

[...] Në shumicën e rasteve, ata vishen me xhaketa cope dhe kësula *terpushi* të sheshta, dhe një shall që e mbështjellin thjesht.

[Gjuhët]

Edhe pse banorët e Beogradit janë konvertuar në islam [potur], gjithsesi ata dinë gjuhën serbe, bullgare dhe atë latine, madje dhe shprehjet e gjuhës boshnjake [...]

Të gjithë fshatarët [rajatë], si edhe njerëzit e lirë [berajatë] janë serbë të pafe, përfshirë këtu dhe të gjithë karrocierët e Siremit. Gjuha e tyre është e ngjajshme me gjuhën bullgare, latine dhe boshnjake, edhe pse ka disa huazime nga disa gjuhë të ndryshme; megjithatë, ata mbeten pjesë e një kombi të krishterë, libri i tyre është Bibla, të cilën e kanë përkthyer në gjuhën e tyre. Shumë prej tyre dinë gjuhën kroate dhe atë franceze [galike], dhe gjuhën italiane e sllovene, sepse këta serbë të pafe janë një komb i lashtë, origjina e të cilëve shkon pas në kohë tek Ajsi⁶⁴, kështu që serbët dhe latinët kanë histori të respektuara dhe të besueshme. Gjithsesi, theksi i tyre i ngjan gjuhës boshnjake [...].

[Tregtia]

Prodhimet nga Egjipti dhe Damasku, Tripoli dhe Sidoni, Bejruti dhe Akra, Izmiri dhe Arabia, Persia dhe India sillen me karroca dhe gamile. Rreth pesë a gjashtë mijë ngarkesa gamilesh dhe karrocash sillen nga gjithë këto vende çdo vit, duke u shpaketuar e paketuar përsëri në këtë qytet, me ngarkesat që shkojnë dhe vijnë nga të gjitha provincat hungareze, polake, çeke, suedeze, austriake, boshnjake, veneciane e spanjolle, sepse ky qytet është Egjipti i Rumelisë dhe gjithë njerëzit e tij janë tregtarë të

matur. Disa mijëra vetë nga popullsia e tij kanë ardhur nga krahina të tjera dhe janë vendosur këtu, sepse ky është qyteti i bollëkut.

[...] Kur Danubi ngrin akull dhjetë pëllëmbë të trashë, me qindra mijëra karroca e slita kalojnë mbi atë shtresë akulli, pa paguar tarifa [bâc] ose detyrime tregu [bâzâr harci]; qoftë fshatarët [raja], qoftë njerëzit e lirë [beraja] i sjellin prodhimet e tyre këtu, kështu që ka plot shitje e blerje, dhe qyteti i Beogradit gëzon një bollëk të madh, dhe të varfrit përfitojnë prej kësaj mundësie për t'u pasuruar.

[Festat]

Në kohëra të tilla, në dhomat e tyre të ngrohura me stufa, njerëzit e Beogradit organizojnë festa të mëdha për njëri-tjetrin me dyzet a pesëdhjetë gjellëra të ndryshme dhe dhjetë lloje ëmbëlsirash, dhe torta me mjaltë e bajame, dhe dhjetëra lloje pijesh, frutash të thata e të freskëta [hoşâb, hoshaf], duke u mbledhur në grupe të mëdha për të pirë e bërë qejf. Dhe nëse një nga ato dhjetë lloje ëmbëlsirash ose pijesh prej frutash të thata do të mungonte, atij burri i kërkohej të organizonte edhe një festë tjetër. Kjo tregon se sa larg shkon hareja dhe argëtimi në këtë qytet të begatë.

Evlija Çelebi, f. 195-200.



Përshkrimi i udhëtimeve të Evlija Çelebisë është një nga veprat kryesore të letërsisë osmane të shekullit të 17-të; gjithsesi, duhet të dimë se në përshkrimet e tij vihen re ekzagjerime; në këtë mënyrë ai synon të nxjerrë në pah tiparet përrallore të rajoneve të ndryshme që ka vizituar. Shifrat e tij janë thuajse gjithnjë tepër të ekzagjeruara, por rrëfimi i tij është i vlefshëm, sepse tregon përbërjen dhe modelin kompleks të jetës në qytet.



Përpiquni të ndani faktet nga trillimi në tekstin e Çelebisë. Ç'rol luajti karakteri dhe natyra e Çelebisë në përshkrimin e Beogradit? Përpiquni të ndryshoni (në dy a tri pika) përshkrimin e tij ngazëllyes me disa të dhëna më të trishta. Deri në ç'pikë ishin qytetet etnikisht homogjene? Cilat ishin përparësitë e qytetarëve në krahasim me fshatarët?

⁶⁴ Figurë në mitologjinë arabe, që mbahet si paraardhësi i sllavëve.

► **Fig. 48.** Një turk hipur mbi kalë, ngarkuar me shporta të mëdha për të mbajtur fruta dhe perime të freskëta



Hegyi, Zimanyi, f. 155, fig. 162.

► **Fig. 49.** Parada e bukëpjekësve në Stamboll (1720)



Hegyi, Zimanyi, fig. me ngjyra 158.

IV-10a. Rezidenca e princit të Vllahisë, Kostandin Mavrokordatit, përshkruar nga udhëtari francez Flashat (mesi i shekullit të 18-të)

Shkova në pallatin e pushimit të princit, i cili, si edhe pallati i princit në qytet, të kujton qëllimin e tij kryesor. Më parë, këto pallate kanë qenë manastire, disi të zbukuruara nga princat paraardhës. Shumica e banesave tona private të dorës së dytë janë shumë më të bukura dhe në vendin tonë nuk ka të tilla, ku mobilimi të jetë më i keq se këtu. Ndoqa rrjedhën e lumit Dambovica, një lumë që rrjedh shumë shpejt dhe nuk thahet kurrë. Përgjatë tij ka shumë mullinj. Mekanizmi i tyre nuk ka ndonjë gjë të veçantë. Po flas për to vetëm sepse ato i dhanë shkas zotit Andronaki - kur më tregoi ato që ishin pranë portave të pallateve – të më thoshte se kopshtet ishin në gjendje të keqe, se të gjitha pusët arteziane ishin prishur dhe se askush në vend nuk guxonte t'i rregullonte, edhe pse princi do të kishte paguar sa t'i kishin kërkuar për to. U thashë se do t'u jepja planin e një pompe që jo vetëm do t'i vinte në punë pusët arteziane, por do të sillte ujë të rrjedhshëm në çdo dhomë që do të dëshironin [...] Princi dukej shumë i kënaqur dhe më siguroi se do të urdhëronte dikë që ta ndërtonte një të tillë për të sa më shpejt të ishte e mundur [...]

Vetëm duke parë se si ishte rezidenca e tij, mund të kisha krijuar një përshtypje për vlerat e tij, por unë pata mundësinë të shikoja inteligjencën dhe zemrën e tij: zbulova tek ai artistin dhe njeriun me shije të hollë në çdo gjë. Koleksioni i tij i librave ishte i pasur dhe i zgjedhur; zotëronte disa piktura me vlerë, disa skulptura të mrekullueshme, pajisje të ndryshme dhe disa pjesë mekanizmesh të pazakonta, të sjella enkas për të nga Gjermania ose Anglia. Mendoj se ai meriton të lavdërohet prej meje, duke thënë se ishte dijetar pa paragjykime dhe tërësisht i paanshëm. Ai i fliste të gjitha gjuhët europiane dhe kishte njohuri për të gjithë shkrimtarët më të rëndësishëm dhe përpiqej t'i studionte sa më mirë ata. U habita nga përparimi që kishte bërë në shkencë.

Călători, IX, f. 256.



Përse autori vendos përballë njëra-tjetres kritikën ndaj infrastrukturës së keqe, me lavdërimet për cilësitë e princit të Vllahisë? A u habit Flashati nga zhvillimi i mikpritësit? Përse? Për më shumë informacion mbi Kostandin Mavrokordatin mund të shikoni tekstin II-22, veçanërisht shënimin në fund të faqes, numër 50.

IV-10b. Johann Georg von Hahn përshkruan qytetin e Prizrenit (mesi i shekullit të 19-të)

[...] Në qoftë se lexuesi do të këtë patur rastin të lexojë në hartë emrin e këtij qyteti, atij me siguri, po ashtu si autorit të këtij shkrimi, as që do t'i këtë shkuar ndërmend që ky është qyteti, më i madh i Shqipërisë dhe hyn në radhën e qyteteve më të rëndësishme të këtij gadishulli, së bashku me Larisën dhe Janinë. Popullsia e Prizrenit e kalon madje atë të Shkodrës dhe me shumë gjasa edhe atë të Manastirit. Në fakt Prizreni, në bazë të listave zyrtare të pagesave, përmbledh 11. 540 shtëpi, prej të cilave 8.400 janë muhamedanësh, 3.000 të krishterësh greke dhe 150 të krishterësh katolikë. Në këto shtëpi banojnë gjithsej 46.000 frymë, nga të cilët 36.000 janë muhamedanë, 8.000 të krishterë grekë (bullgarë dhe vllah) dhe 2.000 të krishterë katolikë. Pretendohet që këtu popullsia po shtohet me ritme të shpejta dhe në këtë drejtim ka ndikuar në mënyrë të qenësishme edhe shndërrimi i këtij qyteti në kryeqytet.

Gjatë organizimit të vilajeteve të bërë në vitin 1843, qendra e guvernatorit të Shkupit (Skopia ose Shkup), kryeqytetit të vjetër të vendit, u shpërngul në Prizren, ndonëse titulli i tij i vjetër Vilajeti i Shkupit (Uskjuj) mbeti i pandryshuar. Ky Vilajet përfshin rrethet e Tetovës (Kalkandele), Gostivarit (Gostivar), Shkupit (Skjuj), Kumanovës (Kumanowa), Palankas (Palanka), Kratovës (Kratowa), Istipit (Istip), Radoviçit (Raowitj), Gjilanit (Gilan), Prishtinës (Prishtina), Pejës (Ipek), dhe Gjakovës (Jakova). Prizreni është qendra e mushirit, ndërsa selitë e kajmajkanëve (zëvendës-guvernatorëve) ndodhen përkatësisht në Shkup dhe Ipek.

Qyteti është ndarë në njëzet lagje. Ai ka njëzetegjashtë xhami, megjithëse ndërmjet tyre nuk ka as edhe një të vetme që të paraqesë ndonjë farë rëndësie nga pikëpamja arkitekturale, si dhe dy kisha greke dhe një shtëpi private që është shndërruar në kishë katolike. Shkollat që ekzistojnë aty janë: shtatëmbëdhjetë shkolla muhamedane për djemtë dhe nëntë për vajza, një shkollë elementare ushtarake (Mekteb Rustie), një shkollë bullgare e subvencionuar nga legatët (nga latinishtja «legatus» që don të thotë përfaqësues, ambasador – sh.p.) si dhe një shkollë katolike e përkrahur nga Madhëria e Tij Perandori, e cila aktualisht numëron njëzetegjashtë nxënës.

[...]

Tregtia ndodhet krejtësisht në duart e të krishterëve. Gjendja e keqe e komunikacionit tokësor me Shkodrën ka sjellë si pasojë që Prizreni të tërheqë nga Selaniku sasi të mëdha manifakturash angleze. Ndërmjet artizanëve vendin e parë e zënë regjuesit e lëkurëve, armëpunuesit dhe rrobaqepësit. Pjesa më e madhe e safianit (lëkurë e imët dhije e regjur dhe sumak, nga turqishtja «sahtjan» dhe persishtja «sahtijan» -sh.p) të prodhuar këtu eksportohet në Hungari.

Johann Georg Von Hahn, *Udhëtim Neper Viset e Drinit dhe te Vardarit*. f. 198.



Johann Georg von Hahn (1811–1869) lindi në Frankfurt am Main dhe studioi për drejtësi në Giessen dhe Heidelberg. Gjatë viteve 1834–1843, punoi për autoritetet e drejtësisë të Mbretërisë të sapo themeluar të Greqisë. Gjatë viteve 1843–1847, qe përfaqësues i Konsullatës së Prusisë në Athinë dhe më pas u transferua në nën-konsullatën e Austrisë në Janinë, ku ra në kontakt me shqiptarët dhe filloi të mësojë gjuhën shqipe. Në vitin 1851, u emërua konsull i Austrisë në ishullin e Siros. Gjatë viteve që jetoi në Janinë, Hahn vizitoi Shqipërinë tri herë dhe mblodhi informacion mbi historinë, filologjinë dhe folklorin shqiptar. Të gjitha materialet e mblodhura janë botuar në një kolanë me 3 vëllime të titulluar *Albanesische Studien (Studime Shqiptare)*, Jena 1854, e cila hodhi themelet për studime shumëdisiplinore albanologjike. Përshkrimi i qytetit të Prizrenit u përfshi në *“Reise durch die Gebiete des Drin und Vardar” (Udhëtim nëpër rajonin e Drinit dhe të Vardarit)*, Vjenë 1867, 1869.

IV-11. Statuti i esnafëve të bakallit në Moskopolis (1779)

Së pari, do të ndërtojnë dashurinë mes nesh, si bazë për të mundur të gjithë armiqtë; së dyti, mjeshttrat do të jenë tepër të nderuar, sepse janë përgjegjës për të rinjtë; dhe kushdo që nuk u bindet urdhrave të mjeshtrit, duhet të përjashtohet nga shoqëria si i dëmshëm për të;

[...]

së shtati, çdo vëlla që trajtohet padrejtësisht, fyhet ose poshtërohet, nuk duhet të kërkojë hakmarrje gjëkund, përveçse të vijë para esnafëve dhe aty do të jepet dënimi i duhur;

së teti, nëse dikush kapet duke sharë më të vjetrit ose duke fyer njerëzit e nderuar që vizitojnë tregun do të fshikullohet në magazinat e tregut dhe në këtë mënyrë, të mësojë të sillt siç duhet;

së nënti, kur thirren nga mjeshtri, vartësit duhet të lënë çdo punë tjetër dhe ta ndjekin atë; gjithashtu, kur vdes një vëlla, duhet që të gjithë të shkojnë në varrimin e tij;

së dhjeti, çdo anëtar që zbulohet se krijon miqësi me një turk, për të përfituar peshk të konservuar me kripë, fasule ose diçka tjetër, do të përjashtohet nga esnafi;

së njëmbëdhjeti, dyqanet do të mbyllën të dielave, por të gjithë lejohen të qëndrojnë jashtë derës së dyqanit; dhe nëse dikush vjen dhe kërkon diçka, mund t'ia japin; gjithashtu, ata që i kanë dyqanet e veta, nuk kanë pse t'i vendosin gjërat e tyre në vende të tjera [...]

Bees, f. 527-528.

? Çfarë qëllimesh kryesore kishin bakallët? Si kërkonin t'i arrinin ata këto qëllime? Në këtë aspekt, njerëzit në Moskopolis, a ishin të ndryshëm nga zejtarët në Europën Perëndimore?

IV-12. Kontrata për marrjen e një çiraku në ishullin e Skirosit (1793)

Kjo letër shërben për të vërtetuar se Konstantis Aistratitisi është marrë vesh me Mastrojirakisit për t'i dhënë nipin e vet, Stamatisin, që të punojë për të, për dy vjet, pa pagesë; ndërsa Mastrojirakisit do t'i mësojë atij zanatin dhe do t'i sigurojë ushqimin,

veshjen dhe këpucët. Në fund të dy viteve, ai do ta marrë atë si ndihmës, që të fitojë rrogën e vet dhe do t'i japë vegla për të punuar.

Nëse Mastrojirakisit e përzë djalin, ai do t'i paguajë atij tridhjetë *gurush* në vit, por nëse fëmija largohet para se të mbarojnë dy vitet, ai nuk do t'i kërkojë asgjë Mastrojirakisit, as shumë e as pak, ndërkohë që ky i fundit mund të kërkojë t'i kthehen veshjet që ka bërë për të. Dokumenti në fjalë u hartua para dëshmitarëve të besueshëm.


1 maj 1793

Dhe nëse një zejtar tjetër do ta kërkojë djalin, ai duhet t'i paguajë Mastrojirakisit tetëdhjetë *gurush*. Papajanis, i biri i Kristofisit, dëshmitar Jorgis Mikaros, dëshmitar Papa-Joanis, i biri i Angelisit, dëshmitar"

Antoniadi, f. 176.

? Ç'mendim keni për këtë kontratë? A ishte e drejtë për të gjitha palët? A mendoni se duhet të ishte marrë edhe mendimi i Stamatisit për këtë çështje?

► Fig. 50. Fëmijë osmanë hipur në një rrotullame për festën e Bajramit



Hegyí, Zimanyi, f. 149, fig. 154.

IV-13. Fetvaja e Ebus-Suudit për ndalimin e kafeneve në perandori (çereku i tretë i shekullit të 16-të)

Pyetje: Sulltani, mbrojtës i fesë, mëse një herë i ka nxjerrë kafenetë jashtë ligjit. Gjithsesi, një grup horrash nuk dëgjojnë, por i mbajnë kafenetë si mjet jetese. Për të tërhequr njerëzit, ata punësojnë nxënës pa mjekër, dhe mbajnë gati vegla argëtimi, por edhe lojëra, si shah a tavëll. Batakçinjtë dhe vagabondët e qytetit mblidhen atje për të marrë opium a hashash. Përveç kësaj, pijnë kafe dhe, kur janë shumë të trullosur, merren me lojëra dhe dije të rreme, dhe i lënë pas dore lutjet e caktuara. Sipas ligjit, çfarë duhet t'i ndodhë një gjykatësi që mund t'i ndalojë këta shitës dhe pirës kafeje, por nuk e bën? Përgjigje: Ata që kryejnë këto veprime të shëmtuara duhet të ndalohen dhe frenohen me ndëshkim të rëndë dhe burgim të gjatë. Gjykatësit që nuk i ndëshkojnë këta persona, duhet të pushohen.

Imber, f. 93-94.



Kafeja erdhi në Perandorinë Osmane nga Afrika Lindore në mes të shekullit të 16-të. Gjatë shekujve XVI–XVII, autoritetet osmane e nxorën jashtë ligjit përdorimin e kafesë disa herë, por pa pasur sukses afatgjatë.



Cilat ishin argumentet e Ebus-Suudit kundër kafeneve?

Cilat ishin dëshirat e Ebus-Suudit dhe cili ishte realiteti i jetës në një qytet të madh?

IV-14. Këngë mejhaneje nga Senji⁶⁵

Të gjithë këndojnë në qytetin Senji,
Por jo nëna e Luka Desançitit,
Që ecën e trishtuar nëpër rrugët e Senjit.
Ajo po hyn në çdo mejhane [*mehana*],
Dhe mejhanet janë plot me njerëz.

Në një prej tyre ajo gjeti Ivesenjanin,
Së bashku me tridhjetë burra,
Duke pirë verë e duke kënduar.
Qan nëna e Luka Desançitit
Dhe futet e thotë:
'Zoti të bekoftë, kapiten i Senjit!
'Dashtë Zoti, zonja ime plakë,
Nëna e vëllait tim të gjakut, Luka Desançitit!
Ai mbush një gotë verë,
Dhe ia drejton asaj duke thënë:
'Pini verë, zonja ime plakë!'

Mijatovic 1974, f. 39-40.



Duke pasur parasysh se mejhanet ishin zakonisht vende për meshkuj, përpikuni të zbuloni pse burrat e Senjit pranuan të pinin verë me nënën e Luka Desançitit. E bënë sepse ajo ishte plakë, apo sepse ishte nëna e shokut të tyre? Ç'mendim keni për këngë të tilla mejhanesh, si mjete për t'i thurur lavde një mënyre të caktuar jetese?

IV-15. Shkrimet e Evlija Çelebisë për bakllavanë e Beogradit (1660)

Në tokat e Rumit dhe tokat e Arabisë dhe Persisë, mbi të gjitha është *bakllavaja* e Beogradit, e cila, për banketet në raste festash mbretërore, bëhet e madhe sa një rrotë karroce, prej një mijë petash [*gülläç*] dhe brumi të përgatitur me miell shumë të bardhë, gjalpë e bajame, dhe piqet në një furrë nëntokë [*tennur*]. Është kaq e madhe, sa nuk do të mund të futej në një furrë të zakonshme dhe secila prej tyre mund të ngopë më shumë se treqind njerëz. Është e madhe, e trashë, dhe e shijshme, por nëse hedh edhe një monedhë *akçe* të vetme, ajo do të zhytet në *bakllava*. Kjo është cilësia e lartë e *bakllavasë* së tyre. Dhe gjella e orizit të ëmbëlsuar që kanë, e gatuar me bajame dhe kanellë, dhe karafil e shafran, është gjithashtu aq e shijshme, sa nuk mund të krahasohet me asgjë [...]

Evlija Çelebi, f. 199

⁶⁵ Senji ishte qytet në bregdetin kroat, nën sundimin habsburgas dhe shërbente gjithashtu si bazë për piratët e Uskokut.

? A keni provuar ndonjëherë bakllava? A është e zakonshme në komunitetin tuaj? A është ndryshe prej asaj të përshkruar nga autori?

IV-16. Menuja e Shefki Mula Mustafait (Sarajevë, gjysma e dytë e shekullit të 18-të)

Unë, sekretari i varfër Shefki Mula Mustafa [...], një natë, pasi hëngra darkë me familjen time, fillova të mendoj se çfarë do të bëja për të ngrënë të nesërmen, dhe nëse do të kisha mundësi të kisha diçka për të ngrënë. Nuk isha i pasur, zahiretë e dimrit ishin mbaruar dhe nuk kisha para. Këto mendime nuk më lanë të flija, por ia lashë në dorë Zotit që ishte kujdesur për mua dhe për familjen time deri tani. Kjo më ndodhi në fund të janarit [Erbejin], kur dita ishte më e shkurtër dhe dielli ishte në solstic. Dhe vërtet, ditët në vazhdim, kur vija në shtëpi, haja për darkë:

IVd. Jeta pranë kufijve të ndryshëm

IV-17. Luftëtarët osmanë *deli*, të përshkruar nga udhëtari francez Nikola de Nikolai (1551)

Delitë janë aventurierë, të ngjashëm me kalorësinë e lehtë, detyra e të cilëve është të kërkojnë aventurën në vendet më të rrezikshme, ku kanë mundësi të tregojnë guximin dhe zotësinë e tyre nëpërmjet akteve heroike në luftë. Për këtë arsye e ndjekin me kënaqësi ushtrinë e sulltanit, pa pagesë (ashtu si edhe *akinxhinjtë*), por shumica prej tyre ushqehen dhe u sigurohen nevojat e tjera me shpenzimet e pashallarëve, guvernatorëve të përgjithshëm [*bejlerbejve*] dhe guvernatorëve [*sanxhakbejve*]; secili prej tyre ka në shpurën e vet një numër të caktuar prej tyre, nga më guximtarët dhe trimat. Ata jetojnë në zonat e Bosnjës dhe Serbisë, të cilat nga njëra anë janë në kufi me Greqinë, dhe nga ana tjetër me Hungarinë dhe Austrinë. Sot quhen serbë ose kroatë, por ata janë ilirët⁶⁶ e vërtetë. [...] Turqit i quajnë *deli*, që do të thotë *burra të krisur*

Natën e parë, byrek guzelma dhe tutmaç, natën e dytë, prodhime bulmeti [*mandra*], natën e tretë, hallvë të ngrohtë dhe mel me mjaltë, natën e katërt, supë me bollgur [*bulgur çorba*] dhe qebab veshkash, natën e pestë, plënc [*shirden*], djathë dhe bukë, natën e gjashtë, plënc [*shirden*], djathë e bukë, natën e shtatë, byrek guzelma, supë dhe byrek, natën e tetë, qebab dhe supë lakre, natën e nëntë, supë trahanaje, natën e dhjetë, qebab me misër të pjekur dhe natën e njëmbëdhjetë, qebab me supë jarina, e kështu me radhë.

Beşeskija, f. 54.

? Çfarë gjellësh osmane gatohen ende në vendin tuaj? Cilën prej tyre keni ngrënë kohët e fundit?

e të guximshëm. Megjithatë, mes tyre ata i thonë vetes *zataznicis* [*zatoçnici*], që në gjuhën e tyre do të thotë: ata që sfidojnë njerëzit [...]. Deliu i parë që kam parë ishte në Adrianopojë [Edrene] [...]. Ai kishte këtë pamje. Pjesa e poshtme e kaftanit të tij dhe pantallonat e tij të gjata e të varura, të quajtura *shallvare* nga turqit, ishin punuar me lëkurën e një ariu të ri, me pjesën me qime nga jashtë. Në *shallvare*, mbante këpucë ose çizme të shkurtra prej *safiani* të verdhë, me majë dhe shumë të larta tek thembrat, me shollë me gozhdë dhe të rrethuara me mamuze të gjata e të gjera. Në kokë kishte një kapele si ato të kalorësve polakë ose gjeorgjianë, që varej mbi një shpatull. Ajo ishte prej lëkure leopardi me pulla. *Deliu* kishte lidhur mbi të, në pjesën e ballit, krahun e madh të një shqiponje, që e bënte të dukej i frikshëm. Dy krahë të tjerë ishin lidhur me sumbulla të shkëlqyeshme mbi mburojën e tij, që ai e mbante varur mbi rrip. Në krah kishte një shpatë [*cimeterre*] dhe një kamë,

⁶⁶ Ilirët ishin një popullsi e lashtë që jetonte në Ballkanin Perëndimor. Në shkrimet e Rilindjes ishte e zakonshme që të bëhej lidhja midis njerëzve që jetonin në një territor me banorët e lashtë të atij vendi.

ndërsa në krahun e djathtë mbante një dajak [busdeghan], domethënë një topuz [...]

Disa ditë më vonë, kur ai u largua nga Adrianopoja [...], e pashë të ngjiste një kalë të bukur turk, të mbuluar me lëkurën e plotë të një luani të madh [...]; topuzi i varej tek shala dhe në dorën e djathtë mbante një heshtë të gjatë [...]

Për më tepër, isha kureshtar ta pyesja nëpërmjet një përkthyesi [dragomanī], se cilit popull i përkiste dhe çfarë feje praktikonte. Ai u përgjigj me mençuri, duke më treguar se ishte me kombësi serbe [...]; përsa i përket besimit të tij, ai tha se kur ishte me turqit thjesht bënte sikur i zbatonte ligjet e tyre, sepse ai ishte i krishterë prej lindjes, në zemër dhe me zgjedhjen e tij të lirë. Dhe për të më bindur plotësisht, ai recitoi në greqisht dhe sllavisht *Lutjen e së Djelës, Lutjen e Virgjëreshës Mari dhe Simbolin e Besimit*.

Nicolay, f. 226-227.

► **Fig. 51. Luftëtar osman deli (shekulli i 16-të)**



Nicolay, f. 228.

❓ Krahasoni përshkrimin me figurën dhe bëni një listë me tiparet e luftëtarit *deli*. Nëse ishte i krishterë, përse luftonte ai në ushtrinë osmane? A mund të krahasohen luftëtarët *deli* me “qentë e luftërave” të të gjitha kohërave? Gjeneroni një shembull nga një periudhë dhe vend tjetër.

IV-18. Institucioni i vëllamit në kufirin boshnjak (1660)

[...] pardje ushtria myslimane [...] mori shumë plaçkë luftime para qytetit të Splitit. Megjithatë, gjatë rrugës së kthimit, atyre u zunë pusi në malin e Prologut dhe qafën e tij. Të dyja palët u përplasën me njëra-tjetrën [...]

Kur të gjithë kalorësit dhe këmbësorët tanë, duke kërcyer si kaproj mbi tokën e thepisur shkëmbore, mbërritën në fushëbetejë, dhe kur të pafetë na panë, sulmuan si një tufë derrash.

[...] [Ushtria myslimane pati një fitore të madhe] [...] një mijë e gjashtëdhjetë koka armiqsh u prenë, shtatëqind e katër u zunë rob. [...] Nga ana jonë, shtatëdhjetë heronj vdiqën si martirë...

[...] Një luftëtar i kufirit [gazi] kishte fshehur një banditë të krishterë në një moçalishte. Kur trimi dhe ai i pafe që po fshihte u paditën tek pashai, pashai u zemërua dhe urdhëroi:

-Ma sillni këtu menjëherë atë burrë dhe robin që po fshihte.

Kur mbërritën të dy në vendin e ekzekutimit, pashai urdhëroi:

- Xhelat, shpejt! – trimi u përkul mbi qafën e robit, e duke thirrur e qarë tha:

- Aman, vezir i madh, ky rob dhe unë jemi bërë vëllamë në fushëbetejë, ne jemi vëllezër me besë. Nëse ti e vret, ai do të shkojë në parajsë me besën time dhe ky do të ishte një dëm i madh për mua; dhe nëse vdes unë, besa e robit, duke qenë se ai është vëllai im prej gjaku, do të më mbetet mua dhe që të dy do të shkojmë në ferr. Përsëri unë humbas. Ai u hodh mbi robin e vet dhe nuk deshi të ngrihej. Pashai i guximshëm pyeti:

- Hej, *gazi*, a është në rregull ky njeri? Luftëtar i kufirit [serhat *gazi*] u përgjigj:

- Kur në këtë zonë kufitare trimat tanë zihen rob nga të krishterët dhe atëherë hanë e pinë në një tavolinë

me ta, ata bëhen vëllezër gjaku me të krishterët dhe bëjnë betimin e besnikërisë. I krishteri i betohet myslimanit se do ta çlirojë atë nga robëria e të pafeve dhe myslimani i jep fjalën e tij të krishterit duke thënë: 'Nëse ti do të kapesh rob nga ne, unë do të çliroj nga turqit'. Kështu ata i japin besën [ahd-ü emam] njëri-tjetrit duke thënë: 'Besimi yt është imi dhe besimi im është yti'. 'Ashtu?' 'Po, kështu është'. Pastaj pijnë nga gjaku i njëri-tjetrit. Në këtë mënyrë, një i krishterë dhe një mysliman bëhen vëllamë. Dikur, ky njeri i shpëtoi jetën këtij myslimani. Tani, ky i pafe, në duart e këtyre njerëzve, është rob. Nëse vëllami i tij e fsheh dhe e shpëton, ai ka përmbushur fjalën e tij dhe besën. Kështu do ta marrë sërish besimin e vet dhe do t'i kthejë atij të tijin. Nëse ky i krishterë do të vritej tani, ai do të shkonte në parajsë, dhe myslimani do të shkonte në ferr me besimin e të pafeut. Edhe pse nuk është e shkruar as në librin e shenjtë mysliman dhe as në atë të krishterë, është shumë e zakonshme në këtë kufi. Kur pashait i treguan gjithë këtë histori, ai tha:

- Lirojini që të dy.
Të dy burrat u larguan nga sytë këmbët. Gjithsesi, ne të gjithë mbetëm të shtangur nga kjo bisedë.

Evlija 1996, f. 145-148.

? Mendoni se vëllami është një formë e zgjuar për të mbijetuar në një zonë kufitare, apo një mënyrë tradhtare për t'u miqësuar me armikun?

IV-19. Kërkesë osmane për një doktor nga Raguza (1684)

Ju falemi, o të nderuar miqtë tanë të guximshëm e të vlefshëm, ju princi dhe bejlerët e Raguzës, nga unë, kapiteni i Gabelas dhe Neretvas dhe agallarët e tjerë të Gabelas.

Agai ynë i vjetër, Abaz Sagraviçi, është sëmurë, ai ka gazra dhe është enjtur poshtë belit. Nuk kemi ndonjë zanatçi këtu që të na thotë se çfarë sëmundjeje ka dhe që të mund ta kurojë me sukses; kështu që nëpërmjet kësaj letre, ju kërkohet me mirësjellje të na dërgoni doktor Nikola Boljahniçin nga Stoni.

Miovic-Peric, f. 285.

? Në ç'mënyrë i zbehte dallimet fetare e politike të jetuarit në kufi? A duhet të ketë shkruar doktori nga Raguza për të kuruar aganë osman?

IV-20. Letra e Simun Koziç Benjas, peshkop i Modrusit, drejtuar papës Leo X (1516)

[..] ju njoftoj, Shenjtëria juaj, se jemi në trysinë e mjerimit të mundshëm nga të gjitha anët [...]; njerëzit tanë janë të detyruar të bëjnë marrëveshje paqeje me turqit dhe t'u paguajnë atyre haraç. [...] Dhe ju lutem, dëgjojeni zërin tonë në këtë gjendje të dëshpëruar. Shqyrtojeni mirë çështjen tonë të drejtë, pranoni kërkesat tona, ti Zot i gjithëpushtetshëm, Trini e shenjtë, Besim i Shenjtë, për të cilat kemi ruajtur të paprekur besnikërinë tonë deri tani, në përndjekjen dhe ankthin më të vështirë. Të gjitha zemrat janë të hapura ndaj teje dhe dëshirat sekrete të secilit nuk të janë fshehur. Ju keni parë mjerimin e popullit tuaj dhe e dini se nuk mund të durojmë më përballë fytyrës së armikut. Së fundmi, duke mos pasur asnjë faj, jua them hapur: kam frikë, Baba i dashur, se bashkatdhetarët tanë të varfër, për shkak të varfërisë dhe dëshpërimit, mund të detyrohen të luftojnë krahas turqve dhe të grabisin të krishterë të tjerë.

Gliga, f. 84-85.

? Cili ishte rreziku më i madh i shprehur në letrën e peshkopit të Modrusit? Ç' del në pah në letrë: shqetësimi për shpëtimin e bashkatdhetarëve apo rreziku i të krishterëve jashtë Kroacisë?

IV-21. Letra e Fran Kërsto Frankopanit për Gaspar Kolnicin (1670)

Urimet më të mira për ty, Kolnic, kapiten prijës! Lavdi Zotit, që burrat tanë arritën dhe janë të pajisur mirë. Mora një letër nga kryetari [Zrinski] për të shkruar atje dhe për të përgatitur kryengritjen; do të punoj ditë e natë që kryengritja të nisë sa më shpejt që të jetë e mundur. Burrat e mi dhe unë jemi gati dhe

mezi pres t'i shoh helmetat tona të përzihen me çallmat; dhe betohem për Zotin, ushtria austriake [krilaki] do të shkatërrohet. [...] Këtë radhë ne do të vendosim si dhe kur do të godasim; dhe nëse është e nevojshme, do t'i bëj vetë një vizitë pashait boshnjak, për të përcaktuar çështjen dhe për të rënë në një mendje për fillimin e aksionit. Kam besim tek Zoti se do të kemi sukses; vetëm nëse e godasim armikun drejt e në kokë, nëse nuk i lejojmë gjermanët [Plunderhosens (gjermanisht) = "pantallonagjerët"] të vijnë në vete. Nëse kryetari më dëgjon mua [...], çdo gjë do të shkojë mirë dhe unë do t'i marr përsipër të gjitha përgjegjësitë, sepse unë di si të merrem me gjermanët.

Mijatovic 1999, f. 90.



Kjo letër ka të bëjë me të ashtuquajturin "komploti Zëriniski". Peter Zëriniski dhe Fran Kërsto Frankopani ishin fisnikë të rëndësishëm kroatë, që kishin poste të rëndësishme në Kroacinë e qeverisur nga Habsburgët në vitet 1660. Edhe pse që të dy, kishin luftuar më parë me guxim kundër turqve, ata mbetën të pakënaqur nga planet e Habsburgëve për përforcimin e absolutizmit në kurriz të çifligjeve të privileguara, dhe planifikuan rrëzimin e Habsburgëve, me ndihmën e Francës ose Osmanëve. U ekzekutuan si komplotistë më 1671. Zëriniski dhe Frankopani u shpallën më vonë luftëtarë të hershëm për pavarësinë e Kroacisë dhe/ose Hungarisë.



Analizoni politikën e ndjekura nga Frankopani, duke patur parasysh se vetëm dy vjet përpara se t'i shkruante këtë letër Kolnit, ai kishte shkruar një poemë: "Ejani vëllezër të dashur, ngrihuni në këmbë/ Duhet të shkatërrojmë brirët e hënës turke/ Për besimin e krishterë, për hir të kalorësisë/ Për hir të botës dhe nderit tonë/ Mos e kurseni jetën".

IV-22. Këngë për sulmin kroat mbi Kladushë

Tadija Senjanini fillon të flasë:
'Ka pasur shumë e shumë heronj të mëdhenj,
Dhe tani vetëm pesëdhjetë kanë mbetur.
Ejani vëllezër, në qytetin fushor të Kladushës, Të grabisim kullën e Orusit.

Le ta shohin jeniçerët turq,
Se si janë serdarët e Kotorit! Atë që thanë, nuk e mohuan,
Kështu që shkuan në qytetin fushor të Kladushës,
Deri në kullën e kapitenit Orus.
Ata grabitën, i morën gjithçka nga kulla e bardhë,
I përzunë djemtë e vajzat turke,
Ushtruan dhunë në gjithë Kladushën. Ata vunë përpara qetë e shëndosha, Ata vunë përpara shumë kuaj turq, Dhe u kthyen në Ravni Kotari.
Ata festuan për një muaj,
Por mund të festonin për një vit të tërë, Aq shumë pasuri kishin marrë.

Mijatovic 1974, f. 102.



Krahasoni sulmin kroat mbi Kladushën osmane, me sulmet osmane që përshkruhen në burimin I-10. A u sollën të krishterët më mirë se myslimanët?

IV-23 Marko Krajleviçi pi verë gjatë muajit të Ramazanit

Sulltan Sulejmani shpalli këto ligje:
"Asnjë burrë të mos pijë verë gjatë Ramazanit".
"Asnjë burrë të mos veshë rroba jeshile".
"Asnjë burrë të mos mbajë një shpatë të kalitur".
"Asnjë burrë të mos kërcejë me një vajzë turke".

Markoja kërceu me të gjitha vajzat turke.
Markoja mbajti shpatë prej metali të kalitur.
Markoja veshi pelerinë të gjelbër të ndezur.
Markoja piu shumë verë gjatë Ramazanit – madje i detyroi të gjithë klerikët myslimanë, dhe haxhilerët e shenjtë, të pinin me të!
[...]

Kur mori vesh këtë histori Sulltan Sulejmani,
Thirri dy lajmëtarë, dhe u tha atyre që t'i thonin Marko Kraljeviçit, se unë, Sulltan Sulejmani,
thërras Markon para gjyqit tim!"
[...]

Sulltan Sulejmani i foli atij ashpër: "
Marko Kraljeviç, biri im, ti e di mirë,
që unë kam dhënë këto udhëzime të prera [...].
Kam dëgjuar nga disa burra të ndershëm gjëra
jo të mira për ty.

Ata thonë se ti nuk u je bindur urdhrave të mia [...].

Dhe Marko Kraljeviçi iu përgjigj sulltanit:
 “O babai im i dashur, sulltan Sulejmani!”
 Nëse unë pi verë gjatë Ramazanit,
 Besimi im ma lejon këtë: unë nuk jam mysliman.
 Dhe nëse unë i nxis klerikët dhe haxhilerët
 Për të pirë me mua, është sepse unë i kam inat
 Burrat esëll që më shohin teksa jam duke pirë –
 Shtëpia ime nuk është tavernë: le të mos vijnë po
 të duan!

Dhe nëse unë vesh një pelerinë të gjelbër, e bëj
 sepse Jam i ri dhe e di që më shkon.
 Nëse mbaj një shpatë prej metali të kalitur,
 Është imja, e blerë me para të ndershme.
 Dhe nëse më pëlqen të kërcej me vajza turke-
 Unë nuk jam i martuar. O sulltan! Edhe ti
 Ke qenë dikur një djalë i ri, pa halle dhe pa gra!

Dhe nëse unë e shtyj prapa kapelen time,
 e bëj sepse fytyra më skuqet,
 kur flas me një mbret.

Sa për mbajtjen e shpatës të lirë në mill -
 Kam frikë se për këtë gjë mund të debatohet!
 Por, nëse dikush do të fillojë një zënkë,
 Kush të jetë më afër meje, do ta ketë pisk punën!”
Serbi, f. 209-215

❓ Përse sulltani urdhëroi ato ndalime? A ishin të motivuara nga feja apo ishte thjesht një përpjekje nga ana e shtetit për të mbajtur nën kontroll individët “e shthurur”? Cila ishte sjellja e heroit të baladës ndaj autoritetit të sulltanit? Ç’nxjerr në pah kjo sjellje lidhur me legjitimitetin e sunduesve?

IV-24. Letër e Petar Petroviç Njegoshit, dërguar Ali Pashë Rizvanbegoviçit (rreth vitit 1834)

Unë, Petar Petroviçi, peshkop i Malit të Zi dhe *Kalorës i Carit të Rusisë*, i dërgoj përshëndetjet më të ngrohta vëllait tim të gjakut, Ali Pashës, *Kalorësit të Carit të Turqisë* dhe vezirit të gjithë Hercegovinës. Po ju shkruaj që t’ju bëj me dije, se e mora letrën tuaj në të cilën më shfaqnit dëshirën tuaj që populli juaj dhe i imi të ruanin paqen me

njëri-tjetrin dhe që e keqja të shfarosej një herë e mirë. Më kanë çuditur fjalët tuaja, sepse unë kam respektuar atë për të cilën ne ramë në një mendje në Dubrovnik dhe nuk kam lejuar asnjë *ushkok* (rebel) hercegovinas të hyjë në vendin tim, ndërsa ju keni vendosur patrulla me ushtarë të cilët po u presin kokat malazezëve, po sulmojnë dhe vrasin barinjët, dhe u marrin gjë e plaçkë. Ata gjithashtu bëjnë padrejtësi dhe krijojnë paqëndrueshmëri të ligjit si asnjëherë më parë, dhe për më tepër, ju u bëni atyre dhurata kur ju sjellin kokën e një malazezi. Kurrë nuk është dëgjuar që njëra palë të ruajë paqen dhe të mbajë besën, ndërsa tjetra ta shkelë me këmbë këtë besë për paqen dhe të bëjë ç’ka do. Unë po i nënshtrohem asaj që kemi rënë dakord, dhe ju, nëse keni dëshirën e mirë, duhet të caktoni njerëz të ndershëm dhe jo *hajdukë* (kaçakë), të cilët e shtypin popullin e gjorë. Vetëm në këtë mënyrë mund të rivendoset paqja mes nesh, nëse ju vërtet e doni këtë gjë. Tani, ju lutem, më ktheni përgjigje se ç’mendim keni në lidhje me zëvendësimin e ushtarëve.

Petar Petroviç Njegos, *Letra të zgjedhura* f.129.



Statusi i Grahovos ishte shqetësimi kryesor në lidhje me kufijtë, në kohën kur metropolit Petar II, Petroviç Njegoshi (1813-1851) erdhi në pushtet. Pas një sërë konfliktesh dhe marrëveshesh të dështuara, kontradiktat u zgjidhën në bisedimet e mbajtura në Cetinë, në nëntor të vitit 1838. Aty u nënshkrua një traktat paqeje ndërmjet të dërguarit të vezirit të Bosnjës dhe Hercegovinës dhe “Krahinës së pavarur të Malit të Zi”, pavarësia politike e së cilës ishte mohuar vazhdimisht nga pashallarët osmanë, dhe banorët e Grahovos ishin të detyruar t’u paguanin taksa autoriteteve turke. Kontradiktat e vazhdueshme midis Malit të Zi dhe Hercegovinës i detyruan metropolitin Petar II dhe vezirin e Hercegovinës, Ali Pashë Rizvanbegoviç-Stoçeviçin të rihapnin negociatat për zgjidhjen e konflikteve kufitare. Pas tri ditë bisedimesh në Dubrovnik, në shtator të vitit 1842, ata nënshkruan një marrëveshje paqeje në të cilën theksohej se palët nënshkruese ishin “Krahina e pavarur e Malit të Zi dhe Pashallëku i Hercegovinës”. Në këtë mënyrë, Ali Pasha e njohu pavarësinë e Malit të Zi, ndërkohë që veziri i Bosnjës e kishte bërë këtë më parë. Me këtë rast, Njegoshi dhe Ali Pasha u bënë edhe vëllezër gjaku. Shpesh herë ata shkëmbyen letra të mbushura me premtime për miqësi të përjetshme.

IV-25. Ndikimi i të krishterëve tek myslimanët shqiptarë

Fqinji i tij i krishterë ka ndikuar mbi shqiptarin mysliman. Ai pi verë dhe e ka shumë qejf birrën – unë pata mundësinë të gjeja birrë me shishe nga Mynihu – dhe ai bënte be për Shën Mërinë.

Fraser, f. 258

IVe. Aspekte nga jeta e grave

IV-26. Martesa “mbretërore” në shekullin e 15-të

[...] Sulltan Murati⁶⁷ grumbulloi një ushtri, me të cilën kishte si qëllim të pushtonte gjithë tokën e despotëve [vilajetin]. Kur e dëgjoi këtë gjë, despoti Gjuraq Brankoviçi⁶⁸ nisi të dërguarit e tij edhe njëherë tek sulltani. I dërgoi ata me shumë dhurata dhe me një mesazh: “Prika e vajzës sime është gati, dërgoni një njeri të marrë skllaven, gruan tuaj.”

Pashallarët i thanë sulltanit: “Duhet ta pranosh ofertën”. [...] Që nga Shkupi, ata dërguan gruan e Isak-beut [...] dhe vajtën drejt e në Smederevo. Brankoviçi dërgoi gra të aristokracisë jomyslimane për t’u takuar me ta dhe organizoi një mirëseardhje të pazakontë. Ata i shoqëruan të ardhurit në Smederevo me respekt të madh [...] Ata bënë një listë të pajës së vajzës së re. Më pas ia dhanë listën Uzbek agait. Thuhet, se atëherë Brankoviçi tha: “Unë nuk ia dhashë pajën vajzës sime, ia dhashë perandorit. Nëse ai ka dëshirë (do), mund t’ia japë kësaj skllaveje të tij; nëse jo, ai mund t’ia japë ndonjë skllaveje tjetër të tij.”

Për t’i rënë shkurt, ata e çuan vajzën në Edrene. Perandori nuk organizoi një dasmë për të, duke thënë: “Pse duhet bërë një dasmë për vajzën e një spahiu të pafe?”

Elezović, f. 18.

? Përse martesat midis dinastive përdorshin për të lidhur shtetet me njëri-tjetrin? Çfarë zgjedhjeje mund të bënin princeshat në këtë aspekt? A “përdorshin” gratë dhe vajzat? Si e sheh kronikani osman martesën e Muratit me Marën? Ç’lloj mentaliteti del në këtë burim?

⁶⁷ Murati II (1421-1451).

⁶⁸ Shih tekstin I-8, veçanërisht shënimin në fund të faqes, numër 18.

? Si mund të ndikonin të krishterët dhe myslimanët tek njëri-tjetri? Gjeni shembuj të tjerë të ndikimit të ndërsjelltë.

IV-27 Gratë shqiptare (rreth vitit 1810)

Unë nuk kam ndonjë dëshirë të madhe të flas për moralin e shqiptarëve. Gratë e tyre, të cilat janë pothuajse të paarsimuar dhe nuk flasin asnjë gjuhë tjetër përveç të tyre, konsiderohen si bagëtia e tyre dhe përdoren si të tilla (por të llojit më të mirë), të detyruara të punojnë dhe ndëshkohen shpesh nga goditjet. Në të vërtetë, ata kanë përbuzje dhe madje neveri për femrat e tyre, dhe nuk ka asgjë në prirjet e tyre rastësore që mund të quhet ajo çka ne e thërrasim pasion të ëmbël.

Megjithatë, të gjithë ata që munden, martohen, sepse kjo është shenjë mirëqenieje, martohen, meqë kanë dëshirë të kenë në shtëpi një skllave. Megjithatë, si në shumicën e vendit, femrat nuk janë aq të shumta në numër sa seksi tjetër; zakonisht nusja nuk sjell prikë tek burri i saj, por burri tek ajo; ai është i detyruar të grumbullojë rreth 1000 gurush [piastra], para se të kërkojë të martohet.

Broughton, f. 136.

? Për ç’arsye gratë e përmendura në këtë burim trajtoheshin kaq keq? Ç’mendon autori për këtë? Mundohuni të kuptoni se cila ishte ideja e tij mbi martesën normale?

IV-28. Solidariteti ndërmjet grave të krishtera – flijimi i Shën Filoteas (1589)

Gjatë asaj kohe [...] gratë e burgosura në Athinë vinin nga vende të ndryshme. Fjalët nuk mund ta përshkruajnë të ndjerën e dashur Filoteja, mirësinë

e saj, zemërgjerësinë e saj, si dhe ngacmimet dhe rreziqet që ajo kishte përjetuar për të shpëtuar dhe liruato ato gra të skllavëruara. [...] Katër nga gratë e skllavëruara kishin dëgjuar mbi reputacionin e gruas së shenjtë dhe kur gjetën mundësinë, u arratisën nga pronarët e tyre, të cilët po i detyronin që të ndryshonin fenë, dhe vajtën ta gjenin atë. Ajo, me interesimin dhe mirësjelljen që e karakterizonte, i mirëprititi dhe i mësoi të tregoheshin guximtare, të përballonin rreziqet dhe të mos ankoheshin për skllavërinë e tyre; madje u përpoq shumë që t'i kthente në shtëpitë e tyre. Kur morën vesh se çfarë kishte ndodhur, pronarët e këtyre grave vajtën tek shtëpia e saj, e morën me forcë dhe e nxorën para guvernatorit mysliman, i cili e futi në burg. Gruaja karizmatike, që në ato çaste ishte gjithashtu mëshirëplotë, ishte gati të sakrifikohe veten e saj për të mos tradhtuar ato gra të gjora, dhe kështu të zbatonte në praktikë çfarë thonin fjalët e Ungjillit.

Synaxaristis, f. 325-326.



Më 19 shkurt, Filoteja vdiq për shkak të plagëve që i kishin bërë. Ajo u shenjtërua dhe u bë një nga mbrojtëset shpirtërore të Athinës.



Përse vepronte Filoteja në këtë mënyrë? A konsideroheshin si krime veprimet e saj nga ligjet osmane?

IV-29. Akti themeltar i Esnafit të Grave Sapunprodhuese në Triki, Thesali (1738)

Gratë e *Esnafit Sapunprodhues* – Stamuloja, Vasilikia, Margaroni, Arkontoja, Venetoja, Angeloja, Pagona, Triantafillia, Kaidoja dhe Ekaterina – u paraqitën përpara meje, në cilësinë e kryetarit dhe përpara klerikëve të nderuar dhe fisnikëve të qytetit të Trikisë, dhe deklaruan se ishte një traditë e vjetër që burrat nuk duhej të përfshiheshin në këtë shoqëri a të praktikonin këtë mjeshtëri. Kështu, ato u morën vesh njëzëri dhe na kërkuan që të ratifikonim këtë marrëveshje dhe ta përfshinim në kodikun e shenjtë; dhe nëse në të ardhmen një grua do të dëshironte të hynte në shoqëri, një vajzë a kunatë e tyre, për të punuar në prodhimin e sapunit, duhej të paguanin shumë prej pesë gurush, sikurse ndodh dhe në

rastin e esnafëve të tjera. Nëse ndonjëra nga gratë do të vdiste, askush nuk lejohej të merret mjetet e punës, të cilat do të shpërndaheshin vetëm ndërmjet grave të esnafit. Në rastin kur ndonjë i/e huaj do të tentonte të praktikonte të njëjtën mjeshtëri (prodhimin e sapunit), pa lejen e këtyre grave, duke shkelur këtë marrëveshje dhe urdhrin e kishës, ai ose ajo do të ndëshkoheshin si nga kisha, dhe nga autoritetet turke dhe duhet t'i paguanin shumë prej dhjetë gurush, esnafit dhe pesëmbëdhjetë gurush, kishës. Ne po e themelojmë këtë esnaf ku nuk do të bëjnë pjesë burrat, dhe ky do të jetë nën kujdesin dhe mbështetjen e klerikëve dhe të fisnikëve. Pas kësaj, u hartua ky dokument, i cili u miratua prej meje, në praninë e klerikëve dhe fisnikëve të nderuar të qytetit tonë të Trikisë dhe u përfshi në kodikun e shenjtë: 1738, 27 korrik.

Giannoulis, f. 45.



Ç'mekanizma krijuan gratë e Trikisë për të mbrojtur interesat e tyre?

► Fig. 52. Zonja e Athinës (1648)



Asdrachas, fig. 71.

IV -30. Divorc në një fshat afër Sofjes (1550)

Ky procesverbal, mbajtur në regjistrin e kadiut, vërteton se jomyslimani Pejo, i biri i Radulit, që jeton në fshatin Birimirçe pranë Sofjes, u paraqit para gjykatës së shariatit, në praninë e gruas së tij Stojana, e bija e Nikollës dhe bëri deklaratën e mëposhtme, me vullnetin e tij të plotë:

“Unë i dhashë divorcin të sipërpërmendurës Stojana, sipas zakonis tonë të rremë⁶⁹; që sot e tutje, ajo është e divorcuar.” Pas kësaj deklaratë, e sipërpërmendura Stojana, e cila ishte e pandehur, e konfirmoi atë dhe kjo deklaratë u regjistrua me miratimin e saj.

[...]

Dëshmitarë: Hajdar beu; elhak Ali, i biri i Sulejmanit, shpërndarësi i thirrjeve për gjyq; Seid Kasumi, i biri i Seid Mehmetit muteveli; përkthyes: Sinani, i biri i Abdullahut, etj.

Turski Izvori, 2, f. 104.

🔑 Kjo çështje është e veçantë, sepse divorci u ligjërue në gjyqin e kadiut, i cili ishte gjyq që zhvillohej për myslimanët. Në shumicën e rasteve, divorcet ndërmjet të krishterëve shpallehin vetëm në gjyqet për të krishterët.

? Si mendoni, përse Pejo dhe Stojana donin që divorci i tyre të bëhej zyrtar edhe në gjyqin e kadiut, edhe në gjyqin e krishterë?

► Fig. 53. Grua turke me fëmijë (1568)



Nicolay, f. 142.

► Fig. 54. Grua turke me veshjen që dilte në qytet – vizatim francez (rreth viteve 1630)



Hegy, Zimanyi, f. 149, fig. 149.

⁶⁹ Këtu do të thotë, sipas zakonis të krishterë.

IV-31. Rasti i një gruaje qipriote që merr divorcin duke u konvertuar në islam (1609) – marrë nga regjistri i *kadiut*

Husna, e bija e Muratit, grua armene, thotë para burrit të saj, Mergerit, i biri i Kulukut, armen: Ai gjithmonë më trajton me egërsi. Nuk e dua. Ai e mohon këtë gjë. Më pas, Husna konvertohet në islam. Pasi ajo merr emrin Aishe, burri i saj ftohet të konvertohet në islam, por ai nuk pranon. Kështu që u dha urdhri që Aishja të ndahet prej tij.

Jennings 1993, f. 141.

? A mendoni se konvertimi i Husnës ishte i sinqertë apo kjo ishte një mënyrë për t'i shpëtuar një burri mizor?

► Fig. 55. Vajzë malësore e Shqipërisë së Veriut (fillimshkulli i 19-të)



? Analizoni veshjet e këtyre grave. Cilat janë elementet e veçanta osmane? Gjeni foto të tjera grash dhe vajzash nga pjesë të tjera të Europës gjatë së njëjtës periudhë. Krahasoni mënyrën se si vishen ato.

IV-32. Regjistrimi tek *kadiu* i divorcit të një burri mysliman dhe një gruaje të krishterë (1610)

Jusufo, biri i Mehmetit nga Lefkoshë, thotë para gruas së tij Mereme, e bija e Ilias, nënshtetas jomysliman [*zimije*]: Gruaja ime Mereme është e pafe [*qafire*]. Kur unë e ftova të konvertohej në islam, ajo nuk pranoi, prandaj unë e ndava atë tri herë. Tani unë jam i divorcuar. Ajo është një e divorcuar.

Jennings 1993, f. 141.

🔑 Ligji mysliman lejonte një burrë mysliman të martohej me një grua jomyslimane, e cila mund të mbante besimin e saj. Në këtë rast të veçantë, Jusufi përdori si një argument më shumë, ndryshimin në besimin fetar, për të justifikuar divorcin. Vini re, gjithashtu, procedurën shumë të thjeshtë që ndiqej për të divorcuar myslimanët.

? A ishte divorci për myslimanët më i lehtë se për të krishterët?

IV-33. Tradhtia bashkëshortore e një jeniçeri me një grua myslimane në Stamboll (1591)

Është e pamundur për mua të mos flas mbi historinë e një gruaje turke, e cila pati marrëdhënie me një jeniçer të ri, Mustafanë. Ajo ishte e re dhe e bukur. Një pasdite, Mustafai e ftoi atë për t'u argëtuar dhe unë i gjeta disa qirinj dhe verën më të mirë. Për mua, vera ishte shumë e mirë, për vetë faktin se ishte nga Bohemia. Gruaja kishte një burrë shumë plak, i cili kishte shumë pak besim tek ajo. Ajo nuk dinte se si të vinte tek vendi i takimit në kohën e duhur, kur e kishte lënë takimin, pak përpara perëndimit të diellit (zakonisht rreshteri ynë dilte për t'u falur gjatë kësaj kohe). Prandaj ajo i tha burrit të saj që do të shkonte për të bërë banjë. Gjithashtu, ajo mori me vete dy gratë e saj shërbëtore, të cilat si zakonisht i mbanin rrobat në legenë të mëdhenj prej bakri, të mbuluara me qilima, dhe kur po kalonin përpara ndërtesës sonë, i vinin asaj nga pas. Banja publike e gruas së bukur nuk ishte larg; Ruka, grua e sulltanit turk, e kishte ndërtuar këtë banjë dhe ua kishte ndaluar burrave të hynin në të. Nëse ky

urdhër shkelej, ata i priste vdekja. Gjatë kohës që po ecte para ndërtesës sonë, gruaja ia bëri me shenjë jeniçerit se do të vinte në takim. Burri i saj dyshues e ndiqte nga pas dhe kur ajo hyri në banjën publike, ai qëndroi përpara ndërtesës, duke prituri që ajo të mbaronte. Po kush është i zoti të zbulojë dredhitë e një gruaje? Ajo kaloi para shtëpisë sonë me një veshje ngjyrë të gjelbër, por në banjën publike ajo ndërroi rrobat dhe veshi ato që kishte sjellë me vete; dhe pasi i la shërbyeset e saj ta prisnin atje, ajo doli nga banja publike dhe takoi jeniçerin e veshur me të kuqe. Ai e mirëpriti dhe e ftoi në apartamentin e tij, e argëtoi në mënyrë të shkëlqyer dhe pasi hëngrën drekë, e nxori nga porta e pasme. Ajo vajti tek banja publike për së dyti, u la dhe vajti në shtëpi me burrin e saj. Unë nuk mund të çmoj dredhinë e asaj gruaje aq sa e meriton, dhe shumë herë unë dhe jeniçeri qeshnim, sa herë e kujtonim.

Mitrovic, f. 107-108.



Venceslas Bratislav von Mitrovici ishte shoqëruesi i ambasadorit austriak në Stamboll në vitin 1591 dhe ishte një vëzhgues i kujdesshëm i shoqërisë osmane.



Cili ishte qëndrimi i autorit ndaj tradhtisë bashkëshortore?

IV-34. Komente të zonjës Mari Uortlei Montagu mbi gratë osmane (1717)

Unë kurrë nuk kam parë në jetën time kaq shumë koka me flokë të bukur. Kam numëruar njëqind e dhjetë kaçurrela tek një grua, të gjitha natyrale. Dhe duhet thënë, se këtu të bukurat janë më të shumta se tek ne. Është e habitshme të shikosh një grua ose vajzë që të mos jetë shumë e bukur. Ato kanë ndërthurjet e tipareve më të bukura në botë dhe zakonisht sy të mëdhenj të zinj. Mund t'ju siguroj me vërtetësi, se Oborri i Anglisë, që unë e vlerësoj si më të bukurin në botën e krishterë, nuk mund të paraqesë kaq shumë bukuri sa ç'kemi këtu nën mbrojtjen tonë. Zakonisht ato u japin formë vetullave dhe si greket, ashtu dhe turket kanë zakon

t'i nxijnë sytë rreth e rrotull në brendësi, që kur i sheh nga larg ose nën dritën e qiriut, të krijohet përshtypja se u shtohet thellësia e ngjyrës së zezë. Mendoj se shumë nga zonjat tona do të gëzoheshin fort po ta mësonin këtë sekret. [...]

Lidhur me moralin ose sjelljen e mirë, unë mund të them, si Harlekini, se ndodh e njëjta gjë si dhe me ju; gratë turke nuk mëkatojnë më pak se të krishterat. Tani që unë jam familjarizuar disi me traditat dhe zakonet e tyre, nuk mund të mos adhuroj ose maturinë e rrallë, ose budallallëkun e skajshëm të të gjithë shkrimtarëve të cilët kanë folur për to. Është e thjeshtë të shohësh se ato kanë më shumë liri se ne; asnjë grua, e çfarëdo rangu shoqëror qoftë, nuk mund të dalë në rrugë pa dy mbulesa: njëra që mbulon të gjithë fytyrën e saj, përveç syve dhe tjetra që i mbulon të gjithë kokën dhe i varet deri në mes të kurrizit. Edhe format e tyre mbulohen nga diçka që quhet *ferexhe*, pa të cilën nuk del asnjë grua. [...] Në dimër, ajo është prej pëlhure, ndërsa në verë, prej materiali të thjeshtë ose mëndafshi. Atëherë, mund ta merrni me mend se sa lehtë maskohen ato, nuk ka mundësi të dallosh zonjën e madhe nga shërbëtorja dhe është e pamundur dhe për burrin më xheloz të njohë gruan e tij kur e takon atë. Dhe asnjë burrë nuk merr guximin të prekë ose të ndjekë një grua në rrugë.

Kjo maskaradë e vazhdueshme u jep atyre lirinë e plotë për të ndjekur parapëlqimet e tyre, pa u rrezikuar se mund të zbulohen. [...] Gjithashtu ato nuk kanë arsye që t'i druhen inatit të burrave të tyre. Ato gra që janë të kamura, kanë në duart e tyre të gjithë pasurinë që e marrin me vete në rast divorci, plus një shtese që burri është i detyruar t'u japë. [...] Është e vërtetë, ligji u lejon burrave të kenë katër gra, por nuk ka raste që një burrë serioz të vendosë ta përdorë këtë mundësi ose që një grua e një rangu të lartë të përjetojë një gjë të tillë. Kur një burrë nuk është besnik, dhe këto gjëra ndodhin, ai e mban dashnoren e tij në një shtëpi më vete dhe e takon atë sa më fshehtas që të mundet, çka ndodh dhe me ju. [...]

Pra, siç e sheh motër e dashur, sjelljet e njerëzve nuk ndryshojnë kaq shumë sa na bëjnë të mendojmë shkrimtarët e ndryshëm që udhëtojnë në këto vende.

Montagu, f. 70-72.



Zonja Montagu ishte gruaja e ambasadorit britanik në Perandorinë Osmane. Letrat e saj tregojnë jo vetëm talent letrar, por edhe mprehtësi dhe njohje të brendshme të shoqërisë osmane.



Duke patur parasysh ngjarjen e treguar nga Mitrovici (burimi IV-33), vlerësoni nëse zonja Montagu kishte të drejtë në lidhje me përparësitë që ka veshja myslimane për gratë që shkelin kurorën bashkëshortore. Përse zonja Montagu e krahasoi situatën e grave osmane me atë të grave britanike? Ishte thjesht shpirti i kontradiktës apo ajo kishte argumente të qëndrueshme për këtë? Bëni një listë me dallimet midis grave me status të ndryshëm shoqëror në Perandorinë Osmane. Cilat ishin shkaqet kryesore të këtyre dallimeve? Besimi fetar? Statusi shoqëror? Sjellja vetjake?

KAPITULLI V: Aspektet e krizës

Shumë historianë bien në një mendje se gjatë fundit të shekullit të 16-të Perandoria Osmane filloi të dobësohej dhe se rënia e saj zgjati më shumë se tre shekuj, deri në fund të shpërbërjes së perandorisë, në fillim të shekullit të 20-të. Të tjerë studiues, që nuk pajtohen me këtë tezë, përcaktojnë si fillimin e dobësimit të Perandorisë ose vitin 1683, kur rrethimi i dytë i Vjenës nga osmanët dështoi dhe kur Perandoria filloi të humbë luftërat dhe territoret në Europë, ose fillimshekullin e 19-të, kur Perandoria Osmane u përfshi si nga ana ekonomike, dhe nga ajo politike në sistemin botëror të mbizotëruar nga bota perëndimore. Tema e rënies së Perandorisë Osmane, edhe pse është trajtuar gjerësisht në studimet historike të shekullit të 20-të, nuk është diçka krejt e re. Kjo temë shfaqet shpesh në shkrimet e shekullit XVI – XVII, ku dijetarët osmanë argumentonin se ‘rendi i vjetër i mirë’ i ‘epokës së artë’ të Sulejmanit I (1520-1566) ishte shkatërruar nga trazirat dhe korrupsioni. Historianët e kanë hedhur poshtë këtë ide, duke e paraqitur si një mjet ideologjik të përdorur nga elita osmane në përplasjet e brendshme të saj. Studimet e kohëve të fundit nxjerrin gjithashtu në pah se Perandoria Osmane arriti ta kapërcente krizën e fundshekullit të 16-të dhe fillimshekullit të 17-të nëpërmjet një procesi modernizimi, monetarizimi dhe burokratizimi, i cili, në fakt, ishte i ngjashëm me ndryshimet që ndodhën në monarkitë më të rëndësishme europiane dhe aziatike të fillimit të epokës moderne. Kështu, këto studime mbështesin tezën se shekujt e 17-të dhe 18-të nuk ishin periudha të një rënieje të vazhdueshme, por periudha të një modernizimi të ndërlikuar, madje në shumë aspekte, ishin periudha zhvillimi dhe rritjeje.

Ky këndvështrim nuk përjashton praninë e elementeve të krizës. Popujt që jetonin në Perandorinë Osmane, sikurse dhe popujt e tjerë, në gjithë botën e fillimit të kohës së re ishin nën ndikimin e kufizimeve të ashpra dhe trysnive të mëdha. Para së gjithash, mbijetesa fizike ishte shpeshherë e pasigurtë. Të mbjellat ishin të pambrojtura ndaj katastrofave natyrore. Zjarret shkatërronin si pasurinë e vënë mënjanë, edhe mjetet e domosdoshme për ekzistencë; sëmundjet e papritura binin shpesh tek njerëzit, të cilët, nga ana tjetër, nuk kishin njohuritë apo mjetet e domosdoshme për t’i kuruar ato. Për shumicën e familjeve, taksimi ishte një sfidë e madhe. Luftërat e jashtme u bënë më të shtrenjta dhe dobësuan financat osmane. Për të rritur të ardhurat, autoritetet rritën taksat dhe zhvlerësuan paranë, megjithatë këto mënyra nuk mjaftuan për të balancuar buxhetin e perandorisë. Shitja e posteve zyrtare dhe ryshfetet e drejtpërdrejta ishin mënyra për të tërhequr kapitalin privat në funksionimin e shtetit, por ato bënë që të krijoheshin një varg lidhjesh të parregullta, të cilat u lejonin grupeve të vogla të zyrtarëve dhe ndërmjetësve të tyre të zhvatnin burime si nga shteti, ashtu dhe nga taksapaguesit.

Ky kapitull dokumenton shtjellimin e krizave të ndryshme dhe përpjekjet për të hartuar zgjidhje të mundshme për këto kriza. Njëra rrugëzgjdhje e mundshme ishte rivendosja e rendit të vjetër, ndërsa një tjetër ishte kërkimi i rrugëve dhe mënyrave për të braktisur sistemin osman. Burimet në këtë kapitull paraqitin një larmi zgjidhjesh të mundshme për krizat e ndryshme, sikurse dhe pasojat serioze të disave prej këtyre zgjidhjeve.

Va. Fatkeqësitë “natyrore”

V-1. Zia e bukës në Stamboll (1758)

Atë vit njerëzit erdhën në Stamboll, pasi në zonat e tjera kishte rënë zia e bukës. Kështu që zia e bukës

filloi dhe në kryeqytet dhe buka filloi të pakësohej. Përpara çdo furre buke qëndronin disa qindra burra. Ata i merrnin bukët gjysmë të pjekura. Njerëzit e moshuar, gratë dhe banorët e tjerë [rajatë]

mbeteshin të uritur. [...] Për këtë arsye, njerëzit filluan të blinin sasi të mëdha orizi. Si pasojë filloi të pakësohej edhe orizi. Duke patur parasysh se muaji i agjërit po afronte dhe se myslimanët nuk duhet të vuajnë gjatë këtij muaji, në muajin Shaban u lëshua një urdhër që i garantonte dy okë⁷⁰ oriz çdo personi. Megjithatë, ditën e fundit të muajit Shaban, disa qindra gra të liga u futën me forcë në dyqanin e një tregtari orizi, *zimmi*⁷¹. Njëra prej tyre nxori një thikë të madhe dhe sulmoi tregtarin *zimmi*. Ai u largua me vrap dhe ato filluan të grabitin orizin. Komandanti i jeniçerëve, Nalband Mehmet pasha, pasi mori vesh për këtë incident, shkoi në vendngjarje për të ndalur grabitjen. Jo vetëm që nuk mundi ta ndalojë grabitjen, por gratë edhe e mallkuan dhe e shanë atë. Atëherë komandanti dërgoi korrierin e tij, Kuzuxhu Mehmet agën tek veziri i madh. Kur u kthye, Kuzucu Mehmet aga raportoi: “Kur shkova tek ai dhe i tregova ç’kishte ngjarë, ai ishte duke dëgjuar disa muzikantë. Nuk u shqetësua fare. Ai thjesht më tha të shkoja tek vendi në fjalë me rojen e jeniçerëve. Shkuam atje. Gratë sapo e panë, u shpërndanë”. Pas këtij skandali, ditën tjetër, komandanti i jeniçerëve u shkarkua nga detyra dhe roja i jeniçerëve [...] u emërua komandant. Falë erërave të forta, dy ditë më pas zbankuan anije të mbushura me oriz dhe kështu që pati përsëri oriz.

Şemdanizâde, f. 16-17.



Rezervat ushqimore të qyteteve shumë të mëdha si Stambolli shpesh varehin nga të mbjellat e provincave të ndryshme. Pavarësisht nga përpjekjet e autoriteteve osmane, periudhat e urisë dhe të panikut ishin të pamënjatueshme, dhe çonin drejt rritjes së çmimeve dhe trazirave publike, të cilat mund të shkaktonin edhe probleme në aspektin politik. Përgjatë periudhës së fillimit të kohës së re, grevat e urisë, shpesh të udhëhequra nga gratë, ishin të zakonshme jo vetëm në Perandorinë Osmane, por edhe në Europën Perëndimore,



Përshkruani mekanizmat ekonomikë dhe psikologjikë të përdorur për të përballuar periudhat e krizave në Stamboll.

Pse ishin gratë pjesëmarrëset kryesore në grevat e urisë?

A do të kishin mundur ato të plaçkisnin dyqanin e një tregtari mysliman orizi? A do të kishin ndërhyrë autoritetet më shpejt dhe më me forcë në këtë rast?

V-2. Tërmeti në Stamboll (1766)

[...] në ditën e tretë, e cila ishte data 12 e muajit Zilhixhe dhe 14 e muajit maj, e enjte [...] gjysmë ore pas lindjes së diellit, një tërmet i madh filloi papritmas. Për shkak të forcës së tij, njerëzit i humbën të gjitha shpresat për jetën dhe ngrinë, pa bërë kurrfarë lëvizjeje. Të gjitha ndërtesat, njerëzit dhe kafshët u shkatërruan. Ata që shpëtuan, u penduan për mëkatet e tyre dhe iu rikthyen besimit. Pas katër minutash, tërmeti ndaloi. Pas largimit të tymit, u vu re se Xhamia e Pushtuesit ishte shembur plotësisht. Xhamia e sulltan Bajazitit dhe ajo e Mihrimahut ishin dëmtuar rëndë. Hani i shitësve të sheqerit, sheshi i faljeve [Dua Mejdani] në pazarin e mbuluar, sikurse dhe tregu i kapelebërësve dhe zona e Bezistanit ishin dëmtuar. Ishin dëmtuar gjithashtu edhe Pallati i Vjetër, muret e Stambollit [kalaja e Shtatë Kullave], Hani i Vezirit, Tregu i Skllëvërve, si dhe hane dhe xhami prej tulle dhe guri, sikurse edhe disa shtëpi prej druri. Edhe disa prej ndërtesave në Galata dhe Uskudar ishin dëmtuar. Edhe ato ndërtesa që dukeshin të paprekura, kishin pësuar dëme që u vunë re më pas. Pallati i Ri, gjithashtu pësoi disa dëmtime në strukturë dhe mure. Doli se 4 000 njerëz vdiqën. Dhe meqë Stambolli ka formën e një trekëndëshi, nuk do t’i mungojnë tërmetet dhe zjarret.

Şemdanizâde, f. 85-86.



Përse xhamitë pësuan më shumë dëme se ndërtesat e tjera në Stamboll?

⁷⁰ Masë peshe osmane rreth 1.283 kg

⁷¹ Nënshetas jomyslimanë.


V-3. Murtaja në Bukuresht (1813)

Në muajin tetor, vdekja përfshiu qytetin, në mënyrë të paparë në asnjë vend tjetër. Qyteti dukej sikur do të shpërthente, kështu që ata u larguan dhe u shpërndanë nga t'i çonin këmbët. Vendi mbeti i shkretë. E çfarë mbeti për të parë? Ngado që të ktheheshe do të dëgjoje: "Largohu, hape rrugën, po kalojnë kujdestarët e kishës me të vdekurit", tetë ose ndoshta dhjetë të vdekur njëri mbi tjetrin, të ndjekur nga një turmë njerëzish të rrekosur dhe fëmijë që qanin. Këta të fundit u vinin kishtarëve pas nëpër lagjet e varfëra, derisa askush nuk mund t'i ndihmonte më me asgjë; dhe pastaj dergjeshin të vdekur në rrugë, derisa kishtarët e varrmihësit të vinin për t'i hequr me karrocet e varrimit. Ndërsa ne të gjallët, e konsideronim veten tashmë të vdekur dhe vinim vërdallë si të hutuar. Më pas, ata filluan të varrosnin njëri-tjetrin në kopshtet e tyre, derisa edhe këto u mbushën plot. Aty ku binte sëmundja, vetëm një ose dy nga dhjetë veta mund të mbeteshin gjallë. Nganjëherë nuk shpëtonte asnjë njeri. Dhe vetëm pak mbaheshin ende në këmbë; disa i kishin mbijetuar vetë sëmundjes, disa të tjerë prej navorës. Priftërinjtë vdiqën nëpër kishat e tyre. Disa të tjerë u larguan. Kishat e shenjta mbetën pa njeri që t'i drejtonte dhe njerëzve u thyhej zemra kur i shihnin

ato në këtë gjendje. Lagjet e varfra mbetën bosh. Vdekja ishte e tmerrshme dhe e pranishme kudo, nga gushti deri në janar. Pas janarit, epidemia filloi të shuhej, por asaj nuk i shpëtuan as familjet e mëdha, ndoshta përveç atyre bojarëve që u mbyllën brenda mureve të shtëpive dhe ruheshin me ushtarë. Ndërsa këtu në Bukuresht, si mund ta them, kishte njerëz që i varrosnin të vdekurit, por kishte raste kur qentë i hëngrën disa nga trupat e varrosur jo shumë thellë nëpër kopshte nga frika e sëmundjes. Si në fshatra, ashtu edhe në qytete, banorët që vdisnin i hanin qentë, se nuk kishte njeri që t'i varroste. [...]

Dhe nëpër spitale grumbulloheshin pircje me 100 trupa njerëzish të zhveshur, të rinj, pleq, fëmijë, të pasur e të varfër, dhe këta trupa fillonin e fryheshin. Më pas, ata hapnin gropa dhe i hidhnin trupat njëri mbi tjetrin, romët, bojarët, hebrenjtë dhe armenët, të gjithë në një vend.

Corfus, f. 340-341.

 Çfarë ndryshimesh kombëtare, shoqërore apo fetare kishin rëndësi në këto situata të skajshme? Ç'do të thoshte të ishte "i vdekur për së gjalli" në qytetin e pllakosur nga murtaja? Në ç'mënyrë "katastrofat" bënin që humanizmi të lihej mënjanë?


Vb. Kriza politike në Stamboll

V-4. Zgjidhjet që jepën në ditarin e Koçi beut për krizën e shtetit osman (rreth 1630)

E kam shkruar këtë trajtesë dhe ia kam dërguar të madhërishtit sulltan, që ai të marrë vesh problemet dhe arsyet e ndryshimeve të kësaj bote, pasi duhet që me vullnetin e Zotit, t'u gjejë një rrugëzgjdhje. Në këtë mënyrë, sulltani mund të ndreqë gjërat. Duhet ta kemi të qartë, së pari, se baza për rregullin e perandorisë dhe të njerëzve janë rregullat fetare dhe ligji fetar, sheriati. Së dyti, sulltani duhet të trajtojë me mirësi dhe të kujdeset për të drejtat e të gjitha shtresave, të dijetarëve që merren me çështjet e nënshtetasve të cilët besojnë në Zot dhe të luftëtarëve që janë gati të japin jetën e tyre në luftë [gaza]. Gjithsesi,

ai duhet të ndëshkojë dhe t'i trajtojë ashpër të padenjët. Gjithashtu, ai duhet të vëzhgojë dhe të zbatojë ligjet e sulltanëve të mëparshëm, të cilat janë ende në fuqi. Shpresohet që në këtë mënyrë gjërat të përmirësohen dhe të vihet rregull dhe të rivendoset prestigji i shtetit. Rendi i takon sulltanit.

Koçi beu, f. 19.

 Gjatë gjysmës së dytë të shekullit të 16-të dhe gjatë shekullit të 17-të, filluan të lëvrohen gjerësisht shkrimet politike osmane, në të cilat përshkruheshin shenjat e krizës politike dhe jepeshin sugjerime për përmirësimin e gjendjes. Megjithatë, shumica e këshillave përqendroheshin në masat që duhet të ndërmerreshin për të rivendosur 'rendin e vjetër' dhe jepnin pak zgjidhje praktike.

❓ A kishte lidhje këshilla e Koçi beut me shkaqet konkrete të krizës apo ishte tepër e përgjithshme? Ç'këshilla mund të kishin qenë më të përshtatshme?

V-5. Të dërguarit e princit moldav Kostandin Mavrokordati argumentojnë se në Stamboll është e nevojshme të korrupsionit shumë njerëz (1741)

Madhëria Juaj, ju na qortoni për dhuratat që kemi dhënë, por nuk mund t'ia kishim dalë mbanë nëse nuk do t'i kishim dhënë ato; megjithatë, nuk ishte e drejtë që të mos japim asnjë dhuratë, pasi jemi në një kohë kur si Porta e vezirit të madh, ashtu dhe të tjerët rrotull tij janë shumë të babëzitur; dhe gjithkush, madje edhe më pak i rëndësishmi prej tyre, është bërë si lubi. Kur të kërkojnë diçka, në fillim e bëjnë me butësi, më pas fillojnë dhe shajnë duke përdorur pushtetin e tyre, dhe në fund të kërcënojnë; kështu që është e pamundur të bësh ndryshe. Qeveri si ajo gjatë sundimit të Ibrahim Pashës⁷², nuk ka më tani në këtë Perandori; pas vezirit të madh, çdo zyrtar i lartë i pallatit të jashtëm

sillet si vezir i pavarur. Kryetari i lajmëtarëve [çauşbasha] është po aq i fuqishëm sa dhe zëvendësi i vezirit të madh [*kethuda*] dhe kreu i klerikëve [*reis*] është po njëjloj i fuqishëm. Ata që ndjekin vezirin e madh janë lubi sikundër ata që janë në pallatin e jashtëm: Hajatin e dini si është, zëvendësi i tij nuk e ka problem t'i flasë drejtpërdrejt agait të vajzave [*darisadet*]; ish sekretari [*iazegi*], Ali-efendiu, flet në vend të tij dhe gjithçka varet prej tij; Molla Esadi është kandidat për zyrën e *myftiut*, Pirizadeja është këshilltar privat, Kara Halif Efendizadeja është tepër i vlerësuar, Amegi ka shumë pushtet dhe është më i afërt me vezirin e madh sesa Çizrieli me aganë e vajzave. Pa përmendur këtu ata që janë më pak të rëndësishëm si Çauşzadeja, Saçirbeu dhe disa të tjerë, të cilët nëse nuk i paguajmë, do të pickojnë si grerëza dhe do të hapin plagë fatale.

Murgescu, f. 165-166.

❓ Krahasoni rekomandimet e Koçi beut me realitetin e përshkruar nga të dërguarit e princit moldav. A ishin ryshfetet një fenomen i rastësishëm apo një sistem më vete? A kishte mundësi të mos jepje ryshfete? Ç'rrezikojë nëse e bëje këtë?

Vc. Luftërat, kryengritjet dhe trazirat në popull

V-6. Fshatarët largohen drejt qyteteve (1665)

Banorët e fshatit Kokre dhe Gogjakovo në rrethit [*kaza*] e Prilepit dolën përpara gjykatës së shariatit bashkë me vojvodën Ibrahim, i cili është vojvoda i zonës [*has*] së Prilepit, njëra nga pronat e vezirit tonë të madh] [...] dhe deklaruan se fshatrat e zonës së sipërpërmendur janë të lira dhe askush nuk duhet të ndërhyjë atje. Gjithsesi, guvernatori i përgjithshëm [*bejlerbeu*], guvernatori [*sanxhakbeu*] dhe zyrtarët e tjerë, bashkë me shumë njerëz dhe kalorës të tyre, qëndrojnë atje dhe përveç se marrin ushqim falas, si p.sh. dele, qengja, mjaltë, vaj dhe prodhime të tjera, patën guximin t'u kërkonin fshatarëve para për taksat e papaguara [*tekalif-i shaka*], edhe pse

ata nuk e kanë të drejtën për të bërë një gjë të tillë. Për këtë arsye, nënshtetasit [*rajatë*] nga fshatrat Veperçani, Peshtani, Dunje dhe Kalen, që bëjnë pjesë në zonën e sipërpërmendur dhe jetojnë atje që nga kohëra të lashta, u larguan nga fshatrat e tyre më 1662, 1663 dhe 1664, dhe u vendosën në qytetet dhe fshatrat e rrethit [*kaza*] tonë. Vojvoda i tyre shkoi dhe u kërkoi të ktheheshin mbrapsht dhe pasi ata nuk pranuan, dërgoi një raport ku kërkonte të lëshohej një urdhër i drejtë.

Prandaj u lëshua ky urdhër, me kusht që në të ardhmen, këtyre banorëve të mos u bihet më në qafë për taksat e papaguara, pa patur një urdhër për këtë; banorët që u larguan nga fshatrat e sipërpërmendura dhe janë shënuar në regjistrat

⁷² Ibrahim pashë Nevshahirli, vezir i madh, 1718-1730.

[*defterët*] për zonën duhet të shpërngulen dhe të kthehen në fshatrat dhe vendet nga të cilat kanë ardhur dhe të vendosen sërish atje.

Odbrani, I, f. 282-283.

❓ Përse u larguan fshatarët nga fshatrat e tyre? Si vepruan pas kësaj zyrtarët? A ishte i drejtë veprimi i tyre?

V-7. Kryengritja e Mehmet aga Bojaxhi-oglu-së në Qipro (rreth 1680)

[...] një histori e kryengritjes së agait të famshëm Mehmed Bojaxhi-oglu, që me sa duket ka ndodhur rreth 1680-ës. Këtë histori e kam dëgjuar drejt e nga zotëria i nderuar, zoti Benua Astier, konsulli i Francës, i cili deri këtë vit, 1788, në mënyrë dinjitoze ka drejtuar esnafin e nderuar të tregtarëve francezë në Qipro [...]. Këto janë fjalët e thëna prej tij: "Mësova diçka nga tradita popullore dhe mora gjithashtu informacion të çmuar nga goja e një turku të moshuar 97 vjeç dhe një greku pothuajse të së njëjtës moshë, të cilët kishin qenë të dy dëshmitarë okularë të një kryengritjeje që ka ndodhur në këtë ishull rreth 80 vjet më parë dhe ka zgjatur plot shtatë vjet. Atëherë Qiproja, ashtu si dhe Rodi dhe ishujt e Arkipelagut [Egjeut], qeveriseshin prej admiralit osman [*Kapudan pasha*]. Taksa vjetore [*haraçi*] që i detyrohej Portës mbledhej nga një mbledhës i veçantë taksash [*haraçxhi*]; *mai'ishet-i* mbledhej për admiralin; dhe taksa në natyrë [*nuzulî*] shkonte për llogari të guvernatorit që e kishte dërguar admiralit [...].

Agallarët e Levkosias, të cilët herë njëri, e herë tjetri nuk i paguanin këto detyrime, filluan të hahen e të grinden; më pas, ata rrokën armët dhe sulmuan njëri-tjetrin, derisa Mehmet aga Bojaxhi-oglu i mposhti të gjithë dhe u shpall udhëheqës i tyre dhe qëndroi si kryengritës për shtatë vjet. Ai i pagoi çdo vit mbledhësit të taksave të dërguar nga Porta shumë e caktuar, për të cilën deri në atë kohë mbledhësit të taksave i ishte dashur të lutej, dhe mbajti një pjesë për nevojat e veta. Ai caktoi si administratorë në çdo krahinë [*kazilik*] njerëz besnikë të tij. Kur Porta mori lajmin se aga Bojaxhi-oglu nuk pranonte të nënshtrohej, dërgoi

në Qipro me ushtri, Çolak Mehmet pashën, për të rivendosur rendin si më parë. Ata hynë në Levkosia, por pas disa muajsh, kur pashai u përpoq të vendoste nën kontroll Bojaxhi-oglu, kryengritësit e detyruan të largohej nga Levkosia dhe të tërhiqej në pronën [*çifligun*] e Qubat-oglusë, ku qëndroi bashkë me ushtrinë pa bërë asnjë lëvizje. U morën masa që lajmi për gjendjen në të cilën ndodhej ushtria të mos arrinte në ministri. Megjithatë, jo shumë kohë më pas, lajmi mbërriti atje dhe menjëherë iu dha urdhër Çifut-oglu Ahmet pashës të nisej nga Karamania për në Qipro me ushtri për të liruar Çolak Mehmet pashën, dhe të hiqte qafe udhëheqësin e kryengritësve. Ahmet pasha veptoi siç ishte urdhëruar, zbarkoi në Akanthu, dhe marshoi drejt e në Kithraia, për të shtënë në dorë mullinjte, në mënyrë që kryengritësit të mos kishin mundësi të bluanin drithin dhe kështu të ndalonte furnizimet për në Levkosia, e cila ishte dhe qendra e kryengritjes. Aty qëndroi për dy muaj, dhe Çolak Mehmeti erdhi ta takonte. [...]

Qyteti mbeti pa bukë dhe pashai që kishte grumbulluar shumë forca dhe mendonte se askush nuk do të guxonte të dilte në krahun e kryengritësve, i propozoi Bojaxhi-oglusë që të tërhiqej, duke i dërguar një letër në të cilën i siguronte jetën. Kryengritësi, duke parë se pashai kishte më shumë forca në qytet, u arratis natën, bashkë me një grup rojesh të besuara, dhe shkoi së pari në Levkara dhe më pas në Levka, ku zëvendësi [*qehajai*] i pashait e zuri në befasi, vrau 28 vetë nga njerëzit e tij dhe zuri 32 të tjerë rob. [...] I ndjekur nga të gjitha anët nga trupat e pashait, në fshehtësi të plotë, ai u drejtua për në Amokostos, duke shpresuar se atje do të mund të gjente strehim, por para se të arrinte në kështjellë, portat ishin mbyllur dhe ushtria e pashait u hodh mbi të dhe ushtarët e paktë që i kishin mbetur. Ai mundi të largohej vetëm me gjashtë burra për në Pila, më pas në Larnaka, duke patur si qëllim të shkonte në Lemosos, por u kap në rrethin e Koilanonit dhe u soll në Levkosia, ku pashai e vari po atë natë. Në mëngjes, ai bashkë me ndjekësit e tij, u panë të ishin varur të gjallë prej mjekre në çengela. Kështu përfundoi kjo kryengritje pas shtatë vjetësh. Të gjithë mbështetësit e tij dhe disa udhëheqës të tjerë të kryengritjes u kapën dhe u vranë.

Qiproja nën regjimin turk, f. 32-35.



Cilat ishin alternativat e mundshme kur njerëzit ngrinin krye kundër Perandorisë Osmane? Ç'do të kishit bërë ju në vend të tyre? Krahasoni fatin e kryengritësve të ndryshëm në Perandorinë Osmane. Sa e mundshme ishte që të negocioje me autoritetet?

V-8. Raport, dërguar papës, lidhur me kryengritjen në Çiprovcit (1688)

Kjo thuhet për kryepeshkopin [katolik] e Bullgarisë, Joan Stefan Knezheviç dhe Georgi Pejaçeviçin: Pasi ishte bindur dhe nxitur nëpërmjet një letre personale nga perandori Leopold për të ndihmuar çështjen e krishterë, kryepeshkopi i lartpërmendur dërgoi, me trupat bullgare, kushëririn e tij, Georgi Pejaçeviçin, për në Karansebesh dhe Siklovar, për të takuar gjeneralin Veterani. Gjatë rrugës [Pejaçeviçi] u bashkua me ushtrinë serbe dhe bashkë me forcat e pricipatës së Vllahisë morën Orshovën dhe u prenë kokat pothuajse të gjithë turqve.

Por kur në vitin 1688, i lartpërmenduri Georgi, bashkë me trupat bullgare, katër kapitenët e Kopilovecit, katër të Çiprovecit dhe të tjerë, bashkë me Çakitë [husarët] donin të shkatërronin kullën e Tjokjolit⁷³, ata u tradhtuan nga një dezertor, dhe mijëra bullgarë u vranë në një betejë të përgjakshme e cila filloi pranë Kulovicës, në të cilën ata u shpartalluan tërësisht. Pas betejës, pjesa e mbetur e trupave u tërhoq nga Çiproveci dhe për njëfarë kohe, ata mbrojtën me sukses qytetin nga Tjokjoli, pa dashur të dorëzohen, edhe pse ai [Tjokjoli], duke përdorur faktin se ishte i krishterë, tentoi t'i joshte ata duke u premtuar poste dhe pasuri në Transilvani. Në fund, qyteti u mor nëpërmjet një sulmi nga turqit dhe hordhitë tartare që arritën atje. Çdo gjë u shkatërrua dhe u dogj, dhe njerëzit u vranë. Thuhet se pasuria e madhe e grumbulluar gjatë qindra vjetëve dhe që ishte shumë gjatë periudhës së gjatë të paqes u nxor nga qyteti me 100 karroca. Por asnjëri nga të krishterët atje nuk mund të shpëtonte gjë tjetër përveç jetës së tij, dhe ishin të paktë ata që ia dolën, sepse edhe kjo qe shumë e vështirë.

Spisarevska, f. 201-202.



Pasi osmanët u mundën në dyert e Vjenës (1683), ushtritë habzburgase pushtuan Budën (1686) dhe Beogradin (1688), duke krijuar idenë se rënia e Perandorisë Osmane në Europën Juglindore ishte e shpejtë. Komuniteti katolik rreth Çiprovcit në Bullgari u përpoq të përfitonte nga përparimi i trupave habzburgase, por kryengritja dështoi dhe ky komunitet u shkatërrua, ndërsa ata që shpëtuan u larguan në Vllahi dhe Transilvani.



Pse ngritën krye bullgarët? Përse Tjokjoli dhe trupat e tij të krishtera e shtypën kryengritjen bullgare?

V-9 Serbët largohen nga frika e përndjekjeve osmane (1690) – dëshmia e (Dhjakut) Atanasije Gjakon Sërbinit


Dhe serbët hipën në anije [...] Ishin rreth dhjetë mijë anije dhe të gjitha u larguan përpjetë rrjedhës së lumit Danub, dhe arritën në qytetin e Budës, i cili ishte nën sundimin e perandorit [habzburgas]. Dhe kështu Zoti lëshoi mbi tokën serbe të tri plagët nga të cilat Davidi përjetoi vetëm një në qytetin e tij: në fillim vdekje, pastaj shpatë dhe mbytje në ujë dhe skllavëri dhe uri të tejskajshme. Kështu që popullit serb nuk i mbeti rrugë tjetër, por të hante mish qeni dhe mishin e njerëzve të vdekur prej urie. E gjitha kjo ndodhi kur isha atje dhe sytë e mi kanë parë trupat e vdekur të serbëve gjithandej nëpër rrugët e Beogradit. Fshatrat dhe rrugët e tij ishin plot me të vdekur, të pavarrosur. Ata që kishin mbetur të gjallë në këmbë, ishin shpërfytyruar, nuk u kishte mbetur asnjë bukuri njerëzore, ishin nxirë nga uria dhe fytyrat u ishin bërë si ato të "etiopianëve". Ata vdiqën dhe vetëm më pak se një e dhjeta e tyre mbijetoi.

Agapova-Ilić, f. 134-135.



Në vitet 1688-1689, sikurse dhe bullgarët katolikë nga Çiprovcit, shumë serbë ortodoksë bashkëpunuan me habzburgët. Megjithatë, më 1690, osmanët edhe një herë fituan mbi ta dhe ripushtuan Beogradin. Në këto kushte, një numër i madh serbësh ortodoksë u arratisën dhe u vendosën në territore të kontrolluara nga habzburgët, duke gëzuar privilegje të mëdha [Slloveni dhe Hungari].


⁷³ Imre Tjokjoli, udhëheqës i qëndresës së fisnikërisë hungareze kundër habzburgëve. Me trupat e tij (kurucz), ai luftoi në krah të osmanëve në luftën e viteve 1683-1699.

 Përpiquni të veçoni pjesët ku Atanasije Sërbini i referohet Biblës dhe ato pjesë ku ai rrëfen historinë e tij. Cilat janë faktet e padyshimta historike?

V-10. Raport i guvernatorit të përgjithshëm venecian për Dalmacinë, në lidhje me ndikimin që Shçepan Mali kishte në Malin e Zi, 1767

Mjaftoi vetëm një letër e këtij reformisti, të ashtuquajtur Shçepan Mali, drejtuar banorëve të Malit të Zi, ku u bëhej thirrje që të bashkoheshin dhe të pajtoheshin me njëri-tjetrin, që këta të fundit të pranonin dhe t'i bindeshin kërkesës së tij... Nuk mund të mos bësh habi dhe mos ta admirosh këtë personazh i cili ka arritur një reputacion të tillë. Thjesht është e pakuptueshme se si një popull i lirë, i cili nuk njuh dhe nuk pranon asnjë rregull, papritur nuk i bindet më atij ligji që e konsideronte mbi çdo ligj tjetër në tokë a në qiell – ligjin e gjakmarrjes, thjesht nga shtypa e një letre. Fakti se ky popull la mizoritë, të cilat ishin aq shumë të ngulitura tek ai, është krejt i paimagjinueshëm. Sipas meje, respekti i këtij populli për dinastinë ruse është aq i madh sa që vetëm hija e saj mjaftoi për ta verbuar dhe për ta detyruar të ndryshojë natyrën e vet.

Petroviç, f. 93.

 Shçepan Mali sundoi në Malin e Zi nga viti 1767 deri në vitin 1773. Ai kishte ardhur në Malin e Zi nga Dalmacia në vitin 1766 dhe ishte mjek popullor. Në këtë kohë pati zëra në Malin e Zi që cari rus, Pjetri III (i cili u vra prej gruas së tij, Careshës Katerinë II), ishte gjallë dhe që ishte larguar nga Rusia. Shçepani pretendonte se ai ishte cari rus. Shumica e njerëzve e besuan atë dhe e pranuan si sundimtarin e tyre, sepse ai i shëmbëllente portretit të varur në një nga manastiret e Malit të Zi, të carit rus, Pjetrit III. Perandoria Osmane trembej se mos shfaqja e këtij të ashtuquajtur cari rus, mund të shërbente si shkëndijë për fillimin e një revolte në Ballkan dhe, për këtë arsye, dërgoi një ushtri me 50 000 vetë kundër Malit të Zi në vitin 1768, por pësoi disfatë. Qeveria ruse dërgoi në Malin e Zi në vitin 1769, princin Georgi Dologorukovin për të larguar Shçepanin. Dologorukovi dështoi në misionin e tij, pasi Shçepani gëzonte mbështetje të gjerë tek malazezët. Pashai i Shkodrës arriti që nëpërmjet shërbëtorit personal të Shçepanit, ta vriste atë në vitin 1773.

V-11 Kryengritja moldave kundër osmanëve (1711)

Dhe më pas princi Dumitrashko [Dumitrashkovoda] thirri bojarët e tij, ata që kishin qëndruar me të, mes të cilëve mund të përmendim kancelarin [logofatin] Nikolai Kostin, gjyqtarin [vornicin] Joan Sturcan, gjyqtarin Jordaki Rusetin, dhe Ilie Katargulin, mbajtësin e thesarit [vistiernicin], dhe u tha se kishte thirrur rusët dhe se ata ishin tashmë duke kaluar lumin Prut në Zagarance.

Kur dëgjuan këto fjalë, të gjithë bojarët u gëzuan dhe të lumtur i thanë princit [vodas]: “Është gjëja më e mirë që mund të bënit, madhëria juaj, sepse kishim frikë se do të dorëzoheshit tek turqit. Dhe ne kishim menduar, se nëse ju do të dorëzoheshit tek turqit, ne do t’ju braktisnim dhe do t’ju përuleshim rusëve”. Dhe tani ata ishin të kënaqur. Vetëm gjyqtari Jordaki Ruseti tha: “Ju keni marrë një vendim të nxituar, madhëria juaj, duke u kërkuar ndihmë rusëve. Do të kishte qenë më mirë të kishit pritur, madhëria juaj, për të parë se çfarë çmimi ka ndihma e tyre”. Princi Dumitrashko u përgjigj me këto fjalë: “Nuk kishte më kohë për të pritur, pasi kisha frikë se turqit do më kapnin. Shumica prej jush tashmë më kanë braktisur, ndërsa ju të tjerët nuk mendoni ashtu si unë”.

Më pas, princi Dumitrashko i hipi kalit dhe vajti të takohej me rusët në lumin Prut [...].

Më pas moldavët, sapo panë rusët dhe ngaqë ishin mësuar të plaçkitnin kur fillonin rrëmuajt, ca me urdhër e ca pa urdhër nisën t’i vrisnin e t’i kapnin robër turqit, në Jashi e në zona të tjera, kudo që mund t’i gjenin, në të gjithë vendin. Dhe iu morën paratë, pasuritë, kuajt, rrobat, qetë, delet, mjaltin, vajin dhe gjithçka tjetër që mund të gjenin. Dhe dyqanet e ushqimeve u zbrazën në rrugë, që edhe fëmijët të merrnin diçka. Edhe plakat morën rrush të thatë, fiq e kikirikë. Edhe ata turq që nuk i vranë, i çuan gjysmë të zhveshur si skllëvër tek princi. Disa prej tyre u strehuan nga shokët. Më pas, këta turq u shërbyen atyre që i strehuan.

Neculce, f. 540-542.



Lufta ruso-turke e viteve 1710-1711 zgjoi shpresat e ortodoksëve të Europës Juglindore, duke menduar se Pjetri i Madh (1682-1725), i cili kishte thyer Suedinë në vitin 1709, do të mund t'i çlironte nga sundimi osman. Princi moldav, Dimitrie Kantemiri (1693; 1710-1711) u bashkua me rusët, por nuk mundi të parandalonte disfatën e tyre përfundimtare në betejën e Stanileshtit (1711).



A i bindeshin plotësisht bojarët princit apo ata kishin planet e tyre politike? Krahasojeni këtë me burimin II-21.

Cilat ishin arsytet për dhunën kundër turqve gjatë kulmit të kryengritjes? A ishin dakord të gjithë moldavët e krishterë me dhunën e ushtruar? Cilat mund të kenë qenë arsytet që disa prej tyre i ndihmuan turqit?

V-12. Ditari i një oficeri habsburgas që përshkruan rrethimin e Dubicës (1788)

Më 22 gusht, beteja për marrjen e Dubicës ishte akoma më e ashpër. Loudoni⁷⁴ u habit nga qëndresa e atyre që mbronin qytetin e Dubicës, prandaj ai dha urdhër që qyteti të digjej. Në orën 11, nisën shpërthime vdekjeprurëse topash, që i vunë flakën qytetit. Menjëherë pas shuarjes së zjarrit nga ata që e mbronin atë, 24 njerëz u avitën në muret e qytetit, duke synuar të hidhnin një sasi me lëndë të djegshme në muret prej druri, por mbrojtësit i vunë re dhe i zbrapsën. Hedhja e lëndëve të djegshme vazhdoi edhe në datën 23 gusht. Për t'i penguar mbrojtësit në përpjekjet e tyre për të shuar zjarrin, filluan goditjet me topa në drejtim të qytetit. Kalaja e Dubicës u dogj përgjatë gjithë natës ndërmjet 23 dhe 24 gushtit dhe zjarri i topave vazhdoi papushim. Më pas, më 25 gusht, dy bateri, me tre topa secila, u vendosën pranë mureve të kështjellës. Zjarri u përqendrua në hyrjen e kështjellës dhe goditja me topa çoi në shkatërrimin e kështjellës së Dubicës. Por edhe pas kësaj, të rrethuarit nuk u dorëzuan. Beteja vazhdoi më 26 gusht, ku nga pas mureve të mbetur të kështjellës, mbrojtësit u përgjigjën me të shtëna armësh dhe topash. Ata që sulmonin qytetin,

⁷⁴ Komandati i ushtrisë habsburgase.

hapën zjarr me të gjitha mjetet. Më pas, rreth orës tetë të mëngjesit, të shtënat nga kështjella u shuan. Rreth orës nëntë, nga kështjella u dërgua dikush në shtabin e kampit austriak për të biseduar. Ai kërkoi armëpushim dhe austriakët pranuan. Në emër të trupave të garnizonit, ai propozoi t'u dorëzonte kështjellën, por me kushtin që mbrojtësit të liheshin të lirë të largoheshin. Austriakët nuk pranuan dhe kërkuan një dorëzim pa kushte. Burri kërkoi tri orë kohë për ta biseduar këtë me trupat e tij, çka iu lejua ta bënte. Pas tri orësh diskutimi, komandanti osman [beu] erdhi me tetë shoqërues dhe dorëzoi zyrtarisht kështjellën.

Kështjella e Dubicës, ose të themi më mirë, rrënojat prej guri, u pushtuan dhe ranë në duart e ushtrisë austriake.

Sljivo, p. 91-92.



A luftuan mirë osmanët në Dubicë? Gjithsesi, përse u dorëzuan ata?

V-13. Mungesa e sigurisë gjatë udhëtimit nëpër Shqipëri

Njëherë kaluam një çast drithërues. Gjendeshim në një vend të sheshtë, kur papritmas, pas shpine u shfaqën gjashtë shqiptarë të armatosur gjer në dhëmbë. Ushtarët e pararojës u tërhoqën kapistrën kuajve dhe i kthyen mbrapsht, hoqën pushkët nga krahu dhe qëndruan mbi yzengji, gati për çdo të papritur. Mund të them se teksa këta malësorë afroheshin, dora ime kërkonte në xhep revolverin që kisha aty. Ushtarët u shpërndanë, sikur do bëheshin gati për të qëlluar. Por shqiptarët, edhe pse dukeshin si luftarakë, nuk kishin aspak qëllime të tilla. Madje u kënaqën nga frika që i pushtoi turqit, të cilëve as që ua hodhën sytë, edhe pse mua më buzëqeshën dhe më përshëndetën teksa kaluan.

Fraser, f. 237-38.



A favorizonte mbajtja në masë e armëve, zhvillimin e Europës Juglindore në shekujt e 18-të dhe 19-të? Argumentoni në mbështetje dhe kundër kësaj ideje.

V-14. Bastisja e Kazanlikut nga Topal Ibrahim (1809)

Një bastisje e tillë u krye nga kaçakët [*daglitë*] në prill të 1809-ës, në qytetin e Kazanlikut⁷⁵, nën udhëheqjen e Topal [çalaman] Ibrahimit, i cili në çastin që hyri në qytet [...] mblodhi prijësat [*ajan*] e zonës dhe kryetarin [*myftarin*] e banorëve [*rajave*] për të marrë vesh se sa taksa paguante qyteti dhe kujt. [...] Më pas, Topal Ibrahim u tha atyre se nuk do ta shkatërronte qytetin ose nuk do t'i vinte zjarrin, nëse ata do të mblidhnin të njëjtën sasi taksash për të dhe nëse do të dërgonin një lajmëtar të shpejtë në Stamboll për të ndërmjetësuar për një ferman me Sulltan Mahmudin, në mënyrë që ai vetë (Topal Ibrahim) të mblidhte taksat për dhjetë vitet e ardhshme.

[...] Por pasi mori paratë e mbledhura, Topal Ibrahim i tha kryetarit të qytetit, Stojan Nikolov: "Po të jap këtë letër (e cila ishte e hapur) për Mustafa Bajraktarin, i cili është tani vezir në Stamboll dhe nëse për 40 ditë ju nuk më sillni fermanin, do ta bëj qytetin shkumb e hi. Deri atëherë do të qëndroj këtu me njerëzit e mi dhe do të pres afatin. Ndërkohë, duhet t'i urdhëroni njerëzit tuaj të na ushqejnë me byrekë dhe pula. Shpresoj që e kuptove."

[...] Ditën kur skadoi afati i dhënë, Topal Ibrahim, i zemëruar tej mase që kryetari e kishte gënjyer, doli vetëm dhe vrau në rrugë me shigjetë Kristo Tomovin. Kjo u mor si sinjal për të vrarë të krishterët, të cilët ishin ngujuar brenda shtëpive të tyre.

Stambolski, f. 28-30.



Gjatë dekadave të para të shekullit të 19-të, mjaft udhëheqës ushtarakë, disa prej të cilëve kishin funksionin e taksa- mbledhësve, filluan të vinin sundimin e vet mbi disa provinca osmane, duke përfituar nga fakti se pushteti qendror u dobësua nga lufta me Rusinë dhe nga kryengritjet e jeniçerëve në Stamboll, dhe nuk mund të siguronin autoritetin e tij. Është ironik fakti se Mustafa Bajraktari, i cili kishte nisur karrierën e tij si *ajan*, në Bullgarinë Veriore dhe ishte bërë vezir i madh (1808), ishte vrarë në Stamboll, në nëntor të vitit 1808, pra 5 muaj para se Topal Ibrahim të dërgonte kryetarin e Kazanlikut tek ai.

? Shpjegoni mënyrën gjysmëligjore të plaçkitjes së përdorur nga Topal Ibrahim. Përse ai thjesht nuk e sulmoi dhe plaçkiti qytetin? A ishte ai një bandit i zakonshëm apo një njeri me ambicje politike? Cilat ishin dallimet ndërmjet vendasve të fuqishëm dhe kaçakëve?

V-15. Letër e Petar Petroviç Njegoshit, dërguar Josip Jelaçit⁷⁶ (3 qershor 1849)

Mbeta tejet i habitur nga letra juaj e datës 1 prill të këtij viti. Nuk ka patur asnjë sulm me armë nga ana e malazezëve në drejtim të Boka Kotorskas⁷⁷, madje edhe turbullira të vogla ka patur tepër rrallë, përveç rasteve kur njerëz të armatosur kanë prishur qetësinë familjare, gjëra që kanë ndodhur gjithmonë. Unë përherë jam sjellë ashtu siç po sillem edhe tani, po bëj të pamundurën që qetësia midis Bokas dhe Malit të Zi të ruhet e paprekur. Në çdo veprim jam udhëhequr nga interesat e Malit të Zi, dhe kam qenë i përkushtuar me një dashuri vëllazërore për ju qysh në fëmijërinë time. I dashur Imzot, i gjithë populli i Bokas do t'i konfirmojë fjalët e mia njëzëri.

Njegosë, f.135.

V-16. Ndërthurja e fatkeqësive në rrëfimin e mësuesit bullgar Todor nga Pirdopi, afër Sofjes (1815-1826)

Le ta dinë dhe të vrasin mendjen të gjithë ata që po e lexojnë ose po e dëgjojnë këtë histori, se çfarë donte të tregonte Zoti me zemërimin e tij tani, diçka që nuk ka ndodhur kurrë më parë, që nga krijimi i kësaj bote. Në vitin 1814, Zoti dërgoi një ndëshkim a murtajë nga lindja në përfundim dhe gjysma e njerëzve vdiqën. Kishte patur edhe më parë epidemi murtaje, por asnjëra prej tyre nuk kishte marrë kaq shumë jetë. Që atëherë deri më 1820, gjatë sundimit

⁷⁵ Qytet në Malet Ballkan, në Bullgarinë Qendrore.

⁷⁶ Guvernatori habsburgas (*bani*) i Kroacisë (1848-1859).

⁷⁷ Boka Kotorska quhej zona rreth gjirit të Kotorrit, sot pjesë e Malit të Zi, por që në vitin 1849, ishte pjesë e Dalmacisë së sunduar nga Austria.

të të mallkuarit Sulltan Mahmud⁷⁸, Zoti na dha paqe [...] Dhe në mars të viti 1821 u shfaq një djall nga Janina, i quajtur Ali Pasha, i cili ngriti krye kundër sulltanit. Sulltani grumbulloi një ushtri prej 500 000 vetash për të luftuar me të, por ishte e pamundur që ai të mposhtej, pasi kështjella e tij ishte shumë e fortë. Ushtria e sulltanit qëndroi atje për një kohë shumë të gjatë dhe dogji shumë fshatra dhe qytete, mori peng dhe vrau shumë të krishterë, çka çoi në rritjen e çmimit të miellit në 60 *gurush* për një *kile*⁷⁹. Kjo çoi drejt një urie shkatërruese mes njerëzve të varfër. Më pas, më 25 mars, u shfaq një tjetër djall nga Vllahia, Vllah beu⁸⁰, i cili mbledhi një ushtri, nisi një kryengritje dhe filloi të plaçkiste fshatrat. Më pas, nga të gjitha anët e Turqisë Europiane [Rumelisë] u dërguan ushtri për të luftuar kundër tij. Ata dogjën shumë fshatra përgjatë Danubit, sikurse dhe vranë dhe zunë rob shumë njerëz.

Më pas, i mallkuari sulltan dha urdhër dhe patriarku Grigori Nepitashi u tërhoq zvarrë nga kisha gjatë meshës dhe u var ditën e dytë të Pashkëve. Shumë njerëz u vranë atë ditë, disa u varën, ndërsa të tjerë u masakruan: 21 peshkopë dhe ndihmësit e tyre, murgj, priftërinj, dhjakë. Më pas, ata filluan të vrisnin të krishterët. Vetëm Zoti e di se sa të krishterë u vranë; ishin disa bullgarë, shumë grekë dhe shqiptarë [*arnautë*] – të gjithë të vranë në Stamboll. Gratë dhe fëmijët u mbytën në det.

Më pas, një ushtri doli nga Stambolli dhe u drejtua në More, ku vrau shumë njerëz nëpër fshatra. Banorët e Moresë u përpoqën të largoheshin nëpërmjet detit dhe u grumbulluan në një ishull, megjithatë shumë prej tyre u vranë atje.

Georgieva, Tzanev, f. 356-357.



Vlerësoni shpjegimin e dhënë nga Todori prej Pirdopi në lidhje me fatkeqësitë e ndryshme të fillimshkullit të 19-të. A jeni në një mendje me të?

V-17. Lutje drejtuar sulltanit për të emëruar Hysen Gradashçeviçin në postin e vezirit

Pashallarë, dinjitarë të përkushtuar të Portës së lartë, mësues, kadilerë, deputetë dhe studiues, si dhe njerëz të tjerë të mirë, kajmekamë, prijës, kapedanë, komandantë ushtarakë, bejlerë me trashëgimtarët e tyre, si dhe krerë të tjerë të pashallëkut, zejtarë dhe tregtarë, kryepleq fshatrash, si dhe shumë njerëz të tjerë, banorë të Sarajevës dhe rrethinave, e po ashtu edhe banorë nga i gjithë vilajeti i Bosnjës erdhën përpara Gjykatës së Sheriatit, dhe shpallën arsyen e ardhjes së tyre në këtë gjykatë, të formuluar si më poshtë:

“Në mënyrë që të arrihet paqja dhe siguria për robërit e Zotit, për të ndaluar trazirat dhe parandaluar kryengritjet, të cilat kanë filluar të shpërthejnë në Bosnjë, krerët dhe udhëheqësit e pashallëkut, si dhe të gjithë ne, të mbledhur këtu sot, kemi zgjedhur shkëlqesinë e tij, të nderuarin Hysen beun, ish-kapedanin e Kalasë së Gradaçacit në Bosnjë, si Vezir dhe Pasha. Këtë gjë e kërkon koha dhe situata në të cilën gjendemi, sepse veprat dhe morali i tij janë vlerësuar gjithmonë nga të gjithë. Të gjithë, të pasur e të varfër, kanë qenë të kënaqur me të, e kanë dashur dhe respektuar. Në mënyrë që të vendoset siguria e plotë dhe paqja si për të pasurit ashtu edhe për të varfërit, në mënyrë që në Bosnjë, në të ardhmen të parandalohen trazirat dhe kryengritjet, po i dërgojmë këtë petition Sulltanit të madhërishtëm, duke i kërkuar që të tregojë mëshirë ndaj robërve të tij dhe të miratojë zgjedhjen tonë dhe të caktojë Hysen beun në postin e përfaqësuesit të Portës së Lartë në Bosnjë dhe t’i japë titullin e Vezirit. Të gjitha krahinat e vilajetit të Bosnjës do të dërgojnë kërkesat e tyre. Vërtetësia e kësaj deklaratë garantohet prej kësaj gjykate.”

BDA, *Hatt-i Humajun Tasnifi*, N° 21148, 22154 li;

⁷⁸ Mahmudi II (1808-1839).

⁷⁹ Njësi mase osmane që luhetet në vende të ndryshme nga 25-400 l.

⁸⁰ Do të thotë ‘Princi i Vllahisë’; nuk është e qartë nëse i referohen Aleksandër Ipsilantit, i biri i një ish-princi të Vllahisë, i cili udhëhoqi kryengritjen greke kundër turqve, apo Tudor Vladimireskut (1780-1821), udhëheqësit të revolucionit në Vllahi, në vitin 1821.

V-18. Leopold Ranke shkruan për Hysen Gradashçeviçin

Boshnjakët e morën Kosovën lehtësisht dhe u pritën kudo si çlirimtarë; vetëm në Pejë hasën pak kundërshti prej shqiptarëve dhe trupave të vezirit të madh. Por trimi Ali pashë Vidajliçi, krahu i djathtë e i besuari i kapedan Hysenit, me shpejtësi arriti ta marrë Pejën. Veziri i madh, i cili ndodhej në Shkup, dërgoi një pjesë të trupave të tij për t'u bërë ballë boshnjakëve, por edhe këto trupa u thyen, dhe pas kësaj shqiptarët kaluan në anën e boshnjakëve. Sikur ushtria boshnjake të kishte vazhduar në këtë

mënyrë, do ta kishte çliruar Shkodrën dhe do të kishte bërë që lufta të merrte një rrjedhë të re. Por kësaj i druhej edhe veziri i madh. Ai synonte t'i bënte për vete boshnjakët, dhe me politikën e tij dinake, t'i bindte që të tërhiqeshin, prandaj dërgoi përfaqësuesit e tij për të dëgjuar kërkesat e tyre. Boshnjakët parashtuan tri kërkesa – pikësëpari, në Bosnjë të ruhej po ajo formë administrimi, pa bërë reforma; së dyti, që veziri i Bosnjës të zgjidhej gjithmonë prej radhëve të vendasve, çka do të thoshte të pranohej dhe të hidheshin bazat për pavarësinë e Bosnjës; dhe së fundi, që kapedan Hyseni, të caktohej menjëherë veziri i Bosnjës.

Ranke, f. 314-315

Bibliografia

- Marija Agapova-Ilić, *Iustrovana istorija Beograda [Histori e ilustruar e Beogradit]*, Beograd 2002.
- Metin And, *Turkish Miniature Painting. Sixty-eight Miniatures in full colour and one hundred and seven black and white illustrations [Piktura turke në miniaturë. Gjashtëdhjetë e tetë miniatura me ngjyra dhe njëqind e shtatë ilustrime bardhë e zj]*, botimi IV, Stamboll, 1987.
- Ivo Andrić, *The Development of Spiritual Life in Bosnia under the Influence of Turkish Rule [Zhvillimi i jetës shpirtërore në Bosnjë nën influencën e sundimit turk]*, Durham and London, 1990.
- Ch. A. Antoniadis, *Archeio Eggrafon Skyrou [Arkivi i dokumenteve të Ishullit të Qipros]*, Athinë, 1990.
- Spyros Asdrachas (red.), *Hoikonomidomi ton valkanikon choron sta chronia tis othomanikis kyriarchias [Struktura ekonomike e vendeve të Ballkanit në periudhën e sundimit osman, në shekujt XV – XIX]*, Athinë, 1979.
- Aşikpaşa-zâde, *Tevarih-i Âl-i Osman [Historia e Dinastisë Osmane]* (redaktuar nga Nihal Atsız) në Osmanli Tahirleri, Stamboll, 1945.
- Ömer Lütfi Barkan, *Türkiye’de Toprak Meselesi. Toplu Eserler 1 [Çështja Agrare në Turqi, Përmbledhje 1]*, Stamboll, 1980.
- Mula Mustafa Sevki Bašeskija, *Ljetopis (1746-1804) [Kronikë (1746-1804)]*, Sarajevë, 1968.
- Gustav Bayerle, *Pashas, Beys and Efendis: a historical dictionary of titles and terms in the Ottoman Empire [Pashallarët, bejlerët dhe efendilerët: fjalor historik i ofiqeve dhe shprehjeve në Perandorinë Osmane]*, Stamboll, 1997.
- N. A. Bees, *Bibliographische Notizen und Nachrichten, "Byzantinisch-Neugriechische Jahrbücher"*, 70 (1928-1929), f. 526-528.
- BOA, CA 3126 (=Başbakanlık Osmanlı Arşivi Cevdet Adliye 3126).
- Fra Bono Benic, *Ljetopis Sutjeskog samostana [Kronika e Manastirit të Sutjeskës]*, Sarajevë, 1979.
- Nicolaus H. Biegman, *The Turco-Ragusan Relationship. According to the Firmans of Murad III (1575-1595) Extant in the State Archives of Dubrovnik [Marrëdhëniet turko raguziane sipas fermaneve të Muratit III (1575-1595) të cilat ruhen në Arkivin e Shtetit në Dubrovnik]*, Hagë – Paris, 1967
- Rudjer Boskovic, *Dnevnik putovanja iz Carigrada u Poljsku [Ditari udhëtimit nga Kostandinopoja në Poloni]*, Zagreb, 1951.
- Lord Broughton, *Travels in Albania and Other Provinces of Turkey in 1809 and 1810. [Udhëtime në Shqipëri dhe provinca të tjera të Turqisë në 1809 dhe 1810.]* Londër, 1855.
- *Bulgarska Istoricheska Biblioteka [Biblioteka historike bullgare]*, IV, Sofje, 1931.
- Dimitrie Cantemir, *Descrierea Moldovei [Përshkrim i Moldavisë]*, Bukuresht, 1973.
- Dimitrie Cantemir, *Opere complete [Vepra të plota]* (red Virgil Cârdeea), VIII/II, Bukuresht, 1987.
- *Călători străini despre țările române [Udhëtarët e huaj për tokat rumune]*, I-IX, Bukuresht, 1968-1997.
- Celâlzâde Mustafa, *Selim-nâme [Përkushtim Selimit]* (redaktorë Ahmet Uđur, Mustafa Çuhadar), Ankara, 1990.
- *Constituțiile Aprobate ale Transilvaniei [Kushtetut a temiruarat të Transilvanisë]*, Kluzh, 1997.
- Ilie Corfus, *Cronica meșteșugarului Ioan Dobrescu [Kronika e mjeshtrit Joan Dobrescu]*, "Studii și articole de istorie", VIII, 1966.

- Yıldıırım Dursun, *Türk Edebiyatında Bektaşî Tipine Bağlı Fıkralar* [Anekdotat rreth arketipit bektashi në letërsinë turke], Ankara, 1976.
- G. Elezović, *Turski izvori za istoriju Jugoslovena* [Burime turke për historinë e jugosllavëve], Beograd, 1932.
- Evlija Çelebi, *Putopis. Odlomci o jugoslovenskim zemljama* [Shënime udhëtimi. Pjesët për tokat jugosllave], Sarajevë, 1996.
- Evlija Çelebi *Seyahatnâmesi* [Udhëtimet e Evlija Çelebiut] (eds. Yücel Dağlı, Seyit Ali Kahraman, Ibrahim Sezgin), vëll. V, Stamboll, 2001.
- Foster John Fraser, *Pictures from the Balkans*. [Tablo nga Ballkani] New York, 1906.
- Tahsin Gemil, *Relaçiile Tërilar Române cu Poarta Otmanë în documente turçești (1601-1712)* [Marrëdhëniet e tokave rumune me Portën Osmane në dokumenet turke (1601-1712)], Bukuresht, 1984.
- Tsv. Georgieva, V. Kitanov, *Documenti za istorijata na bulgarskija narod prez 15-17 Vek* [Dokumente për historinë e Bullgarisë në shekujt XV-XVII], 1. Blagoevgrad, 1991.
- Tsv. Georgieva, D. Tzanev (eds.), *Hristomatija po Bulgarska Istorija* [Krestomaci për historinë e Bullgarisë], vëll. 3, Pleven, 1982.
- Ferdo Gestrin, Milko Kos, Vasilij Melik, *Zgodovinska čitankaza 6. razredosnovnihšol*, Ljubljana, 1971.
- G. Giannoulis, *Codikas Trikkis* [Kodeksi i Trikit], Athinë, 1980.
- Vedran Gliga, *GovoriprotivTuraka* [Fjalime kundër osmanëve], Split, 1983.
- Güvahi, *Pendnâme* [Libri i Këshillave] (red M. Hengirmen), Ankara, 1983.
- Klara Hegyi, Vera Zimanyi, *The Ottoman Empire in Europe*, [Perandoria Osmane në Europë] Budapest, 1989.
- Hezarfen Hüseyin Efendi, *Telhîsü'lBeyânff Kavânin-iâl-iOsman* [Përmbledhjemeshënime e Hezarfen Hüseyin Efendiut për ligjet e Shtëpisë së Lavdishme të Osmanëve] (red Sevim İlgürel), Ankara, 1998.
- Frédéric Hitzel (red.), *Enfants de langue Drogmans*, Stamboll, 1995.
- Colin Imber, Ebu's-Su'ud: *The Islamic Legal Tradition* [Tradita ligjore islamike], Stanford, 1997.
- Halil Inalcık, *The Ottoman Empire. The Classical Age 1300-1600* [Perandoria Osmane. Periudha klasike 1300-1600], Londër, 1973.
- Halil Inalcık (red.) *Hicri 835 Tarihli Suret-i Defter Sancak-iArvanid* [Kopje e defterit të provincës Arvanid nga viti 835 i Hegjirës], botimi II, Ankara, 1987.
- *Istoria tou Ellinikou Ethnous* [Historia e kombit grek], t. 11-12, Athinë, 1975.
- Ronald C. Jennings, *The Judicial Registers (Şer'î Mahkeme Sicilleri) of Kayseri (1590-1630) as a Source for Ottoman History* [Regjistrat gjyqësorë të Kajzerit (1590-1630) si burim për historinë osmane (temë doktore dhe pabotuar)], 1972, Universiteti i Kalifornisë, Los Angeles; Mikrofilmat e universitetit, Ann Arbor, Michigan).
- Ronald C. Jennings, *Christians and Muslims in Ottoman Cyprus and the Mediterranean World, 1571-1640*, [Të krishterët dhe myslimanët në Qipron dhe Tokat e Mesdheut Osmane] Nju Jork – Londër, 1993.
- David Jones, *A complete history of the Turks*, [Historia e plotë e turqve] Londër, 1719.
- Esther Juhasz (red.), *Sephardi Jews in the Ottoman Empire. Aspects of Material Culture*, [Hebrenjtë Sefardi në Perandorinë Osmane, Aspekte të Kulturës Materiale] Jerusalem, 1990.
- Ahmet Kal'a (red.), *Istanbul Ahkam Defterleri. Istanbul Finans Tarihi I (1742-1787)* [Defteri i Stambollit me dekretet e Këshillit Perandorak. Historia financiare e Stambollit I (1742-1787)], Stamboll, 1998.

- *Koçi Bej Risalesi [Memorandumi i Koçi Beut]* (red. Ali Kemal Aksüt), Stamboll, 1939.
- Ioannis Koliopoulos, Ioannis Chassiotis (red.), *H neoteri kai synchroni Makedonia [Maqedonia e kohëve të reja dhe bashkëkohore]*, vëll.I, Maqedonia gjatë sundimit osman, Athinë-Selanik n.d.
- Benedikt Kuripestic, *Putopis kroz Bosnu, Srbiju, Bugarsku i Rumeliju 1530 [Udhëtim nëpër Bosnjë, Serbi, Bullgari dhe Rumeli 1530]*, Sarajevë, 1950.
- *Le voyage d'Outremer, de Bertrandon dela Broquiere*, Beograd, 1950.
- Bernard Lewis (red.), *The World of Islam. Faith, People, Culture. [Bota e Islamit. Besimi, Njerëzit, Kultura]* Londër, 1997.
- Siz Harry Luke, *Cyprus under the Turks, 1571 - 1878, [Qiproja në nsundimin turk, 1571-1878]* Londër, 1969 (botimi i parë: 1921).
- Makarios Melissenos (Melissourgos), *The chronicle of the siege of Constantinople April 2 to May 29 1453, Book III, 3-13 inclusive, Chronicon Maior, in The fall of the Byzantine Empire. A Chronicle by George Sphrantzes 1401-1477. [Kronika e rrethimit të Kostandinopojës nga 2 prilli deri 29 maj 1453, libri III, përfshirë 3-13, Chronicon Maior, në Rënia e Perandorisë Bizantine. Kronikë nga George Sphrantzes 1401-1477.]* Përkthyer nga Marios Philippides, Amherst, 1980.
- I. Menounos, *Kosma tou Aitolou. Didaches kai viografia [Kozma Etolu, mësimet dhe biografia]*, Athinë, 1980.
- Konstantin Mihailović iz Ostrovice, *Janičareve uspomene ili turska hronika [Kujtimet e jeniçerëve apo Kronika turke]* (red. Đorđe Živanović), Beograd, 1966.
- Andjelko Mijatovic, *Uskoci i krajsnici [Uskotët dhe kufitarët]*, Zagreb, 1974.
- Andjelko Mijatovic, *Zrinsko-Frankopanska urota [Komploti i Zrinskit dhe Frankopanit]*, Zagreb, 1999.
- Vesna Miovic-Peric, *Narazmedju [Në vijën ndarëse]*, Raguzë, 1997.
- *Adventures of Baron Wenceslas Wratislaw of Mitrowitz. What he saw in the Turkish metropolis, Constantinople; experienced in his capacity; and after his happy return to his country, committed to writing in the year of our Lord 1599. [Aventurat e Baronit Wenceslas Wratislawi Mitrovicës. Çfarë pa ai në metropolin turk, Kostandinopojë; atë që përjetoi vetë dhe pas kthimit në vendin e tij e hodhi në letër, në vitin e Zotit 1599.]* Përkthyer nga origjinali Bohemian nga A. H. Wratislaw, Londër, Bell & Daldy, 1862; përkthimi greqisht: I Konstantinoupolis kata ton 16o aiona (1591-1596), përkthyer nga Ioannis Ep. Dryskos, Athinë, 1920.
- Lady Mary Wortley Montagu, *The Turkish Embassy Letters [Letrat e ambasadës turke]* (red Anita Desai & Malcolm Jack), Londër, 1994.
- Bogdan Murgescu (koord.) *Istoria României în texte [Historia rumune në tekste]*, Bukuresht, 2001.
- Ioan Neculce, *Opere, Letopiseșul Țării Moldovei și O samă de cuvinte [Vepra. Kronika e Moldavisë dhe disa thënie]* (red Gabriel Ștrempele), Bukuresht, 1982.
- Mehmet Neşri, *Kitab-ı Cihannüma [Një dritare në historinë botërore]* (red. FR. Unat & M. A. Köymen), Ankara, 1957.
- Nicolas de Nicolay, *Dans l'empire de Soliman le Magnifique* (red. Marie-Christine Gomez-Géraud, Stéphane Yérasimos), Paris, 1989.
- *Odrani tekstovi za istorijata na makedonskiot narod [Tekste të zgjedhura për historinë e popullit maqedon]*, I-II, Skopje, 1975.
- *Osmanski Izvori za Isljimizatcionite Protzesi na Balkanite [Burime osmane për proceset e islamizimit në Ballkan]* (red Eugeni Radoshev et alia), Sofje, 1990.
- Peçevi Ibrahim Efendi, *Peçevi Tarihi [Historia e Peçevit]* (red Bekir Sýtký Baykal), vëll. II, Ankara, 1992.
- A.Philippidis-Braat, *La captivité de Palamas chez les Turcs: Dossier et commentaire, "Travaux et mémoires"*, 7 (1979), f. 109-222.

- Radovan Samardžić, *Beograd i Srbija u spisima francuskih savremenika XVI-XVII vek* [Beogradi dhe Serbia në shënimet e bashkëkohësve francezë në shekujt XVI-XVII], Beograd, 1961.
- Hans Schiltberger, *Travel Notes*, [Shënime udhëtimi] Sofje, 1971.
- *The Serbian Epic Ballads. An Anthology.* [Baladat epike serbe. Antologji] Përkthyer në vargje anglisht nga Geoffrey N. W. Locke, Beograd, 1996.
- Stanford, J. Shaw. *The Jews of the Ottoman Empire and the Turkish Republic*, [Hebrenjtë e Perandorisë Osmane dhe Republikës Turke] Houndmills, 1991.
- Galib Slijo, *Bosna i Hercegovina 1788-1812* [Bosnja dhe Hercegovina 1788-1812], Banja Luka, 1992.
- George Sphrantzes, *The fall of the Byzantine Empire (Chronicon Minus)*, in *The Fall of the Byzantine Empire. A Chronicle by George Sphrantzes 1401-1477.* [Rënia e Perandorisë Bizantine (Chronicon Minus) në Rënia e Perandorisë Bizantine. Kronikë nga George Sfrances 1401-1477.] E përkthyer nga Marios Philippides, Amherst, 1980.
- Y. D. Spisarevska, *Chiprovskoto vastanie i Evropejskijat svjat* [Kryengritja e Qipros dhe bota europiane], Sofje, 1988.
- Hristo Stambolski, *Avtobiografija. Dnevnitzi. Spomeni* [Autobiografi. Ditare. Kujtime], Sofje, 1972.
- Bernard Stulli, *Zidovi u Dubrovniku* [Hebrenjtë në Raguzë], Zagreb, 1989.
- *Synaxaristis Neomartyron* [Përmbledhje bio-grafish të martirëve të rinj], Selanik, 1984.
- Şemdanizâ de Süleyman Efendi, *Tari-i-mür'it-tevarih* [Histori] (red Münir Aktepe), Stamboll, 1978.
- *Taylesanizâ de Hafiz Abdullah Efendi Tarihi. Istanbul'un uzun dört yili* (1785-1789) [Historia e Taylesanizâde Hafiz Abdullah Efendiut. Katër vitet e gjata të Stambollit (1785-1789)] (red Feridun Emecan), Stamboll, 2003.
- Sture Theolin, *The Swedish Palace in Istanbul, [Pallati suedez në Stamboll]* Stamboll, 2000.
- Maria Todorova, *Podbrani Izvori za Istorijata na Balkanskite Narodi XV-XIX vek* [Përmbledhje me burime për historinë e popujve të Ballkanit në shek. XV-XIX], Sofje, 1977.
- *Turski lavori za Istorijata na Pravoto v Bulgaskite Zemi* [Burime turke për historinë e së drejtës në tokat bullgare] (red Bistra Tzvetkova), vëll. 2, Sofje, 1971.
- Cyryla Vazvazova-Karateodorova (red.) *Nepresahvashti Izvori. Documentalni Materiali za Istorijata na Plovdiv i Plovdivsko* [Burime të qëndrueshme. Dokumente lidhur me historinë e Plovdivit dhe krahinës së Plovdivit], Plovdiv, 1975.
- P. Zerlentou, *Systasis tou Koinou ton Mykonion* [Kushetuta e komunitetit të Mikonos], Hermoupolis, 1924.
- Johann Georg Von Hahn, *Udhetim Neper Viset e Drinit dhe te Vardarit, Perkteu: Pjeter Radiqi, Botues "GEER" & Nikolle Lleshi, Tirane, 2001.*
- Kasalica Vladislav, *Kulturna baština Crne Gore* (Trashëgimia kulturore e Malit të Zi), Tivar, 2008.
- Petrović Petar Njegoš, *Izabrana pisma* (Letra të zgjedhura), Beograd, 1984.
- Petrović Rastislav, *Rusija i Crna Gora u doba vladike Vasilija i Šćepana Malog*, Zbornik radova „Rusija i južnoslovenske zemlje u XVIII veku“, (Rusia dhe Mali i Zi në kohën e peshkopit Vasilije dhe Shçepan Malit në dokumentet e "Rusia dhe vendet sllave të jugut gjatë shekullit të 18-të"), Beograd, 1986.

Hartat

- Harta 2: *The Periodical Historical Atlas of Europe* [Atlasi Periodik Historik i Europës], Christos Nussli 2002, www.euroatlas.com

Koordinatorët

Koordinatori i përgjithshëm

Kristina Koulouri, kryetare e Komisionit për Mësimdhënien e Historisë të CDRSEE, është profesore e Historisë Moderne në Universitetin e Peleponezit (Greqi). Ka lindur më 1962 në Athinë, kreu doktoraturën në *Paris I-Pantheon, Sorbonë*, në janar të vitit 1990. Në vitin 1994 ka fituar çmimin “Nicolas Svoronos” për kërkimet dhe botimet shkencore në fushën e historisë. Ka qenë anëtare e grupit për projektin e Këshillit të Europës “Të Mësuarit dhe Mësimdhënien e Historisë së Europës në shekullin e 20-të” (1996-2000). Ajo ka qenë anëtare e komisioneve shkencore për autorizimin e teksteve të historisë në shkollat e mesme greke; koordinatore e projekteve për historinë e teksteve shkollore dhe për historinë e Komitetit Olimpik Helen. Gjithashtu është autore e disa librave dhe artikujve për mësimdhënien e historisë, historisë së historiografisë, teksteve shkollore, kujtesës kombëtare dhe identitetit kombëtar dhe historisë së sporteve. Botimet kryesore: *Dimensions ideologique de l'historicité en Grèce (1834-1914)*; *Les manuels scolaires d'histoire et de géographie*, Frankfurt, Peter Land, 1991; *Sport et société bourgeoise. Les associations sportives en Grèce 1870-1922*, Paris, L'Harmattan, 2000; *Clio in the Balkans. The Politics of History Education*, Thessaloniki, CDRSEE, 2002 (editor); *Athens, Olympic City, 1896-1906*, Athens, IOA, 2004 (editor).

Libri i punës 1 – Perandoria Osmane

Halil Berktaş, historian, aktualisht profesor i asociuar dhe drejtues i Programit të Historisë në Fakultetin e Arteve dhe Shkencave Sociale në Universitetin *Sabancı* (Stamboll, Turqi). Ai ka lindur më 1947. Studimet universitare i kreu për shkencë ekonomike në *Yale University* (1968) dhe ka kryer doktoraturën në fushën e historisë në Universitetin e Birmingamit. Ka punuar në Fakultetin e Shkencave Politike në Universitetin e Ankarasë, në Universitetin Teknik të Lindjes së Mesme në Ankara dhe në Universitetin *Bogazic* në Stamboll. Ai ka vizituar një sërë universitetesh të huaja: në kuadër të Bursës së Këshillit Britanik, Kolegjin Uolfson, Cambridge pranverë 1990; Fullbright Fellowship, Harvard, 1997 (i asociuar me Qendrën për Studime Europiane dhe Qendrën për Studime të Lindjes së Mesme); NEXUS Senior Fellow, Qendër për Studimet e Përparuara në Sofje (Bullgari), 2002-2003. Ai është zëvendëskryetar i Komitetit të Mësimdhënies së Historisë të Qendrës për Demokraci dhe Pajtim në Europën Juglindore (Selanik, Greqi); anëtar themelues dhe ish-zëvendëspresident i Asamblesë së Qytetarëve të Helsinkit (Turqi). Gjithashtu, është anëtar i bordeve këshilluese redaktoriale në këto organe: Revista e Studimeve Fshatare, Revista e Ndryshimit Agrar, Revista e Studimeve të Europës Juglindore dhe Detit të Zi. Botimet kryesore (në turqisht): “Ideologjia republikane dhe (historiani) Fuat Koprulu”; “Nga fisi në feudalizëm”, “Fundi i një Ere” dhe (në anglisht): “Qasje të reja ndaj shtetit dhe fshatarësisë në historinë osmane” (1991, në bashkëpunim me Suraija Faroqhi). Interesat aktuale studimore: Historiografia, qasje krahasimore për nacionalizmat në Ballkan, ndërtimi fillestar dhe ripërkufizimi qemalist i kujtesës kombëtare turke mes traumave kombndërtuese dhe spastrimeve etnike të fillimshkullit të 20-të.

Bogdan Murgescu, ka lindur më 1963 në Bukuresht, është profesor në Fakultetin e Historisë në Universitetin e Bukureshtit; i është akorduar bursa Herzog Roman nga Fondacioni Aleksander von Humboldt në Berlin (1998-2000) dhe ka dhënë mësim si Profesor i Ftuar në Universitetin e Pitsburgut (2002) dhe në Universitetin e Europës Qendrore në Budapest (2004). Gjithashtu, është president i Degës së Bukureshtit dhe zëvendëspresident në rang kombëtar i Shoqërisë Rumune për Studimet Historike, koordinitor kombëtar i konkursit të kërkimeve historike *ISTORIA MEA-EUSTORY* dhe anëtar i Komitetit Ekzekutiv të Rrjetit EUSTORY. Ka botuar një sërë studimesh akademike dhe disa libra për historinë e Rumanisë, për marrëdhëniet osmano-rumune, për historinë ekonomike e sociale të shekujve XV-XX dhe historiografinë e kohëve të fundit. Gjithashtu ka drejtuar botimin e 5 vëllimeve, midis të cilave *Rumania dhe Europa: Modernizimi si tundim, Modernizimi si kërcënim* (Bukuresht 2000) dhe *Historia rumune në tekste* (Bukuresht 2001).

Libri i punës 2 – Kombet dhe shtetet në EJJ

Mirela-Luminita Murgesku është profesore e asociuar në Fakultetin e Historisë në Universitetin e Bukureshtit; është gjithashtu drejtore ekzekutive e Qendrës për Studime Historike, Ekonomike e Sociale, Bukuresht, dhe anëtare e Komitetit të Mësimdhënies së Historisë të Qendrës për Demokraci dhe Pajtim në Europën Juglindore, Selanik. Ka marrë pjesë në një sërë projektesh ndërkombëtare në fusha si analiza e teksteve shkollore, mësimdhënia e historisë, historiografia, kultura historike dhe nacionalizmi, dhe i janë akorduar bursa prej Fondacionit Andrew F. Mellon, Deutscher Akademischer Austauschdienst (DAAD) dhe Maison des Sciences de l'Homme dhe Fondacionit European të Shkencës. Përveç studimeve të shumta akademike dhe kapitujve nëpër libra, ka redaktuar katër vëllime dhe ka botuar *“Midis ‘të krishterit të mirë’ dhe ‘rumunit të guximshëm’*. Roli i shkollës fillore në ndërtimin e identitetit kombëtar rumun” (Jashi, 1999) dhe *“Histori nga çanta e shkollës. Kujtesa dhe librat e shkollës gjatë viteve 1990-të”*, Bukuresht 2004.

Libri i Punës 3 – Luftërat Ballkanike

Valeri Kamenov Kolev, ka lindur më 1960 në Plovdiv, Bullgari. Ka marrë titullin *Master në Histori* dhe një master tjetër në anglisht nga Universiteti i Sofjes, 1986. Është lektor i Historisë Moderne Bullgare (1878-1944) në Universitetin e Sofjes prej 1988 dhe në Akademinë Kombëtare të Arteve të Bukura në Sofje, që prej vitit 1999. Doktoraturën në histori e ka marrë më 2001. Është anëtar i Bordit Redaktorial të revistës historike *“Minalo”* (që prej vitit 1994). Është anëtar i komiteteve të kurrikulave në histori dhe edukim qytetar në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës. Është bashkautor i tekstit të Historisë për klasën e 10-të. Fushat kryesore të interesit janë: shteti dhe qeverisja lokale, jeta politike e sociale, dhe politika e jashtme.

Libri i Punës 4 – Lufta II Botërore

Kreshmir Erdelja ka lindur në Zagreb më 1968. Ka studiuar Histori e Gjeografi në Universitetin e Zagrebit, ku është diplomuar me temën *“Qëndrimi i Shtetit të Pavarur të Kroacisë (NDH) ndaj shkrimtarëve dhe letërsisë”*. Interesi i tij kryesor akademik është historia e shekullit të njëzetë. Punon si mësues historie në një shkollë fillore në Zagreb. Është përfshirë në shkrimin e teksteve shkollore të historisë. Është autori i tekstit të historisë dhe i një përmbledhjeje me lexime për klasën e shtatë të shkollës tetëvjeçare dhe vitit të parë të shkollës së mesme.

Kontribuesit

Boro BRONZA,

Hulumtues në fushën e historisë, Banja Luka, Bosnjë e Hercegovinë.

Helian DEMIRI,

Lektor në Universitetin "Aleksandër Xhuvani", Shqipëri.

Ljupka HRISTOVA,

Mësuese historie, Maqedoni.

Nikola JORDANOVSKI,

Kandidat për titullin doktor në Shkollën Pasuniversitare për Studime Sociale, Varshavë, i lindur në Maqedoni.

Niyazi Mustada KIZILYUREK,

Profesor i asociuar në Universitetin e Qipros, Departamenti i Studimeve Turke.

Angelos KYRIAKOUDIS,

Mësues historie, Qipro.

Bogdan Florin POPOVICI,

Dega e Qarkut të Brasovit të Arkivave Kombëtare, kandidat për titullin doktor në Institutin e Historisë të Bukureshtit, Rumani.

Božo REPE,

Profesor në Departamentin e Historisë, Universiteti i Lubljanës, Slloveni.

Milan RISTOVIC,

Profesor, Fakulteti i Filozofisë në Universitetin e Beogradit dhe kryetar i Shoqatës për Historinë Sociale, Serbi e Mal i Zi.

Araks SAHINER,

Doktor shkencash në fushën e historisë, Kryetar i Departamentit të Shkencave Sociale në Shkollat MEF, Turqi.

Andrei SORA,

Redaktor revistash historike, Bukuresht, Rumani.

Vladimir Georgiev STANEV,

Kandidat për titullin doktor në Universitetin e Sofjes, Departamenti i Historisë, dhe mësues historie në Shkollën e Matematikës në Sofje, Bullgari.

Igor STOJAKOVIC,

Mësues historie dhe bashkautor i teksteve të historisë për shkollat tetëvjeçare, Zagreb, Kroaci.

Lina VENTURA,

Profesor i asociuar në Departamentin e Politikave Sociale dhe Arsimore, Universiteti i Peloponezit, Greqi.

Lista e mësuesve të Historisë

Kresimir Alajbeg, Zagreb

Arzy Aydin, Stamboll

Marilena Bercea, Bukuresht

Hristo Berov, Sofie

Radu Cerkez, Bukuresht

Emina Dautovic, Beograd

Bojana Dujkovic, Banja Luka

Irena Lilkova Garkova,

Plovdiv Entela Jorgji, Tiranë

Alma Kasaruho, Tiranë

Hayrettin Kaya, Stamboll

Yordanka Hristova Karaguerova, Sofje

Snjezana Koren, Zagreb

Davor Koznjak, Zagreb

Eliza Kyriakou, Nikozia

Angelos Kyriakoudes, Limasol

Maria Kyriazi, Selanik

Anastasia Kyrkini-Koutoula, Athinë

Margita Madunic, Zagreb

Codruta Matei, Bukuresht

Valentina Maver, Lubljanë

Mire Mladenovski, Shkup

Nada Molerovik, Shkup

Sorin Oane, Ramnicu-Valcea

Nuket Oren, Stamboll

Valentin Maxim Oros,

Kluzh Mutlu Ozturk, Stamboll

Adrian Papajani, Tiranë

Maria Philipidou, Pafos

Nicu Pohoata, Bukuresht

Jelka Razpotnik, Lubjanë

Vassiliki Sakka, Athinë

Ljupka Smilanovska, Shkup

Nevenka Sres, Lubjanë

Angela Tongal, Stamboll

Fatmiroshe Xhemali, Tiranë

Nenad Zarkovic, Beograd

Maria Zografaki, Ksanthi



PERANDORIA OSMANE RRETH VITI 1600

Franca	Shtet i pavarur	Sofja *	Qytet	c.	Shtet
Libani	Shtet nën varësi	Mantova □	Qytet - shtet	d.	Dukat
Hungaria	Ndarja e shtetit	Monferrat □	Qytet - shtet në varësi	gd	Dukat i madh
EJALETI	Provincë	Spoleta □	Qytet provincial	K.	Mbretëri
Banu Sellab	Popullsi	S. Narshah	Sanxhak	E.	Ejalet

Shënim:
Të gjithë ejalet osmane janë shkruar me shkronja të mëdha. Për shtetet nën varësi, ngjyra përkatëse tregon varësinë e tyre



JEPNI VLERËSIMIN TUAJ PËR KËTË LIBËR!

Mendimi juaj si lexues është me shumë rëndësi për ne, në mënyrë që të vlerësojmë punën e bërë dhe të planifikojmë nismat tona të ardhshme. Qendra për Demokraci dhe Pajtim në Europën Juglindore (CDRSEE), së bashku me një numër kolegësh dhe bashkëpunëtorësh kanë kryer një punë të madhe dhe kanë shfrytëzuar burime të çmuara për projektin “Mësimdhënia e Historisë Moderne të Europës Juglindore”, rezultat i të cilit është ky libër që keni në duar. Në mënyrë që të vlerësojmë frytshmërinë e metodës së përdorur, dobinë e kësaj sipërmarrjeje dhe vlerën e punës sonë, do të dëshironim që të jepnit vlerësimin tuaj për këtë projekt. Ju lutemi, na jepni opinionin tuaj të sinqertë, duke na kushtuar pak kohë dhe kujdes nga ana juaj.

Pasi ta lexoni këtë libër ose ta keni përdorur në klasë, ju lutemi, shkoni në faqen tonë të internetit, dhe tek seksioni “Librat e Punës të Historisë” plotësoni një formular vlerësimi. Formularin e vlerësimit mund ta gjeni në adresën: <http://www.cdsee.org/jhp/index.html>

Nëse dëshironi, mund të na shkruani në adresën elektronike: info@cdrsee.org dhe komentet tuaja do t’i dërgohen drejtpërsëdrejti njërit prej koordinatorëve të PHP-së.

Gjithashtu, mund të na shkruani edhe në adresën postare:

Center for Democracy and Reconciliation in Southeast Europe (CDRSEE)
Krispou 9, Ano Poli, 54634 Thessaloniki, Greece

